

Liahona

Fjalime në Konferencën e Përgjithshme

U Mbështetën Dy
Apostuj të Rinj

U Mbështetën Autoritete
të Reja të Përgjithshme
dhe Drejtuese të Reja
të Përgjithshme të
Organizatave Ndhmëse

U Njoftuan Shtatë
Tempuj të Rinj





Presidenca e Parë

Presidenti Rasëll M. Nelson (në qendër) u mbështet si Presidenti i 17-të i Kishës gjatë Konferencës së Përgjithshme Vjetore të 188-të. Këshilltarët e tij në Presidencën e Parë janë Presidenti Dallin H. Oaks (majtas) dhe Presidenti Henri B. Ayring.

Sesioni i Paradites të së Shtunës

- 6 **Kuvendi Solemn**
Presidenti Henri B. Ajring
- 9 **Dhurata të Çmuara nga Perëndia**
Presidenti M. Rasëll Ballard.
- 12 **A Jam Unë Fëmijë i Perëndisë?**
Plaku Brajën K. Tejlor
- 15 **Sikundër Krishti ju Fal, ashtu Bëni edhe Ju**
Plaku Leri J. Eko Houk
- 17 **Zemra e një Profeti**
Plaku Geri E. Stivenson
- 21 **Deri Shtatëdhjetë Herë Shtatë**
Plaku Lin G. Robins
- 24 **Profeti i Perëndisë**
Plaku Nil L. Andersen

Sesioni i Pasdites të së Shtunës

- 28 **Mbështetja e Drejtuesve të Kishës**
Presidenti Dallin H. Ouks
- 29 **Raporti i Sektorit të Kontrollit Financiar të Kishës, 2017**
Kevin R. Xhergensen
- 30 **Zemërbutë dhe të Përlulur nga Zemra**
Plaku Dejvid A. Bednar
- 34 **Edhe një Ditë më Shumë**
Plaku Tejlor G. Godoi
- 36 **Të Rejat në Punë**
Boni L. Oskarson
- 39 **Ordinancat Shpëtuese do të na Sjellin Dritë të Mrekullueshme**
Plaku Taniela B. Uakolo
- 42 **Mësimdhënia në Shtëpi – Një Përgjegjësi e Gëzueshme dhe e Shenjtë**
Devin G. Durrant
- 46 **Historia Familjare dhe Puna në Tempull: Vulosja dhe Shërimi**
Plaku Dejll G. Renland

Sesioni i Përgjithshëm i Priftërisë

- 50 **Çfarë Ka Nevojë të Kuptojë Çdo Mbajtës i Priftërisë Aarone**
Daglas D. Holms
- 54 **Fjalët Paraqitëse**
Presidenti Rasëll M. Nelson
- 55 **Kuorumi i Pleqve**
Plaku D. Tod Kristoferson
- 58 **Shih! Një Ushtri Mbret'rore**
Plaku Ronald A. Rasband
- 61 **Dhënia e Frymëzuar e Shërbesës**
Presidenti Henri B. Ajring
- 65 **Fuqitë e Priftërisë**
Presidenti Dallin H. Ouks
- 68 **Dhënia e Shërbesës me Fuqinë dhe Autoritetin e Perëndisë**
Presidenti Rasëll M. Nelson

Sesioni i Paradites të së Dielës

- 75 **Merreni Shpirtin e Shenjtë si Udhërrëfyesin Tuaj**
Plaku Leri Y. Uilson
- 78 **Me një Mendje të Vetme**
Reina I. Aburto
- 81 **Dashuria e Pastër: Shenja e Vërtetë e Çdo Dishepulli të Vërtetë të Jezu Krishtit**
Plaku Masimo De Feo
- 83 **Ai që do të Ngulmojë deri në Fund, do të Shpëtohet**
Plaku Klaudio D. Zivic
- 86 **Të Keni Shpirtin e Tij me Ju**
Presidenti Henri B. Ajring
- 89 **Gjëra të Vogla dhe të Thjeshta**
Presidenti Dallin H. Ouks
- 93 **Zbulesë për Kishën, Zbulesë për Jetën Tonë**
Presidenti Rasëll M. Nelson

Sesioni i Pasdites të së Dielës

- 97 **Zoti Krisht Është Ngritur Sot**
Plaku Gerit W. Gong
- 98 **Profetët Flasin nëpërmjet Fuqisë së Shpirtit të Shenjtë**
Plaku Ulises Soares
- 100 **Dhënia e Shërbesës**
Presidenti Rasëll M. Nelson
- 101 **“Jini me Ta e Forcojini Ata”**
Plaku Xhefri R. Holland
- 104 **Dhënia e Shërbesës ashtu siç e Jep Shpëtimtari**
Xhin B. Bingham
- 107 **Shiheni Njeriun!**
Plaku Diter F. Uhtdorf
- 111 **E Gjitha Ka të Bëjë me Njerëzit**
Peshkopi Zherald Kosë
- 114 **Përgatituni që të Takoni Perëndinë**
Plaku Kuentin L. Kuk
- 118 **Punës Le t'i Vihemi**
Presidenti Rasëll M. Nelson
- 72 **Autoritetet e Përgjithshme dhe Drejtuesit e Përgjithshëm të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme**
- 119 **Raporti Statistikor, 2017**
- 120 **Treguesi i Ngjarjeve në Konferencë**
- 121 **Lajme të Kishës**
- 137 **Eja, Më Ndiq - për Kuorumin e Pleqve dhe Shoqatën e Ndihmës**



Konferenca e Përgjithshme Vjetore e 188-të

Sesioni i Përgjithshëm i Paradites të së Shtunës, 31 Mars 2018

Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring.
Lutja e hapjes: Plaku Mervin B. Arnold.
Lutja e mbylljes: Plaku W. Mark Baset.
Muzika nga Tabernacle Choir [Kori i Tabernakullit]; Mak Uilberg dhe Rajën Mërfi; drejtues; Endrju Ansuorth dhe Klei Kristiansen, organistë: “E Ëmbël Puna”, *Himne*, nr. 85; “T’Falemi, Per’ndi, për Profetin”, *Himne*, nr. 13, përsht. Wilberg; “Dëgjojm’ Zën’ e një Profeti”, *Himne*, nr. 16, përsht. Murphy; “Para, Shenjtor”, *Himne*, nr. 39; “Tell Me the Stories of Jesus” [“Tregom’ Ngjarjet e Jezusit”], *Children’s Songbook*, f. 57, përsht. Murphy; “Rron Shëlbuesi Im”, *Himne*, nr. 73, përsht. Wilberg.

Sesioni i Përgjithshëm i Pasdites të së Shtunës, 31 Mars 2018

Drejtimi: Presidenti Dallin H. Ouks.
Lutja e hapjes: Plaku Mark A. Breg.
Lutja e mbylljes: Plaku Pitër F. Mërs.
Muzika nga një kor i bashkuar i studentëve nga institutet e fesë në zonën e Solt-Lejk-Siit në Jutë; Marshall Mek-Donald dhe Riçard Decker, drejtues; Linda Margets dhe Boni Gudlif, organiste: “Eja, Zën’ e Profetit D’gjo”, *Himne*, nr. 15, përsht. Matthews dhe Goodliffe; “Ku Mund të Gjej Paqë?” *Himne*, nr. 67, përsht. McDonald dhe Parker; “T’Drejtën Zgjidh”, *Himne*, nr. 150; potpuri, përsht. McDonald: “Si Rini e Sionit Sot”, *Himne*, nr. 164 dhe “Shufra e Hekurt”, *Himne*, nr. 179; “Do Shkoj Ku Ti Do që të Shkoj”, *Himne*, nr. 173, përsht. Wilberg.

Sesioni i Përgjithshëm i Priftërisë së Mbrëmjes të së Shtunës, 31 Mars 2018

Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring.
Lutja e hapjes: M. Xhozef Brof.
Lutja e mbylljes: Plaku K. Bret Natres.
Muzika nga një kori i priftërisë nga Universiteti “Brigam Jang” – Ajdaho, Randall Kempton, Pol Basëllberg dhe Dejvid Lozano-Torres, drejtues; Brajën Matias dhe Endrju Ansuorth organistë: “Sa i Fort’ një Themel”, *Himne*, nr. 41, përsht. Busselberg, bot. nga Sharpe Music Press; “Ati në Qiell”, *Himne*, nr. 71, përsht. Busselberg, bot. nga Sharpe Music Press; “Praise to the Lord, the Almighty” [“Lavdi Zotit, të Plotfuqishmit”], *Hymns*, nr. 72; “Burra t’Per’ndis’ Ço’unil!”, *Himne*, nr. 209.

Sesioni i Përgjithshëm i Paradites të së Dielës, 1 Prill 2018

Drejtimi: Presidenti Rasëll M. Nelson.
Lutja e hapjes: Plaku S. Mark Palmer.
Lutja e mbylljes: Plaku Hoakin E. Kosta.
Muzika nga Mormon Tabernacle Choir [Kori Mormon i Tabernakullit]; Mak Uilberg, drejtues; Klei Kristiansen dhe Riçard Eliot, organistë: “Në K’të Dit’ Hareje, G’zimi”, *Himne*, nr. 33; “Zoti Krisht Ësht’ Ngritur Sot”, *Himne*, nr. 119, përsht. Wilberg; “He Sent His Son” [“Ai Dërgoi Birin e Tij”] *Children’s Songbook*, f. 34–35, përsht. Hoffheins; “Gëzim, Zoti Ësht’ Mbret!” *Himne*, nr. 35; “Ai Ësht’ Ngritur!” *Himne*, nr. 118, përsht. Wilberg, bot. nga Oxford University Press.

Sesioni i Përgjithshëm i Pasdites të së Dielës, 1 Prill 2018

Drejtimi: Presidenti Dallin H. Ouks.
Lutja e hapjes: Plaku Uedhërford T. Klejton.
Lutja e mbylljes: Plaku Valeri V. Kordon.
Muzika nga Mormon Tabernacle Choir [Kori Mormon i Tabernakullit]; Mak Uilberg dhe Rajan Mërfi, drejtues; Riçard Eliot dhe Brajën Matias, organistë: “Shkëlqen Fort Mëshir’ e Atit”, *Himne*, nr. 213, përsht. Murphy; “Pranë Zemrës së Bariut”, *Himne*, nr. 138, përsht. Wilberg; “Shëlbues i Izraelit”, *Himne*, nr. 6;

“Doni Njëri-Tjetrin”, *Himne*, nr. 203, përsht. Wilberg; “Punës Le t’i Vihemi”, *Himne*, nr. 154, përsht. Elliott, bot. nga Jackman.

Mundësohen Bisedat e Konferencës

Për të gjetur biseda të konferencës së përgjithshme në internet në shumë gjuhë, vizitoni faqen conference.lds.org dhe përzgjidhni një nga gjuhët. Bisedat mundësohen gjithashtu në programin kompjuterik Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit]. Përgjithësisht, brenda gjashtë javëve pas konferencës së përgjithshme, mundësohen gjithashtu regjistrime pamore e zanore në anglisht në qendrat e shpërndarjes. Informacioni për konferencën e përgjithshme në formate të përdorshme nga anëtarë me paaftësi, mundësohet në faqen disability.lds.org.

Në Kapak

Përpara: Fotografi nga Leslie Nilsson.
Prapa: Fotografi nga Cody Bell.

Fotografimi i Konferencës

Fotografitë në Solt-Lejk-Siti u bënë nga Cody Bell, Janae Bingham, Mason Coberly, Randy Collier, Weston Colton, Alessandra DeAgostini, Ashlee Larson, Brian Nicholson, Leslie Nilsson, Matt Reier, Christina Smith, Dave Ward dhe Mark Weinberg.



**MAJ 2018 VËLL. 20 NR. 3
LIAHONA 14751 101**

Revista ndërkombëtare zyrtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Presidenca e Parë: Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, Henri B. Ajring

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve: M. Rasëll Ballard, Xhefri R. Holland, Diter F. Uhtdorf, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen, Ronald A. Rasband, Geri E. Stivenson, Dejll G. Renland, Gerit W. Gong, Ulises Soaresh

Kryeredaktor: Hugo E. Martinez

Ndihmësredaktorë: Randall K. Bennett, Carol F. McConkie

Këshilltarë: Brian K. Ashton, Bonnie H. Cordon, LeGrand R. Curtis Jr., Edward Dube, Sharon Eubank, Donald L. Hallstrom, Douglas D. Holmes, Erich W. Kopsischke

Drejtor Përgjegjës: Richard I. Heaton

Drejtor i Revistave të Kishës: Allan R. Loyborg

Përgjegjës i Punëve: Garff Cannon

Redaktor Përgjegjës: Adam C. Olson

Ndihmësredaktor Përgjegjës: Ryan Carr

Ndihmëse e Botimit: Francisca Olson

Grupi i Shkrimit dhe i Redaktimit: Maryssa Dennis, David Dickson, David A. Edwards, Matthew D. Flitton, Lori Fuller, Garrett H. Garff, LaRene Porter Gaunt, Jon Ryan Jensen, Charlotte Larcabal, Michael R. Morris, Eric B. Murdock, Sally Johnson Odekirk, Joshua J. Perkey, Jan Pinborough, Richard M. Romney, Mindy Selu, Chakell Wardleigh, Marissa Widdison

Drejtor Përgjegjës i Artit: J. Scott Knudsen

Drejtor Artit: Tadd R. Peterson

Grupi i Dizajnimit: Jeanette Andrews, Fay P. Andrus, Mandie Bentley, C. Kimball Bott, Thomas Child, David Green, Colleen Hincley, Eric P. Johnsen, Susan Lofgren, Scott M. Mooy, Emily Chieko Remington, Mark W. Robison, Brad Teare, K. Nicole Walkenhorst

Bashkërenduese për Pronësinë Intelektuale:

Collette Nebeker Aune

Përgjegjëse e Prodhimit: Jane Ann Peters

Grupi i Prodhimit: Ira Glen Adair, Julie Burdett, Thomas G. Cronin, Bryan W. Gysi, Ginny J. Nilson, Derek Richardson

Përgatitja për Shtyp: Joshua Dennis, Ammon Harris

Drejtor Shtypi: Steven T. Lewis

Drejtor i Shpërndarjes: Troy R. Barker

Mbikëqyrës i Përkthimit Shqip: Sparti Kashari

Për pajtimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, shkoni në store.lds.org ose kontaktoni me qendrën tuaj vendore të Kishës për shpërndarjen ose me udhëheqësin e lagjes apo degës

Paraqitini dorëshkrimet dhe pyetjet në internet në liahona.lds.org; nëpërmjet postës elektronike liahona@ldschurch.org; ose nëpërmjet postës në *Liahona*, Rm. 2420, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150-0024, USA.

Liahona (një term nga Libri i Mormonit, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamsisht, bullgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fixhisht, finlandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, islandisht, italisht, japonisht, kambodhisht, kinezisht, kiribatisht, koreanisht, kroatisht, letonisht, lituanisht, malagasisht, marshallisht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, samoaisht, sebuanisht, sillovenisht, spanjisht, suahilisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tongaisht, ukrainisht, urdisht dhe vietnamisht. (Periodiciteti ndryshon sipas gjuhës.)

© 2018 nga Intellectual Reserve, Inc. I rezervohen të gjitha të drejtat. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Informacion për të drejtën e autorit: Përveç nëse sugjerohet ndryshe, individët mund të kopjojnë material nga *Liahona* për përdorimin e tyre vetjak, jo për tregti (përfshirë për thirrjet në Kishë). Kjo e drejtë mund të anulohet në çdo kohë. Lënda figurative nuk lejohet të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime të shënimi i meritave për punën artistike. Çështjet e së drejtës së autorit duhet të drejtohen tek Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., FL 13, Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: cor-intellectualproperty@ldschurch.org.

For Readers in the United States and Canada: May 2018 Vol. 20 No. 3. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753), is published six times a year (January, April, May, July, October, and November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150. USA subscription price is \$3.00 per year; Canada, \$3.60 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address must be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone or at store.lds.org. (Canada Poste Information: Publication Agreement #40017431) POSTMASTER: Send all UAA to CFS (see DMM 507.1.5.2). NONPOSTAL AND MILITARY FACILITIES: Send address changes to Distribution Services, Church Magazines, P.O. Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368, USA.



Treguesi i Folësve

Aburto, Reina I., 78
Ajring, Henri B., 6, 61, 86
Andersen, Nil L., 21
Ballard, M. Rasëll, 9
Bednar, Dejvid A., 30
Bingham, Xhin B., 104
De Feo, Masimo, 81
Durrant, Devin G., 42
Eko Houk, Leri J., 15
Godoi, Tejlor G., 34
Gong, Gerit W., 97
Holland, Xhefri R., 101
Holms, Daglas D., 50
Kosé, Zherald, 111
Kristoferson, D. Tod, 55
Kuk, Kuentin L., 114
Nelson, Rasëll M., 54, 68, 93, 100, 118
Oskarson, Boni L., 36
Ouks, Dallin H., 28, 65, 89
Rasband, Ronald A., 58
Renland, Dejll G., 46
Robins, Lin G., 21
Soares, Ulises, 98
Stivenson, Geri E., 17
Tejlor, Brajeni K., 12
Uakolo, Taniela B., 39
Uhtdorf, Diter F., 107
Uilson, Leri Y., 75
Xhergensen, Kevin, R., 29
Zivic, Klaudio D., 83

Treguesi Tematik

Atësia, 65
Besëlidhjet, 39, 83, 97, 111, 118
Besimi, 9, 24, 50, 86, 98, 118
Bindja, 24, 83, 86, 89
Dashuria, 54, 78, 81, 86, 100, 101, 104
Dashuria Hyjnore, 61
Denjësia, 65, 75
Dishepullimi, 36, 81, 104, 107, 111, 118
Drejtësia, 114
Dhënia e Shërbesës, 54, 55, 58, 61, 68, 78, 86, 100, 101, 104, 111
Falja, 15, 21, 81
Familja, 42, 65
Fatkeqësia, 107
Fëmijët, 12, 42
Fryma e Shenjtë, 75, 86, 93, 98
Gëzimi, 34
Hiri, 21
Historia familjare, 36, 46, 114
Jezu Krishti, 9, 12, 15, 21, 24, 30, 34, 39, 75, 78, 81, 83, 86, 89, 93, 97, 98, 104, 107, 111
Jozef Smithi, 12, 39, 86, 93, 97
Konferenca e përgjithshme, 118
Korumet e priftërisë, 54, 55, 58, 61, 104
Krenaria, 30
Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve, 17, 93
Kuvendi solemn, 6, 17, 24, 93
Libri i Mormonit, 12
Lutja, 42, 75, 78, 83, 86, 93
Mëmësia, 12
Mësimdhënia, 17, 42, 50
Mësimi i shtëpisë, 100, 101
Natyra hyjnore, 12, 30
Ndjekja e profetit, 17, 24, 58, 98
Ordinancat, 39, 46, 50, 97, 114, 118

Organizimi i Kishës, 17, 58, 101
Pashka, 93, 97, 107
Pendimi, 21, 24, 50, 75, 83, 89, 107
Përendia, Ati, 12, 78, 81
Përgatitja, 114
Përgjegjshmëria, 36, 114
Përulësia, 30, 86
Plani i shpëtimit, 34, 81
Presidenca e Parë, 17, 93
Priftëria, 65, 68, 100
Priftëria Aarone, 50
Priftëria Melkizedeke, 55, 58, 65
Profetët, 9, 17, 24, 30, 97, 98
Puna misionare, 114
Puna në tempull, 36, 46, 114, 118
Qëndrueshmëria, 83
Ringjallja, 89, 97, 107
Rinia, 104
Sakramenti, 9, 21, 39, 83
Sakrifika, 34
Studimi i shkrimeve të shenjta, 12, 42, 83
Suksesi, 21
Shabati, 9
Shërbimi, 9, 36, 54, 55, 61, 65, 68, 78, 81, 101, 104
Shërimi, 46
Shlyerja, 12, 15, 34, 39, 50, 81, 93, 97, 107
Shoqata e Ndhmës, 100, 104
Shtëpia, 42, 111
Tempujt, 97
Të Rejat, 36, 100
Të Rinjtë, 36
Thirrjet në Kishë, 65, 93
Uniteti, 58, 78, 114
Vdekja, 107
Vizitat mësimore, 100, 101
Zbulesa, 75, 93
Zemërbutësia, 30



Pjesë të spikatura nga Konferenca e Përgjithshme Vjetore e 188-të

Kjo konferencë e përgjithshme ishte historike për shumë arsye, përfshirë ristrukturimin e kuorumeve të Priftërisë Melkizedeke dhe fillimin e një epoke të re për dhënien e shërbesës. Por ndoshta ngjarja më e shumëpritur ishte mundësia jonë vetjake për ta mbështetur Presidentin Rasëll M. Nelson si Presidentin e 17-të të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Një Kuvend Solemn

Kur ne u ngritëm në këmbë dhe e mbështetëm një profet dhe President të ri, duart tona të ngritura nuk u numëruan nga ndonjë mbajtës njerëzor analet; ato u shënuan në qiell si një besëlidhje me Perëndinë.

Gjatë gjithë konferencës, pamë prova se kjo është Kisha e Shpëtimtarit, e udhëhequr prej Tij nëpërmjet shërbëtorëve të Tij. Ne dëshmuam pozicionin që një profet i gjallë zë në lidhje me secilin prej nesh – jo duke qëndruar ndërmjet nesh dhe Shpëtimtarit, por duke qëndruar përkrah nesh dhe duke treguar rrugën drejt Shpëtimtarit. Përjetuam mundësinë për të marrë një “dëshmi vetjake se thirrja e Presidentit

Nelson është nga Perëndia” dhe për ta hedhur spirancën e “shpirtit tonë të Zoti Jezu Krisht [duke i] dëgj[uar] ata që Ai i dërgon” (shih nga Plaku Nil L. Andersen në faqen 26).

- Ju mund të mësoni më shumë mbi Presidentin Nelson në shtojcën e veçantë prej 16 faqesh që shoqëron botimet e majit 2018 të revistave *Ensign* dhe *Liahona*.

Mbështetja e Udhëheqësve të Rinj

Përveç mbështetjes të Presidentit Nelson, ne mbështetëm më shumë se 70 udhëheqës të rinj.

- Gjejini një listë të njerëzve të mbështetur, përfshirë Të Shtatëdhjetët Zonalë të rinj, në faqet 6–8, 28–29.
- Lexojini biografitë e shkurtra të udhëheqësve të rinj duke filluar nga faqja 121.

Ndryshimet në Kuorume dhe në Dhënien e Shërbesës

Edhe pse të mbikëqyrura nga profetët, ndryshimet e njoftuara gjatë konferencës “janë shembuj të zbulesave [nga Perëndia] që e kanë udhëhequr këtë Kishë që prej fillimit të

saj”, tha Plaku Xhefri R. Holland (shih faqen 101).

- Lexojini udhëzimet mbi ristrukturimin e kuorumeve, nga Presidenti Nelson, Plaku D. Tod Kristoferson dhe Plaku Ronald A. Rasband, duke filluar nga faqja 54.
- Lexojini udhëzimet mbi dhënien e shërbesës, nga Presidenti Nelson, Plaku Holland dhe Motra Xhin B. Bingham, duke filluar nga faqja 100.
- Gjeni më shumë informacion mbi këto ndryshime dhe burime udhëzuese në pjesën e lajmeve në faqet 132–133.

Tempuj të Tjerë

Për ta theksuar “mesazhi[n] tonë] drejtuar botës” që “ne i ftojmë të gjithë fëmijët e Perëndisë në të dyja anët e velit të vijnë te Shpëtimtari i tyre, të marrin bekimet e tempullit të shenjtë, të kenë gëzim të përhershëm dhe të kualifikohen për jetën e përjetshme”, Presidenti Nelson njoftoi shtatë tempuj të rinj.

- Gjejini se ku do të jenë vendndodhjet e shtatë tempujve të rinj në faqen 133. ■





Paraqitur nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë



Kuvendi Solemn

Vëllezër dhe motra, Presidenti Nelson ka kërkuar që unë të merrem me çështjen e kuvendit solemn për të cilin jemi mbledhur sot.

Ky është një rast me rëndësi të madhe për anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme në mbarë botën.

Duke filluar nga data 10 tetor 1880, kur Xhon Tejlori u mbështet që ta pasonte Brigam Jangun si profet, shikues dhe zbulues dhe si President të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, secili prej këtyre rasteve është emërtuar si një kuvend solemn formal i trupës së Kishës për të shprehur zërin e Kishës.

Do të votojmë sipas kuorumeve dhe grupeve. Kudo që të jeni, ju ftojme të ngriheni në këmbë vetëm kur t'ju kërkohet dhe ta shprehni duke ngritur dorën se zgjidhni t'i mbështetni ata njerëz emrat e të cilëve do të paraqiten. Duhet të votoni vetëm kur t'ju kërkohet të ngriheni në këmbë.

Autoritetet e Përgjithshme të caktuar në Tabernakull dhe në Sallën e Asamblesë në Sheshin e Tempullit do ta vëzhgojnë votimin në ato godina. Në qendrat e kunjeve, një anëtar i presidencës së kunjit do ta vëzhgojë votimin. Nëse ndokush jep një votë kundër, ai individ duhet të vihet në kontakt me presidentin përkatës të kunjit të vet.

Tani do të vijojmë me punimet. Sërish, ju lutemi, ngrihuni në këmbë

dhe votoni vetëm kur t'ju kërkohet ta bëni këtë.

U lutemi anëtarëve të Presidencës së Parë që të ngrihen.

Propozohet që Presidenca e Parë ta mbështetë Rasëll Marion Nelsonin si profet, shikues dhe zbulues, dhe si President të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

U lutemi anëtarëve të Presidencës së Parë që janë dakord, ta shfaqin atë.

Propozohet që Presidenca e Parë t'i mbështetë Dallin Harris Ouksin si Këshilltar të Parë dhe Henri Benion Ajringun si Këshilltar të Dytë në Presidencën e Parë të Kishës.

Ata anëtarë të Presidencës së Parë





që janë dakord, mund ta shfaqin atë.

Propozohet që Presidenca e Parë ta mbështetë Dallin Harris Ouxsin si President të Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve dhe Melvin Rasëll Ballardin si President Veprues të Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve.

Anëtarët e Presidencës së Parë që janë dakord, mund ta shfaqin atë.

Propozohet që Presidenca e Parë të mbështetë si anëtarë të Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve: M. Rasëll Ballard, Xhefri R. Holland, Diter F. Uhtdorf, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen, Ronald A. Rasband, Geri E. Stivenson, Dejll G. Renland, Gerit Uollter Gong dhe Ulises Soares.

U lutemi anëtarëve të Presidencës

së Parë, ta shfaqin atë.

Propozohet që Presidenca e Parë t'i mbështetë këshilltarët në Presidencën e Parë dhe Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve si profetë, shikues e zbulues.

U lutemi anëtarëve të Presidencës së Parë, ta shfaqin atë.

Presidenca e Parë tani do të ulet.

I ftojme Plakun Gong dhe Plakun Soares të zënë vendet e tyre në Kuorumin e Të Dymbëdhjetëve.

U lutemi vetëm anëtarëve të Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve, përfshirë Plakun Gong dhe Plakun Soares, që të ngrihen.

Propozohet që Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve ta mbështetë Rasëll Marion Nelsonin si profet, shikues dhe zbulues, dhe si President të Kishës së

Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, së bashku me këshilltarët e tij dhe anëtarët e Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve siç u paraqitën dhe u votuan nga Presidenca e Parë.

U lutemi anëtarëve të Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve që janë dakord, ta shfaqin atë.

Ju mund të uleni.

U lutemi Autoriteteve të Përgjithshme Të Shtatëdhjetë dhe anëtarëve të Peshkopatës Kryesuese që të ngrihen.

Propozohet që të gjithë Autoritetet e Përgjithshme Të Shtatëdhjetë dhe anëtarët e Peshkopatës Kryesuese, ta mbështetin Rasëll Marion Nelsonin si profet, shikues dhe zbulues, dhe si President të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme,



së bashku me këshilltarët e tij dhe anëtarët e Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve, siç u paraqitën dhe u votuan nga Presidenca e Parë.

U lutemi të gjithë Autoriteteve të Përgjithshme Të Shtatëdhjetë dhe anëtarëve të Peshkopatës Kryesuese që janë dakord, ta shfaqin atë.

Ju mund të uleni.

U lutemi atyre sa vijnë, kudo ku mund të jenë në mbarë botën: të gjithë Të Shtatëdhjetëve Zonalë, patriarkëve, priftërinjve të lartë dhe pleqve të shuguruar, që të ngrihen.

Propozohet që Rasëll Marion Nelsoni të mbështetet si profet, shikues dhe zbulues, dhe si President i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, së bashku me këshilltarët e tij dhe anëtarët e Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve siç u paraqitën dhe u votuan.

U lutemi të gjithë atyre që janë dakord, ta shfaqin atë.

Ndonjë kundër, mund ta shfaqë po ashtu.

Ju lutemi, uleni.

U lutemi të gjitha anëtareve të Shoqatës së Ndhmës – domethënë të gjitha grave të moshave 18 vjeçe e lart, që të ngrihen.

Propozohet që Rasëll Marion Nelsoni të mbështetet si profet, shikues dhe

zbulues, dhe si President i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, së bashku me këshilltarët e tij dhe anëtarët e Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve siç u paraqitën dhe u votua më parë.

U lutemi të gjitha atyre që janë dakord, ta bëjnë të ditur duke ngritur dorën.

Ndonjë kundër, mund ta bëjë të ditur po ashtu.

Ju mund të uleni.

U lutemi atyre që mbajnë vetëm Priftërinë Aarone – domethënë të gjithë priftërinjve, mësuesve dhe dhjakëve të shuguruar, që të ngrihen.

Propozohet që Rasëll Marion Nelsoni të mbështetet si profet, shikues dhe zbulues, dhe si President i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, së bashku me këshilltarët e tij dhe anëtarët e Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve siç u paraqitën dhe u votua më parë.

U lutemi të gjithë atyre që janë dakord, ta bëjnë të ditur duke ngritur dorën.

Ndonjë kundër, mund ta bëjë të ditur po ashtu.

Ju mund të uleni.

U lutemi të rejave të moshave 12 deri 18 vjeçe, që të ngrihen.

Propozohet që Rasëll Marion

Nelsoni të mbështetet si profet, shikues dhe zbulues, dhe si President i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, së bashku me këshilltarët e tij dhe anëtarët e Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve siç u paraqitën dhe u votua më parë.

U lutemi të gjitha atyre që janë dakord, ta bëjnë të ditur duke ngritur dorën.

Ndonjë kundër, mund ta bëjë të ditur po ashtu.

Ju mund të uleni.

Tani u lutemi të gjithë anëtarëve, kudo ku mund të ndodhen, përfshirë të gjithë ata që u ngritën në këmbë më parë, që të ngrihen.

Propozohet që Rasëll Marion Nelsoni të mbështetet si profet, shikues dhe zbulues, dhe si President i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, së bashku me këshilltarët e tij dhe anëtarët e Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve siç u paraqitën dhe u votuan.

U lutemi të gjithë atyre që janë dakord, ta bëjnë të ditur duke ngritur dorën.

Ndonjë kundër, mund ta bëjë të ditur po ashtu.

Të gjithë mund të uleni.

Faleminderit, vëllezër dhe motra, për dashurinë dhe përkrahjen tuaj. ■



Nga Presidenti M. Rasëll Ballard,
President Veprues i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Dhurata të Çmuara nga Perëndia

Jeta mund të mbushet me besim, gëzim, lumturi, shpresë dhe dashuri teksa ushtrojmë sasinë më të vogël të besimit të vërtetë të Krishti.

Vëllezërit dhe motrat e mia, sapo kemi marrë pjesë në një kuvend solemn, një praktikë gjurmët e së cilës mund të gjenden në Bibël, kur Izraeli i lashtë u mbledh të ndiente praninë e Zotit dhe të kremtonte bekimet e Tij.¹ Ne kemi privilegjin të jetojmë në një kohë kur kjo praktikë e lashtë është rivendosur nëpërmjet Profetit Jozef Smith.² Ju nxit ta shënoni në ditarin tuaj vetjak se çfarë ndiet lidhur me këtë rast, më të shenjtin, në të cilin keni marrë pjesë.

Kohët e fundit i dhamë lamtumirën mikut dhe profetit tonë të dashur, Presidentit Tomas S. Monson. Edhe pse të gjithëve na merr malli për të, ne i jemi thellësisht mirënjohës Zotit që ka thirrur një profet të ri, Presidentin Rasëll M. Nelson, që të kryesojë mbi Kishën e Tij. Sipas një mënyre të rregull, tani kemi filluar një kapitull të ri në historinë e Kishës sonë. Kjo është një dhuratë e çmuar nga Perëndia.

Kur secili prej nesh e mbështeti Presidentin Nelson nëpërmjet ngritjes së duarve tona, ne vepruam si dëshmitarë përpara Perëndisë dhe e pranuan se ai është pasuesi i ligjshëm i Presidentit Monson. Me duart tona të ngritura,

ne premtuam që t'i bindemi zërit të tij ndërkohë që ai merr udhëzim nga Zoti.

Zoti ka thënë:

“Ju duhet t’u vini veshin fjalëve dhe urdhërimeve të tij [domethënë, të Presidentit të Kishës], që ai do t’ju japë ashtu siç i merr ato . . . ;

Sepse fjalën e tij duhet ta merrni si nga goja ime, plot durim e besim.”³

E kam njohur presidentin dhe profetin tonë të ri për më shumë se 60 vjet. Kam shërbyer me të në Kuorumin e Të Dymbëdhjetëve për 33 vjet dhe jam dëshmitar se dora e Zotit ka qenë duke

e përgatitur atë që të bëhej Apostulli ynë kryesues dhe Profeti ynë për t’i administruar të gjithë çelësat e priftërisë së shenjtë në tokë. Secili prej nesh e mbështetë plotësisht atë dhe këshilltarët e tij dhe e ndjekë drejtimin e tyre. Dhe gjithashtu mirëpresim ngrohtësisht Plakun Gong dhe Plakun Soares si anëtarë të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve.

Pas Ringjalljes së Jezusit, ngjarje të cilën e kremtojmë këtë fundjavë të lavdishme të Pashkës, Ai iu shfaq dishepujve të tij dhe tha: “Paqja me ju! Sikurse më ka dërguar mua Ati, *ashtu unë po ju dërgoj ju.*”⁴ Vini re një veprim me dy faza – Perëndia dërgon Birin e Tij. Biri dërgon shërbëtorët e Tij – burra dhe gra të vdekshme – që ta përmbushin veprën e Tij.

Nuk duhet të habitemi kur dimë që ata individë, të cilët thirren për të bërë punën e Zotit, nuk janë njerëz të përsosur. Histori në shkrimet e shenjtë japin hollësi për raste rreth burrave dhe grave që u thirrën nga Perëndia që të përmbushnin një vepër të madhërrishme – bij dhe bija të mira të Atit tonë Qiellor, të thirrur të shërbenin në detyrat e tyre në Kishë, duke u përpjekur fort që të bënin më të mirën, por prapëseprapë askush prej tyre nuk





ishte i përsosur. E njëjta gjë është e vërtetë për ne sot.

Nisur nga realiteti i dobësive dhe paaftësive tona njerëzore, si mund të shkojmë përpara drejt përkrahjes dhe mbështetjes së njëri-tjetrit? Kjo fillohet me besim – besim të vërtetë, të sinqertë në Zotin Jezu Krisht. Besimi në Shpëtimtarin është parimi i parë i doktrinës dhe i ungjillit të Krishtit.

Disa vite më parë, po vizitoja Tokën e Shenjtë. Teksa kaluam me makinë pranë një bime sinapi, drejtori i Qendrës së UBJ-së në Jerusalem më pyeti nëse kisha parë ndonjëherë një kokërr sinapi. Nuk kisha parë kështu që ndalua. Më tregoi farat prej bimës së sinapit. Çuditërisht ishin të vogla.

Atëherë m'u kujtuan mësimet e Jezusit: "Sepse në të vërtetë, unë po ju them, se po të keni besim sa një kokërr sinapi, do t'i thoni këtij mali: 'Zhvendosuni nga këtu atje', dhe ai do të zhvendoset; dhe asgjë nuk do të jetë e pamundshme për ju"⁵.

Nëse kemi besim sa një kokërr sinapi, Zoti mund të na ndihmojë që t'i zhvendosim malet e shkurajimit dhe të dyshimit në detyrat përpara nesh, kur shërbejmë me fëmijët e Perëndisë, përfshirë pjesëtarët e familjes, anëtarët e Kishës dhe ata që nuk janë ende anëtarë të Kishës.

Vëllezër dhe motra, jeta mund të mbushet me besim, gëzim, lumturi,

shpresë dhe dashuri teksa ushtrojmë sasinë më të vogël të besimit të vërtetë të Krishti – madje të besimit sa një kokërr sinapi.

Plaku Xhorxh A. Smith kujtoi një këshillë që Profeti Jozef Smith ia dha atij: "Ai më tha se unë kurrë nuk duhet ta humbas kurajën, çfarëdo vështirësisht që mund të më rrethojnë. Nëse do të mbytesha në gropën më të ulët të Nova-Skocias dhe të gjitha Malet Shkëmbore të më mbulonin përsipër, unë nuk duhej ta humbisja kurajën, por të vazhdoja të mbahesha fort, të ushtroja besim dhe ta ruaja kurajën e mirë, dhe në fund, do të dilja në majë të pìrgut."⁶

Ne duhet ta mbajmë mend shpalljen e Palit: "Unë mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon"⁷. Njohuria e kësaj gjëje është një dhuratë tjetër e çmuar nga Perëndia.

Përveç dhuratave që kam përmendur, ka shumë, shumë të tjera. Tani do të flas për vetëm disa prej tyre – dhuratën e ditës së Shabatit, të sakramentit, të shërbimit ndaj të tjerëve dhe dhuratën e pashembullit, të dhënë nga Perëndia, të vetë Shpëtimtarit tonë.

Fuqia e ditës së Shabatit është të përjetojmë në kishë dhe në shtëpi kënaqësinë, gëzimin dhe ngrohtësinë e të ndierit të Shpirtit të Zotit pa asnjë lloj shpërqendrimi.

Shumë njerëz ia lejojnë vetvetes që të jetojnë pothuajse në internet me

pajisjet e tyre inteligjente – me ekrane që i ndriçojnë fytyrat e tyre ditë e natë dhe me kufje në veshë që e bllokojnë zërin e qetë, të vogël të Shpirtit. Nëse nuk gjejmë kohë që të largohemi prej mjeteve elektronike, ne mund t'i humbasim mundësitë për ta dëgjuar zërin e Atij që tha: "Ndaluni dhe pranoni që jam Perëndi"⁸. Tani, nuk ka asgjë të gabuar që të përfitojmë nga përparimet në teknologjitë, të frymëzuara nga Zoti, por ne duhet të jemi të urtë në përdorimin e tyre. Mbajeni mend dhuratën e ditës së Shabatit.

Bekimi i marrjes së sakramentit në mbledhjen e sakramentit nuk duhet të bëhet kurrë rutinë ose thjesht diçka që e bëjmë. Janë vetëm 70 minuta nga e gjithë java kur mund të bëjmë një ndërprerje dhe të gjejmë më shumë paqe, gëzim e lumturi në jetën tonë.

Marrja e sakramentit dhe ripërtëritja e besëlidhjeve tona është shenjë nga ne për Zotin që ne gjithmonë e kujtojmë Atë. Shlyerja e Tij është një dhuratë e hirshme nga Perëndia.

Privilegji i shërbimit ndaj fëmijëve të Atit Qiellor është një mundësi tjetër për ta ndjekur shembullin e Birit të Tij të Dashur nëpërmjet shërbimit ndaj njëri-tjetrit.

Disa mundësi shërbimi janë të caktuara zyrtarisht – në familjen tonë, në thirrjet tona të Kishës dhe në pjesëmarrjen tonë në organizatat e shërbimit në komunitet.

Anëtarët e Kishës – si burrat ashtu edhe gratë – nuk duhet të ngurojnë, nëse dëshirojnë, që të vënë kandidatura për detyra shtetërore në çfarëdo rangu qeveritar kudo ku jetojnë. Zërat tanë janë thelbësorë sot dhe të rëndësishëm në shkollat tona, qytetet tona dhe vendet tona. Atje ku ekziston demokracia, është detyra jonë si anëtarë që të votojmë për burra e gra të nderuara, që janë të gatshëm të shërbejnë.

Shumë mundësi për të shërbyer nuk janë të përcaktuara zyrtarisht – pa detyra të caktuara – dhe vijnë kur u shtrijmë dorën e ndihmës të tjerëve që i hasim në udhëtimin e jetës. Mbani mend, Jezusi i dha mësim doktorit të ligjit se ne duhet ta duam Perëndinë dhe të afërmin tonë porsì veten, duke përdorur samaritanin e mirë si shembull.⁹

Shërbimi hap një mundësi nëpërmjet të cilës ne e kuptojmë jetën dhe shërbesën e Krishtit. Ai erdhi të shërbente, sikurse na mësojnë shkrimet e shenjta, “sepse edhe Biri i njeriut nuk erdhi që t’i shërbejnë, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si çmim për shpëtimin e shumë vetëve”¹⁰.

Pjetri mund të ketë dhënë përshkrimin më të mirë të shërbesës së Shpëtimtarit në vdekshmëri me gjashtë fjalë kur iu drejtua Jezusit, “i cili e përshkoi vendin duke bërë mirë”¹¹.

Zoti Jezu Krisht është dhurata më e çmuar e të gjitha dhuratave tona nga Perëndia. Jezusi . . . tha: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje”¹².

Nefi e shpjegoi rëndësinë e Shpëtimtarit tonë kur shpalli: “Ne flasim për Krishtin, ne gëzojemi në Krishtin, ne predikojmë për Krishtin, ne profetizojmë mbi Krishtin dhe shkruajmë sipas profecive tona, që fëmijët tanë të mund të dinë se cilit burim t’i drejtohen për heqjen e mëkateve të tyre”¹³. Ne duhet ta mbajmë Krishtin si qendrën e jetës sonë në të gjitha kohët dhe në të gjitha vendet.

Ne duhet të mbajmë mend se është emri i Tij që shfaqet në vendet tona të adhurimit; ne pagëzojemi në emrin e Tij; dhe ne konfirmohemi, shugurohemi, marrim dhurimin [indaumentin] dhe vulosemi në martesë në emrin e Tij. Ne e marrim sakramentin dhe premtojmë ta marrim mbi vete emrin e Tij – dhe të bëhemi të krishterë të vërtetë. Së fundmi,

neve na kërkohet në lutjen e sakramentit që “githmonë ta kujtoj[më] atë”¹⁴.

Teksa përgatitemi për të dielën e Pashkës nesër, ne duhet të kujtojmë se Krishti është më i larti. Ai është Gjykatësi i drejtë, Avokati ynë besnik, Shëlbuesi ynë i bekuar, Bariu i Mirë, Mesia i premtuar, një Mik i vërtetë dhe shumë, shumë më tepër. Ai është me të vërtetë një dhuratë shumë e çmuar për ne nga Ati ynë.

Në dishepullimin tonë ne kemi shumë kërkesa, shqetësime dhe detyra. Gjithsesi, disa veprimtari duhet të jenë gjithmonë në thelbin e anëtarësisë sonë në Kishë. “Prandaj”, urdhëroi Zoti, “ji besnik; qëndro në detyrën që të kam caktuar; *ndihmo* të dobëtit, *ngri* duart që varen poshtë dhe *forco* gjunjët e këputur.”¹⁵

Kjo është Kisha në veprim! Kjo është feja e pastër! Ky është ungjilli në kuptimin e tij të vërtetë kur ne ndihmojmë, ngremë dhe forcojmë ata që kanë nevoja shpirtërore dhe materiale! Bërja e kësaj gjëje na kërkon që t’i vizitojmë dhe t’i ndihmojmë ata¹⁶, që dëshmitë e tyre për besimin tek Ati Qiellor, Jezu Krishti dhe Shlyerja e Tij të nguliten në mënyrë të palëkundshme në zemrat e tyre.

Zoti na ndihmoftë dhe na bekoftë që t’i ruajmë si thesar dhuratat tona të shumta, të çmuara, të marra nga Perëndia, përfshirë anëtarësinë tonë në Kishën e Tij të rivendosur. Lutem që ne do të mbushemi vërtet me dashuri për fëmijët e Atit tonë Qiellor, do të jemi në gjendje t’i kuptojmë nevojat e tyre dhe do të jemi të gatshëm që t’u përgjigjemi pyetjeve dhe shqetësimeve të tyre rreth ungjillit në mënyra të qarta dhe dashamirëse, të cilat do ta shtojnë të kuptuarin dhe vlerësimin për njëri-tjetrin.

Dëshmoj se Jezu Krishti është Shpëtimtari ynë. Ajo që do të na mësohet në këtë konferencë të përgjithshme, na vjen me anë të frymëzimit nga apostujt e profetët, nga Autoritetet e Përgjithshme dhe

motrat udhëheqëse që janë Drejtuese të Përgjithshme të Kishës. Qëndroftë gëzimi dhe paqja e Zotit me secilin prej nesh është lutja ime e përlulur, në emrin e Zotit Jezu Krisht, amen. ■

SHËNIME

1. Shih *Encyclopedia of Mormonism* (1992), “Solemn Assemblies”, 3:1390–1391.
2. Shih Doktrina e Besëlidhje 88:70.
3. Doktrina e Besëlidhje 21:4–5.
4. Gjoni 20:21; theksimi i shtuar.
5. Mateu 17:20.
6. George A. Smith, në *Teachings of Presidents of the Church: Joseph Smith* (2007), f. 235.
7. Filipianëve 4:13.
8. Psalmeve 46:10.
9. Shih Lluca 10:25–37.
10. Mateu 20:28.
11. Veprat e Apostujve 10:38.
12. Gjoni 14:6.
13. 2 Nefi 25:26.
14. Doktrina e Besëlidhje 20:77, 79.
15. Doktrina e Besëlidhje 81:5; theksimi i shtuar.
16. Shih Jakob [Bibël] 1:27.





Nga Plaku Brajën K. Tejlor,
i Të Shtatëdhjetëve

A Jam Unë Fëmijë i Perëndisë?

Si mund ta përjetojë secili prej nesh fuqinë e të kuptuarit të identitetit tonë hyjnor? Kjo fillon duke kërkuar ta njohim Perëndinë, Atin tonë.

Kohët e fundit shkova në kishë me mamanë time të dashur në mesin e një grupi të ndërtuar prej guri. I tërhequr nga zërat e njomë që vinin nga po e njëjta dhomë e Fillores në të cilën merrja pjesë dekada më parë, hyra në fund të dhomës dhe vështrova udhëheqëse të kujdesshme që po jepnin mësim temën e këtij viti: “Unë Jam Fëmijë i Perëndisë”¹. Buzëqesha teksa kujtova mësuese të duruara dhe të dashura, të cilat gjatë kohës së këngës në ato kohë, do të shikonin shpesh nga unë – ai vogëlush i panënshtuar në fund të radhës – si për të thënë: “A është ai *me të vërtetë* fëmijë i Perëndisë? Dhe kush e dërgoi atë këtu?”²

E ftoj secilin prej nesh që ta hapë zemrën ndaj Frymës së Shenjtë i cili “. . . i dëshmon frymës sonë se ne jemi bij të Perëndisë”³.

Fjalët e Presidentit Bojd K. Paker janë të qarta e të çmueshme: “Ti je fëmijë i Perëndisë. Ai është ati i shpirtit tënd. Nga ana shpirtërore ti je me një prejardhje fisnike, pasardhësi i Mbretit të Qiellit. Ngulite atë të vërtetë në mendjen tënde dhe mbahu tek ajo. Pavarësisht nga brezat e shumtë të

paraardhësve të tu në vdekshmëri, pavarësisht se cilën racë apo popull përfaqëson, prejardhja e shpirtit tënd mund të shkruhet në një rresht të vetëm. Ti je fëmijë i Perëndisë!”⁴

“Kur ta . . . shihni Atin tuaj”, përshkroi Brigam Jangu, “ju do të shihni një qenie me të cilin jeni njohur prej shumë kohësh, dhe Ai do t’ju marrë në krahët e Tij, dhe ju do të jeni gati për ta shtrënguar në përqafim dhe për ta puthur Atë.”⁵



Lufta e Madhe mbi Identitetin Hyjnor

Moisiu mësoi për trashëgiminë e tij hyjnore duke folur ballë për ballë me Zotin. Pas kësaj përvoje, “Satani erdhi ta tundonte” me qëllim dinak, por prapëseprapë të egër për të shtrembëruar identitetin e Moisiut, “duke thënë: Moisi, *biri i njeriut*, adhuromë mua. Dhe . . . Moisiu hodhi vështrimin mbi Satanin dhe tha: Kush je ti? Sepse, vër re, unë jam një *bir i Perëndisë*.”⁶

Kjo luftë e madhe mbi identitetin hyjnor tërbohet egërsisht teksa arsenalin në shumëfishim i Satanit ka si qëllim ta shkatërrojë besimin tonë dhe njohurinë tonë për marrëdhënien tonë me Perëndinë. Fatmirësisht ne jemi bekuar me një kuptueshmëri dhe vizion të qartë të identitetit tonë të vërtetë që nga fillimi: “Pastaj Perëndia tha: ‘Ta bëjmë njeriun sipas [vetë] shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne’”⁷ dhe profetë të gjallë shpallin: “Secil[a] [qënie njerëzore] është një bir ose bijë shpirtërore e dashur e prindërve qiellorë dhe, si i tillë, secili ka një natyrë dhe destinacion hyjnor”⁸.

Arritja për t’i ditur këto të vërteta me siguri⁹ na ndihmon të mposhtim sprova, shqetësime dhe vuajtje të çdo lloji.¹⁰ Kur e pyetën: “Si mund t’i ndihmojmë ata që janë duke u ndeshur me [një sfidë vetjake]”, një Apostull i Zotit udhëzoi: “Mësojuni identitetin e tyre dhe qëllimin e tyre”¹¹.

“Njohuria më e Fuqishme që Unë Zotëroj”

Këto të vërteta të fuqishme ishin jetëndryshuese për shoqen time, Xhenin¹², e cila kur ishte adoleshente shkaktoi një aksident të rëndë me makinë. Edhe pse trauma e saj fizike ishte e rëndë, ajo ndjeu vuajtje kaq therëse sepse shoferja tjetër kishte humbur jetën. “Dikush humbi nënën dhe ishte faji im”, thotë ajo. Xheni, e cila vetëm pak ditë më parë u ngrit në këmbë dhe recitoi: “Ne jemi bija të Atit tonë Qiellor,

i cili na do”¹³, tani pyeste veten: “Si mund të më dojë Ai *mua*?”

“Vuajtja fizike kaloi”, thotë ajo, “por nuk mendoja se do të shërohesha ndonjëherë nga plagët emocionale dhe shpirtërore.”

Në mënyrë që të mbijetonte, Xheni i fshehu ndjenjat e saj thellësisht, duke u bërë e largët dhe e mpirë. Pas një viti, kur më në fund ajo ishte në gjendje që të fliste rreth aksidentit, një këshilltar i frymëzuar e ftoi të shkruante frazën “Unë jam fëmijë i Perëndisë” dhe ta thoshte atë 10 herë në ditë.

“Të shkruaja fjalët ishte e lehtë”, kujton ajo, “por unë nuk mund t’i thosha ato. . . . Kjo e bëri të vështirë dhe unë nuk besoja se Perëndia më donte mua si fëmijën e Tij. Unë krspullohesha dhe qaja.”

Pas disa muajsh, Xheni më në fund qe në gjendje ta përmbushte detyrën çdo ditë. “E derdha gjithë shpirtin tim”, tha ajo, “duke iu përgjyer Perëndisë. . . . Atëherë fillova t’u besoja fjalëve.” Ky besim e lejoi Shpëtimtarin që të fillonte ta shëronte shpirtin e saj të plagosur. Libri i Mormonit solli ngushëllim dhe kurajë për Shlyerjen e Tij.¹⁴

“Krishti i ndjeu dhembjet e mia, brengat e mia, fajin tim”, përfundon Xheni. “Unë ndjeva dashurinë e pastër të Perëndisë dhe nuk kisha përjetuar kurrë asgjë aq të fuqishme! Ta di se unë jam fëmijë i Perëndisë është njohuria më e fuqishme që unë zotëroj!”

Kërkimi për ta Njohur Perëndinë, Atin Tonë

Vëllezër dhe motra, si mund ta përjetojë secili prej nesh fuqinë e të kuptuarit të identitetit tonë hyjnor? Kjo fillon me kërkimin për ta njohur Perëndinë, Atin tonë.¹⁵ Presidenti Rasëll M. Nelson dëshmoi: “Diçka e mrekullueshme ndodh kur një fëmijë i Perëndisë kërkon të dijë më shumë rreth Tij dhe Birit të Tij të Dashur”¹⁶.



Të mësuarit për Shpëtimtarin dhe ndjekja e Tij na ndihmojnë të njohim Atin. “Duke qenë . . . vula e qenies së [Atit të] tij”¹⁷, Jezusi dha mësim: “Biri nuk mund të bëjë asgjë prej vetvetes, përveç asaj që sheh se bën Ati”¹⁸. Çdo fjalë dhe veprim i Krishtit zbulon natyrën e vërtetë të Perëndisë dhe marrëdhënien tonë me Të.¹⁹ Plaku Xhefri R. Holland dha mësim: “Me gjak që shfaqej nga çdo por dhe një thirrje ankthi në buzët e Tij, Krishti [e] kërkoi Atë, të cilin Ai kishte kërkuar gjithmonë – Atin e Tij. ‘Abba’, thirri Ai, ‘Baba’”²⁰.

Ashtu si Jezusi e kërkoi me zell Atin e Tij në Gjetseman, në të njëjtën mënyrë i riu Jozef Smith, në 1820-ën, e kërkoi me lutje Perëndinë në Korijen e Shenjtë. Pasi lexoi: “Në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtia, le të kërkojë nga Perëndia”²¹, Jozefi shkoi mënjanë për t’u lutur.

“Rashë në gjunjë”, shkroi ai, “dhe fillova t’i tregoj dëshirat e zemrës sime Perëndisë. . . .

. . . Unë pashë një shtyllë drite tamam mbi kokën time. . . .

. . . Unë pashë dy Personazhe, shkëlqimi dhe lavdia e të cilëve i kapërcen të gjitha përshkrimet, duke qëndruar mbi mua në ajër. Një prej tyre më foli, duke më thirrur në emër dhe tha, duke treguar tjetrin: [Jozef], *Ky Është*

*Biri Im i Dashur. Dëgjoje Atë!”*²²

Kur i ndjekim shembujt e Shpëtimtarit dhe të Profetit Jozef dhe e kërkojmë me zell Perëndinë, ne do të arrijmë të kuptojmë në një mënyrë të vërtetë, ashtu si Xheni bëri, se Ati ynë na njeh me emër, se ne jemi fëmijët e Tij.

Ju nëna, veçanërisht nëna të reja, që shpesh ndiheni të mposhtura ose të mbytura teksa përpiqeni fort të rritni “një brez që i bën ballë mëkatit”²³, kurrë mos e nënvlerësoni rolin tuaj qendror në planin e Perëndisë. Në çaste stresuese – ndoshta kur jeni duke ndjekur të vegjlit dhe një erë e djegur nga kuzhina ju njofton se darka që po e përgatitni me dashuri, është tashmë një ofertë e djegur – dijeni se Perëndia i shenjtëron ditët tuaja më të vështira.²⁴ “Mos ki frikë, sepse unë jam me ty”²⁵, na siguron Ai paqësisht. Ne ju nderojmë ndërsa ju e përmbushni shpresën e Motrës Xhoi D. Xhons, e cila shpalli: “Fëmijët tanë e meritojnë të kuptojnë identitetin e tyre hyjnor”²⁶.

E ftoj secilin prej nesh ta kërkojë Perëndinë dhe Birin e Tij të Dashur. “Askund tjetër”, drejtoi Presidenti Nelson, “nuk jepen mësim më qartë dhe më fuqishëm këto të vërteta sesa në Librin e Mormonit.”²⁷ Hapini faqet e tij dhe mësoni se Perëndia i bën “të gjitha gjërat për mirëqenien dhe për lumturinë

[tonë]²⁸, se Ai është “i dhembshur dhe i hirshëm, i ngadalshëm në zemërim, i duruar dhe plot mirësi”²⁹ dhe se “të gjithë janë njësoj para [Tij]”³⁰. Kur ndiheni të lënduar, të humbur, të frikësuar, të zemëruar, të mërzhitur, të uritur ose të braktisur pa shpresë në skajet e jetës³¹ – hapeni Librin e Mormonit dhe ju do të arrini të dini që “[Perëndia] nuk do të na braktisë kurrë. Ai kurrë nuk na ka braktisur dhe kurrë nuk do të na braktisë. Ai nuk mund të na braktisë. Nuk është në karakterin e Tij [që të na braktisë]”³².

Të arrijmë ta njohim Atin tonë ndryshon gjithçka, veçanërisht zemrën tonë, teksa shpirti i Tij i butë na pohon identitetin tonë të vërtetë dhe vlerën tonë të madhe në sytë e Tij.³³ Perëndia ecën me ne përgjatë shtegut të besëlidhjes kur ne e kërkojmë Atë nëpërmjet përgjërimeve plot lutje, kërkimit në shkrimet e shenja dhe përpjekjeve të bindura.

Shkëlqimi i Karakterit të Perëndisë - Dëshmia ime

Unë e dua Perëndinë e etërve të mi³⁴, “Perëndinë e Plotfuqishëm”³⁵, i cili vajton me ne në brengat tona, e qorton me durim padrejtësinë tonë dhe gëzohet kur ne përpiqemi t’i “braktis[im] të gjitha mëkatet [tona] për ta njohur [Atë]”³⁶. Unë e adhuroj Atë, i cili është gjithmonë “babai i jetimëve”³⁷ dhe shoqëruesi i të pashoqëruarve. Me mirënjohje dëshmoj se kam arritur ta njoh Perëndinë, Atin tim, dhe jap dëshmi të përsosurive, cilësive dhe të “shkëlqimit të karakterit të [Tij]”³⁸.

Që secili prej nesh të mund ta kuptojë me të vërtetë “trashëgiminë [tonë] fisnike”³⁹ si fëmijë i Perëndisë duke arritur ta njohim Atë, “të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që [Ai e] k[a] dërguar”⁴⁰ është lutja ime e zjarrtë në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



SHËNIME

- Shih *Orientuesi për Kohën e Përbashkët 2018: Unë Jam Fëmijë i Perëndisë*, lds.org/manual/primary.
- Shih “Fëmi i Perëndis’ Jam”, *Himnet*, f. 196.
- Romakëve 8:16.
- Boyd K. Packer, “To Young Women and Men”, *Ensign*, maj 1989, f. 54.
- Brigham Young, “Discourse”, *Deseret News*, 1 shtator 1856, f. 235.
- Moisiu 1:12–13; theksimi i shtuar.
- Zanafilla 1:26.
- “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, *Liahona*, maj 2017, f. 145.
- Jozef Smithi pohoi: “Është parimi i parë i ungjillit që të dimë me siguri karakterin e Perëndisë” (nga the “King Follett sermon”, 7 prill 1844; në *History of the Church*, 6:305).
- Shih Alma 36:3, 27.
- Russell M. Nelson, në Tad R. Callister, “Our Identity and Our Destiny” (Takim shpirtëror në Universitetin “Brigam Jang”, 14 gusht 2012), 1, speeches.byu.edu.
- Emri është ndryshuar.
- “Tema e Të Rejave”, *Përparimi Personal i Të Rejave* (2009), f. 3, PersonalProgress.Lds.org.
- Shih 2 Nefi 2; 6–9; Mosia 2–5; 14–16; Alma 7; 34; 39–42; Helamani 14; 3 Nefi 11; Moroni 7.
- Profeti Jozef Smith dha mësim: “Nëse njerëzit nuk e kuptojnë karakterin e Perëndisë, ata nuk kuptojnë vetveten” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 42).
- Rasëll M. Nelson, “Libri i Mormonit: Si do të ishte Jeta Juaj pa Të?” *Liahona*, nëntor 2017, f. 61.
- Hebrenjve 1:3.
- Gjoni 5:19.
- Shih Jeffrey R. Holland, “The Grandeur of God”, *Liahona*, nëntor 2003, f. 70-73.
- Jeffrey R. Holland, “The Hands of the Fathers”, *Liahona*, korrik 1999, f. 19.
- Jakob [Bibël] 1:5.
- Joseph Smith – Historia 1:15–17.
- Rasëll M. Nelson, “Një Lutje drejtuar Motrave të Mia”, *Liahona*, nëntor 2015, f. 97.
- Shih “Sa i Fort’ një Themel”, *Himne*, nr. 41.
- Isaia 41:10.
- Joy D. Jones, në Marianne Holman Prescott, “2018 Primary Theme ‘I Am a Child of God’ Teaches Children Their Divine Identity”, seksioni i lajmeve të Kishës i LDS.org, 5 janar 2018, news.lds.org.
- Rasëll M. Nelson, “Libri i Mormonit: Si do të ishte Jeta Juaj pa Të?” f. 61.
- Helamani 12:2; shih edhe 2 Nefi 26:24.
- Lectures on Faith* (1985), f. 42.
- 2 Nefi 26:33.
- E dua historinë emocionuese të burrit të vjetër pionier i cili, pas përvojës së tij në kalimin e rrafshinave, dëshmoi: “Ne vuajtëm përtej gjithçkaje që ju mund të përfytyroni dhe shumë vdiqën nga ekspozimi ndaj të ftohtit dhe uria, por a dëgjuan ndonjëherë një të mbijetuar nga ajo kompani të shqiptojë ndonjë fjalë kritike? As edhe një nga ajo kompani kurrë nuk u largua nga Kisha apo e braktisi atë, sepse secili prej nesh kaloi me dije absolute se Perëndia jeton, sepse ne u njohëm me Të në kushtet tona më të shkajshme” (në David O. McKay, “Pioneer Women”, *Relief Society Magazine*, janar 1948, f. 8; theksimi i shtuar).
- George Q. Cannon, “Remarks”, *Deseret Evening News*, 7 mars 1891, f. 4.
- Shih Doktrina e Besëlidhje 18:10.
- Shih Veprat e Apostujve 5:30; 22:14; “Perëndia i Etërve, Dor’ e Tij”, *Himnet*, nr. 38.
- Moisiu 1:3; shih Zbulesa 15:3; 21:22–23; 3 Nefi 4:32; Doktrina e Besëlidhje 109:77; 121:4.
- Alma 22:18.
- Psalmeve 68:5, shih edhe Jakob [Bibël] 1:27.
- Lectures on Faith* (1985), f. 42.
- “Mos Ndalo”, *Himne*, nr. 163.
- Gjoni 17:3.



Nga Plaku Leri J. Eko Houk,
i Të Shtatëdhjetëve

Sikundër Krishti ju Fal, ashtu Bëni edhe Ju

Të gjithë ne mund të marrim paqe të papërskrueshme dhe partneritet me Shpëtimtarin tonë ndërsa mësojmë t'i falim bujarisht ata që kanë mëkatuar ndaj nesh.

“Tani ditën e parë të javës, shumë herët në mëngjes, ato me gra të tjera shkuan te varri, duke sjellë erërat e mira që kishin përgatitur.

Dhe gjetën që guri ishte rrokullisur nga varri.

Por, kur hynë, nuk e gjetën trupin e Zotit Jezus.

Dhe, ndërsa ishin shumë të hutuara nga kjo, ja, iu paraqitën atyre dy burra të veshur me rroba të ndritshme.

Dhe, mbasi ato, të tmerruara, e mbanin fytyrën të përkulur përdhe, ata u thanë: ‘Pse e kërkoni të gjallin midis të vdekurve?’

Ai nuk është këtu, por është ringjallur.”¹

Nesër, në Shabatin e Pashkës, ne do të kujtojmë në një mënyrë të veçantë atë që Jezu Krishti ka bërë për ne: “Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme”². Përfundimisht, ne do të ringjallemi ashtu siç u ringjall Ai, për të jetuar përgjithmonë.

Nëpërmjet mrekullisë së Shlyerjes së shenjtë të Jezu Krishtit, ne mund të marrim gjithashtu dhuratën e faljes për

mëkatet dhe mbrapshtitë tona, nëse e pranojmë mundësinë dhe përgjegjësinë e pendimit. Dhe, duke i marrë ordonancat e nevojshme, duke i mbajtur besëlidhjet dhe duke i bindur urdhërimeve, ne mund të fitojmë jetën e përjetshme dhe ekzaltimin.

Sot, dua të përqendrohem te falja, një dhuratë thelbësore dhe e çmuar që na ofrohet nga Shpëtimtari dhe Shëlbuësi ynë, Jezu Krishti.

Një natë dhjetori në vitin 1982, unë dhe bashkëshortja ime, Terri, u zgjuam



nga një telefonatë në shtëpinë tonë në Pokatelo të Ajdahos. Kur iu përgjigja telefonit, dëgjova vetëm të qara me ngashërim. Më në fund, motra ime më tha me gjysmë zëri: “Tomi vdiq”.

Një shofer i dehur 20-vjeçar, me shpejtësi më shumë se 135 km në orë, në mënyrë të shkujdesur kaloi pa ndaluar në dritën e kuqe të semaforit, në një periferi të Denverit në Kolorado. Ai u përplas fuqishëm me makinën që po drejtohej nga vëllai im më i vogël, Tomi, duke e lënë të vdekur menjëherë atë dhe gruan e tij, Xhoanën. Ata po ktheheshin në shtëpi te vajza e tyre e vogël pas një feste Krishtlindjeje.

Unë dhe bashkëshortja ime udhëtuan menjëherë me avion për në Denver dhe shkua në morg. U mblodhëm me prindërit dhe vëllezërit e motrat e mia dhe vajtuam humbjen e Tomit dhe të Xhoanës sonë të dashur. I kishim humbur ata nga një vepër e pakuptimtë kriminale. Zemrat tona ishin të thyera dhe zemërimi ndaj kundërvajtësit të ri filloi të ziente brenda meje.

Tomi kishte shërbyer si avokat në Departamentin e Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara dhe ishte në udhë e sipër për të qenë një mbrojtës i fortë për mbrojtjen e tokave të amerikanëve vendës dhe burimeve natyrore për vitet që do të vinin.

Pasi kishte kaluar njëfarë kohe, në gjykatë u mbajt një seancë dëgjimore për të riun, i cili u shpall përgjegjës për vrasje nga pakujdesia në drejtimin e automjetit. Ndërkohë që po ndienin ende hidhërim e pikëllim, prindërit e mi dhe motra më e madhe, Kejt, morën pjesë në seancën dëgjimore. Prindërit e shoferit të dehur ishin atje gjithashtu dhe, pasi përfundoi dëgjesa, ata u ulën në një stol dhe qanë. Prindërit dhe motra ime ishin ulur pranë tyre ndërkohë që ata përpiqeshin t'i mbanin nën kontroll emocionet e tyre. Pas një çasti, prindërit dhe motra ime



u ngritën dhe ecën drejt prindërve të shoferit dhe u ofruan fjalë ngushëlluese dhe faljeje. Burrat shtrënguan duart; gratë i mbajtën duart [njëra-tjetrës]; kishte pikëllim të madh e lot të shumtë për të gjithë dhe një pranim se të dyja familjet kishin vuajtur pa masë. Mamaja, babai dhe Kejti hapën udhën me forcën dhe kurajën e tyre të heshtur dhe i treguan familjes sonë se ç'pamje ka falja.

Kjo dhënie e faljes në ato çaste bëri që zemra ime të zbutej dhe i hapi një shteg shërimit. Me kalimin e kohës mësova se si të kisha një zemër falëse. Barra ime e dhimbshme u lehtësua vetëm me ndihmën e Princit të Paqes. Do të më marrë malli gjithmonë për Tomin dhe Xhoanën, por tani falja më lejon që t'i kujtoj ata me gëzim të çlirët. Dhe e di se ne do të jemi sërish së bashku si familje.

Nuk po sugjeroj që ta lëmë të kalojë sjelljen e paligjshme. E dimë fare mirë se individët duhet të mbajnë përgjegjësi për veprat e tyre kriminale dhe keqbërjet civile. Megjithatë, ne gjithashtu e dimë se, si bij dhe bija të Perëndisë, i ndjekim mësimet e Jezu Krishtit. Duhet të falim edhe kur duket sikur të tjerët mund të mos e meritojnë faljen tonë.

Shpëtimtari dha mësim:

“Sepse në qoftë se ju ua falni njerëzve gabimet e tyre, Ati juaj qiellor do t’juja falë edhe juve;

por në qoftë se ju nuk ua falni njerëzve gabimet e tyre, as Ati juaj nuk do t’ua falë juve gabimet tuaja”³.

Të gjithë ne mund të marrim paqe të papërshtueshme dhe partneritet me Shpëtimtarin tonë ndërsa mësojmë t’i falim bujarisht ata që kanë mëkatuar ndaj nesh. Ky partneritet e sjell fuqinë e Shpëtimtarit në jetën tonë në një mënyrë të pagabueshme dhe të paharrueshme.

Apostulli Pal këshilloi:

“Vishuni, pra, si të zgjedhur të Perëndisë, . . . me dhembshuri të brendshme, mirësinë, përlulësinë, zemërbutësinë dhe me durimin, duke duruar njeri tjetrin dhe duke falur njeri tjetrin, . . . ; *dhe sikundër Krishti ju ka falur, ashtu bëni edhe ju*”⁴.

Vetë Zoti shpalli:

“Prandaj, unë ju them se ju duhet ta falni njëri-tjetrin; sepse ai që nuk ia fal shkeljet vëllait të tij, mbetet i dënuar përpara Zotit; sepse atij i ngelet mëkati më i madh.

Unë, Zoti, do të fal kë do të fal, por nga ju kërkohet t’i falni të gjithë njerëzit.”⁵

Mësimet e Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit tonë, Jezu Krishtit, janë të qarta; mëkatari duhet të jetë i gatshëm që t’i falë të tjerët nëse ai ose ajo shpreson të marrë falje.⁶

Vëllezër e motra, a ka njerëz në jetën tonë që na kanë lënduar? A i ushqejmë ato që quhen ndjenja plotësisht të justifikuarra mërie dhe zemërimi? A po e lejojmë krenarinë që të na pengojë të falim dhe t’i lëmë gjërat të shkojnë? E ftoj gjithsecilin prej nesh që të falë plotësisht dhe ta lërë shërimin të

ndodhë së brendshmi. Por edhe nëse falja nuk vjen sot, dijini se ashtu siç e dëshirojmë dhe punojmë për të, ajo do të vijë – ashtu siç bëri më në fund për mua pas vdekjes së vëllait tim.

Ju lutem, kujtoni gjithashtu se një element thelbësor i faljes përfshin faljen e vetvetes.

“Ai që është penduar për mëkatet e tij”, tha Zoti, “po ai falet dhe unë, Zoti, nuk i kujtoj më ato.”⁷

Lutem që të gjithë ne në këtë ditë ta kujtojmë dhe ta ndjekim shembullin e Jezu Krishtit. Mbi kryq në Golgota, në ankhin e Tij, Ai shqiptoi këto fjalë: “O Atë, fali ata sepse nuk dinë ç’bëjnë”⁸.

Duke pasur një frymë faljeje dhe duke vepruar sipas saj, ashtu si prindërit dhe motra ime më e madhe, ne mund ta kuptojmë premtimin e Shpëtimtarit: “Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po jua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë”⁹.

Dëshmoj se kjo paqe do të vijë në jetën tonë ndërsa ua vëmë veshin mësimëve të Jezu Krishtit dhe e ndjekim shembullin e Tij duke i falur të tjerët. Ndërsa falim, unë premtoj se Shpëtimtari do të na forcojë, dhe fuqia e gëzimi i Tij do të vërshojnë në jetën tonë.

Varri është bosh. Krishti jeton. Unë e njoh Atë. Unë e dua Atë. Jam mirënjohës për hirin e Tij, që është fuqia forcuese e që mjafton për t’i shëruar të gjitha gjërat. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Lluca 24:1–6.
2. Gjoni 3:16.
3. Mateu 6:14–15.
4. Kolosianëve 3:12–13; theksimi i shtuar.
5. Doktrina e Besëlidhje 64:9–10.
6. Shih James E. Talmage, *The Articles of Faith*, bot. 12-të, (1924), f. 110.
7. Doktrina e Besëlidhje 58:42.
8. Lluca 23:34.
9. Gjoni 14:27.



Nga Plaku Geri E. Stivenson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Zemra e një Profeti

Ne mund të gëzohemi që profeti i Zotit është në vendin e duhur dhe që puna e Zotit po bëhet në mënyrën hyjnore që Ai e ka përshkruar.

Jam lutur me zjarr që Fryma e Shenjtë do të jetë me secilin prej nesh sot në këtë ngjarje qiellore. Ajo që kemi dëshmuar bashkërisht, ka qenë shumë mbresëlënëse ndërsa profeti i 17-të i kësaj periudhe ungjillore është mbështetur në një kuvend solemn.

Ndërsa kërkoja udhërrëfim për të ditur temën që Zoti donte të trajtoja sot, mendja më shkoi te një bashkëbisedim i kohëve të fundit me Presidencën e Parë të sapothirrur. Në këtë diskutim,

njëri prej këshilltarëve shprehu fjalë të ngjashme me këto: “Unë shpresoj thellësisht që anëtarësia e Kishës të mund ta kuptojë rëndësinë e asaj që ka ndodhur me thirrjen e profetit tonë të ri, Presidentit Rasëll M. Nelson, dhe rëndësinë e shenjtërinë e kuvendit solemn që do të ndodhë në konferencën e përgjithshme”. Ai vëzhgoi më tej: “Kanë kaluar 10 vjet dhe shumë njerëz, veçanërisht të rinjtë e Kishës, nuk e mbajnë mend ose nuk e kanë përjetuar këtë më parë”.



Kjo më bëri të reflektoj mbi përvojat që kam pasur. Profeti i parë që sjell ndërmend, është Presidenti Dejvid O. Mek-Kej. Isha 14 vjeç kur ai ndërroi jetë. Më kujtohen një ndjesi humbjeje që e shoqëroi vdekjen e tij, lotët në sytë e nënës sime dhe pikëllimi i ndier nga e gjithë familja jonë. Më kujtohet se si fjalët “Të lutem bekoje Presidentin Dejvid O. Mek-Kej” dilnin kaq natyrshëm nga buzët e mia kur lutesha saqë, nëse nuk isha i kujdesshëm, edhe pas vdekjes së tij, e gjeja veten duke përdorur të njëjtat fjalë. Pyesja veten nëse zemra dhe mendja ime do të kishin të njëjtën ndjenjë dhe bindje për profetët që do ta pasonin atë. Por, pothuajse si prindërit që e duan secilin prej fëmijëve të tyre, unë gjeta dashuri, u lidha dhe fitova dëshmi për Profetin Jozef Filding Smith, i cili pasoi Presidentin Mek-Kej, dhe për secilin prej profetëve më pas: Harold B. Li, Spenser W. Kimball, Ezra Taft Benson, Hauard W. Hanter, Gordon B. Hinkli, Tomas S. Monson dhe sot Presidentin Rasëll M. Nelson. E mbështeta plotësisht secilin profet me dorën të ngritur lart – dhe zemrën të lartësuar.

Ndërkohë që secili prej profetëve tanë të dashur ka ndërruar jetë, është më se e natyrshme të kemi një ndjenjë pikëllimi dhe humbjeje. Por trishtimi ynë zbutet nga gëzimi dhe shpresa që vijnë kur përjetojmë njërin nga bekimet e mëdha të Rivendosjes: thirrjen dhe mbështetjen e një profeti të gjallë në tokë.

Për këtë qëllim, unë do të flas për këtë proces hyjnor siç u vërejt gjatë 90 ditëve të fundit. Do ta përshkruaj atë në katër segmente: së pari, vdekjen e profetit tonë të dashur dhe shpërbërjen e Presidencës së Parë; së dyti, periudhën kohore në pritje të riorganizimit të Presidencës së Parë të re; së treti, thirrjen e profetit të ri; dhe së katërti, mbështetjen e profetit të ri dhe të Presidencës së Parë në kuvendin solemn.



Vdekja e një Profeti

Më 2 janar 2018, profeti ynë i dashur, Tomas S. Monsoni, kaloi në anën tjetër të velit. Ai do të ketë përgjithmonë një vend në zemrat tona. Presidenti Henri B. Ajring shprehu ndjenja për vdekjen e Presidentit Monson, të cilat përshkruajnë shkurtimisht ndjenjat tona: “Shenja dalluese e jetës së tij, ashtu si e Shpëtimtarit, do të jetë shqetësimi i tij vetjak për të ndihmuar të varfrit, të sëmurët – madje të gjithë individët – në mbarë botën”¹.

Presidenti Spenser W. Kimball shpjegoi:

“Ndërsa një yll zbret përtej horizontit, një tjetër shfaqet dhe vdekja prodhon jetë.

Vepra e Zotit është e pafundme. Edhe kur vdes një udhëheqës i fuqishëm, për asnjë çast të vetëm Kisha nuk është pa udhëheqje, në saje të Perëndisë që i jep vazhdimësi dhe pafundësi mbretërisë së tij. Ashtu siç ka ndodhur tashmë . . . më parë në këtë periudhë ungjillore, një popull me nderim e mbyll një varr, i than lotët dhe ata i kthejnë fytyrat e tyre drejt së ardhmes.”²

Ndërqeverisja Apostolike

Periudha kohore ndërmjet vdekjes së një profeti dhe riorganizimit të Presidencës së Parë përmendet si një “ndërqeverisje apostolike”. Gjatë kësaj periudhe, Kuorumi i Dymbëdhjetë

Apostujve, nën udhëheqjen e presidentit të kuoromit, i mban çelësat së bashku për të administruar udhëheqjen e Kishës. Presidenti Jozef F. Smith tha: “Gjithmonë ka një krye në Kishë dhe nëse Presidenca e Kishës hiqet nga vdekja ose nga ndonjë shkak tjetër, atëherë kreu pasues i Kishës janë Dymbëdhjetë Apostujt, derisa të organizohet sërish një presidencë”³.

Periudha më e fundit e ndërqeverisjes filloi kur Presidenti Monson vdiq më 2 janar dhe përfundoi 12 ditë më vonë, të dielën më 14 janar. Në atë mëngjes Shabati, Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve u takua në dhomën e sipërme të Tempullit të Solt-Lejkut në një frymë agjërimi dhe lutjeje, nën drejtimin kryesues të Presidentit Rasëll M. Nelson, Apostullit më të vjetër në detyrë dhe Presidentit të Kuoromit të Të Dymbëdhjetëve.

Thirrja e një Profeti të Ri

Në këtë mbledhje të shenjtë dhe të paharrueshme, duke ndjekur një praktikë të mëparshme, të vendosur në unitet dhe njëzëri, Vëllezërit u ulën sipas vjetërsisë në detyrë në një gjysmërrethi me 13 karrige dhe i ngritën duart fillimisht për të mbështetur organizimin e një Presidencë të Parë dhe më pas për ta mbështetur Presidentin Rasëll Marion Nelson si President të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Kjo mbështetje u pasua nga mbledhja e Kuoromit të Të

Dymbëdhjetëve në një rreth dhe vendosja e duarve mbi kokën e Presidentit Nelson për ta shuguruar e veçuar atë, me Apostullin pasues më të vjetër në detyrë që vepronte si zë.

Më pas Presidenti Nelson përmendi emrat e këshilltarëve të tij, Presidentin Dallin Harris Ouks, Presidentin Henri B. Ajring, me Presidentin Ouks si President i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve dhe Presidentin Melvin Rasëll Ballard si President Veprues i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve. Pas votimeve të ngjashme mbështetëse, secili prej këtyre Vëllezërve u veçua në detyrat e tij përkatëse nga Presidenti Nelson. Kjo ishte një përvojë thellësisht e shenjtë, me një derdhje të shumtë të Shpirtit. Ju ofroj dëshminë time absolute se vullneti i Zotit, për të cilin ne u lutëm me zjarr, u shfaq fuqishëm në veprimtaritë dhe ngjarjet e asaj dite.

Me shugurimin e Presidentit Nelson dhe riorganizimin e Presidencës së Parë, ndërqeverisja apostolike mbaroi, dhe Presidenca e Parë e sapoformuar filloi të funksionojë, mrekullisht, pa asnjë sekondë ndërprerjeje në qeverisjen e mbretërisë së Zotit në tokë.

Kuvendi Solemn

Këtë mëngjes, ky proces hyjnor kulmoi në përputhje me mandatin nga shkrimet e shenja të përvijuar të Doktrina e Besëlidhje: “Pasi të gjitha gjërat duhet të bëhen në rregull dhe

me miratimin e përbashkët në kishë, me anë të lutjes së besimit”⁴ dhe “tre Priftërinj të Lartë Kryesues, . . . të mbështetur nga mirëbesimi, besimi dhe lutja e kishës, përbëjnë një kuorum të Presidencës së Kishës”⁵.

Plaku Dejvid B. Hejt përshkroi një ngjarje të mëparshme si ajo ku ne morëm pjesë sot:

“Ne jemi dëshmitarë dhe pjesëmarrës në një rast shumë të shenjtë – një kuvend solemn për të vepruar sipas gjërave qiellore. Ashtu si në kohët e lashta, ka pasur shumë agjërime dhe lutje të ofruar nga shenjtoret anembanë botës, që ata të mund të merrnin një derdhje të shumtë të Shpirtit të Zotit, e cila është kaq e dukshme . . . në këtë rast, këtë mëngjes.

Një kuvend solemn, sikurse e nënkupton emri, shënon një rast të shenjtë, të matur dhe plot nderim kur shenjtoret mblihdhen nën drejtimin e Presidencës së Parë.”⁶

Vëllezër e motra, ne mund të gëzohemi – madje të bërtasim “Hosana!” – se zëdhënësi i Zotit, një profet i Perëndisë, është në vendin e duhur dhe se Zoti është i kënaqur që puna e Tij po bëhet në mënyrën hyjnore që Ai e ka përshkruar.

Presidenti Rasëll M. Nelson

Ky proces i shuguruar në mënyrë hyjnore çon drejt një profeti tjetër të thirrur në mënyrë hyjnore. Ashtu si Presidenti Monson ishte një nga banorët më të mëdhenj që jetoi në këtë tokë, po kështu është Presidenti Nelson. Ai është përgatitur thellësisht dhe mbikëqyrur posaçërisht nga Zoti për të na udhëhequr në këtë kohë. Çfarë bekimi i madh është që ta kemi tani Presidentin e shtrenjtë Rasëll M. Nelson si profetin tonë të dashur e të përkushtuar – Presidentin e 17-të të Kishës në këtë periudhë të fundit ungujillore.

Presidenti Nelson është me të vërtetë një njeri i jashtëzakonshëm. Pata privilegjin të shërbej në Kuorumin e Të Dymbëdhjetëve me të si presidentin tim të kuoromit për më shumë se dy vjet. Kam udhëtuar me të dhe mrekullohem nga energjia e tij, teksa një njeri përpigjet të ruajë të njëjtin ritëm me të. Në tërësi, ai ka vizituar 133 vende gjatë jetës së tij.

Rrezja e veprimit të tij shtrihet tek të gjithë, të rinj e të vjetër. Duket se i njeh të gjithë dhe është veçanërisht i talentuar për t’i mbajtur mend emrat. Të gjithë ata që e njohin, e ndiejnë se janë të parapëlqyerit e tij. Dhe kështu është me secilin prej nesh – për shkak të dashurisë dhe shqetësimit të tij të vërtetë për çdokënd.

Shoqërimi im kryesor me Presidentin Nelson ka qenë në role kishtarë, prapëseprapë, unë jam njohur edhe me jetën profesionale që bëri Presidenti Nelson përpara se të thirrej si Autoritet i Përgjithshëm. Siç shumë prej jush e dinë, Presidenti Nelson ishte një kirurg zemre i njohur në botë dhe, në fillim të

karrierës së tij mjekësore, ishte një nga njerëzit e parë që zhvilloi makinerinë zemër-mushkëri. Ai ishte në ekipin kërkimor që mbështeti ndërhyrjen e parë me zemër të hapur te një qenie njerëzore, në vitin 1951, duke përdorur një bajpas zemër-mushkëri. Presidenti Nelson kreu një ndërhyrje në zemër për Presidentin Spenser W. Kimball, jo shumë kohë përpara se Presidenti Kimball të bëhej profeti.

Në mënyrë interesante, ndërsa thirrja e Presidentit Nelson tek Të Dymbëdhjetët 34 vjet më parë i dha fund një *karriere profesionale mjekësore* për forcimin dhe rregullimin e zemrës, ajo filloi një *shërbesë si një Apostull* kushtuar forcimit dhe rregullimit të zemrave të dhjetëra mijërave njerëzve të panumërt anembanë botës, të cilët janë lartësuar e shëruar nga fjalët e tij dhe nga veprat e diturisë, shërbimit e dashurisë.

Një Zemër si e Krishtit

Kur përfytyroj një zemër si të Krishtit në ushtrimin e përditshëm, unë shoh Presidentin Nelson. Nuk kam takuar



asnjë njeri që e mishëron këtë tipar në një nivel më të lartë sesa e bën ai. Ka qenë një kujdestari mbresëlënëse për mua të jem në pozitën për të vëzhguar drejtpërsëdrejti shfaqjet e zemrës si të Krishtit të Presidentit Nelson.

Brenda disa javësh nga thirrja ime tek Të Dymbëdhjetët, në tetor 2015, unë pata mundësinë që të kisha një vështrim nga afër të jetës së mëparshme profesionale të Presidentit Nelson. U ftova të merrja pjesë në një ngjarje ku ai u nderua si pionier për kirurgjinë e zemrës. Kur hyra në sallë, u habita kur pashë numrin e madh të njerëzve profesionistë që ishin atje për të nderuar e vlerësuar punën që Presidenti Nelson e kishte bërë shumë vite më parë si doktor dhe kirurg.

Atë mbrëmje, shumë njerëz të profesionit u ngritën dhe shprehën respektin dhe admirimin e tyre për ndihmesën e jashtëzakonshme të Presidentit Nelson në specialitetin e tij mjekësor. Pavarësisht nga sa mbresëlënëse ishte secili prej prezantuesve në përshkrimin e arritjeve të ndryshme të Presidentit Nelson, unë isha edhe më i magjepsur nga një bisedë që nisa me një burrë i cili qe ulur pranë meje. Ai nuk e dinte se kush isha, por e njihnte Presidentin Nelson si dr. Nelson, drejtor të programit të praktikantëve të kirurgjisë së toraksit në një shkollë mjekësore në vitin 1955.

Ky burrë ishte ish-student i Presidentit Nelson. Ai tregoi shumë kujtime. Më interesanti ishte përshkrimi prej tij i stilit të mësimdhënies së Presidentit Nelson, i cili, tha ai, solli me vete një masë të madhe të famës. Ai shpjegoi se shumë nga mësimdhënja për praktikantët e kirurgjisë së zemrës zhvillohej në sallën e operacionit. Atje, praktikantët vëzhgonin dhe kryenin ndërhyrje nën mbikëqyrjen e trupës pedagogjike, si një klasë laboratorike. Ai tregoi se mjedisi i dhomës së operacionit nën



kirurgë të caktuar të trupës pedagogjike ishte kaotik, konkurrues, i mbushur me tension dhe madje i shtyrë nga egoja. Ky burrë e përshkroi atë si një mjedis të vështirë, ndonjëherë madje poshtërues. Si rrjedhojë, kirurgët praktikantë madje ndienin se karrierat e tyre shpesh ishin në rrezik.

Pastaj ai shpjegoi mjedisin e pashoq që gjendej në sallën e operacionit të Presidentit Nelson. Ishte paqësor, i qetë dhe dinjitoz. Praktikantët trajtoheshin me respekt të thellë. Megjithatë, pas paraqitjes së një procedure, dr. Nelsoni priste nivelin më të lartë të kryerjes nga secili prej praktikantëve. Ky burrë përshkroi më tej se si rezultatet më të mira të pacientëve dhe kirurgët më të mirë dolën nga dhoma e operimit të dr. Nelsonit.

Kjo nuk ishte aspak një habi për mua. Kjo është ajo që kam vëzhguar drejtpërdrejtë dhe prej së cilës jam bekuar me të vërtetë në Kuorumin e Të Dymbëdhjetëve. Ndihem sikur kam qenë, në njëfarë kuptimi, një nga “praktikantët e tij në trajnim”.

Presidenti Nelson ka një mënyrë të jashtëzakonshme për t’i mësuar të tjerët dhe për të ofruar korrigjim në një mënyrë pozitive, respektuese dhe lartësuese. Ai është mishërimi i një zemre si të Krishtit dhe një shembull për të gjithë ne. Prej tij mësojmë se në çfarëdo

rrethane që e gjejmë veten tonë, sjellja jonë dhe zemrat tona mund të jenë në përputhje me parimet e ungjillit të Jezu Krishtit.

Tani ne kemi bekimin e madh për ta mbështetur profetin tonë, Presidentin Rasëll M. Nelson. Gjatë gjithë jetës së tij, ai i ka lartësuar rolet e tij të shumta si student, baba, profesor, bashkëshort, mjek, udhëheqës i piftërisë, gjysh dhe Apostull. Ai i përmbushi këto role atëherë – dhe vazhdon ta bëjë këtë – me zemrën e një profeti.

Vëllezër e motra, ajo që kemi dëshmuar sot dhe në të cilën kemi marrë pjesë, në një kuvend solemn, më çon drejt dëshmisë sime se Presidenti Rasëll M. Nelson është zëdhënësi i gjallë i Zotit për gjithë njerëzimin. Unë gjithashtu shtoj dëshminë time për Perëndinë, Atin, për Jezu Krishtin dhe rolin e Tij si Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Henry B. Eyring, në Marianne Holman Prescott, “Apostles Share Thoughts about President Thomas S. Monson on Social Media”, seksioni i Lajmeve të Kishës i LDS.org, 12 janar 2018, news.lds.org.
2. Spencer W. Kimball, në Conference Report, prill 1970, f. 118.
3. *Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* (1998), f. 223.
4. Doktrina e Besëlidhje 28:13.
5. Doktrina e Besëlidhje 107:22.
6. David B. Haight, “Solemn Assemblies”, *Ensign*, nëntor 1994, f. 14.



Nga Plaku Lin G. Robins,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Deri Shtatëdhjetë Herë Shtatë

Në një jetë mes pengesash e papërsosurisë, ne të gjithë jemi mirënjohës për mundësitë e dyta.

Gabimet janë fakte të jetës. Është e pamundur në thelb që të mësosh të luash në piano me mjeshtëri pa bërë mijëra gabime – ndoshta madje një milion. Për të mësuar një gjuhë të huaj, dikush duhet të përballet me turpërimin nga bërja e mijëra gabimeve – ndoshta madje një milion. Edhe atletët më të mirë të botës nuk reshtin kurrë së bëri gabime.

Është thënë: “Suksesi nuk është mungesa e dështimit, por kalimi nga dështimi në dështim pa e humbur asnjëherë entuziazmin”¹.

Gjatë shpikjes së llambës elektrike, Tomas Edisoni jo më kot tha: “Nuk dështova 1000 herë. Llamba ishte një shpikje me 1000 hapa.”² Çarls. F. Katering i quajti dështimet “tabela orientuese të rrugës drejt arritjes”³. Me shpresë, çdo gabim që bëjmë bëhet një mësim urtësie, duke i kthyer gurët pengues në gurë kalldrëmi.

Besimi i palëkundur i Nefit e ndihmoi atë të kalonte nga dështimi në dështim derisa më në fund i mori fletët prej tunxhi. Moisiut iu deshën 10 orvatje përpara se të kishte më në fund sukses për të dalë nga Egjipti me izraelitët.

Ne mund ta pyetim veten – nëse edhe Nefi, edhe Moisiu ishin në punën e Zotit, pse Zoti nuk ndërhyri e nuk i ndihmoi të kishin sukses që me përpjekjen e parë? Pse i lejoi Ai ata – dhe pse na lejon ne – të ngecim e të dështojmë në orvatjet tona për t’ia dalë mbanë? Ndër shumë përgjigje të rëndësishme për atë pyetje, ja tek janë disa:

- E para është që Zoti e di se “të gjithë këto gjëra do të [na] japin përvojë

dhe do të jenë për të mirën [tonë]”⁴.

- E dyta, që të na lejojë ta “provoj[m]ë hidhësinë, që të mund të di[m]ë ta çmoj[m]ë të mirën”⁵.
- E treta, për të vërtetuar se “përfundimi i betejës varet nga Zoti”⁶ dhe është vetëm nëpërmjet hirit të Tij që ne mund ta përmbushim punën e Tij dhe të bëhemi si Ai.⁷
- E katërta, për të na ndihmuar të zhvillojmë e të përvetësojmë një sërë tiparësh të ngjashme me të Krishtit që nuk mund të rafinohen përveçse nëpërmjet kundërshtimit⁸ dhe “në furrën e pikëllimit”⁹.

Ndaj, në një jetë mes pengesash e papërsosurisë, ne të gjithë jemi mirënjohës për mundësitë e dyta.

Në vitin 1970, kur isha student i vitit të parë në UBJ, u regjistrova në një lëndë për fillestarët në bazat e fizikës, e cila jepej nga Xhei Belif, një profesor i jashtëzakonshëm. Pas përfundimit të çdo kapitulli të lëndës, ai na bënte provim. Nëse një student merrte notën 6 dhe dëshironte një notë më të mirë, profesori Belif e lejonte studentin të bënte një provim



të ndryshuar që trajtonte të njëjtin material. Nëse studenti/ja merrte 9 në orvatjen e dytë dhe ishte prapë i pakënaqur, ai ose ajo mund ta bënte provimin për herë të tretë e të katërt e kështu me radhë. Duke më lejuar shumë mundësi të dyta, ai më ndihmoi të shkëlqejë dhe të merrja më në fund një 10 në lëndën e tij.

Ai ishte një profesor i rrallë dhe i urtë i cili i frymëzonte studentët e tij që të vazhdonin të përpiqeshin – ta konsideronin dështimin si një mësues, jo si një tragjedi dhe të mos i druheshin dështimit, por të mësonin prej tij.

Kohët e fundit e mora në telefon këtë njeri të shkëlqyer 47 vjet pasi ndoqa lëndën e tij të fizikës. E pyeta pse ishte i gatshëm t'i lejonte studentët të bënin orvatje të pakufizuara për ta përmirësuar notën. Përgjigja e tij qe: “Doja të isha nga ana e studentëve”.

Ndërkohë që jemi mirënjohës për mundësitë e dyta pas gabimeve ose dështimeve të mendjes, ne qëndrojmë plot habi përpara hirit të Shpëtimtarit kur

na jep mundësi të dyta për ta mposhtur mëkatën ose dështimet e zemrës.

Askush nuk është nga ana jonë më shumë sesa Shpëtimtari. Ai na lejon t'i bëjmë dhe të vazhdojmë t'i bëjmë sërish provimet e Tij. Për t'u bërë si Ai do të na duhen *mundësi të dyta* të panumërta, në betejat tona ditë pas dite me njeriun e natyrshëm, të tilla si kontrollimi i orekseve, mësimi i durimit dhe i faljes, kapërcimi i plogështisë dhe shmangia e mëkateve nga mosveprimi, për të përmendur vetëm disa. Nëse të gabosh është pjesë e natyrës njerëzore, sa dështime do të duhen derisa natyra jonë të mos jetë më njerëzore por hyjnore? Mijëra? Ka të ngjarë që një milion.

Duke e ditur që shtegu i ngushtë e i ngushtuar do të ishte plot me sprova dhe që dështimet do të ishin një dukuri e përditshme për ne, Shpëtimtari pagoi një çmim të pafundmë për të na dhënë aq mundësi sa do të na duheshin për ta kaluar me sukses provën tonë në vdekshmëri. Kundërshtimi që Ai lejon, shpesh mund të

duket i pakapërcyeshëm dhe pothuajse i pamundur për t'u duruar, sidoqoftë Ai nuk na lë pa shpresë.

Hiri i Shpëtimtarit është kurdoherë i gatshëm dhe kurdoherë i pranishëm që të na e mbajë shpresën të ndezur teksa përballemi me sprovat e jetës. Ky hir është “një ndihmë ose forcë [hyjnore] . . . një fuqi ndihmuese që i lejon burrat dhe gratë të marrin bekime në këtë jetë dhe të fitojnë jetë të përjetshme dhe ekzaltim, *pasi* të kenë bërë përpjekjet më të mira”¹⁰. Hiri i Tij dhe syri i Tij i dashur janë mbi ne gjatë gjithë rrugëtim tonë teksa Ai e frymëzon, i lehtëson barrët, e forcon, e çliron, e mbron, e shëron dhe e “ndihmo[n] popullin e tij” në ndonjë mënyrë tjetër, edhe kur ai pengohet përgjatë shtegut të ngushtë dhe të ngushtuar.¹¹

Pendimi është dhurata e kurdo- gjendur e Perëndisë që na lejon dhe mundëson të kalojmë nga dështimi në dështim pa e humbur asnjëherë entuziazmin. Pendimi nuk është plani i Tij rezervë në rastin kur ne mund të dështojmë. Pendimi është plani i Tij, duke e ditur që do të dështojmë. Ky është ungjilli i pendimit dhe siç ka vërejtur President Rasëll M. Nelson, ai do të jetë “një program mësimor sa vetë jeta”¹².

Në këtë program mësimor pendimi sa vetë jeta, sakramenti është mënyra që Zoti ka caktuar për sigurimin e qasjes së vazhdueshme në faljen e Tij. Nëse e marrim atë me një zemër të thyer dhe një shpirt të penduar, Ai na ofron falje të përjavshme teksa përparojmë nga dështimi në dështim gjatë shtegut të besëlidhjes. Pasi “pavarësisht nga mëkatet e tyre, brendësia ime mbushet me dhembshuri për ta”¹³.

Por saktësisht sa herë do të na falë Ai? Sa zgjat vetëpërmbytja e Tij? Në një rast Pjetri e pyeti Shpëtimtarin: “Zot, në se vëllai im mëkaton kundër meje, sa





që të hedhim një vështrim të brendshëm te vetja nëpërmjet atyre thjerrave për ta dalluar përparimin tonë dhe për të na frymëzuar që të “shkoljmë] përpara me një vendosmëri në Krisht, duke pasur një ndriçim të përkryer të shpresës”²².

Jam mirënjohës në përjetësi për dashamirësinë, durimin dhe vetëpërmbytjen e dashur të Prindërve Qjellorë dhe Shpëtimtarit, që na lejojnë të kemi mundësi të dyta të panumërta në rrugëtimin tonë të kthimit për në praninë e Tyre. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Ky citim iu është atribuar disa autorëve, përfshirë Abraham Linkolnit dhe Uinston Çërçillit.
2. Thomas Edison, në Zorian Rotenberg, “To Succeed, You Must Fail, and Fail More”, 13 nëntor 2013, insightsquared.com.
3. Charles F. Kettering, në Thomas Alvin Boyd, *Charles F. Kettering: A Biography* (1957), f. 40. Ky citim i është atribuar shpesh edhe autorit C. S. Lewis.
4. Doktrina e Besëlidhje 122:7. Edhe Shpëtimtari “mësoi të jetë i bindur nga ato që pësoi” (Hebrenjve 5:8). Ndërkohë që këto shkrime të shenja po i referohen mundimit dhe vuajtjes për shkak të mjedisit ose kushteve tona të pafavorshme, gabimet që bëjmë janë edhe për të mirën tonë nëse mësojmë prej tyre.
5. Moisiu 6:55.
6. 1 Samuelit 17:47; shih edhe 1 Nefi 3:29.
7. Shih Jakobi [LiM] 4:7.
8. Shih 2 Nefi 2:11.
9. Isaia 48:10; 1 Nefi 20:10.
10. “Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta”, “Hir”; theksimi i shtuar.
11. Alma 7:12.
12. Russell M. Nelson, në Dallin H. Oaks and Neil L. Andersen, “Repentance” (fjalim i mbajtur në seminarin për presidentët e rinj të misionëve, 26 qershor 2015), f. 11.
13. Doktrina e Besëlidhje 101:9.
14. Mateu 18:21.
15. Mateu 18:22.
16. Mosia 26:30; theksimi i shtuar.
17. Moroni 6:8; theksimi i shtuar.
18. “Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta”, “Pendim, Pendohem”, scriptures.lds.org.
19. Boyd K. Packer, Konferenca e Kunjit në Kingsland, Xhorxhia, gusht 1997.
20. Shih 3 Nefi 27:27.
21. 2 Korintasve 12:9; shih edhe Ethëri 12:27.
22. 2 Nefi 31:20.

herë duhet ta fal? Deri shtatë herë?”¹⁴

Me sa duket, Pjetri mendoi se *shtata* ishte një numër i madh mjaftueshëm për ta theksuar marrëzinë e faljes së tepërt dhe që mirëdashja duhet të ketë kufijtë e saj. Në përgjigje, Shpëtimtari në thelb i tha Pjetrit që as të mos e numëronte – as të caktonte kufij për faljen.

“Jezusi i tha: ‘Unë nuk të them deri shtatë herë, por deri shtatëdhjetë herë shtatë.’”¹⁵

Dukshëm, Shpëtimtari nuk po caktonte një kufi maksimal prej 490 herësh. Kjo do të ishte e krahasueshme me të thënit se marrja e sakramentit ka një kufi prej 490 herësh dhe se, herën e 491-të, një kontrollor qiellor ndërhyjnë dhe thotë: “Më vjen keq, por kartës sate të pendimit sapo i mbaroi afati – nga kjo pikë e tutje, je vetëm”.

Zoti e përdori llogaritjen matematikore shtatëdhjetë herë shtatë si një metaforë për Shlyerjen e Tij të pafundme, dashurinë e Tij të pakufishme dhe hirin e Tij të pakufizuar. “Po, dhe *kurdo* që njerëzit e mi pendohen, unë do t’ua fal shkeljet që kanë bërë kundër meje.”¹⁶

Kjo nuk do të thotë se sakramenti bëhet lejë për të mëkatuar. Kjo është një nga arsytet pse kjo frazë u përfshi në librin e Moronit: “Por, kurdoherë që pendoheshin dhe kërkonin ndjesë me *dëshirë të sinqertë*, ata faleshin”¹⁷.

Me dëshirë të sinqertë nënkuptohet *me përpjekje të vërtetë* dhe ndryshim të

vërtetë. “Ndryshimi” është fjala kryesore që përdoret tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta për të përkufizuar fjalën *pendim*: “Një ndryshim i mendjes dhe zemrës që sjell një qëndrim të ri ndaj Perëndisë, vetes dhe jetës në përgjithësi”¹⁸. Ai lloj ndryshimi sjell *rritje* shpirtërore. E pra, suksesi ynë, nuk është *kalimi* nga dështimi në dështim, por *rritja* nga dështimi në dështim pa e humbur asnjëherë entuziazmin.

Për sa i përket *ndryshimit*, mbajeni parasysh këtë ide të thjeshtë: “Gjërat që nuk ndryshojnë, mbeten njësoj”. Kjo e vërtetë e ditur nuk ka për qëllim t’ju fyejë inteligjencën, por është këshilla e thellë e Presidentit Bojd K. Paker, i cili në atë kohë shtoi: “Dhe kur mbaron ndryshimi ynë – *mbarojmë ne*”¹⁹.

Për shkak se nuk duam të *mbarojmë* derisa të bëhemi siç është Shpëtimtari²⁰, nevojitet të vazhdojmë të ngrihemi sa herë që rrëzohemi, me një dëshirë për të vazhduar rritjen dhe përparimin pavarësisht nga dobësitë tona. Në dobësinë tonë, Ai na jep siguri: “Hiri im të mjafton, sepse fuqia ime përsoset në dobësi”²¹.

Rritjen tonë fizike mund ta dallojmë vetëm me metoda si ajo e renditjes në kohë të imazheve ose grafikët e rritjes. Në mënyrë të ngjashme, rritja jonë shpirtërore zakonisht është e pakuptueshme përveçse me thjerrat e retrospektivës. Do të ishte diçka e mençur



Nga Plaku Nil L. Andersen,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Profeti i Perëndisë

Një profet nuk qëndron ndërmjet jush dhe Shpëtimtarit. Përkundrazi, ai qëndron përkrah jush dhe ju tregon rrugën drejt Shpëtimtarit.

uroj mirëseardhjen edhe nga ana ime Plakut Gerrit Gong dhe Plakut Ulise Soares në vëllazërinë e pakrahasueshme të Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve.

Në mbështetjen e Presidentit Rasëll M. Nelson si profeti i Zotit dhe si President i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, ne ishim pjesë e një kuvendi solemn të shpallur në mënyrë hyjnore – solemn, sepse ngjarjet e kësaj ore të kaluar janë paraprirë në qiejt që përpara se të ishte bota. Zoti Jezu Krisht, i cili e drejton punën e Tij, sot nëpërmjet Presidentit Ajring, na e ka paraqitur profetin e Tij, udhëheqësin e Tij të vajosur, neve, popullit të Tij të besëlidhjes, duke na lejuar publikisht që të shprehim gatishmërinë tonë për ta mbështetur atë dhe për ta ndjekur këshillën e tij.

Ju miliona anëtarë që nuk jeni këtu me ne në Qendrën e Konferencave, unë dëshiroj që ju të dini se Shpirti i Zotit në këtë godinë gjatë mbështetjes së Presidentit Nelson ishte saktësisht siç e keni paramenduar – plot me fuqi shpirtërore. Por kuvendi ynë, i drejtuar nga qielli, nuk është vetëm në këtë Qendër të Konferencave, por anëmbanë botës – në godinat kishtarë në Azi, Afrikë dhe Amerikën Veriore; në shtëpitë në Amerikën Qendrore e Jugore dhe Europë; në verandat e mbuluara në vendet e

Paqësorit dhe ishujt e detit. Ky kuvend është në çfarëdo pjese të botës ku mund të jeni ju, edhe nëse lidhja juaj mund të mos jetë më shumë se regjistrimi zanor nga telefoni juaj inteligjent. Duart tona të ngritura nuk u numëruan nga peshkopët tanë, por ato sigurisht u shënuan në qiell, pasi besëlidhja jonë është me Perëndinë dhe veprimi ynë shënohet në librin e jetës.

Zoti e Zgjedh Profetin e Tij

Përzgjedhja e një profeti bëhet nga Vetë Zoti. Nuk ka fushatë elektorale, as debate, as përpjekje për pozitë, as mosmarrëveshje, as mosbesim, as pëshënjellim apo rrëmujë. Unë gjithashtu

vërtetoj se fuqia e qiellit ishte me ne në dhomën e sipërme të tempullit, kur me lutje e rrethuan Presidentin Nelson dhe e ndiem pëlqimin e pamohueshëm të Zotit mbi të.

Përzgjedhja e Presidentit Nelson për të shërbyer si profeti i Perëndisë u bë shumë kohë më parë. Fjalët e Zotit drejtuar Jeremias gjejnë zbatim edhe për Presidentin Nelson: “Para se unë të të formoja në barkun e nënës sate, të kam njohur; para se ti të dilje nga barku i saj, të kam shenjtëruar dhe të kam caktuar profet të kombeve”¹. Vetëm tre vjet më parë, Plaku Nelson, në moshën 90-vjeçare, ishte i katërti për nga vjetërsia si Apostulli, me dy prej atyre tre Apostujve që ishin më të rinj në moshë nga ç’ishte ai. Zoti, i cili e kontrollon jetën dhe vdekjen, e zgjedh profetin e Tij. Presidenti Nelson, në moshën 93-vjeçare, ka shëndet të habitshëm. Shpresojmë që ai do të jetë me ne për një ose dy dekada të tjera, por sa për tani po përpiqemi ta bindim të qëndrojmë larg shpateve rrëshqitëse për ski.

Ndërkohë që e mbështetim profetin si të vajosurin e Zotit, le të jetë e qartë se ne adhurojmë vetëm Perëndinë, Atin tonë Qiellor, dhe Birin e Tij hyjnor. Është nëpërmjet meritave, mëshirës dhe



Karkasoni në Francë



Presidenti Nelson me stërnipin e tij të 118-të.

hirit të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, që ne mund të hyjmë një ditë sërish në praninë e Tyre.²

Përse e Ndjekim Profetin

Por Jezusi gjithashtu na mësoi një të vërtetë të rëndësishme rreth shërbëtorëve që Ai na dërgon. “Ai që ju pranon”, tha Ai, “më pranon mua; dhe ai që më pranon mua, pranon atë që më ka dërguar.”³

Roli më i rëndësishëm i profetit të Zotit është të na mësojë për Shpëtimtarin dhe të na udhëheqë drejt Tij.

Ka shumë arsye logjike për ta ndjekur Presidentin Rasëll M. Nelson. Edhe njerëzit jo të besimit tonë do ta quanin atë një njeri mendjendritur. Ai ishte mjek në moshën 22-vjeçare, një kirurg zemre i nderuar dhe një pionier i mirënjohur në zhvillimin e kirurgjisë me zemër të hapur.

Shumica e vlerësojnë urtësinë dhe gjykimin e tij: nëntë dekada mësimi mbi jetën e vdekjen, të jetuarin vetëmohues, dashurinë dhe mësimdhënien për fëmijët e Perëndisë në çdo cep të globit dhe pjekurinë me përvojat e rritjes së 10 fëmijëve, 57 nipërve e mbesave dhe 118 stërnipërve e stërmbesave (kjo shifër e fundit ndryshon shpesh; një stërnip u lind të mërkurën që shkoi).

Ata që e njohin mirë, do të flisnin për përballjen e Presidentit Nelson me

vështirësitë e jetës me besim e kurajë. Kur kanceri ia mori jetën bijës së tij 37-vjeçare, Emilisë, duke lënë pas një bashkëshort të dashur dhe pesë fëmijë të vegjël, e dëgjova të thoshte: “Unë isha babai i saj, një mjek dhe një Apostull i Zotit Jezu Krisht, por m’u desh ta ulja kokën dhe të pranoja: ‘Mos u bëftë vullneti im, por yti’”⁴.

Një Rojë në Kullë

Edhe pse i admirojmë të gjitha këto cilësi fisnike, përse e ndjekim Presidentin Nelson? Përse e ndjekim profetin? Sepse Zoti Jezu Krisht e ka thirrur dhe e ka përcaktuar atë si zëdhënës të Tij në tokë dhe si rojën e Tij mbi kullë.

Karkasoni është një qytet mbresëlënës në Francë, i rrethuar me mure, i cili ka ekzistuar që nga kohët mesjetare. Kulla të larta ngrihen prej mureve të tij të mbrojtura, të ndërtuara për rojat të cilët qëndronin në ato kulla ditë e natë, duke e mbajtur vëmendjen e tyre të gozhdur në largësi për armikun. Kur roja shihte të afrohej një armik, zëri i tij paralajmërues i mbronte njerëzit e

Karkasonit nga rreziku i afërt që nuk mund ta shihnin.

Një profet është si një rojë mbi kullën, duke na mbrojtur nga rreziqe shpirtërore që nuk mund t’i shohim.

Zoti i tha Ezekielit: “Të kam vendosur si rojë për shtëpinë e Izraelit; prandaj dëgjo fjalën [nga] goj[al]a ime dhe i lajmëro nga ana ime”⁵.

Ne shpesh flasim për nevojën tonë për ta ndjekur profetin, por merrni parasysh këtë barrë të rëndë që Zoti e vendos mbi profetin e Tij: “[Nëse] ti nuk flet për të paralajmëruar të pabesin . . . [dhe] ai i pabesë . . . vdes për shkak të paudhësisë së tij, . . . për gjakun e tij do t’i kërkoj llogari dorës sate”⁶.

Një Dëshmi Vetjake më e Madhe

Ne e përqafojmë Presidentin Nelson sikurse do të kishim përqaftuar Pjetrin apo Moisiun nëse do të kishim jetuar në kohën e tyre. Perëndia i tha Moisiut: “Unë do të jem me gojën tënde dhe do të të mësoj atë që duhet të thuash”⁷. Ne e dëgjojmë profetin e Zotit me besimin që fjalët e tij janë “si nga goja [e Zotit]”⁸.





A është ky besim i verbër? Jo, nuk është. Ne secili kemi dëshmi shpirtërore për vërtetësinë e Rivendosjes së ungjillit të Jezu Krishtit. Me anë të vetë vullnetit dhe zgjedhjes sonë, ne e ngritëm dorën këtë mëngjes, duke shpallur dëshirën tonë për ta mbështetur profetin e Zotit nëpërmjet “mirëbesimi[t], besimi[t] dhe lutje[ve]”⁹ tona dhe për ta ndjekur këshillën e tij. Ne kemi privilegjin si shenjtorë të ditëve të mëvonshme që të marrim dëshmi vetjake se thirrja e Presidentit Nelson është nga Perëndia. Ndërkohë që bashkëshortja ime, Kathi, e ka njohur Presidentin Nelson personalisht për gati tri dekada dhe nuk ka asnjë dyshim për mantelin e tij hyjnor, në kohën e veçimit të tij, ajo filloi të lexonte të gjitha bisedat e tij të konferencave të përgjithshme në 34 vitet e shkuara, duke u lutur për një siguri edhe më të thellë për rolin e tij profetik. Ju premtoj se kjo dëshmi më e madhe do të vijë kur ju ta kërkonti atë përlësisht e denjësisht.

Përse jemi kaq të gatshëm për ta ndjekur zërin e profetit tonë? Për ata që e kërkojnë me zell jetën e përjetshme, zëri i profetit sjell siguri shpirtërore në kohë shumë të turbullta.

Ne jetojmë në një planet ku ziejnë miliona zëra. Interneti, telefonat tanë inteligjentë, paketat me lojëra argëtuese, që të gjitha kërkojnë vëmendjen tonë dhe e hedhin ndikimin e tyre mbi ne, duke shpresuar se do t'i blejmë prodhimet e tyre dhe do t'u përshtate mi standardeve të tyre.

Moria në dukje e pafundme e informacionit dhe opinioneve na kujton për paralajmërimet në shkrimet e shenjta të të qenit “të lëkundur”¹⁰, të “ngr[itur] dhe [të] përplas[ur nga] era”¹¹ dhe të mbisunduar nga “dinakëria” e atyre që përdorin “gënjeshtra të gabimit”¹².

Hedhja e spirancës së shpirtit tonë te Zoti Jezu Krisht kërkon që t'i dëgjojmë ata që Ai i dërgon. Ndjekja e profetit në një botë rrëmuje është si të jemi të mbështjellë me një kuvertë të butë, të ngrohtë në një ditë acari të ftohtë.

Ne jetojmë në një botë të arsyes, debatit, argumentit, logjikës dhe shpjegimit. Bërja e pyetjeve “Përse?” është pozitive në shumë aspekte të jetës sonë, duke e lejuar fuqinë e intelektit tonë për të na udhërrëfyer në një mori zgjedhjesh dhe vendimesh me të cilat përballemi çdo ditë.

Por zëri i Zotit shpesh vjen pa shpjegim.¹³ Shumë kohë përpara se akademikët ta studionin ndikimin e mungesës së besnikërisë te bashkëshortet/ët dhe fëmijët mirëbesues, Zoti shpalli: “Nuk do të shkelësh besnikërinë bashkëshortore”¹⁴. Përveç mbështetjes tek intelekti, ne e ruajmë si thesar dhuratën e Frymës së Shenjtë.

Mos u Habitni

Zëri i profetit, edhe pse flet me mirësi, shpesh do të jetë një zë që na kërkon të ndryshojmë, të pendohemi dhe të kthehemi te Zoti. Kur nevojitet korrigjim, mos u vonofshim. Dhe mos u alarmoni kur zëri paralajmëruet i profetit ndeshet me opinionet e sotme, të pranuar gjerësisht. Goditjet e zjarra të talljes nga njerëz të irrituar mosbesues gjithmonë ndizen në çastin kur profeti fillon të flasë. Kur jeni të përlurur në ndjekjen e këshillës së profetit të Zotit, ju premtoj një bekim më të madh sigurie dhe paqeje.

Mos u habitni nëse me raste pikëpamjet tuaja vetjake fillimisht nuk janë në harmoni me mësimet e profetit të Zotit. Këto janë çaste mësimi, përluljeje, kur ne biem në gjunjë për lutje. Ne ecim përpara me besim, duke mirëbesuar te Perëndia, duke e ditur se me kohën, do të marrim më shumë qartësi shpirtërore nga Ati ynë Qiellor. Një profet e përshkroi dhuratën e pakrahasueshme të Shpëtimtarit si “vullneti[n e] Birit duke u shkrirë në vullnetin e Atit”¹⁵. Nënshtrimi i vullnetit tonë ndaj vullnetit të Perëndisë nuk është, në fakt, aspak nënshtrim, por fillimi i një fitoreje të lavdishme.

Disa do të përpiqen t'i rrëmojnë me imtësi fjalët e profetit, duke hasur vështirësi për të përcaktuar se cili është zëri i tij profetik dhe cili është opinioni i tij vetjak.

Në vitin 1982, dy vjet përpara thirrjes si Autoritet i Përgjithshëm, Vëllai Rasëll M. Nelson tha: “Kurrë nuk e pyes veten: ‘Kur flet profeti si profet dhe kur nuk flet?’ Interesi im ka qenë: ‘Si mund të jem më shumë si ai?’” Dhe ai shtoi: “[Filozofia ime është të] mos vë më pikëpyetje pas deklaratave të profetit dhe të vendos pikëçuditje në vend të tyre”¹⁶. Kjo është mënyra se si një burrë i përlurur dhe shpirtëror zgjodhi se si t’i jepte drejtim jetës së vet. Tani, 36 vjet më vonë, ai është profeti i Zotit.

Rritja e Besimit Tuaj te Shpëtimtari

Në jetën time vetjake, kam zbuluar se kur i studioj plot lutje fjalët e profetit të Perëndisë dhe e përputh shpirtërisht me kujdes, me durim, vullnetin tim me mësimet e tij të frymëzuara, besimi im në Zotin Jezu Krisht gjithmonë rritet.¹⁷ Nëse zgjedhim ta vëmë mënjane këshillën e tij dhe vendosim se ne e dimë më mirë se ai, besimi ynë vuan dhe këndvështrimi ynë i përjetshëm errësohet. Ju premtoj se, tekta qëndroni të vendosur në ndjekjen e profetit, do të rritet besimi juaj në Shpëtimtarin.

Shpëtimtari tha: “Të gjithë profetët . . . kanë dëshmuar për mua”¹⁸.

Një profet nuk qëndron ndërmjet jush dhe Shpëtimtarit. Përkundrazi, ai qëndron përkrah jush dhe ju tregon rrugën drejt Shpëtimtarit. Përgjegjësia më e madhe dhe dhurata më e çmuar e një profeti për ne është dëshmia e tij e sigurt, dituria e tij e patundur se Jezusi është Krishti. Si Pjetri i lashtë, profeti ynë shpall: “[Ai është] Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë”¹⁹.

Në një ditë të ardhshme, duke e hedhur vështrimin pas në vdekshmërinë tonë, ne do të ngazëllemi që ecëm në tokë në kohën e një profeti të gjallë. Në atë ditë, lutem që ne do të jemi të aftë të themi:

E dëgjuam atë.

E besuam atë.
I studiuam fjalët e tij me durim e besim.
U lutëm për të.
Qëndruam krah tij.
Ishim mjaft të përlurur sa ta ndiqnim atë.
E deshëm atë.
Ju jap dëshminë time solemne se Jezusi është Krishti, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë, dhe se Presidenti Rasëll M. Nelson është profeti i Tij i vajosur në tokë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Jeremia 1:5
2. Shih 2 Nefi 2:8.
3. Mateu 10:40.
4. Kujtim vetjak; shih edhe Spencer J. Condie, *Russell M. Nelson: Father, Surgeon, Apostle* (2003), f. 235.
5. Ezekiel 33:7.
6. Ezekiel 33:8.
7. Eksodi 4:12.
8. Doktrina e Besëlidhje 21:5.
9. Doktrina e Besëlidhje 107:22.



10. Efesianëve 4:14.
11. Jakob [Bibël] 1:6.
12. Efesianëve 4:14.
13. Presidenti Dallin H. Oaks dikur tha: “Në një intervistë të vitit 1988 . . . shpjegova qëndrimin tim ndaj përpjekjeve për të dhënë arsye njerëzore për një zbulësë hyjnore: ‘Nëse i lexoni shkrimet e shenjta me këtë pyetje në mendje: ‘Përse e urdhëroi Zoti këtë ose përse e urdhëroi atë’, ju zbuloni se u dha arsye në më pak se një në njëqind urdhra. Nuk është modeli i Zotit për të dhënë arsye. Ne [të vdekshmit] mund t’i japim arsye zbulësës. Ne mund t’u japim arsye urdhërimeve. Kur e bëjmë këtë, ne lihem vetëm. Disa njerëz dhanë arsye për [zbulësën] . . . dhe në mënyrë të mahnitshme mësuuan se e kishin gabim. Ka një mësim në këtë. . . . Unë mora vendim shumë kohë më parë se kisha besim në urdhrin dhe nuk kisha besim në arsyet që ishin sugjeruar për të.’ . . . ‘. . . E gjithë tërësia e arsyeve më duket se është një marrje e panevojshme e rrezikut. . . . Le të mos e bëjmë gabimin që është bërë në të shkuarën, . . . duke u përpjekur t’i japim arsye zbulësës. Arsyet në masë të gjerë krijohen nga njerëzit. Zbuluesat janë ato që ne i mbështetim si vullnetin e Zotit dhe është atje vendi ku gjendet siguria” (*Life’s Lessons Learned* [2011], f. 68–69).
14. Eksodi 20:14.
15. Mosia 15:7.
16. Russell M. Nelson, në Lane Johnson, “Russell M. Nelson: A Study in Obedience”, *Tambuli*, janar 1983, f. 26.
17. Presidenti Henri B. Ajring tha: “Një tjetër ide e gabuar është të besosh se zgjedhja për ta pranuar ose jo këshillën e profetëve nuk është më tepër se të vendosësh nëse të pranosh një këshillë të mirë dhe të përfitosh dobinë e saj, ose të mbetesesh aty ku je. Por zgjedhja për të mos zbatuar këshillën profetike e ndryshon vetë terrenin ku qëndrojmë. Ai bëhet më i rrezikshëm. Mospranimi i këshillës profetike zvogëlon fuqinë tonë për të marrë këshillë të frymëzuar në të ardhmen. Rasti më i mirë për të vendosur që Noeu të ndihmohej për të ndërtuar arkën, ishte kur ai kërkoi ndihmë për herë të parë. Çdo herë që ai kërkoi ndihmë pas kësaj, çdo dëshmim për t’u përgjigjur, do ta zvogëlonte ndjeshmërinë ndaj Shpirtit. Kështu që çdo herë që ai kërkonte ndihmë, do të ishte dukur më e pamend, derisa erdhi shiu. Por atëherë ishte tepër vonë” (“Finding Safety in Counsel”, *Ensign*, maj 1997, f. 25).
18. 3 Nefi 20:24.
19. Mateu 16:16; shih edhe Gjoni 6:69.



Paraqitur nga Presidenti Dallin H. Oaks,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Mbështetja e Drejtuesve të Kishës

Përmendim se raporti statistikor, që zakonisht paraqitet gjatë këtij sesioni të konferencës së përgjithshme të prillit, do të publikohet tani në LDS.org menjëherë pas kësaj mbledhjeje dhe do të përfshihet në botimin e konferencës të revistave të Kishës.

Unë do të paraqit tani disa ndryshime në udhëheqjen e Kishës si dhe Drejtuesit e Përgjithshëm dhe Të Shtatëdhjetët Zonalë të Kishës për votimin mbështetës, pas të cilit, Vëllai Kevin R. Xhergensen, drejtor përgjegjës i Sektorit të Kontrollit Financiar të Kishës, do të lexojë raportin e kontrollit financiar.

Pasi u dhanë thirrjet e tyre për të shërbyer si anëtarë të rinj të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, propozohet që ne t'i lirojmë Pleqtë Gerit W. Gong dhe Ulises Soares nga shërbimi i tyre si anëtarë të Presidencës së Të Shtatëdhjetëve.

Gjithashtu, i lirojmë Pleqtë Krejg C. Kristensen, Lin G. Robins dhe Huan A. Uceda nga shërbimi i tyre si anëtarë të Presidencës së Të Shtatëdhjetëve, lirime që hyjnë në fuqi më 1 gusht.

Të gjithë ata që dëshirojnë t'u shprehin vlerësim këtyre Vëllezërve për shërbimin e tyre të përkushtuar, u lutemi ta tregojnë.

Propozohet që t'i lirojmë personat që vijojnë nga shërbimi i tyre si Të

Shtatëdhjetë Zonalë: Stiven R. Bangerter, Methju L. Karpenter, Matias Held, Dejvid P. Homer, Kajl S. Mek-Kej, R. Skot Runia dhe Huan Pablo Vijar.

Ata që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur vlerësim këtyre Vëllezërve për shërbimin e tyre me gatishmëri, mund ta bëjnë këtë duke ngritur dorën.

Propozohet që t'i lirojmë nga thirrjet me mirënjohje të përzemërt Motrat Boni L. Oskarson, Karol F. Mek-Konki dhe Nill F. Mariot, si Presidencë e

Përgjithshme e Të Rejave. Po ashtu i lirojmë nga thirrjet anëtarët e kryesisë së përgjithshme të Të Rejave, të cilat kanë shërbyer kaq mirë.

Të gjithë atyre që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur vlerësim këtyre motrave për shërbimin dhe përkushtimin e tyre të shquar, u lutemi ta shfaqin.

Propozohet që ta lirojmë Motrën Boni H. Kordën nga shërbimi si Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Fillores

Ata që dëshirojnë të shprehin vlerësim ndaj Motrës Kordën, mund ta bëjnë këtë duke ngritur dorën.

Propozohet që ne t'i mbështetim personat që vijojnë për të shërbyer si anëtarë të Presidencës së Të Shtatëdhjetëve, duke hyrë në fuqi menjëherë: Pleqtë Karl B. Kuk dhe Robert C. Gei.

Personat që vijojnë do të shërbejnë gjithashtu si anëtarë të Presidencës së Të Shtatëdhjetëve, duke hyrë në fuqi nga data 1 gusht 2018: Pleqtë Terens M. Vinson, Zhoze A. Teisheira dhe



Karlos A. Godoi.

Ata që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Ata që janë kundër, nëse ka.

Propozohet që ne t'i mbështetim personat që vijojnë si Autoritete të reja të Përgjithshme Të Shtatëdhjetë: Stiven R. Bangarter, Methju L. Carpenter, Xhek N. Xherard, Matias Held, Dejvid P. Homer, Kajl S. Mek-Kej, Huan Pablo Vijar dhe Takashi Uada.

Të gjithëve që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Ata kundër, me të njëjtën shenjë.

Propozohet që t'i mbështetim personat që vijojnë si Të Shtatëdhjetë të rinj Zonalë: Riçard K. Ahaxhi, Alberto A. Alvarez, Duejn D. Bell, Glen Bërxis, Viktor R. Kalderon, Ariel E. Çaparro, Daniel Kordova, Xhon N. Krejg, Majkëll Cizla, Uilliam H. Dejvis, Riçard J. DeVris, Kajlar G. Domingez, Shon Daglas, Majkëll A. Dan, Keneth J. Fërmixh, Edgar Flores, Silvio Flores, Saulo G. Franko, Karlos A. Genaro, Mark A. Gilmur, Serhio A. Gomez, Roberto Gonzalez, Virhilio Gonzalez, Spenser R. Griffin, Methju S. Harding, Dejvid J. Harris, Kevin J. Hethëuej, Riçard Holzapfel, Justash Ilunga, Okeçukvu I. Imo, Piter M. Xhonson, Majkëll D. Xhons, Pungve S. Kongolo, Xhorxh Keneth G. Li, Aretemio C. Maligon, Edgar A. Mantija, Linkoln P. Martins, Klement M. Matsvagotata, Karl R. Maurer, Deniell S. Mer II, Glen D. Mella, Isak K. Morrison, Jutaka Nagatomo, Allister B. Oxhers, R. Xhefri Parker, Viktor P. Patrik, Denis E. Pineda, Henrike S. Simplicio, Xhefri H. Singer, Majkëll L. Stejli, Xharot Subiantoro, Xhefri K. Uecëll, Majkëll S. Uillshted, Helmut Vondra dhe Dejvid L. Rajt.

Të gjithëve që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Ata që janë kundër, nëse ka.

Propozohet që ne ta mbështetim

Boni H. Kordënin për të shërbyer si Presidente e Përgjithshme e Të Rejave, me Mishel Lin Krejgun si Këshilltare të Parë dhe Rebeka Lin Krejvënin si Këshilltare të Dytë.

Ata që janë dakord, mund ta shfaqin atë.

Ndonjë kundër, mund ta tregojë po ashtu.

Propozohet që ne ta mbështetim Liza Rëne Harknesin për të shërbyer si Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Fillores

Ata që janë dakord, mund ta shfaqin atë.

Ata që janë kundër, nëse ka.

Propozohet që ne t'i mbështetim Autoritetet e tjera të Përgjithshme, Të

Raporti i Sektorit të Kontrollit Financiar të Kishës, 2017

Paraqitur nga Kevin R. Xhergensen,

Drejtor Përgjegjës, Sektori i Kontrollit Financiar të Kishës

Drejtuar Presidencës së Parë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Të dashur Vëllezër: Siç përkruhet me anë të zbulës në seksionin 120 të Doktrinës e Besëlidhjeve, Këshilli mbi Planifikimin e Të Dhjetave – i përbërë nga Presidenca e Parë, Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve dhe Peshkopata Kryesuese – e autorizon shpenzimin e fondeve të Kishës. Subjektet e Kishës i shpenzojnë fondet në përputhje me buxhetet, rregulloret dhe procedurat e miratuara.

Sektori i Kontrollit Financiar të Kishës, i cili përbëhet nga profesionistë të licencuar dhe është i pavarur nga të gjithë sektorët e tjerë të Kishës, ka përgjegjësinë të kryejë kontrolle financiare me qëllim që të japë siguri të arsyeshme lidhur me kontributet e marra, shpenzimet e bëra dhe mbrojtjen e pasurive të Kishës.

Bazuar mbi kontrollet financiare të kryera, Sektori i Kontrollit Financiar të Kishës është i mendimit se, në çdo hollësi të rëndësishme, kontributet e marra, shpenzimet e bëra dhe pasuritë e Kishës për vitin 2017, janë regjistruar dhe administruar në përputhje me buxhetet, rregulloret dhe praktikatat llogaritëse të miratuara të Kishës. Kisha i ndjek praktikatat që u jepen mësim anëtarëve të saj, të të jetuarit brenda një buxheti, të shmangies së borxhit dhe të kursimit për një rast nevojë.

Paraqitur me respekt nga

Sektori i Kontrollit Financiar të Kishës

Kevin R. Xhergensen

Drejtor Administrimi ■



Nga Plaku Dejvid A. Bednar,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Shtatëdhjetët Zonalë dhe Presidentat e Përgjithshme të Organizatave Ndhimëse me përbërjen e tyre të tanishme.

Të gjithëve që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Ata që janë kundër, nëse ka.

Presidenti Nelson, votimi u regjistrua. Ne i ftojmë ata që mund të kenë qenë kundër ndonjërit prej propozimeve, që të vihen në kontakt me presidentët e tyre të kunjeve.

Me mbështetjen që sapo u zhvillua, kemi tani 116 Autoritete të Përgjithshme. Afërsisht 40 për qind e tyre u lindën jashtë Shteteve të Bashkuara – në Gjermani, Brazil, Meksikë, Zelandën e Re, Skoci, Kanada, Korenë e Jugut, Guatemalë, Argjentinë, Itali, Zimbabve, Uruguai, Peru, Afrikën e Jugut, Samoan Amerikane, Angli, Porto-Riko, Australi, Venezuelë, Kenia, Filipine, Portugali, Fixhi, Kinë, Japoni, Kili, Kolumbi dhe Francë.

Vëllezër dhe motra, ne ju falënderojmë për besimin dhe lutjet tuaja të vazhdueshme në emrin e udhëheqësve të Kishës.

Tani i ftojmë Autoritetet e reja të Përgjithshme Të Shtatëdhjetë, Presidentën e re të Përgjithshme të Të Rejave dhe Motrën Harknes, të Presidentës së Përgjithshme të Filllores, që të zënë vendet e tyre në tribunë. ■

Zemërbutë dhe të Përulur nga Zemra

Zemërbutësia është një tipar përcaktues i Shëlbuesit dhe vihet në dukje prej aftësisë për t'u përgjigjur me drejtësi, për t'u nënshtruar me gatishmëri dhe për t'u vetëpërmbytur me fuqi.

Gëzohem në mundësinë e shenjtë për të mbështetur udhëheqësit tanë të Kishës dhe i uroj përzemërsisht mirëseardhjen Plakut Gong dhe Plakut Soares në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve. Shërbesat e këtyre burrave besnikë do të bekojnë individë e familje anembanë botës dhe unë pres me dëshirë që të shërbej me ta dhe të mësoj prej tyre.

Lutem që Fryma e Shenjtë do të na japë mësim e do të na ndriçojë ndërsa mësojmë së bashku rreth një aspekti jetik të natyrës hyjnore të Shpëtimtarit¹,

që secili prej nesh duhet të përpiqet fort ta ndjekë.

Do të paraqes disa shembuj që e theksojnë këtë cilësi si të Krishtit përpara se ta përcaktoj tiparin e veçantë më vonë në mesazhin tim. Ju lutem, dëgjojeni me kujdes secilin shembull dhe merrini në shqyrtim me mua përgjigjet e mundshme të pyetjeve që do të shtroj.

Shembulli 1. I Riu Pasanik dhe Amuleku

Në Dhiatën e Re, ne mësojmë për një të ri pasanik, i cili e pyeti Jezusin: “Mësuesi i mirë, çfarë të mire duhet të bëj që të kem jetë të përjetshme?”² Shpëtimtari fillimisht e këshilloi të zbatonte urdhërimet. Mësuesi më pas i bëri të riut një kërkesë shtesë, të përshtatur sipas nevojave dhe rrethanave të tij të veçanta.

“Jezusi i tha: ‘Në qoftë se do të jesh i përsosur, shko, shit ç’të kesh, jepua të varfërve dhe ti do të kesh një thesar në qiell; pastaj eja dhe më ndiq mua’.

Por i riu, kur i dëgjoji këto fjalë, iku i trishtuar, sepse kishte pasuri të madhe.”³

Krahasojeni përgjigjen e të riut pasanik me përvojën e Amulekut, siç përshkruhet në Librin e Mormonit.



Amuleku ishte një burrë punëtor dhe i pasur, me shumë farefis e miq.⁴ Ai e përshkroi veten e tij si një burrë i cili u thirr shumë herë, por nuk donte të dëgjonte; një burrë i cili i dinte gjërat e Perëndisë, por nuk zgjodhi t'i dinte.⁵ Një burrë i mirë në thelb, Amuleku e humbi përqendrimin për shkak të shqetësimeve të botës, po ashtu si i riu pasanik i përshkruar në Dhiatën e Re.

Edhe pse e kishte ngurtësuar zemrën më parë, Amuleku iu bind zërit të një engjëlli, e pranoi profetin Alma në shtëpinë e vet dhe i siguroi ushqim. Ai u zgjua shpirtërisht gjatë vizitës së Almës dhe u thirr të predikonte ungjillin. Amuleku më pas hoqi dorë nga “i gjithë ari dhe argjendi i tij dhe nga gjërat e çmueshme të tij . . . për fjalën e Perëndisë, [dhe nuk] u pranua më nga ata që kishin qenë njëherë miqtë e tij dhe gjithashtu nga i ati dhe nga farefisi i tij”⁶.

Çfarë mendoni se e shpjegon ndryshimin midis përgjigjeve të të riut pasanik dhe Amulekut?

Shembulli 2. Pahorani

Gjatë një periudhe të rrezikshme lufte, të përshkruar në Librin e Mormonit, ndodhi një shkëmbim letrash midis Moronit, kapitenit të ushtrive nefite, dhe Pahoranit, kryegjykatësit dhe guvernatorit të vendit. Moroni, ushtria e të cilit po vuante për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme nga qeveria, i shkroi Pahoranit “për t[a] dënuar”⁷ dhe e akuzoi atë dhe bashkudhëheqësit e tjerë për moskokëçarje, plogështi, mospërfillje dhe madje që ishin tradhtarë.⁸

Pahorani mund të ishte inatosur fare lehtë me Moronin dhe deklarimet e tij të pasakta, por nuk u inatos. Ai u përgjigj me dhembshuri dhe përshkroi një rebelim kundër qeverisë për të cilin Moroni nuk kishte dijeni. Dhe më pas Pahorani shpalli:

“Vër re, unë po të them ty Moroni se nuk gëzohem për vuajtjet tuaja të mëdha, po, ato e brengosin shpirtin tim. . . .

. . . Në letrën tënde ti më ke qortuar, por nuk ka rëndësi; unë nuk jam zemëruar, por gëzohem nga zemërmadhësia jote.”⁹

Çfarë mendoni se e shpjegon përgjigjen e matur të Pahoranit kundrejt akuzave të Moronit?

Shembulli 3. Presidenti Rasëll M. Nelson dhe Presidenti Henri B. Ajring

Në konferencën e përgjithshme gjatë muaj më parë, Presidenti Rasëll M. Nelson përshkroi përgjigjen e tij ndaj ftesës së Presidentit Tomas S. Monson për t'i studiuar, përsiatur dhe vënë në jetë të vërtetat që përmbahen në Librin e Mormonit. Ai tha: “Jam përpjekur ta ndjek këshillën e tij. Mes gjërash të tjera, kam bërë lista se çfarë është Libri i Mormonit, çfarë *pohon*, çfarë *përgënjeshtron*, çfarë *përmbush*, çfarë *sqaron* dhe çfarë *zbulon*. Qasja ndaj Librit të Mormonit në atë këndvështrim ka qenë një ushtrim mbresëlënës dhe frymëzues! Jua rekomandoj secilit prej jush.”¹⁰

Presidenti Henri B. Ajring po ashtu theksoi rëndësinë që pati në jetën e tij kërkesa e Presidentit Monson. Ai vëzhgoi:

“E kam lexuar Librin e Mormonit çdo ditë për më shumë se 50 vjet. Prandaj mbase mund të kisha menduar me arsye se fjalët e Presidentit Monson ishin për dikë tjetër. Prapëseprapë, si shumë prej jush, unë e ndjeva inkurajimin nga profeti dhe premtimin e tij të më ftonin për të bërë një përpjekje më të madhe. . . .

Rezultati i lumtur për mua dhe për shumë prej jush, ka qenë ajo që premtoi profeti.”¹¹

Çfarë mendoni se i shpjegon



përgjigjet e menjëhershme dhe të përzemërta ndaj ftesës së Presidentit Monson nga këta dy udhëheqës të Kishës së Zotit?

Nuk po sugjeroj që përgjigjet e forta shpirtërisht të Amulekut, Pahoranit, Presidentit Nelson dhe Presidentit Ajring shpjegohen vetëm nga një cilësi si e Krishtit. Sigurisht, shumë tipare dhe përvoja të ndërthurura çuan drejt pjekurisë shpirtërore të pasqyruar në jetën e këtyre katër shërbëtorëve fisnikë. Por Shpëtimtari dhe profetët e Tij kanë theksuar një cilësi thelbësore që ne të gjithë kemi nevojë ta kuptojmë më tërësisht dhe të përpiqemi fort që ta përfshijmë në jetën tonë.

Zemërbutësia

Ju lutem vini re karakteristikën që e përdori Zoti për ta përshkruar veten e Tij në shkrimin e shenjtë vijues: “Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse unë jam *zemërbutë dhe i përuhur nga zemra*; dhe ju do të gjeni prehje për shpirtrat tuaj”¹².

Në mënyrë udhëzuese, Shpëtimtari zgjodhi të theksonte zemërbutësinë mes gjithë tipareve dhe virtyteve që Ai mund t'i kishte përzgjedhur.

Një model i ngjashëm është i dukshëm në një zbulës të marrë nga Profeti Jozef Smith në vitin 1829. Zoti



shpalli: “Mëso nga unë dhe dëgjoji fjalët e mia; *ec në butësinë e Shpirtit tim* dhe ti do të kesh paqe në mua”¹³.

Zemërbutësia është një tipar përcaktues i Shëlbuesit dhe vihet në dukje prej aftësisë për t’u përgjigjur me drejtësi, për t’u nënshtruar me gatishmëri dhe për t’u vetëpërmbytur me fuqi. Kjo cilësi na ndihmon t’i kuptojmë më tërësisht reagimet përkatëse të Amulekut, Pahoranit, Presidentit Nelson dhe Presidentit Ajring.

Për shembull, Presidenti Nelson dhe Presidenti Ajring iu përgjigjën me drejtësi e me të shpejtë inkurajimit nga Presidenti Monson për ta lexuar e studiuar Librin e Mormonit. Edhe pse që të dy burrat po shërbenin në detyra të rëndësishme dhe të shquara në Kishë dhe i kishin studiuar shkrimet e shenja gjerësisht për dekada, ata në përgjigjet e tyre nuk shfaqën asnjë ngurrim apo ndjenjë që t’i jepnin rëndësi vetes.

Amuleku iu nënshtrua me gatishmëri vullnetit të Perëndisë, pranoi një thirrje për ta predikuar ungjillin dhe i la pas rrethanat e tij të rehatshme dhe marrëdhëniet familjare. Dhe Pahorani u bekua me një vetëpërmbyturje largpamëse dhe të fuqishme për të vepruar, në vend që të reagoonte tekta i shpjegonte Moronit sfidat që kishin dalë nga rebelimi kundër qeverisë.

Cilësia si e Krishtit e zemërbutësisë shpesh keqkuptohet në botën tonë bashkëkohore. Zemërbutësia është e fortë, jo e dobët; vepruese, jo pësuese;

e guximshme, jo e ndrojtur; e përmbytur, jo e tepruar; e thjeshtë, jo vetëmburrëse; dhe e hirshme, jo e pahijshme. Një njeri zemërbutë nuk nxitet lehtë në zemërim, nuk ka pretendime ose nuk është imponues, dhe me gatishmëri i vlerëson arritjet e të tjerëve.

Ndërkohë që *përrulësia* në përgjithësi nënkupton varësinë nga Perëndia dhe nevojën e vazhdueshme për udhërrëfim dhe përkrahjen e Tij, një karakteristikë dalluese e *zemërbutësisë* është një aftësi pranuese e veçantë shpirtërore për të mësuar nga Fryma e Shenjtë si edhe nga njerëzit që mund të duken më pak të zotë, me më pak përvojë ose më pak të arsimuar, të cilët mund të mos mbajnë pozita të rëndësishme, apo që ndryshe mund të mos duken se kanë shumë për të dhënë nga vetja. Silleni ndërmend se si Naamani, komandanti i ushtrisë së mbretit të Sirisë, e mposhti krenarinë e vet dhe me zemërbutësi e pranoi këshillën e shërbëtorëve të tij që t’i bindej Eliseut, profetit, dhe të lahej në lumin Jordan shtatë herë.¹⁴ Zemërbutësia është mbrojtja kryesore nga verbëria kryelartë që shpesh rrjedh nga fama, pozita, pushteti, pasuria dhe lajkat.

Zemërbutësia - një Tipar si i Krishtit dhe një Dhuratë Shpirtërore

Zemërbutësia është një tipar i zhvilluar nëpërmjet dëshirës, ushtrimit me drejtësi të lirisë së zgjedhjes dhe përpjekjes së fuqishme për të ruajtur

githmonë një shlyerje të mëkateve tona.¹⁵ Ajo është gjithashtu një dhuratë shpirtërore të cilën ne mund ta kërkojmë në mënyrën e duhur.¹⁶ Gjithsesi, ne duhet t’i mbajmë mend qëllimet për të cilat jepet një bekimi i tillë, madje për t’u sjellë dobi dhe për t’u shërbyer fëmijëve të Perëndisë.¹⁷

Kur vijmë te Shpëtimtari dhe e ndjekim Atë, ne jemi në gjendje që dalëngadalë dhe shkallë-shkallë të aftësohemi për t’u bërë më shumë si Ai. Ne fuqizohemi nga Shpirti me vetëpërmbyturje të disiplinuar dhe një sjellje të qëndrueshme e të qetë. Prandaj, zemërbutësia është cilësia që fitojmë kur bëhemi dishepuj të Mësuesit dhe jo thjesht diçka që ne e bëjmë vetë.

“Moisiu u arsimua me gjithë diturinë e Egjiptasve dhe ishte i pushtetshëm në fjalë e në vepra”¹⁸. Prapëseprapë, ai “ishte një njeri shumë zemërbutë, më tepër se kushdo mbi faqen e dheut”¹⁹. Dituria dhe zotësia e tij mund të kishin bërë që ai të ishte plot krenari. Përkundrazi, tipari dhe dhurata shpirtërore e zemërbutësisë, me të cilën ai u bekua, e pakësuan arrogancën nga jeta e tij dhe e lartësuan Moisiun si një mjet për t’i plotësuar qëllimet e Perëndisë.

Mësuesi si një Shembull i Zemërbutësisë

Shembujt më të madhërishtë dhe më domethënës të zemërbutësisë gjenden në jetën e Vetë Shpëtimtarit.

Shëlbuesi i Madh, i cili “zbriti nën gjithçka”²⁰ dhe vuajti, u gjakos dhe vdiq që “të na *pastrojë* nga çdo paudhësi”²¹, me dhembshuri i *lau* këmbët e pluhurosura të dishepujve të Tij.²² Një zemërbutësi e tillë është një karakteristikë dalluese e Zotit, si shërbëtor dhe udhëheqës.

Jezusi jep shembullin më të lartë të aftësisë për t’u përgjigjur me drejtësi dhe aftësisë për t’u nënshtruar me

gatishmëri, teksa vuajti agoninë rënduese në Gjetseman.

“Kur arriti në vend, u tha [dishepujve të Tij]: ‘Lutuni që të mos hyni në tundim’.

Dhe . . . ra në gjunjë dhe lutej, duke thënë:

‘O Atë, po të duash, largoje këtë kupë nga unë! Megjithatë mos u bëftë vullneti im, por yti.’”²³

Zemërbutësia e Shpëtimtarit në këtë përvijë përjetësisht thelbësore dhe stërmunduese tregon për secilin prej nesh rëndësinë që ka vënia e urtësisë së Perëndisë përpara vetë urtësisë sonë.

Qëndrueshmëria e aftësisë së Zotit për t’u nënshtruar me gatishmëri dhe për t’u vetëpërbajtur me fuqi është për ne të gjithë mbresëlënëse dhe frymëzuese. Kur një grup i armatosur i rojave të tempullit dhe i ushtarëve romakë mbërritën në Gjetseman për ta kapur dhe arrestuar Jezusin, Pjetri nxori shpatën e vet dhe ia preu veshin e djathtë shërbëtorit të kryepriiftit.²⁴ Atëherë Shpëtimtari e preku veshin e shërbëtorit dhe e shëroi.²⁵ Ju lutem, vini re që Ai e shtriu dorën dhe e bekoj robëruesin e Tij të mundshëm, duke përdorur të njëjtën fuqi qiellore që mund të mos e kishte lejuar Atë të zihej rob dhe të kryqëzohej.

Merrni gjithashtu parasysh mënyrën se si Mësuesi u akuzua dhe u dënua përpara Pilatit që të kryqëzohej.²⁶ Jezusi kishte shpallur gjatë tradhtisë që i bënë: “A kujton ti, vallë, se unë nuk mund t’i lutem Atit tim, që të më dërgojë më shumë se dymbëdhjetë legjione engjëjsh?”²⁷ Prapëseprapë, “Gjykatësi [i] Përrjetshëm [i] atyre që janë gjallë dhe që kanë vdekur”²⁸ në mënyrë paradoksale u gjykua përpara një njeriu të caktuar përkohësisht në një pozitë politike. “Por [Jezusi] nuk iu përgjigj në asnjë fjalë, kështu që guvernatori u çudit shumë.”²⁹ Zemërbutësia e Shpëtimtarit dëshmohej në përgjigjen



e Tij të disiplinuar, vetëpërbajtjen e fuqishme dhe mungesën e dëshirës për ta ushtruar fuqinë e Tij të pafundme për përfitim vetjak.

Premtimi dhe Dëshmia

Mormoni e përkufizon zemërbutësinë si themelin prej të cilit ngrihen të gjitha aftësitë dhe dhuratat shpirtërore.

“Prandaj, në qoftë se një njeri ka besim, ai duhet të ketë shpresë, pasi pa besim, nuk mund të ketë ndonjë shpresë.

Dhe përsëri vini re, unë ju them juve se ai nuk mund të ketë besim dhe shpresë, në qoftë se nuk është i bindur dhe i përvuajtur në zemër.

Përndryshe, besimi dhe shpresa e tij është e kotë, meqë askush nuk pranohet para Perëndisë, në qoftë se nuk është i bindur dhe i përvulur në zemër; dhe në qoftë se një njeri është i bindur dhe i përvulur në zemër dhe pohon me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë se Jezusi është Krishti, ai duhet të ketë

dashuri hyjnore; pasi në qoftë se nuk ka dashuri hyjnore, ai s’është asgjë; prandaj është e nevojshme që të ketë dashuri hyjnore.”³⁰

Shpëtimtari shpalli: “Lum ata që janë zemërbutë, sepse ata do ta trashëgojnë tokën”³¹. Zemërbutësia është një aspekt thelbësor i natyrës hyjnore dhe mund të merret e zhvillohet në jetën tonë për shkak të Shlyerjes së Shpëtimtarit dhe nëpërmjet asaj Shlyerje.

Unë dëshmoj se Jezu Krishti është Shëlbuesi ynë i ringjallur dhe i gjallë. Dhe premtoj se Ai do të na udhërrëfjëjë, mbrojtë e forcojë ndërkohë që ecim në butësinë e Shpirtit të Tij. Unë shpall dëshminë time të sigurt për këto të vërteta, në emrin e shenjtë të Zotit Jezu Krisht, amen. ■

SHËNIME

1. Shih 2 Pjetër 1:4.
2. Mateu 19:16.
3. Mateu 19:21–22.
4. Shih Alma 10:4.
5. Shih Alma 10:5–6.
6. Alma 15:16.
7. Alma 60:2.
8. Shih Alma 60:5–33.
9. Alma 61:2, 9.
10. Rasëll M. Nelson, “Libri i Mormonit: Si do të ishte Jeta Juaj pa Të?” *Liahona*, nëntor 2017, f. 61.
11. Henri B. Ajring, “Mos Kini Frikë të Bëni Mirë”, *Liahona*, nëntor 2017, f. 100.
12. Mateu 11:29; theksimi i shtuar.
13. Doktrina e Besëlidhje 19:23; theksimi i shtuar.
14. Shih 2 Mbretërve 5:1–17.
15. Shih Mosia 4:12, 26; Moroni 8:25–26.
16. Shih Doktrina e Besëlidhje 46:8.
17. Shih Doktrina e Besëlidhje 46:8–9, 26.
18. Veprat e Apostujve 7:22.
19. Numrat 12:3.
20. Doktrina e Besëlidhje 88:6.
21. 1 Gjon 1:9; theksimi i shtuar.
22. Shih Gjoni 13:4–5.
23. Lluca 22:40–42.
24. Shih Gjoni 18:10.
25. Shih Lluca 22:51.
26. Shih Mateu 27:2, 11–26.
27. Mateu 26:53.
28. Moroni 10:34.
29. Mateu 27:14.
30. Moroni 7:42–44.
31. Mateu 5:5.



Nga Plaku Tejlor G. Godoi,
i Të Shtatëdhjetëve

Edhe një Ditë më Shumë

Ne të gjithë kemi një “të sotme” për ta jetuar dhe çelësi për ta bërë ditën tonë të suksesshme, është të jemi të gatshëm të sakrifikojmë.

Disa vite më parë, miqtë e mi patën një foshnjë të mrekullueshme me emrin Brigam. Pas lindjes së vet, Brigami u diagnostikua me një gjendje të rrallë që quhet sindroma Hanter, që fatkeqësisht nënkuptonte se Brigami do të kishte jetë të shkurtër. Një ditë, kur Brigami dhe familja e tij po vizitonin territorin e tempullit, Brigami shqiptoi një frazë të veçantë; ai tha dy herë: “Edhe një ditë më shumë”. Pikërisht ditën tjetër, Brigami ndërroi jetë.

E kam vizituar varrin e Brigamit disa herë dhe për çdo herë, unë sjell ndër mend frazën “edhe një ditë më shumë”. Pyes veten se çfarë do të thoshte, ç’ndikim do të kishte në jetën time ta dija se do të kisha vetëm një ditë më shumë për të jetuar. Si do ta trajtoja bashkëshorten time, fëmijët e mi dhe të tjerët? Sa i durueshëm dhe i sjellshëm do të isha? Si do të kujdesesha për trupin tim? Sa me zjarr do të lutesha dhe do të kërkoja në shkrimet e shenjta? Mendoj se në një mënyrë a në një tjetër, të gjithë në njëfarë kohe do të kemi një vetëdijesim mbi frazën “edhe një ditë më shumë” – kuptimin se duhet ta përdorim me mençuri kohën që kemi.

Në Dhiatën e Vjetër lexojmë historinë e Ezekias, mbretit të Judesë.

Profeti Isaia i njoftoi Ezekias se jeta e Ezekias po mbaronte. Kur dëgjoi fjalët e profetit, Ezekia filloi të lutej, të përgjerohej dhe të qante me të madhe. Në atë rast, Perëndia i shtoi 15 vite jetës së Ezekias. (Shih Isaia 38:1–5.)

Nëse do të na thuhej se do të kishim një kohë të shkurtër për të jetuar, edhe ne mund të luteshim për më shumë ditë jete për hir të gjërave që duhet t’i kishim bërë, apo t’i kishim bërë ndryshe.

Pavarësisht kohës që Zoti, në urtësinë e Tij, vendos t’i dhurojë secilit prej nesh, për një gjë mund të jemi të sigurt: ne të gjithë kemi një “të sotme” për ta

jetuar dhe çelësi për ta bërë ditën tonë të suksesshme, është të jemi të gatshëm të sakrifikojmë.

Zoti tha: “Vini re, e tanishmja quhet *e sotme* deri në ardhjen e Birit të Njeriut dhe në të vërtetë është një ditë sakrifice” (DeB 64:23; theksimi i shtuar).

Fjala *sakrifice* vjen nga fjalët latinisht *sacer*, që do të thotë “i/e shenjtë”, dhe *facere*, që do të thotë “bëj”, me fjalë të tjera t’i bësh gjërat të shenjta, t’u sjellësh nder.

“Sakrifica sjell të qiellit bekime” (“Lavdi Burrit”, *Himne*, nr. 19).

Në ç’mënyrë sakrifica do t’i bëjë ditët tona domethënëse dhe të bekuara?

Së pari, sakrifica vetjake na forcon dhe u jep vlerë gjërave për të cilat sakrifikojmë.

Disa vite më parë në një të diel agjërimi, një motër e moshuar doli në foltore për të dhënë dëshminë e saj. Ajo jetonte në një qytet që quhej Ikuitos, që është në Amazonën peruane. Ajo na tregoi se qysh nga koha e pagëzimit, kishte pasur gjithmonë synimin e marrjes së ordinancave të tempullit në Lima të Perusë. Ajo pagoi besnikërisht të dhjetë të plotë dhe kurseu nga të ardhurat e pakta për vite.



Gëzimi i saj që shkoi në tempull dhe mori ordinancat e shenjta atje, u shpreh me këto fjalë: “Sot mund të them se më në fund ndihem gati të kaloj nëpër vel. Unë jam gruaja më e lumtur në botë; kam kursyer para, nuk e keni idenë prej sa kohësh, për të vizituar tempullin dhe pas shtatë ditësh në lumë dhe 18 orësh me autobus, unë më në fund u gjenda në shtëpinë e Zotit. Kur e lashë atë vend të shenjtë, thashë me vete, pas gjithë sakrificave që m'u deshën për të ardhur në tempull, unë nuk do të lejoj asgjë që të më bëjë ta marr me lehtësi çdo besëlidhje që bëra; do të ishte shpërdorim. Ky është zotim tepër serioz!”

Unë mësova nga kjo motër e ëmbël që sakrifica personale është një forcë e paçmueshme e cila u jep shtysë vendimeve tona dhe vendosmërisë sonë. Sakrifica personale nxit veprimet tona, zotimet e besëlidhjet tona dhe u jep gjërave të shenjta kuptim.

Së dyti, sakrificat që bëjmë për të tjerët dhe që të tjerët bëjnë për ne, rezultojnë në bekime për të gjithë.

Kur isha student stomatologjie, tabloja financiare e ekonomisë sonë vendore nuk qe shumë nxitëse. Inflacioni e ulte fort vlerën e monedhës nga dita në ditë.

Kujtoj vitin kur duhej të regjistrohesha në praktikën e kirurgjisë; duhej të kisha gjithë pajisjet e nevojshme kirurgjikale para regjistrimit në atë semestër. Prindërit e mi kursyen fondet e nevojshme. Por një natë diçka dramatike ndodhi. Ne shkuam të blinin pajisjet, vetëm për të zbuluar se shuma e parave që kishim për të blerë të gjitha pajisjet, mjaftonte tani për të blerë vetëm një palë pinceta kirurgjikale – dhe asgjë tjetër. Ne u kthyem në shtëpi me duart bosh dhe me zemra të rënduara nga mendimi që po humbisja një semestër kolegji. Befas, sidoqoftë, nëna ime tha: “Tejlor, eja me mua; le të dalim”.



Shkuam në qendrën e qytetit ku kishte shumë vende për të blerë e shitur bizhuteri. Kur arritëm në një dyqan, nëna ime nxori nga kuletat e saj një qese të vogël kadife blu që mbante një byzylyk ari të mrekullueshëm, me një gdhendje ku thuhej: “Bijës sime të dashur nga babai yt”. Ishte një byzylyk që gjyshi im ia pati dhënë në një nga ditëlindjet e saj. Pastaj, para syve të mi, ajo e shiti.

Kur mori paratë, ajo më tha: “Nëse ka një gjë për të cilën jam e sigurt, është se ti do të bëhesh dentist. Shko dhe bli të gjitha pajisjet që të duhen.” Tani, a mund ta përfytyroni se çfarë lloj studenti u bëra qysh prej atij çasti? Doja të isha më i miri dhe t'i mbaroja shpejt studimet ngaqë e dija koston e lartë të sakrificës që po bënte ajo.

Mësova se sakrificat që të dashurit tanë bëjnë për ne, na freskojnë si uji i ftohtë në mes të shkretëtirës. Një sakrificë e tillë sjell shpresë dhe motivim.

Së treti, çfarëdo sakrificë që bëjmë, është e vogël krahasuar me sakrificën e Birit të Perëndisë.

Cila është vlera qoftë edhe e një byzylyku të artë shumë të dashur krahasuar me sakrificën e vetë Birit të Perëndisë? Si mund ta nderojmë atë sakrificë të pafundme? Çdo ditë ne mund ta kujtojmë që kemi edhe një ditë më shumë për të jetuar dhe për të qenë besnikë. Amuleku dha mësim: “Po, unë do të doja që ju të vini dhe

të mos ngurtësoni më zemrat tuaja; pasi vini re, tani është koha dhe dita e shpëtimit tuaj; dhe prandaj, në qoftë se ju do të pendoheni dhe nuk do të ngurtësoni zemrat tuaja, plani i madh i shëlbimit do të realizohet menjëherë për ju” (Alma 34:31). Me fjalë të tjera, nëse do t'i ofrojmë Zotit sakrificën e një zemre të thyer dhe një shpirti të penduar, menjëherë bekimet e planit të madh të lumturisë shfaqen në jetën tonë.

Plani i shëlbimit është i mundur në saje të sakrificës së Jezu Krishtit. Sikurse e përshkroi Ai Vetë, sakrifica “më bëri mua, madje Perëndi, më i madhi i të gjithëve, të dridhem për shkak të dhembjes e të më dalë gjak nga çdo por dhe të vuaj si në trup e në shpirt – dhe të dëshiroj që të mos e pi kupën e hidhur e të mpakem” (DeB 19:18).

Dhe është për shkak të kësaj sakrifice, pas ndjekjes së procesit të pendimit të singertë, që ne mund ta ndiejmë barrën e gabimeve dhe të mëkateve tona të hiqet. Në fakt, faji, turpi, dhembja, hidhërimi dhe mendimi i keq për veten zëvendësohen me një ndërgjegje të qartë, lumturi, gëzim dhe shpresë.

Njëkohësisht, kur e nderojmë dhe jemi mirënjohës për sakrificën e Tij, ne mund të marrim në masë të madhe dëshirën e fortë për të qenë fëmijë më të mirë të Perëndisë, për të qëndruar larg mëkatit e për t'i mbajtur besëlidhjet si kurrë më parë.



Nga Boni L. Oskarson,
e Sapolluar nga Thirrja si Presidente e Përgjithshme e Të Rejave

Atëherë, ashtu si Enosi pas marrjes së faljes për mëkatet e tij, ne vetë do ta ndiejmë dëshirën për të sakrifikuar dhe për të kërkuar mirëqenien e vëllzërve dhe motrave tona (shih Enosi 1:9). Dhe ne do të jemi më të gatshëm në secilën “edhe një ditë më shumë” për ta ndjekur ftesën që Presidenti Hauard W. Hanter na ofroi kur tha: “Paq[t]jo një grindje. Gjej një mik të harruar. Flake dyshimin dhe zëvendësoje me besim. . . . Jep një përgjigje të ëmbël. Nxite rininë. Shfaq besnikërinë tënde me fjalë dhe vepra. Mbjaj një premtim. Shmang një mëri. Fal një armik. Kërko ndjesë. Përpiku të kuptosh. Shqyrto kërkesat e tua ndaj të tjerëve. Mendo së pari për dikë tjetër. Ji i sjellshëm. Ji miqësor. Qesh pak më tepër. Shpreh mirënjohjen tënde. Mirëprit një të huaj. Gëzo zemrën e një fëmije. . . . Shprehe dashurinë tënde dhe shprehe përsëri atë” (*Mësime të Presidentëve të Kishës: Hauard W. Hanter* [2015], f. 32; përshtatur nga “What We Think Christmas Is”, *McCall's*, dhjetor 1959, f. 82–83).

I mbushëshim ditët tona me atë impuls dhe forcë që na japin sakrifica vetjake dhe sakrifica që bëjmë për të tjerët ose marrim prej tyre. Dhe në një mënyrë të veçantë, gëzofshim paqen dhe gëzimin që sakrifica e të Vetëmlindurit na ofron; po, atë paqe që përmendet kur lexojmë se Adami ra që njerëzit të mund të jenë dhe njerëzit janë – ju jeni – që ju të mund të keni gëzim (shih 2 Nefi 2:25). Ai gëzim është gëzimi i vërtetë që vetëm sakrifica dhe Shlyerja e Shpëtimtarit Jezu Krisht mund ta japin.

Është lutja ime që ne të ndjekim Atë, që ne ta besojmë Atë, që ne ta duam Atë dhe që ne ta ndiejmë dashurinë e shfaqur nga sakrifica e Tij sa herë që kemi rastin të jetojmë edhe një ditë më shumë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

Të Rejat në Punë

Çdo e re në Kishë duhet të ndihet e vlerësuar, të ketë mundësi për të shërbyer dhe ta ndiejë se ka diçka me vlerë për të kontribuar në këtë punë.

Një vit më parë, në sesionin e përgjithshëm të priftërisë së konferencës, Peshkopi Zherald Kosé u foli burrave të Kishës duke përshkruar se si mbajtësit e Priftërisë Aarone dhe Melkizedeke janë partnerë të pandarë në përmbushjen e punës për shpëtimin¹. Ai mesazh ka qenë një bekim i madh për ndihmën e dhënë të rinjve që mbajnë Priftërinë Aarone për ta kuptuar rolin që ata luajnë për ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë në këtë tokë. Shërbimi i tyre i përbashkët e forcon Kishën dhe sjell një kthim më të thellë në besim dhe zotim në zemrën e të rinjve tanë kur e kuptojnë vlerën e kontributit të tyre dhe sa madhështore është kjo punë.

Sot unë do të doja që fjala ime të jetë një mbështetje për atë mesazh, ndërsa flas për të rejat e Kishës, të cilat janë po aq të nevojshme dhe thelbësore për përmbushjen e punës së Zotit në familjet e tyre dhe në Kishën e Tij.

Ashtu si Peshkopi Kosé, unë jetoja në një degë të vogël të Kishës gjatë një pjese të mirë të adoleshencës sime dhe shpesh më kërkonin të plotësoja detyra dhe thirrje që zakonisht do të ishin kryer nga të triturit. Përveç kësaj, ata prej nesh që ishin në programin për rininë, shpesh merrnin kryesimin në ndihmën për organizimin dhe drejtimin

e veprimtarive dhe ngjarjeve të veçanta. Ne shkruanim pjesë teatrale, krijuam një grup muzikor për të sjellë argëtim në veprimtaritë e degës dhe ishim pjesëmarrëse në gjithçka në çdo mbledhje. Unë u thirra që të isha koristja e degës dhe të drejtoja të kënduarin në mbledhjen e sakramentit çdo javë. Ishte një përvojë e mrekullueshme për një 16-vjeçare që të qëndronte përpara të gjithëve në degë çdo të diel dhe t'i drejtonte gjatë këndimit të himneve. Unë ndihesha e nevojshme dhe e dija se kisha diçka për të kontribuar. Njerëzit



i mbanin shpresat tek unë që të isha atje, dhe më pëlqente shumë të ndihesha e dobishme. Ajo përvojë më ndihmoi ta ndërtoja dëshminë time për Jezun Krishtin dhe sikurse ndodhi edhe për Peshkopin Kosë, ajo i hodhi spirancat e jetës sime te shërbimi i ungjillit.

Çdo anëtar duhet ta dijë se sa i nevojshëm është. Çdo person ka diçka të rëndësishme për të kontribuar dhe ka talente dhe aftësi të pasqyrore që ndihmojnë për ecurinë e kësaj pune të rëndësishme. Të rinjtë tanë kanë detyra në Priftërinë Aarone që përshkruhen te Doktrina e Besëlidhje, që shpesh janë të dukshme. Mund të vërehet më pak te të rejtat e Kishës, prindërit dhe udhëheqësit e tyre, se që nga koha që janë pagëzuar, të rejtat kanë përgjegjësi besëlidhëse që të "vajtojnë" me ata që vajtojnë; po, dhe të ngushëllojnë ata që kanë nevojë të ngushëllohen dhe të qëndrojnë si dëshmitar[e] të Perëndisë në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet që [ato] të gjenden. . . , madje deri në vdekje"². Të rejtat kanë mundësi t'i përmbushin këto përgjegjësi në lagjet dhe degët e tyre dhe kur shërbejnë në presidencat e klasave, në këshillat e rinisë dhe thirrje të tjera. Çdo e re në Kishë duhet të ndihet e vlerësuar, të ketë mundësi për të shërbyer dhe ta ndiejë se ka diçka me vlerë për të kontribuar në këtë punë.

Te *Manuali 2*, ne mësojmë se puna e shpëtimit brenda lagjeve tona përfshin "punën misionare të anëtarit, mbajtjen e të kthyerve në besim, aktivizimin e anëtarëve më pak aktivë, punën në tempull e për historinë familjare dhe mësimdhënien e ungjillit"³. Kjo punë drejtohet nga peshkopët tanë besnikë, të cilët i mbajnë çelësat e priftërisë për lagjen e tyre. Që prej shumë vjetësh presidenca jonë bën pyetjen: "Në cilat nga këto fusha të përmendura nuk duhet të përfshihen të rejtat tona?" Përgjigjja është



se ato kanë diçka për të kontribuar në të gjitha fushat e kësaj pune.

Për shembull, kohët e fundit takova disa të reja në zonën e Las Vegasit, që ishin thirrur të shërbenin si këshilluese të lagjes për tempullin dhe historinë familjare. Ato shkëlqenin nga entuziazmi që ishin në gjendje t'u mësonin dhe ndihmonin anëtarët e lagjes së tyre për t'i gjetur paraardhësit e vet. Ato kishin zotësi të vyera në kompjuter, kishin mësuar se si ta përdornin programin FamilySearch dhe ishin të lumtura që po e ndanin atë njohuri me të tjerët. Dukej qartë që ato kishin dëshmi dhe një kuptueshmëri mbi rëndësinë për kërkimin e emrave të paraardhësve tanë të vdekur, në mënyrë që ordinancat shpëtuese thelbësore të kryeshin në tempull për ta.

Disa muaj më parë, unë kisha mundësinë të vija në provë një ide me një të re 14-vjeçare. Mora kopje të dy fletëve aktuale të lagjes me rendin e ditës dhe ia dhashë Emës dhe Megit, secilës nga një kopje. I kërkova ta lexonin rendin e ditës dhe të shihnin a kishte atje ndonjë rast veprimtarie nga këshillat e lagjes në të cilat ato mund të jepnin ndihmesën e tyre. Ema pa që një familje e re po shpërngulej në lagje dhe ajo tha se mund t'i ndihmonte të hynin në shtëpinë e re dhe të shpake-tonin. Ajo mendoi se mund t'u bënte shoqëri fëmijëve të familjes dhe t'u tregonte shkollën e tyre të re. Ajo pa

se po afrohej një darkë me lagjen dhe mendoi se kishte shumë mënyra se si mund ta ofronte ndihmesën e saj.

Megi pa se kishte disa njerëz të moshuar në lagje që kishin nevojë për vizita dhe shoqërim. Ajo tha se do t'i pëlqente shumë t'i vizitonte dhe t'i ndihmonte këta anëtarë të mrekullueshëm më në moshë. Ajo ndjeu gjithashtu se mund t'i ndihmonte duke u mësuar anëtarëve të lagjes se si të hapnin llogari në median shoqërore dhe t'i përdornin ato. Në të vërtetë, nuk kishte qoftë edhe një gjë në këto fletë të rendit të ditës që *nuk mund* ta bënin këto dy të reja!

A i shohin ata që janë ulur në këshillat e lagjes apo ata që mbajnë ndonjë thirrje në lagje, të rejtat si burime të vyera për të ndihmuar për plotësimin e shumë nevojave brenda lagjeve tona? Zakonisht ka një listë të gjatë situatash në të cilat duhet të shërbejë dikush dhe ne shpesh mendojmë se vetëm të rriturit në lagje i plotësojnë këto nevoja. Ashtu si mbajtësit e Priftërisë Aarone janë ftuar të punojnë me baballarët e tyre dhe burra të tjerë të Priftërisë Melkizedeke, të rejtat tona mund të thirren që të japin ndihmesë dhe shërbim për plotësimin e nevojave të anëtarëve të lagjes me nënat e tyre ose motra të tjera shembullore. Ato janë të afta, të zellshme dhe të gatshme për të bërë shumë më tepër sesa thjesht të marrin pjesë të dielave në kishë!



Ndërsa i marrim në shqyrtim rolet që pritet se do të marrin të rejat në të ardhmen e afërt, ne mund ta pyetim veten se çfarë lloj përvajsh mund t'u sigurojmë tani, që do t'i ndihmojnë ato të përgatiten për të qenë misionare, mësuese të ungjillit, udhëheqëse në organizatat e Kishës, punonjëse të tempullit, bashkëshorte, nëna, kujdestare, shembuj dhe mikështa. Faktikisht ato mund të fillojnë t'i përmbushin shumë nga ato role që tani. Rinisë shpesh u kërkohet të ndihmojnë duke dhënë mësim të dielën në klasat e tyre. Tani për të rejat tona janë vënë në dispozicion mundësi që të bëjnë shërbime në tempull, të kryera më parë nga punonjësit apo vullnetarët për ordinancat, kur e frekuentojnë tempullin me grupet e tyre të rinisë, për të kryer pagëzime për të vdekurit. Vajzat tona që janë në moshën e Fillores tani ftohen të marrin pjesë në mbledhjet për Përgatitjen për Tempullin dhe Priftërinë, të cilat do t'i ndihmojnë të kuptojnë se edhe ato janë pjesëmarrëse të rëndësishme në punën që drejtohet nga priftëria. Ato po mësojnë se burrat, gratë, rinia dhe fëmijët janë të gjithë përfitues të bekimeve të priftërisë dhe të gjithë mund të kenë një rol aktiv në çuarjen përpara të punës së Zotit.

Peshkopë, ne e dimë se detyrat tuaja janë shpesh të rënda, por ashtu siç një prej përparësive tuaja më të larta është që t'i kryesoni kuorimet e

Priftërisë Aarone, *Manuali 2* shpjegon që “peshkopi dhe këshilltarët e tij japin udhëheqje priftërie për organizatën e Të Rejave. Ata kujdesen dhe i forcojnë individualisht të rejat, duke punuar ngushtë me prindërit dhe udhëheqëset e Të Rejave në këtë përpjekje.” Ai shpall edhe që “peshkopi dhe këshilltarët e tij marrin pjesë rregullisht në mbledhjet, shërbimet dhe veprimtaritë e Të Rejave”⁴. Ne jemi mirënjohës për peshkopët që gjejnë kohë t'i vizitojnë klasat e Të Rejave dhe që krijojnë mundësi për të rejat që të jenë më shumë sesa thjesht spektatore të punës. Ju falënderoj që siguroheni që të rejat tuaja të jenë pjesëmarrëse të vjera në plotësimin e nevojave të anëtarëve të lagjes! Këto mundësi për të shërbyer në mënyra kuptimplote i bekojnë ato shumë më tepër sesa veprimtaritë në të cilat thjesht zbatimen.

Për ju, të reja të Kishës, vitet tuaja të adoleshencës mund të jenë të ngarkuara dhe shpesh sfiduese. Ne kemi vënë re se gjithnjë e më shumë prej jush po luftojnë me probleme të vetëvlerësimit, ankthit, niveleve të larta të stresit e ndoshta edhe depresionit. Kthimi i mendimeve tuaja tek të tjerët, në vend që të ndaleni te problemet tuaja, mund të mos i zgjidhë të gjitha këto probleme, por shërbimi shpesh mund t'i lehtësojë barrët tuaja dhe t'i bëjë sfidat tuaja të duken më pak të vështira. Një nga mënyrat më të mira

për t'i rritur ndjenjat e vetëvlerësimit është të tregojmë nëpërmjet kujdesit dhe shërbimit tonë ndaj të tjerëve se ne kemi shumë vlera për të kontribuar⁵. Ju nxit ju të reja ta ngrini dorën për të dalë vullnetare dhe t'i përvisheni punës kur shihni [raste] nevojtare përreth jush. Teksa i përmbushni përgjegjësitë tuaja të besëlidhjes dhe merrni pjesë në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë, bekime do të vërshojnë në jetën tuaj dhe do të zbuloni gëzimin e thellë dhe të përherëshëm të dishepullimit.

Vëllezër e motra, të rejat tona janë të mrekullueshme. Ato kanë talente, entuziazëm të pakufishëm e energji dhe janë të dhembshura dhe përkujdesëse. Ato *duan* të japin ndihmesë. Ato duhet të dinë se janë të vjera dhe thelbësore në punën e shpëtimit. Ashtu siç të rinjtë përgatiten për Priftërinë Aarone për një shërbim më të madh ndërsa përparojnë drejt Priftërisë Melkizedeke, edhe të rejat tona po përgatiten për t'u bërë anëtare të organizatës më të madhe të grave në tokë – Shoqatës së Ndihmës. Së bashku, këto të reja e të rinj të bukur, të fortë e besnikë po përgatiten të jenë bashkëshorte e bashkëshortë dhe nëna e baballarë që do të rritin familje të denja për mbretërinë çelestiale të Perëndisë.

Unë dëshmoj se puna e Atit tonë Qiellor është që të bëjë të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e fëmijëve të Tij⁶. Të rejat tona të çmuara kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në ndihmën që [japin] për të përmbushur këtë punë të madhërishtme. Në emrin e Jezut Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Zherald Kosé, “Përgatiteni Udhën”, *Liahona*, maj 2017, f. 75–78.
2. Mosia 18:9.
3. *Manuali 2: Administrimi i Kishës* (2010), faqe 24.
4. *Handbook 2*, 10.3.1.
5. Shih Mateu 10:39.
6. Shih Moisiu 1:39.



Nga Plaku Taniela B. Uakolo,
i Të Shtatëdhjetëve

Ordinancat Shpëtuese do të na Sjellin Dritë të Mrekullueshme

Pjesëmarrja në ordinanca dhe nderimi i besëlidhjeve që i shoqërojnë ato, do t'ju sjellin dritë të mrekullueshme dhe mbrojtje në këtë botë gjithnjë e më të errët.

Vëllezër e motra, unë gëzohem me ju në ungjill ose në doktrinën e Krishtit.

Një mik një herë e pyeti Plakun Nil L. Andersen, në atë kohë një i Shtatëdhjetë, si ndihej kur fliste përpara 21000 njerëzve në Qendrën e Konferencave. Plaku Andersen u përgjigj: “Nuk janë 21000 njerëzit që të vënë në siklet, janë 15 Vëllezërit e ulur prapa teje”. Atëherë nënqesha, por tani e kuptoj. Sa i dua dhe i mbështet këta 15 burra si profetë, shikues e zbulues!

Zoti i tha Abrahamit se nëpërmjet farës së tij dhe nëpërmjet priftërisë, të gjitha familjet e tokës do të bekoheshin “me bekimet e Ungjillit, . . . madje të jetës së përjetshme” (Abraham 2:11; shih edhe vargjet 2–10).

Këto bekime të premtuara të ungjillit dhe të priftërisë u rivendosën në tokë dhe më pas, në vitin 1842, Profeti Jozef Smith ua administroi dhurimin [indaumentin] një numri të kufizuar burrash e grash. Mërsi Filling Tompson ishte njëra prej tyre. Profeti i tha asaj: “K[ly

dhurim] do të të nxjerrë nga errësira në dritë të mrekullueshme”¹.

Sot dua të përqendrohem tek ordinancat shpëtuese që do të na sjellin juve dhe mua dritë të mrekullueshme.

Ordinancat dhe Besëlidhjet

Tek *Të Vërtetë ndaj Besimit* lexojmë: “Një ordinancë është një akt i shenjtë

e zyrtar që kryhet nëpërmjet autoritetit të priftërisë. Ordinanca[t] [që] janë thelbësore për ekzaltimin tonë . . . quhen ordinanca shpëtuese. Ato përfshijnë pagëzimin, konfirmimin, shugurimin [në] Priftëri[n]ë Melkizedeke (për burrat), indaumentin [në] tempull. . . dhe vulosjen e martesës.”²

Plaku Dejvid A. Bednar na mësoi: “Ordinancat e shpëtimit dhe të ekzaltimit, të administruara në Kishën e rivendosur të Zotit . . . përbëjnë kanalet e autorizuara nëpërmjet të cilave bekimet dhe fuqitë e qiellit mund të rrjedhin brenda jetës sonë individuale”³.

Si një monedhë me dy anë, të gjitha ordinancat shpëtuese shoqërohen nga besëlidhje me Perëndinë. Perëndia na premtoi bekime nëse i nderojmë me besnikëri ato besëlidhje.

Profeti Amuleku shpalli: “Kjo . . . është koha për . . . t[‘u] përgatit[ur që] të takohe[mi] me Perëndinë” (Alma 34:32). Si përgatitemi ne? Duke i marrë ordinancat me denjësi. Për ta thënë me fjalët e Presidentit Rasëll M. Nelson, ne gjithashtu duhet të “vazhdo[jmë] në shtegun e besëlidhjeve”. Presidenti Nelson vazhdoi: “Zotimi juaj për ta ndjekur Shpëtimtarin nëpërmjet bërjes



së besëlidhjeve me Të dhe më pas nëpërmjet mbajtjes së atyre besëlidhjeve, do ta hapë derën drejt çdo bekimi dhe privilegji shpirtëror në dispozicion të burrave, grave dhe fëmijëve kudo⁴.

Xhoni dhe Boni Njuman, njësoj si shumë prej jush, janë marrës të bekimeve shpirtërore që u premtuan nga Presidenti Nelson. Një të diel, pasi shkoi në kishë me tre fëmijët e saj të vegjël, Boni i tha Xhonit, i cili nuk ishte anëtar i Kishës: “Unë nuk mund ta bëj e vetme këtë gjë. Duhet të vendosësh a do të vish në kishën time me ne ose zgjidh një kishë në të cilën mund të shkojmë bashkë, por fëmijët kanë nevojë ta dinë që edhe babai i tyre e do Perëndinë.” Të dielën vijuese dhe çdo të diel pas asaj, Xhoni jo vetëm që shkoi në kishë; ai edhe shërbeu duke luajtur në piano për shumë lagje, degë e klasa Filloreje përgjatë viteve. Pata privilegjin të takohesha me Xhonin në prill 2015 dhe, në atë takim, diskutuam për faktin se mënyra më e mirë me anë të së cilës ai mund ta shfaqte dashurinë e tij për Bonin, ishte ta çonte atë në tempull, por kjo nuk mund të ndodhte nëse ai nuk pagëzohej.

Xhoni u pagëzua në vitin 2015, pasi e frekuentoi Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtoreve të Ditëve të Mëvonshme për 39 vjet. Një vit më vonë, Xhoni dhe Boni u vulosën në Tempullin e Memfisit në Tenesi, 20 vjet pasi ajo kishte marrë dhurimin [indaumentin] e vet. Djali i tyre 47-vjeçar, Roberti, tha për të atin: “Babi është çelur vërtet që kur ka marrë priftërinë”. Boni shtoi: “Xhoni ka qenë gjithnjë një njeri i lumtur dhe i hareshëm, por marrja e ordinancave dhe nderimi i besëlidhjeve të tij e ka zgjeruar mirësinë e tij”.

Shlyerja e Krishtit dhe Shembulli i Tij

Shumë vjet më parë, Presidenti Bojd K. Paker paralajmëroi: “Sjellja e

mirë pa ordinancat e ungjillit nuk do ta shëlbojë e as nuk do ta ekzaltojë njerëzimin⁵. Në fakt, nuk na nevojiten vetëm ordinancat dhe besëlidhjet për t’u rikthyer tek Ati ynë, por na nevojitet edhe Biri i Tij, Jezu Krishti dhe Shlyerja e Tij.

Mbreti Beniamin dha mësim se fëmijëve të njerëzve mund t’u vijë shpëtimi vetëm në dhe nëpërmjet emrit të Krishtit (shih Mosia 3:17; shih edhe Nenet e Besimit 1:3).

Nëpërmjet Shlyerjes së Tij, Jezu Krishti na shëlboi nga pasojat e Rënies së Adamit dhe e bëri të mundur pendimin dhe ekzaltimin tonë përfundimtar. Gjatë gjithë jetës së Tij, Ai na dha shembullin që t’i marrim ordinancat shpëtuese në të cilat “fuqia e perëndishmërisë manifestohet” (DeB 84:20).

Pasi Shpëtimtari e mori ordinancën e pagëzimit për të “plotësuar të gjithë drejtësinë” (shih 2 Nefi 31:5–6), Satani e tundoi Atë. Po ashtu, tundimet tona nuk mbarojnë pas pagëzimit ose vulosjes, por marrja e ordinancave të shenjta dhe nderimi i besëlidhjeve që i shoqërojnë ato, na mbushin me dritë të mrekullueshme dhe na japin forcën për t’u bërë ballë e për t’i mposhtur tundimet.

Paralajmërim

Isaia profetizoi se në ditët e mëvonshme, “toka është përdhosur . . . sepse

këta kanë . . . marrë nëpër këmbë besëlidhjen e përjetshme” (Isaia 24:5; shih edhe DeB 1:15).

Një paralajmërim i përafërt, që iu zbulua Profetit Jozef Smith, ishte që disa njerëz i “afrohen [Zotit] me buzët e tyre, . . . [dhe] ata u mësojnë për doktrina urdhërimet e njerëzve, duke patur një formë shenjtërie, por e mohojnë fuqinë e saj”(Joseph Smith – Historia 1:19).

Pali gjithashtu paralajmëroi se shumë njerëz do të ishin “të perëndishëm në dukje, por mohues të fuqisë së saj; edhe nga këta largohu” (2 Timoteut 3:5). E përsërit, nga këta largohuni.

Shpërqendrimet dhe tundimet e shumta të jetës janë si “ujqër grabitqarë” (Mateu 7:15). Është bariu i vërtetë që do ta përgatitë, mbrojë dhe paralajmërojë delen dhe tufën kur këta ujqër të afrohen (shih Gjoni 10:11–12). Si ndihmësbarinj që kërkojnë të imitojnë jetën e përsosur të Bariut të Mirë, a nuk jemi ne barinj për vetë shpirtin tonë si edhe për shpirtin e të tjerëve? Me këshillën e profetëve, shikuesve dhe zbuluesve, të cilët sapo i mbështetëm, dhe me fuqinë dhe dhuratën e Frymës së Shenjtë, ne mund t’i shohim ujqërit tek vijnë nëse jemi syçelë dhe të përgatitur. Në kundërshtim me këtë, nëse jemi barinj të shkujdesur të





vetë shpirtit tonë dhe të të tjerëve, ka të ngjarë të ketë humbje shpirtrash. Shkujdesja çon në humbje shpirtrash. E ftoj secilin prej nesh që të jetë një bari besnik.

Përvoja dhe Dëshmia

Sakramenti është një ordinancë që na ndihmon të qëndrojmë në shteg dhe marrja e tij me denjësi është provë që ne po i mbajmë besëlidhjet që i shoqërojnë të gjitha ordinancat e tjera. Disa vite më parë, kur unë dhe bashkëshortja ime Anita po shërbenim në Misionin e Litëll-Rokut në Arkansas, dola të jepja mësim me dy misionarë të rinj në moshtë. Gjatë mësimit, vëllai i mirë të cilit po i jepnim mësim, tha: “Kam qenë në kishën tuaj; pse duhet të hani bukë e të pini ujë çdo të diel? Në kishën tonë, e bëjmë atë dy herë në vit, për Pashkë

dhe Krishtlindje dhe kjo është shumë kuptimplote.”

Ne i treguam atij se jemi urdhëruar që të “mblidhe[mil] shpesh së bashku [që] të m[arrim] bukë dhe verë” (Moroni 6:6; shih edhe DeB 20:75). Lexuam me zë të lartë Mateun 26 dhe 3 Nefin 18. Ai u përgjigj se prapë nuk e kuptonte pse ishte e nevojshme të bëhej.

Më pas i treguam krahasimin që vijon: “Përfytyro sikur je përfshirë në një aksident të rëndë me makinë. Je lënduar dhe ke humbur ndjenjat. Dikush të afrohet me vrap duke e parë që je pa ndjenja dhe merr në telefon numrin e urgjencës 127. Të jepet ndihma e shpejtë dhe bëhesh i ndërgjegjshëm.”

E pyetëm këtë vëlla: “Kur të jesh në gjendje të dallosh se ku je, çfarë pyetjesh do të kesh?”

Ai tha: “Do të dëshiroj të di si

përfundova atje dhe kush më gjeti. Do të dëshiroja ta falënderoja atë çdo ditë ngaqë më shpëtoi jetën.”

I treguam këtij vëllai të mirë në ç’mënyrë Shpëtimtari na shpëtoi jetën dhe se si nevojitet ta falënderojmë Atë çdo ditë, përditë!

Më pas e pyetëm: “Duke e ditur se Ai dha jetën për ty e për ne, sa shpesh do të dëshiroje ta haje bukën e ta pije ujin si emblema të trupit dhe gjakut të Tij?”

Ai tha: “E kuptoj, e kuptoj. Por ka edhe diçka tjetër. Kisha juaj nuk ka gjallëri si e jona.”

Asaj pyetjeje iu përgjigjëm: “Çfarë do të bëje nëse Shpëtimtari Jezu Krisht do të hynte në derën tënde?”

Ai tha: “Do të gjunjëzohesha menjëherë”.

E pyetëm: “A nuk është kjo ajo që ndien kur hyn në godinat kishtarë të shenjtoreve të ditëve të mëvonshme – nderim për Shpëtimtarin?”

Ai tha: “E kuptoj, e kuptoj!”

Ai erdhi në kishë atë të diel Pashke dhe vazhdoi të kthehej atje.

E ftoj secilin prej nesh ta pyetë veten: “Çfarë ordinancash, përfshirë sakramentin, më nevojitet të marr dhe çfarë besëlidhjesh, të bëj, mbaj dhe nderoj?” Ju premtoj se pjesëmarrja në ordinancat dhe nderimi i besëlidhjeve që i shoqërojnë ato, do t’ju sjellin dritë të mrekullueshme dhe mbrojtje në këtë botë gjithnjë e më të errët. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 442.
2. *Të Vërtetë ndaj Besimit: Një Referim për Ungjillin* (2005), f. 105; shih edhe *Manuali 2: Administrimi i Kishës* (2010), 2.1.2.
3. Devid A. Bednar, “Gjithmonë Mbani një Heqje të Mëkateve Tuaja”, *Liahona*, maj 2016, f. 60.
4. Rasëll M. Nelson, “Teksa Ecim Përpara së Bashku”, *Liahona*, prill 2018, f. 6–7.
5. Boyd K. Packer, “The Only True Church”, *Ensign*, nëntor 1985, f. 82.



Nga Devin G. Durrant,
Këshilltar i Parë në Presidencën e
Përgjithshme të Shkollës të së Dieles

Mësimdhënia në Shtëpi – Një Përgjegjësi e Gëzueshme dhe e Shenjtë

Unë lutem për ndihmën e qiellit ndërsa përpiqemi fort që të jemi mësues si Krishti në shtëpitë tona.

Bashkëshortja ime e dashur, Xhuli, dhe unë kemi rritur gjashtë fëmijë të çmuar dhe kohët e fundit vatra jonë familjare është boshatisur. Sa shumë më merr malli që t'i kem fëmijët në shtëpi gjithë kohën. Më merr malli kur mësoja prej tyre dhe kur i mësoja ata.

Sot bisedën time dua t'u drejtoj të gjithë prindërve dhe të gjithë atyre që dëshirojnë të jenë prindër. Shumë prej jush tani janë duke rritur fëmijë. Për të tjerë, ajo kohë mund të vijë shpejt. Dhe ende për të tjerë, prindërimi mund të jetë një bekim në të ardhmen. Unë lutem që ne të gjithë ta dallojmë se çfarë përgjegjësie e gëzueshme dhe e shenjtë është të mësosh një fëmijë¹.

Si prindër, ne i njohim fëmijët tanë me Atin Qiellor dhe Birin e Tij, Jezu Krishtin. I ndihmojmë fëmijët tanë të thonë lutjen e tyre të parë. U ofrojmë udhërrëfim dhe përkrahje teksa hyjnë në shtegun e besëlidhjes² nëpërmjet pagëzimit. I mësojmë që t'u binden

urdhërimeve të Perëndisë. I edukojmë ata rreth planit të Tij për fëmijët e Tij dhe i ndihmojmë të dallojnë pëshpëritjet e Frymës së Shenjtë. U tregojmë atyre histori për profetët e lashtë dhe i nxitim të ndjekin profetët e gjallë. Lute mi për fitoret e tyre dhe vuajmë me ta gjatë sprovave të tyre. Ne u dëshmojmë

fëmijëve tanë për bekimet e tempullit dhe përpiqemi t'i përgatitim mirë që të shërbejnë në misione me kohë të plotë. U japim këshillë të vyer kur fëmijët tanë bëhen vetë prindër. Por – edhe atëherë – ne kurrë nuk rreshtim së qeni prindërit e tyre. Nuk rreshtim kurrë së qeni mësuesit e tyre. Nuk lirohemi kurrë nga këto thirrje të përjetshme.

Le të mendojmë sot për disa nga mundësitë e mrekullueshme që kemi për t'u dhënë mësim fëmijëve tanë në shtëpitë tona.

Mësimdhënia në Mbrëmjen Familjare

Le ta nisim me mbrëmjen familjare, e cila ishte një përparësi e lartë në shtëpinë e mbushur me besim ku u rrita unë. Nuk më kujtohen mësimet të veçanta që na u mësuan në mbrëmjen familjare, por vërtet më kujtohet se nuk humbëm kurrë as edhe një javë³. E dija se çfarë ishte e rëndësishme për prindërit e mi⁴.

Mbaj mend një nga veprimtaritë e mia më të parapëlqyera të mbrëmjes familjare. Babai ftonte një prej fëmijëve të tij për të kaluar "Provën". Ai i jepte fëmijës një radhë me udhëzime si: "Së pari, shko në kuzhinë dhe hape e mbylle frigoriferin. Më pas vrapo për



në dhomën time të gjumit dhe merr një palë çorape nga komoja. Pastaj kthehu tek unë, hidhu lart e poshtë tri herë dhe thuaj: 'Babi, ia dola!'

Më pëlqente shumë kur më vinte radha. Doja që ta kryeja çdo hap siç duhej dhe i gëzohesha çastit kur mund të thosha: "Babi, ia dola!" Kjo veprimtari më ndihmoi të ndërtoja vetëbesim dhe e bëri më të lehtë për një djalë të shpërqendruar që të kushtonte vëmendje kur mami ose babi na mësonte një parim të ungjillit.

Presidenti Gordon B. Hinkli këshilloi: "Nëse keni ndonjë dyshim për virtutin e mbrëmjes familjare, provojeni atë. Mblidhni fëmijët tuaj rreth vetes, mësojini ata, jepuni dëshmi atyre, lexojini së bashku shkrimet e shenjta dhe kaloni mirë së bashku."⁵

Gjithmonë do të ketë kundërshtime për të mos e zhvilluar mbrëmjen familjare⁶. Sidoqoftë, unë ju ftoj të gjeni një mënyrë për t'i kaluar pengesat dhe ta bëni mbrëmjen familjare një përparësi – dhe bëjeni zbatimjen një element kyç.

Mësimdhënia për Lutjen Familjare

Lutja familjare është një mundësi tjetër kryesore për të dhënë mësim.

Më pëlqen shumë se si babai i Presidentit N. Eldon Taner e mësoi atë gjatë një lutjeje familjare. Presidenti Taner tha këtë:

"Më kujtohet që një mbrëmje, kur u gjuhëzuam në lutje familjare, babai im i tha Zotit: 'Eldoni bëri diçka sot që nuk duhet ta kishte bërë; atij i vjen keq dhe nëse do ta falësh, ai nuk do ta bëjë më atë'.

Kjo më dha vendosmërinë që të mos e bëja më – shumë më tepër sesa po të merrja një ndëshkim fizik."⁷

Kur isha djalosh, ndonjëherë acarohesha me lutjet familjare në pamje të parë të tepruara, duke menduar me vete: "A nuk u lutëm vetëm disa minuta



më parë?" Tani, si prind, e di që si familje nuk mund të lutemi kurrë tepër⁸.

Gjithnjë më ka bërë përshtypje mënyra se si Ati Qiellor e paraqiti Jezu Krishtin si Birin e Tij të Dashur⁹. Më pëlqen të lutem për fëmijët e mi në emër teksa më dëgjojnë mua t'i shpreh Atit Qiellor se sa të dashur janë ata për mua. Duket se nuk ka kohë më të mirë për t'u shprehur dashuri fëmijëve tanë sesa kur lutemi me ta apo i bekojmë ata. Kur familjet mblidhen në lutje të përlulur, mësohen mësimet e fuqishme dhe që mbeten gjatë.

Mësimdhënia në Çdo Kohë

Mësimdhënia prindërore është si të jesh një mjek roje. Ne gjithmonë duhet të jemi gati që t'i mësojmë fëmijët tanë ngaqë nuk e dimë kurrë se kur do të na trokasë mundësia.

Ne jemi si Shpëtimtari, mësimet e të cilit shpesh "nuk ndodh[ën] në një sinagogë, por në vendndodhje të thjeshta, të përditshme – gjatë ngrënies së një darke me dishepujt e Tij, gjatë nxjerrjes së ujit nga një pus apo duke ecur pranë një peme fiku"¹⁰.

Shumë vite më parë, nëna ime tregoi se dy bashkëbisedimet e saj më të mira për ungjillin me vëllanë tim më të madh, Metin, ndodhën ndërkohë që ajo po paloste rrobat e lara dhe njëherë tjetër ndërsa po e çonte me makinë te

dentisti. Një ndër gjërat e shumta që unë adhuroja tek nëna ime, ishte gatishmëria e saj për t'i mësuar fëmijët e vet.

Mësimdhënia e saj prindërore nuk rreshti kurrë. Ndërkohë që po shërbeja si peshkop, nëna ime, atëherë 78 vjeçe, më tha se isha bërë për t'u qethur. Ajo e dinte se duhej të isha shembull dhe nuk ngurroi të ma thoshte këtë. Të dua, Nënë!

Si baba, unë jam i nxitur t'i studioj dhe t'i përsiat personalisht shkrimet e shenjta, me qëllim që të jem në gjendje të përgjigjem kur fëmijët ose nipërit dhe mbesat e mia vijnë në një rast të papritur për mësimdhënie¹¹. "Disa nga çastet më të mira të mësimdhënies fillojnë me një pyetje ose shqetësim në zemrën e një anëtarit të [familjes]."¹² A po dëgjojmë gjatë atyre çasteve?¹³

Mua më pëlqen shumë ftesa e Apostullit Pjetër: "Jini gjithnjë gati për t'u përgjigjur në mbrojtjen tuaj kujt do [do të shtoja edhe fëmijës] që ju kërkon shpjegime për shpresën që është në ju"¹⁴.

Kur isha adoleshent, unë dhe babai im kënaqeshim kur e sfidonim njëri-tjetrin për të parë se kush kish-te shtrëngimin më të fortë të dorës. I shtrëngonim duart me njëri-tjetrin sa më fort që të ishte e mundur, në përpjekje për ta bërë tjetrin të ngër-dheshej në fytyrë nga dhembja. Tani nuk duket më diçka zbatimëse, por në

atë kohë ishte disi. Pas një ndeshjeje të tillë, babi më shihte në sy e thoshte: “Ti ke duar të forta, bir. Shpresoj që duart e tua ta kenë gjithnjë forcën për të mos e prekur kurrë një zonjushë në mënyrë të papërshtatshme.” Më pas ai më ftoi të qëndroja i pastër moralisht dhe t’i ndihmoja të tjerët të bënin të njëjtën gjë.

Plaku Douglas L. Kelister tregoi këtë rreth babait të vet: “Ndërsa një ditë po ktheheshim me makinë nga puna, babai im befasi tha: ‘Sot pagova të dhjetën time. Te çeku i së dhjetës shkrova ‘falenderit’. I jam kaq mirënjohës Zotit që e bekon familjen tonë.’”

Plaku Kelister më pas shprehu këtë lavdërim për babanë e tij si mësues: “Ai më mësoi si veprimet ashtu edhe sjelljet e bindjes”¹⁵.

Më duket e urtë të pyetim me vete herë pas here: “Çfarë do t’u mësoj ose çfarë po u mësoj fëmijëve të mi nëpërmjet veprimeve dhe sjelljeve të mia të bindjes?”

Mësimdhënia për Studimin Familjar të Shkrimeve të Shenjta

Studimi familjar i shkrimeve të shenjta është një vend ideal për mësimdhënien e doktrinës në shtëpi.

Presidenti Rasëll M. Nelson tha: “Prindërit tanë jo vetëm që duhet të kapen pas fjalës së Zotit, por ata kanë një përgjegjësi hyjnore për t’ua mësuar atë fëmijëve të tyre”¹⁶.

Ndërsa unë dhe Xhuli po i rritnim fëmijët tanë, ne u përpoqëm të ishim këmbëngulës dhe krijues. Një vit vendosëm ta lexonim Librin e Mormomit në spanjisht si familje. Vallë a ishte kjo arsyeja përse Zoti e thirri secilin prej fëmijëve tanë që shërbyen një mision me kohë të plotë, në një mision ku flitej spanjisht? *Es posible [Është e mundur]*.

U preka jashtë mase kur Vëllai Brajën K. Eshtën më tregoi se ai dhe babai i tij lexuan së bashku çdo faqe të



Librit të Mormomit gjatë vitit të tij të fundit të shkollës së mesme. Vëllai Eshtën i do shumë shkrimet e shenjta. Ato janë të shkruara në mendjen e tij dhe në zemrën e tij. Babai i tij e mbolli atë farë kur Vëllai Eshtën ishte adoleshent dhe ajo farë¹⁷ është rritur në një pemë me rrënjë të thella të së vërtetës. Vëllai Eshtën ka bërë të njëjtën gjë me fëmijët e tij më të mëdhenj.¹⁸ Djali i tij tetëvjeçar e pyeti kohët e fundit: “Babi, kur do të filloj ta lexoj Librin e Mormomit me ty?”

Mësimdhënia me Anë të Shembullit

Së fundi, mësimdhënia prindërore më ndikuese është shembulli ynë. Ne këshillohemi që të jemi “shembull për besimtarët në fjalë, në sjellje, në dashuri, në Frymë, në besim dhe në dëlirësi”¹⁹.

Gjatë një udhëtimi kohët e fundit, unë dhe Xhuli frekuentuam kishën dhe pamë që ky varg gjeti zbatim. Një i ri, që së shpejti do të largohej për në misi-on, foli në mbledhjen e sakramentit.

Ai tha: “Ju të gjithë mendoni se babai im është një njeri kaq i mirë në kishë, por . . .”, ai u ndal dhe unë me padurim vrisja mendjen se çfarë do të thoshte më pas. Ai vazhdoi dhe tha: “Ai është një njeri më i mirë në shtëpi”.

E falënderova më pas këtë të ri për fjalët frymëzuese që kishte thënë për babanë e tij. Më pas mora vesh se

babai i tij ishte peshkopi i lagjes. Edhe pse peshkopi po i shërbente lagjes së tij besnikërisht, djali i tij ndiente se punën më të mirë ai e kryente në shtëpi²⁰.

Plaku D. Tod Kristoferson këshillon: “Ne kemi shumë mënyra për t’i dhënë mësim . . . brezit të ri dhe ne duhet t’ia përkushtojmë të menduarin dhe përpjekjet tona më të mira për të përfutur plotësisht prej tyre. Mbi të gjitha, ne duhet të vazhdojmë t’i nxitim dhe t’i ndihmojmë prindërit për të qenë mësues më të mirë dhe më të qëndrueshëm . . . veçanërisht me anë të shembullit.”²¹

Kjo është mënyra se si jep mësim Shpëtimtari²².

Vitin e kaluar, ndërsa ishim me pushime me dy prej fëmijëve tanë më të vegjël, Xhuli sugjeroi se do të ishim mëkëmbës për pagëzimet si në Tempullin e Seint-Xhorxhit ashtu edhe në Tempullin e San-Diegos. Mërmërita – me vete – tekta mendoja: “Ne shkuam në tempull kur ishim në shtëpi dhe tani jemi me pushime. Përse të mos bëjmë diçka që ngjan më shumë me pushimet?” Pas pagëzimeve, Xhuli donte të bënte fotografi jashtë tempullit. Në heshtje mërmërita – përsëri. Mund ta merrni me mend se çfarë ndodhi më pas – ne bëmë fotografi.

Xhuli do që fëmijët tanë të kenë kujtime për rastin kur ndihmuam

paraardhësit tanë, po ashtu edhe unë. Nuk na duhej një mësim i mirëfilltë mbi rëndësinë e tempujve. Ne po e jetonim atë – falë një nëne që e do tempullin dhe dëshiron që fëmijët e saj të kenë po atë dashuri.

Ndërsa prindërit e çmojnë njëri-tjetrin dhe japin shembuj të drejtë, fëmijët bekohen përjetësisht.

Përfundimi

Për të gjithë ju që po përpiqeni fort të bëni më të mirën për të dhënë mësim në shtëpitë tuaja, uroj që të gjeni paqe dhe gëzim në përpjekjet tuaja. Dhe nëse ndieni se ka vend për përmirësim apo keni nevojë për një përgatitje më të madhe, ju lutem, përgjigjuni me përlulesi kur Shpirti ju nxit dhe zotohuni për të vepruar²³.

Plaku L. Tom Peri tha: “Shëndeti i çfarëdo shoqërie, lumturia e njerëzve të saj, mirëqenia e tyre dhe paqja e tyre të gjitha gjejnë rrënjë të përbashkëta në mësimin e fëmijëve në shtëpi”²⁴.

Po, vatra e shtëpisë sime tani është bosh, por jam ende në gatishmëri, i gatshëm dhe i zellshëm për të gjetur mundësi të tjera të çmuara për t’i mësuar fëmijët e mi të rritur, fëmijët e tyre dhe një ditë, shpresoj, edhe fëmijët e tyre.

Unë lutem për ndihmën e qiellit ndërsa përpiqemi fort që të jemi mësues si Krishti në shtëpitë tona. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Doktrina e Besëlidhje 68:25; 93:40.

Plaku L. Tom Peri dha mësim: “Ndikimi i kundërshtarit është kaq i përhapur dhe ai po sulmon, duke u përpjekur të gërryjë dhe shkatërrojë vetë themelin e shoqërisë sonë, madje familjen. Prindërit duhet ta ndajnë mendjen që mësimdhënia në shtëpi është përgjegjësia më e shenjtë dhe më e rëndësishmja” (“Nënat që i Mësojnë Fëmijët në Shtëpi”, *Liahona*, maj 2010, f. 30).

Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve dhanë mësim: “Bashkëshorti dhe bashkëshortja kanë një përgjegjësi solemne të duan dhe të

kujdesen për njëri-tjetrin dhe për fëmijët e tyre. ‘Bijtë janë një trashëgimi që vjen nga Zoti’ (Psalmi 127:3). Prindërit kanë një detyrë të shenjtë për të rritur fëmijët e tyre me dashuri dhe drejtësi, për të plotësuar nevojat e tyre fizike dhe shpirtërore, për t’i mësuar ata ta duan dhe t’i shërbejnë njëri-tjetrit, për të zbatuar urdhërimet e Perëndisë dhe për të qenë qytetarë që u binden ligjeve kudo që jetojnë. Bashkëshortët dhe bashkëshortet, nënat dhe etërit, do të mbahen përgjegjës përpara Perëndisë për plotësimin e këtyre detyrimeve” (“Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”, *Liahona*, maj 2017, f. 145).

2. Shih Rasëll M. Nelson, “Teksa Ecim Përpara së Bashku”, *Liahona*, prill 2018, f. 7.
3. Plaku Dejvid A. Bednar tha: “Sot, nëse ju do të mund t’i pyesnit bijtë tanë të rritur se çfarë kujtojnë për lutjen familjare, studimin e shkrimit të shenjtë dhe mbrëmjen familjare në shtëpi, besoj se e di se do të përgjigjeshin. Ka gjasa që ata nuk do të vinin në dukje një lutje të veçantë apo një rast specifik të studimit të shkrimit të shenjtë, apo një mësim veçanërisht kuptimplotë të mbrëmjes familjare të shtëpisë, si çastin më karakteristik në zhvillimin e tyre shpirtëror. Ajo që do të thoshin se kujtojnë është që, si familje, ne ishim këmbëngulës” (“Më të Zellshëm dhe më të Përfshirë në Shtëpi”, *Liahona*, nëntor 2009, f. 19).
4. Shih “Parajs’ mund t’Jet’ Shtëpia”, *Himne*, nr. 193.
5. *Mësime të Presidentëve të Kishës: Gordon B. Hinkli* (2016), f. 176.
6. Shih 2 Nefi 2:11.
7. N. Eldon Tanner, “Never Be Ashamed of the Gospel of Christ”, *Ensign*, shkurt 1980, f. 4.

8. Shih 3 Nefi 18:21.
9. Shih Mateu 3:16–17; 3 Nefi 11:6–8; Doktrina e Besëlidhje 18:34–36; Joseph Smith – Historia 1:17.
10. “Përfitoni nga Çaste Rastësore për Mësimdhënie”, *Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit* (2016), f. 16. *Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit* përfshin një larmi këshillash dhe mjetesh për mësimdhënien në shtëpi.
11. Shih Doktrina e Besëlidhje 11:21; 84:85.
12. *Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit*, f. 16.
13. Shih “Dëgjoni”, *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2004), f. 191–192.
14. 1 Pjetër 3:15.
15. Douglas L. Callister, “Most Influential Teacher—Emeritus Seventy Pays Tribute to Father”, 29 gusht 2016, news.lds.org.
16. Russell M. Nelson, “Set in Order Thy House”, *Liahona*, janar 2002, f. 81.
17. Shih Alma 32:28–43.
18. Motra Melinda Eshtën kujdeset në vend të bashkëshortit të saj, Vëllait Eshtën, kur ai ndodhet jashtë qytetit.
19. 1 Timoteu 4:12; shih edhe Alma 17:11.
20. Peshkopi Xhefri L. Stuart shërben në Lagjen e Dytë Sauthgejt në Seint-Xhorxh, Jutë. Samueli, i biri, tani po shërben në Misionin e Medellitit, Kolumbi.
21. D. Tod Kristoferson, “Strengthening the Faith and Long-Term Conversion of the Rising Generation”, mbledhje e udhëheqjes të konferencës së përgjithshme, shtator 2017.
22. Shih 3 Nefi 27:21, 27.
23. Shih Doktrina e Besëlidhje 43:8–9.
24. L. Tom Perry, “Nënat që i Mësojnë Fëmijët në Shtëpi”, f. 30.





Nga Plaku Dejll G. Renland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Historia Familjare dhe Puna në Tempull: Vulosja dhe Shërimi

Kur i mbledhim historitë tona familjare dhe shkojmë në tempull në emër të paraardhësve tanë, Perëndia përmbush bekime të premtuara njëkohësisht në të dyja anët e velit.

Marrëdhëniet familjare mund të jenë disa prej përvojave më shpërblyese por edhe më sfiduese që mund të hasim. Shumë prej nesh janë ndeshur me një mosmarrëveshje të njëfarë lloji brenda familjeve tona. Një mosmarrëveshje e tillë u zhvillua midis dy heronjve të Rivendosjes së Kishës së Jezu Krishtit në këto ditë të mëvonshme. Parli dhe Orson Prati ishin vëllezër, të kthyer të hershëm në besim dhe Apostuj të shuguruar. Secili u përball me një sprovë besimi, por doli prej saj me dëshmi të patundur. Që të dy sakrifkuan shumë dhe dhanë ndihmesë të madhe për kauzën e së vërtetës.

Gjatë epokës së Navusë marrëdhënia e tyre u bë e tendosur, duke arritur kulmin në një kundërvënie të ashpër, publike në vitin 1846. U zhvillua një përçarje e thellë dhe e zgjatur. Fillimisht Parli i shkroi Orsonit që t'i jepnin zgjidhje përçarjes, por Orsoni nuk u përgjigj. Parli hoqi dorë, duke menduar se letërkëmbimi kishte marrë fund përgjithmonë, në qoftë se nuk fillohej nga Orsoni.¹

Disa vite më vonë, në mars 1853, Orsoni mësoi rreth një projekti për të botuar një libër mbi pasardhësit e Uilliam Pratit, paraardhësit më të hershëm amerikan të vëllezërve. Orsoni filloi të derdhte lot “si fëmijë i vogël” teksa i hodhi një sy këtij thesari të çmuar të historisë familjare. Zemra e tij u zbut dhe ai vendosi ta ndreqte ndarjen me vëllanë e tij.



Orsoni i shkroi Parlit: “Tani, vëllai im i dashur, nuk ka asnjë mes gjithë pasardhësve të Paraardhësit tonë, Kolonelit Uilliam Prat, që ka interes kaq të madh në kërkimin e pasardhësve të tij sesa ne”. Orsoni ishte një prej të parëve që e kuptoi se shenjtorët e ditëve të mëvonshme kanë detyrim që të bëjnë kërkime dhe t'i grumbullojnë historitë familjare, me qëllim që të mund të kryejmë ordinanca mëkëmbëse për paraardhësit tanë. Letra e tij vazhdoi: “E dimë se Perëndia i etërve tanë ka pasur dorë në gjithë këtë gjë. . . . Të kërkoj vërtet falje që kam qenë kaq i gabuar dhe nuk të kam shkruar. . . . Shpresoj që do të më falësh.”² Pavarësisht nga dëshmitë e tyre të palëkundura, dashuria e tyre për paraardhësit e tyre ishte përshpejtuesi për të zgjidhur një përçarje, për të shëruar një plagë dhe për të kërkuar e dhënë falje.³

Kur Perëndia na udhëzon të bëjmë një gjë, Ai shpesh ka shumë qëllime në mendje. Historia familjare dhe puna në tempull nuk është vetëm për të vdekurit, por i bekon edhe të gjallët. Orsonit dhe Parlit, ajo ia ktheu zemrat te njëri-tjetri. Historia familjare dhe puna në tempull siguruan fuqinë për të shëruar atë që kishte nevojë për shërim.

Si anëtarë të Kishës, ne kemi vërtet një përgjegjësi të caktuar në mënyrë hyjnore për t'i kërkuar paraardhësit tanë dhe për t'i grumbulluar historitë familjare. Kjo është shumë më tepër sesa një hobi për të cilin nxitemi, sepse ordinancat e shpëtimit janë të nevojshme për të gjithë fëmijët e Perëndisë.⁴ Ne duhet t'i përcaktojmë vetë paraardhësit tanë të cilët vdiqën pa i marrë ordinancat e shpëtimit. Ne mund t'i kryejmë ordinancat në mënyrë mëkëmbëse në tempuj dhe paraardhësit tanë mund të zgjedhin t'i pranojnë ordinancat.⁵ Ne nxitemi gjithashtu që t'i ndihmojmë anëtarët e lagjeve dhe të kunjeve me emrat e familjeve të tyre. Është mahnitëse aq sa të lë pa frymë fakti që, nëpërmjet historisë familjare dhe punës në tempull, ne mund të ndihmojmë për t'i shëlbuar të vdekurit.

Por teksa marrim pjesë në historinë familjare dhe punën në tempull sot, ne gjithashtu kualifikohemi për bekimet "shëruese" të premtuara nga profetët dhe apostujt.⁶ Këto bekime janë gjithashtu mahnitëse dhe befasuese për shkak të qëllimit, veçantisë dhe rrjedhjes së tyre në vdekshmëri. Kjo listë e gjatë përfshin këto bekime:

- Kuptueshmëri më të madhe për Shpëtimtarin dhe flijimin e Tij shlyes;
- Ndikim më të madh të Frymës së Shenjtë⁷ për të ndier forcë dhe drejtim për vetë jetën tonë;
- Besim më të madh, në mënyrë që kthimi në besim te Shpëtimtari të bëhet i thellë dhe i qëndrueshëm;
- Aftësi dhe shtysë më të madhe për të mësuar e për t'u penduar⁸ për shkak të një kuptueshmërie se cilët jemi, nga vijnë dhe një pamjeje më të qartë se ku po shkojmë;
- Ndikime më të mëdha përmirësuese, shenjtëruese dhe pajtuese në zemrat tona;



- Gëzim më të madh nëpërmjet një aftësie më të madhe për ta ndier dashurinë e Zotit;
- Bekime më të mëdha familjare, parvarësisht nga gjendja jonë familjare e tanishme, e shkuar apo e ardhshme, apo nga sa e papërsosur mund të jetë pema jonë familjare;
- Dashuri dhe vlerësim më të madh për paraardhësit dhe të afërmit e gjallë, prandaj ne nuk ndihemi më të vetëm;
- Fuqi më të madhe për të dalluar ato gjëra që kanë nevojë për shërim dhe si rrjedhojë, me ndihmën e Zotit, për t'u shërbyer të tjerëve;
- Mbrojtje më të madhe nga tundimet dhe ndikimi në shtim e sipër i kundërshtarit; dhe
- Ndihmë më të madhe për t'i shëruar zemrat e shqetësuara, të thyera apo të merakosura dhe për t'i shëruar të lënduarit.⁹

Nëse jeni lutur për ndonjë prej këtyre bekimeve, merrni pjesë në historinë familjare dhe punën në tempull. Kur ta bëni këtë, lutjet tuaja do të marrin përgjigje. Kur kryhen ordinanca në emër të të vdekurve, fëmijët e Perëndisë në

tokë shërohen. Nuk është për t'u habitur përse Presidenti Rasëll M. Nelson, në mesazhin e tij të parë si President i Kishës, shpalli: "Adhurimi juaj në tempull dhe shërbimi juaj atje për paraardhësit tuaj do t'ju bekojnë me zbulësë dhe paqe të shtuar vetjake dhe do ta forcojnë zotimin tuaj për të qëndruar në shtegun e besëlidhjeve"¹⁰.

Edhe një profet i hershëm parashikoi bekime si për të gjallët, ashtu edhe për të vdekurit.¹¹ Një lajmëtar qiellor i tregoi Ezekielit një vegim të një tempulli me ujë që dilte çurg prej tij. Ezekielit iu tha:

"Këto ujëra drejtohen . . . [dhe] zbrezin në Arabah dhe do të derdhen në det[in e vdekur]; . . . [dhe] ujërat e tij do të shëndoshen.

Dhe do të ndodhë që çdo qenie e gjallë që lëviz do të jetojë, kudo që arrin lumi; . . . sepse [do të] shëndosh[en] . . . [dhe] kudo që arrin lumi gjithçka ka për t'u gjallëruar."¹²

Dy karakteristika të ujit ia vlen të përmenden. Së pari, edhe pse rrëkeja e vogël nuk kishte degë të tjera ushqyese, ajo u rrit në një lumë të fuqishëm, duke u bërë më e gjerë dhe më e thellë sa më larg që rridhte. Diçka e ngjashme ndodh me bekimet që rrjedhin nga tempulli ndërkohë që individët vulosen si familje. Rritje domethënëse ndodh e shkon para e pas përmes brezave teksa ordinancat vulosëse i lidhin familjet së bashku.

Së dyti, lumi e ripërtëriu gjithçka që preku. Po ashtu bekimet e tempullit kanë një aftësi çudibërëse për të shëruar. Bekimet e tempullit mund të shërojnë zemrën, jetën dhe familjet.

Më lejoni ta ilustruj. Në vitin 1999 një i ri i quajtur Tod u rënua nga një enë gjaku që u këput në trurin e tij. Edhe pse Todi dhe familja e vet ishin anëtarë të Kishës, aktivizimi i tyre kishte qenë me hope dhe askush nuk



i kishte përjetuar bekimet e tempullit. Natën e fundit të jetës së Todit, nëna e tij, Beti, u ul pranë shtratit të tij duke ia prekur dorën dhe tha: “Tod, nëse vërtet duhet të ikësh, të premtoj se do të kujdesem që të bëhet puna jote në tempull”. Të nesërmen në mëngjes u bë e ditur se truri i Todit nuk funksiononte më. Kirurgët e transplantuan zemrën e Todit te pacienti im, një njeri i mrekullueshëm, i quajtur Rod.

Disa muaj pas transplantimit, Rodi mësoi se kush ishte familja e dhuruesit të zemrës së tij dhe filloi një letërkëmbim me ta. Gati dy vjet më pas, nëna e Todit, Beti, e ftoi Rodin që të ishte i pranishëm kur ajo shkoi në tempull për herë të parë. Rodi dhe Beti u takuan për herë të parë ballë për ballë në dhomën çelestiale të Tempullit të Seint-Xhorxhit në Jutë.

Pak kohë më pas vdiq babai i Todit – bashkëshorti i Betit. Dy vjet më pas, Beti e ftoi Rodin të përfaqësonte në mënyrë mëkëmbëse birin e saj të vdekur në marrjen e ordinancave të tij të tempullit. Rodi ishte mirënjohës që ta bënte këtë dhe puna mëkëmbëse arriti

kulmin në një dhomë vulosjeje në Tempullin e Seint-Xhorxhit në Jutë. Beti u vulos me bashkëshortin e saj të vdekur, duke qëndruar tek altari përballë nipit të saj, i cili shërbeu si mëkëmbës. Më pas, me lot që i rridhnin nëpër faqe, ajo i kërkoi Rodit të bashkohej me ta tek altari. Rodi ra në gjunjë pranë tyre, duke vepruar si mëkëmbës për birin e saj, Todin, zemra e të cilit ende po rrihte brenda kraharorit të Rodit. Dhuruesi i zemrës së Rodit, Todi, më pas u vulos me prindërit e tij për gjithë përjetësinë. Nëna e Todit e kishte mbajtur premtimin që ia bëri vite më parë birit të saj që po vdiste.

Por historia nuk mbaron atje. Përsëmbëdhjetë vjet pas transplantimit të zemrës së tij, Rodi u fejuar, do të martohet dhe më kërkoi që të kryejë vulosjen në Tempullin e Provos në Jutë. Në ditën e dasmës u takova me Rodin dhe nusen e tij të mrekullueshme, Kimin, në një dhomë ngjitur me dhomën e vulosjes, ku po prisnin familjet dhe miqtë e tyre më të ngushtë. Pas një takimi të shkurtër me Rodin dhe Kimin, i pyeta nëse kishin ndonjë pyetje.

Rodi tha: “Po. Familja që më dhuroi zemrën është këtu dhe do të donte të takohej me ju.”

U kapa në befasi dhe pyeta: “Do të thuash që janë këtu? Pikërisht tani?”

Rodi u përgjigj: “Po”.

Hodha hapat drejt dhomës dhe i kërkova familjes të dilte nga dhoma e vulosjes. Beti, bija e saj dhe dhëndri i saj u bashkuan me ne. Rodi e përshëndeti Betin me një përqaftim, e falënderoi për ardhjen dhe më pas më njohu me të. Rodi tha: “Beti, ky është Plaku Renland. Ai ishte mjeku që u kujdes për zemrën e birit tënd për kaq shumë vite.” Ajo kaloi përmes dhomës dhe më përqafoi. Dhe për disa minuta në vazhdim pati përqaftime dhe lot gëzimi nëpër dhomë.

Pasi e mblodhëm veten, shkuam në dhomën e vulosjes ku Rodi dhe Kimi u vulosën për kohën dhe gjithë përjetësinë. Rodi, Kimi, Beti dhe unë mund të dëshmojmë se qielli ishte shumë pranë, se atje atë ditë pati të tjerë me ne, të cilët kishin kaluar më parë përmes velit të vdekshmërisë.

Perëndia, në aftësinë e Tij të pafundme, vulos dhe shëron individë e familje pavarësisht nga tragjedia, humbja dhe vështirësia. Ne nganjëherë i krahasojmë ndjenjat që i përjetojmë në tempuj, me përjetimin e një vështrimi kalimthi të qiellit.¹³ Atë ditë në Tempullin e Provos në Jutë, kjo thënie e C. S. Ljuisit kumboi brenda meje: “[Njerëzit e vdekshëm] thonë për disa vuajtje të përkohshme: ‘Asnjë gëzim i ardhshëm nuk mund t’ia shlyejë ato’, duke mos e ditur se Qielli, pasi e ke arritur, do të punojë në drejtimin e kundërt dhe do ta kthejë edhe atë agoni në lavdi. . . . Të Bekuarit do të thonë: ‘Ne nuk kemi jetuar kurrë diku tjetër përveçse në Qiell!’”¹⁴

Perëndia do të na forcojë, ndihmojë dhe mbajë¹⁵; dhe Ai do të na i shenjtërojë vuajtjet më të mëdha.¹⁶ Kur i

mbledhim historitë tona familjare dhe shkojmë në tempull në emër të paraardhësve tanë, Perëndia i përmbush shumë nga këto bekime të premtuara njëherësh në të dyja anët e velit. Në mënyrë të ngjashme, ne bekohemi kur i ndihmojmë të tjerët në lagjet dhe kunjet tona për të bërë të njëjtën gjë. Anëtarët që nuk jetojnë pranë një tempulli, gjithashtu i marrin këto bekime duke marrë pjesë në punën e historisë familjare, duke i mbledhur emrat e paraardhësve të tyre që t'iu kryhen ordinancat e tempullit.

Gjithsesi Presidenti Nelson na paralajmëroi: “Ne mund të frymëzohemi gjithë ditën rreth përvojave të tempullit dhe të historisë familjare që i kanë pasur të tjerët. Por duhet të bëjmë diçka që ta përjetojmë vetë me të vërtetë gëzimin.” Ai vazhdoi: “Ju ftoj që me lutje të merrni parasysh se çfarë lloj sakrifice – mundësisht një sakrifikim të kohës suaj – mund të bëni me qëllim që të bëni më shumë punë në tempull dhe punë për historinë familjare”¹⁷. Kur e pranoni ftesën e Presidentit Nelson, ju do të zbuloni, mblidhni dhe lidhni së bashku familjen tuaj. Përveç kësaj, bekime do të rrjedhin drejt jush dhe



familjes suaj ashtu si lumi për të cilin foli Ezekieli. Ju do të gjeni shërim për ato gjëra që kanë nevojë të shërohen.

Orson dhe Parli Prati përjetuan ndikimet shëruese dhe vulosëse të historisë familjare dhe punës në tempull në fillim të kësaj periudhe ungjillore. Beti, familja e saj dhe Rodi e përjetuan atë. Edhe ju mund ta përjetoni atë. Nëpërmjet flijimit të Tij shlyes, Jezu Krishti i ofron këto bekime për të gjithë, si për të vdekurit edhe për të gjallët. Për shkak të këtyre bekimeve, ne do të zbulojmë se, në mënyrë metaforike, “nuk kemi jetuar kurrë diku tjetër përveç . . . Qiell[it]”¹⁸. Unë dëshmoj kështu, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Parley P. Pratt to Orson Pratt, 25 maj 1853, Orson Pratt Family Collection, Biblioteka e Historisë së Kishës, Solt-Lejk-Siti; në Teryl L. Givens dhe Matthew J. Grow, *Parley P. Pratt: The Apostle Paul of Mormonism* (2011), f. 319.
2. Orson Pratt to Parley P. Pratt, 10 mars 1853, Parley P. Pratt Collection, Biblioteka e Historisë së Kishës, Solt-Lejk-Siti; në Givens dhe Grow, *Parley P. Pratt*, f. 319.
3. Në mënyrë domethënëse, Orson Prati jo vetëm që ndihmoi në botimin e librit për pasardhësit e Uilliam Prati, por disa vite më vonë, në 1870-ën, ai dhe familja e tij kryen mbi 2 600 pagëzime mëkëmbëse në Shtëpinë e Dhurimit [Indaumentit] në Solt-Lejk-Siti për individët e vdekur në libër, (shih Breck England, *The Life and Thought of Orson Pratt* [1985], f. 247).
4. Shih Joseph Smith, *History of the Church*, 6:312–313.
5. Shih “Names Submitted for Temple Ordinances”, letër e Presidencës së Parë, 29 shkurt 2012. Paraardhësit emrat e të cilëve dorëzohen për ordinanca mëkëmbëse në tempull, duhet të jenë të lidhur me dorëzuesin. Pa përjashtim, anëtarët e Kishës nuk duhet të dorëzojnë emra nga ndonjë grup i paautorizuar, të tillë si njerëz të famshëm dhe viktimat të Holokaustit të hebrenjve.
6. Shih Dallin H. Oaks, “In Wisdom and Order”, *Tambuli*, dhjetor 1989, f. 18–23; D. Todd Christofferson, “The Redemption of the Dead and the Testimony of Jesus”, *Liahona*, janar 2001, f. 10–13; Boyd K. Packer, “Your Family History: Getting Started”, *Liahona*, gusht 2003, f. 12–17; Tomas S. Monson, “Të Vërteta të Qëndrueshme për Kohë të Ndryshueshme”, *Liahona*, maj 2005, f. 19–22; Henri B. Ajring, “Me Zemra të Bashkuara”, *Liahona*, maj 2005, f. 77–80; M. Rasëll Ballard, “Fe, Familje, Fakte dhe Fryte”, *Liahona*, nëntor 2007, f. 25–27; Rasëll M. Nelson, “Shpëtimi dhe Ekzaltimi”, *Liahona*, maj 2008, f. 7–10; Rasëll M. Nelson, “Breza të Lidhur me Dashuri”, *Liahona*, maj 2010, f. 91–94; Devid A. Bednar, “Zemrat e Fëmijëve do të Kthehen”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 24–27; Riçard G. Skot, “Gëzimi i Shëlbimit të të Vdekurve”, *Liahona*, nëntor 2012, f. 93–95; Kuentin L. Kuk, “Rrënjët dhe Degët”, *Liahona*, maj 2014, f. 44–48; Tomas S. Monson, “Përshpejtimi i Punës”, *Liahona*, qershor 2014, f. 4–5; Henry B. Eyring, “The Promise of Hearts Turning”, *Liahona*, korrik 2014, f. 4–5; Devid A. Bednar, “Puna Misionare, Puna e Historisë Familjare dhe Puna në Tempull”, *Liahona*, tetor 2014, f. 14–19; Neil L. Andersen, “‘My Days’ of Temples and Technology”, *Liahona*, shkurt 2015, f. 26–33; Neil L. Andersen, “Sharing the Temple Challenge”, Family Discovery Day, shkurt 2015, LDS.org; Kuentin L. Cook, “The Joy of Family History Work”, *Liahona*, shkurt 2016, f. 22–27; Geri E. Stivenson, “Ku Janë Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë?”, *Liahona*, maj 2016, f. 29–32; Diter F. Uhtdorf, “Në Lavdërim të Atyre që Shpëtojnë”, *Liahona*, maj 2016, f. 77–80; Kuentin L. Kuk, “Shikojeni Vetën Tuaj në Tempull”, *Liahona*, maj 2016, f. 97–101; Dale G. Renlund, Ruth L. Renlund dhe Ashley R. Renlund, “Family History and Temple Blessings”, *Liahona*, shkurt 2017, f. 34–39; Dallin H. Oaks dhe Kristen M. Oaks, “Connected to Eternal Families”, Family Discovery Day, mars 2018, LDS.org.
7. Shih Doktrina e Besëlidhje 109:15.
8. Shih Doktrina e Besëlidhje 109:21.
9. Shih Boyd K. Packer, “Balm of Gilead”, *Ensign*, nëntor 1987, f. 16–18; Jeremia 8:22; 51:8.
10. Rasëll M. Nelson, “Teksa Ecim Përpara së Bashku”, *Liahona*, prill 2018, f. 7.
11. Shih Ezekiel 40–47; Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Ezekiel”.
12. Ezekiel 47:8–9.
13. Shih Spencer W. Kimball, “Glimpses of Heaven”, *Ensign*, dhjetor 1971, f. 36–37.
14. C. S. Lewis, *The Great Divorce: A Dream* (2001), f. 69.
15. Shih Isaia 41:10.
16. Shih “Sa i Fort’ një Themel”, *Himne*, nr. 41.
17. Rasëll M. Nelson dhe Uendi W. Nelson, “Hapini Qiejt nëpërmjet Punës së Tempullit dhe Historisë Familjare”, *Liahona*, tetor 2017, f. 19.
18. Lewis, *The Great Divorce*, f. 69.



Nga **Daglas D. Holms**,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rinjve

Çfarë Ka Nevojë të Kuptojë Çdo Mbajtës i Priftërisë Aarone

Shugurimi juaj në Priftërinë Aarone është thelbësor për t'i ndihmuar fëmijët e Perëndisë që të marrin fuqinë shlyese të Krishtit.

Vëllezër, është privilegj të jem me ju në këtë konferencë historike. Kur isha president i ri misioni, pata emocion kur morëm grupin tonë të parë të misionarëve të rinj. Disa prej misionarëve tanë më me përvojë po përgatiteshin për një mbledhje të shkurtër me ta. Vura re se kishin vendosur karriqe fëmijësh në një gjysmë rrethi.

“Për çfarë i doni karriget e vogla?”, i pyeta.

Misionarët, disi me druajte, thanë: “Për misionarët e rinj”.

Besoj se mënyra se si i shohim të tjerët e ndikon së tepërmi kuptueshmërinë se kush janë dhe çfarë mund të bëhen.¹ Misionarët tanë të rinj u ulën në karrige të rriturish atë ditë.

Nganjëherë, kam frikë, se në mënyrë figurative ne u japim të rinjve tanë të Priftërisë Aarone karrige fëmijësh ku të ulen, në vend që t'i ndihmojmë të kuptojnë se Perëndia u ka dhënë një mirëbesim të shenjtë dhe një punë jetike për të bërë.

Presidenti Tomas S. Monson na këshilloi që të rinjtë kanë nevojë të

kuptojnë se “çfarë do të thotë . . . të jenë mbajtës të priftërisë së Perëndisë. Ata duhet të udhëzohen drejt një vetëdijeje shpirtërore për shenjtërinë e thirrjes që u është shuguruar atyre.”²

Sot lutem që Fryma e Shenjtë do të na udhërrëfejë drejt një kuptueshmërie më të madhe për fuqinë dhe shenjtërinë e Priftërisë Aarone dhe do të na

frymëzojë të përqendrohemi më me zell tek detyrat tona të priftërisë. Mesazhi im është për të gjithë mbajtësit e Priftërisë Aarone, përfshirë ata që gjithashtu mbajnë Priftërinë Melkizedeke.

Plaku Dejl G. Renland na mësoi se qëllimi i priftërisë është t'u sigurojë fëmijëve të Perëndisë mundësi për ta përdorur fuqinë shlyese të Jezu Krishtit.³ Për ta marrë fuqinë shlyese të Krishtit në jetën tonë, ne duhet të besojmë tek Ai, të pendo kemi për mëkatet tona, të bëjmë dhe të mbajmë besëlidhje të shenjta nëpërmjet ordinancave dhe të marrim Frymën e Shenjtë.⁴ Këto nuk janë parime në të cilat përfshihemi vetëm një herë; përkundrazi, ato veprojnë së bashku, duke e përforcuar njëritjetrin dhe duke ngritur mbi njëritjetrin në një proces të vazhdueshëm drejt përparimit lartësues që të “[vijmë] te Krishti dhe [të] përsos[emi] në të”⁵.

Pra, cili është roli i Priftërisë Aarone në këtë gjë? Si na ndihmon të fitojmë mundësi për ta përdorur fuqinë shlyese të Krishtit? Besoj se përgjigjja gjendet në çelësat e Priftërisë Aarone – çelësat e shërbesës së engjëjve dhe të ungjillit përgatitor.⁶



Shërbesa e Engjëjve

Le ta fillojmë me një aspekt të shërbesës së engjëjve. Përpara se fëmijët e Perëndisë të mund të kenë besim në Jezun Krishtin, ata kanë nevojë të dinë për Të dhe t'u mësohet ungjilli i Tij. Siç tha Apostulli Pal:

“Si do të besojnë tek ai për të cilin nuk kanë dëgjuar? Dhe si do të dëgjojnë, kur s'ka kush predikon?”

Dhe si do të predikojnë pa qenë dërguar? . . .

Besimi, pra, vjen nga dëgjimi, dhe dëgjimi vjen nga fjala e Perëndisë.⁷

Që nga fillimi i kohës, Perëndia ka “dërg[uar] engjëj, për t'u shërbyer fëmijëve të njerëzve, për t'u treguar . . . ardhjen e Krishtit”.⁸ Engjëjt janë lajmëtarë qiellorë që japin mesazhin e Perëndisë.⁹ Në hebraisht dhe greqisht rrënja e fjalës *engjëll* është “lajmëtar”.¹⁰

Pothuajse në të njëjtën mënyrë si engjëjt që janë lajmëtarë të autorizuar, të dërguar nga Perëndia për ta shpallur fjalën e Tij dhe, si rrjedhim, për të ndërtuar besim, edhe ne që mbajmë Priftërinë Aarone, jemi shuguruar që të “japim mesim dhe t'i ftoj[më] të gjithë të vijnë te Krishti”.¹¹ Predikimi i ungjillit është një detyrë priftërie. Dhe fuqia që lidhet me këtë detyrë, nuk është vetëm për profetët apo thjesht vetëm për misiionarët. Është për ju!¹²

Pra, si e marrim këtë fuqi? Si mund ta sjellë një dhjak 12-vjeçar – ose secili prej nesh – në zemrat e fëmijëve të Perëndisë besimin te Krishti? E fillojmë duke e mbledhur si thesar fjalën e Tij kështu që fuqia e tij të jetë me ne.¹³ Ai ka premtuar se, në qoftë se e bëjmë këtë, ne do të kemi “fuqinë e Perëndisë për të bindur njerëzit”.¹⁴ Një mundësi mund të jetë për të dhënë mesim në një mbledhje kuorumi ose kur të vizitohet shtëpia e një anëtar. Mund të jetë diçka më



pak formale, si një bashkëbisedim me një mik apo pjesëtar të familjes. Në cilindo prej këtyre mjedisëve, nëse jemi të përgatitur, ne mund ta japim mesim ungjillin sipas mënyrës që do ta jepnin engjëjt: me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë.¹⁵

Kohët e fundit dëgjova Xhejkëbin, një mbajtës të Priftërisë Aarone në Papua të Guinesë së Re, të dëshmonte për fuqinë e Librit të Mormonit dhe mënyrën se si e ka ndihmuar t'i bëjë ballë ligësisë dhe ta ndjekë Shpirtin. Fjalët e tij ma shtuan besimin tim dhe e shtuan besimin e të tjerëve. Besimi im gjithashtu është rritur kur kam dëgjuar mbajtës të Priftërisë Aarone të japin mesim e të dëshmojnë në mbledhjet e kuorumeve të tyre.

Të rinj, ju jeni lajmëtarë të autorizuar. Nëpërmjet fjalëve dhe veprimeve tuaja, ju mund të sillni në zemrat e fëmijëve të Perëndisë besim te Krishti.¹⁶ Sikurse tha Presidenti Rasëll M. Nelson: “Për ta do të jeni si një engjëll shërbëtar”.¹⁷

Ungjilli Përgatitor

Besimi më i madh te Krishti gjithmonë çon drejt një dëshire për të ndryshuar ose për t'u pënduar.¹⁸ Prandaj është logjike që çelësi i shërbesës së engjëjve do të shoqërohej nga çelësi i ungjillit përgatitor, “ungjillit [të] pendimit dhe [të] pagëzimit, dhe [të] heqjes së mëkateve”.¹⁹

Kur i studioni detyrat tuaja të Priftërisë Aarone, ju do të shihni një urdhrë të qartë për t'i ftuar të tjerët të pendohen dhe të përmirësohen.²⁰ Kjo nuk do të thotë që të qëndrojmë në anë të rrugës duke bërë turr: “Pendohuni!” Më shpesh do të thotë që *ne* pendohemi, falim dhe teksojmë u japim shërbesë të tjerëve, ne ofrojmë shpresën dhe paqen që i sjell pendimi – sepse e kemi përjetuar atë vetë.

Kam qenë me mbajtës të Priftërisë Aarone teksojmë vizituan bashkëanëtarë të kuorumit. E kam dëshmuar përkujdesjen e tyre që i zbut zemrat dhe i ndihmon vëllezërit e tyre të ndiejnë dashurinë e Perëndisë. Dëgjova një të ri



Priftërinjtë të cilët pagëzuan familjen Mbuelongo në Sidnej të Australisë, arritën ta kuptonin se çfarë do të thotë të jenë të "autorizuar nga Jezu Krishti".

t'u jepte dëshmi bashkëmohatarëve të tij për fuqinë e pendimit. Kur e bëri atë, zemrat u zbutën, u bënë zotime dhe u ndje fuqia shëruese e Krishtit.

Presidenti Gordon B. Hinkli dha mësim: "Është një gjë të pendohesh. Është një gjë tjetër të na hiqen dhe të na falen mëkatet tona. Fuqia për ta bërë këtë gjë të ndodhë, gjendet në Priftërinë Aarone."²¹ Ordinancat e Priftërisë Aarone të pagëzimit dhe të sakramentit e dëshmojnë dhe e plotësojnë pendimin tonë për një heqje të mëkateve.²² Presidenti Dallin H. Oaks e shpjegoi atë në këtë mënyrë: "Ne urdhërohem të pendohemi për mëkatet tona dhe të vijmë te Zoti me një zemër të thyer e një shpirt të penduar dhe të marrim sakramentin. . . Kur ne i ripërtërijmë besëlidhjet tona të pagëzimit në këtë mënyrë, Zoti e ripërtërin ndikimin pastrues të pagëzimit tonë."²³

Vëllezër, është një privilegj i shenjtë që të administrojmë ordinancat që sjellin heqje të mëkateve për zemrat e penduara nëpërmjet fuqisë shlyese të Shpëtimtarit.²⁴

Kohët e fundit më treguan për një prift, që e ka të vështirë të shprehet, i cili po bekonte sakramentin për herë të parë. Kur e bëri, një shpirt i fuqishëm erdhi mbi të dhe bashkësinë. Më vonë në mbledhje, ai dha një dëshmi të thjeshtë, por të qartë për

fuqinë e Perëndisë që e ndjeu gjatë asaj ordinance.

Në Sidnej të Australisë katër anëtarë të një kuorumi të priftërinjve pagëzuan pjesëtarë të familjes Mbuelongo. Nëna e njërit prej këtyre priftërinjve më tregoi se si kjo përvojë e ndikoi fuqishëm birin e saj. Këta priftërinj arritën të kuptonin se çfarë do të thotë të jenë të "autorizuar nga Jezu Krishti"²⁵.

Siç e dini, priftërinjtë tani mund të kryesojnë në kryerjen e pagëzimeve mëkëmbëse në tempull. Biri im 17-vjeçar kohët e fundit më pagëzoi mua për disa prej paraardhësve tanë. Ne që të dy ndiem mirënjohje të thellë për Priftërinë Aarone dhe privilegjin e veprimit për shpëtimin e fëmijëve të Perëndisë.

Të rinj, kur përfshihen me zell në detyrat tuaja të priftërisë, ju merrni pjesë me Perëndinë në punën e Tij që "të bë[ni] të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut"²⁶. Përvoja si këto e rritin dëshirën tuaj dhe ju përgatitin të jepni mësim për pendimin dhe të pagëzoni njerëz të kthyer në besim kur të jeni misionarë. Ato gjithashtu ju përgatitin për shërbimin gjatë gjithë jetës në Priftërinë Melkizedeke.

Gjon Pagëzori, Shembulli Ynë

Mbajtës të Priftërisë Aarone, ne kemi privilegjin dhe detyrën për të qenë

bashkëshërbëtorë me Gjon Pagëzorin. Gjoni u dërgua si lajmëtar i autorizuar për të dhënë dëshmi për Krishtin dhe për t'i fuar të gjithë të pendoheshin e të pagëzoheshin – domethënë, ai ushtroi çelësat e Priftërisë Aarone që kemi diskutuar. Gjoni më pas shpalli: "Unë po ju pagëzoj me ujë, për pendim; por ai që vjen pas meje është më i fortë se unë . . . ; ai do t'ju pagëzojë me Frymën e Shenjtë dhe me zjarrin"²⁷.

Prandaj, Priftëria Aarone, me çelësat e shërbesës së engjëjve dhe të ungjillit përgatitor, përgatit udhën për fëmijët e Perëndisë që të marrin, nëpërmjet Priftërisë Melkizedeke, dhuratën e Frymës së Shenjtë, dhuratën më të madhe që mund të marrim në këtë jetë.²⁸

Ç'përgjegjësi të rëndësishme u ka dhënë Perëndia mbajtësve të Priftërisë Aarone!

Një Ftesë dhe Premtim


Prindër dhe udhëheqës të priftërisë, a mund ta kuptoni rëndësinë e këshillës së Presidentit Monson për t'i ndihmuar të rinjtë të kuptojnë se "çfarë do të thotë . . . të jenë mbajtës të priftërisë së Perëndisë"²⁹? Të kuptuarit dhe të lartësuarit e Priftërisë Aarone do t'i përgatitin për të qenë mbajtës besnikë të Priftërisë Melkizedeke, misionarë të mbushur me fuqi dhe bashkëshortë e etër të drejtë. Nëpërmjet shërbimit të tyre, ata do ta kuptojnë dhe do ta ndiejnë realitetin e fuqisë së priftërisë, fuqisë për të vepruar në emër të Krishtit për shpëtimin e fëmijëve të Perëndisë.

Të rinj, Perëndia ka një punë për ju për ta bërë.³⁰ Shugurimi juaj në Priftërinë Aarone është thelbësor për t'i ndihmuar fëmijët e Tij që të marrin fuqinë shlyese të Krishtit. Unë premtoj se kur t'i vini këto detyra të shenjta në qendër të jetës suaj, ju do të ndieni fuqinë e Perëndisë si kurrë më parë. Ju do ta kuptoni identitetin tuaj si bir

i Perëndisë, i thirrur me një thirrje të shenjtë për të bërë punën e Tij. Dhe, si Gjon Pagëzori, ju do të ndihmoni për të përgatitur udhën për ardhjen e Birit të Tij. Për këto të vërteta unë jap dëshmi, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Kjo është çfarë i ndodhi Moisiut. Pas takimit të tij mbresëlënës me Perëndinë, ai filloi ta shihte veten ndryshe – si bir i Perëndisë. Ky këndvështrim e ndihmoi t'i bënte ballë Satanit, i cili e quajti atë "biri i njeriut" (shih Moisiu 1:1–20). Shih edhe Tomas S. Monson, "Shihini të Tjerët ashtu siç Mund të Bëhen", *Liahona*, nëntor 2012, f. 68–71; Dejl G. Renland, "Nëpërmjet Syve të Perëndisë", *Liahona*, nëntor 2015, f. 93–94.
2. Thomas S. Monson, mbledhje e udhëheqjes së konferencës së përgjithshme, mars 2011.
3. Shih Dejl G. Renland, "Priftëria dhe Fuqia Shlyese e Shpëtimtarit", *Liahona*, nëntor 2017, f. 64–67.
4. Shih 2 Nefi 31–32; 3 Nefi 11:30–41; 27:13–21; Ethëri 4:18–19; Moisiu 6:52–68; 8:24.
5. Moroni 10:32; shih edhe *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2004), f. 6.
6. Shih Doktrina e Besëlidhje 13:1; 84:26–27; 107:20.
7. Romakëve 10:14–15, 17. Jozef Smithi e dha mësim po këtë të vërtetë: "Besimi vjen nga dëgjimi i fjalës së Perëndisë, përmes dëshmisë së shërbëtorëve të Perëndisë; ajo dëshmi shoqërohet gjithmonë nga Shpirti i profecisë dhe i zbulësës" (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 411).
8. Moroni 7:22; shih Alma 12:28–30; 13:21–24; 32:22–23; 39:17–19; Helamani 5:11; Moroni 7:21–25, 29–32; Doktrina e Besëlidhje 20:35; 29:41–42; Moisiu 5:58; shih edhe Mateu 28:19; Romakëve 10:13–17.
9. Shih George Q. Cannon, *Gospel Truth*, përzgj. Jerrel L. Newquist (1987), f. 54.
10. Shih James Strong, *The New Strong's Exhaustive Concordance of the Bible* (1984), seksioni i fjalorit të hebraishtes dhe kaldeishtes, f. 66, seksioni i fjalorit të greqishtes, f. 7.
11. Doktrina e Besëlidhje 20:59.
12. Shih Henri B. Ajring, "Që Ai të Mund të Forcohet Gjithashtu", *Liahona*, nëntor 2016, f. 75–78; Alma 17:3; Helamani 5:18; 6:4–5; Doktrina e Besëlidhje 28:3.
13. Shih 1 Gjon 2:14; Alma 17:2; 26:13; 32:42. *Plotësoj një Detyrë ndaj Perëndisë: Për Mbajtësit e Priftërisë Aaronë* është një mjet i vlefshëm që vjen në ndihmë për ta përbushur këtë gjë.
14. Doktrina e Besëlidhje 11:21; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 84:85.
15. Shih 2 Nefi 32:3; Doktrina e Besëlidhje 42:14; 50:17–22.
16. Shih Moroni 7:25.
17. Russell M. Nelson, "Honoring the Priesthood", *Ensign*, maj 1993, f. 40; shih edhe Alma 27:4.
18. Shih Alma 34:17; Helamani 14:13.
19. Doktrina e Besëlidhje 84:27.
20. Shih Doktrina e Besëlidhje 20:46, 51–59, 73–79. *Plotësoj një Detyrë ndaj Perëndisë: Për Mbajtësit e Priftërisë Aaronë* është një mjet i vlefshëm për të na ndihmuar të kuptojmë detyrat tona.
21. Gordon B. Hinckley, "The Aaronic Priesthood—a Gift from God", *Ensign*, maj 1988, f. 46.
22. Plaku D. Tod Kristoferson shpjegoi: "Pagëzimi me ujë është hapi përfundimtar ose kurorëzues për procesin e pendimit. Heqja dorë nga mëkati, e shoqëruar me besëlidhjen tonë të bindjes, e përfundon pendimin tonë; në të vërtetë, pendimi mbetet i pambaruar pa atë besëlidhje" ("Building Faith in Christ", *Ensign*, shtator 2012, f. 14–15). Shih edhe D. Tod Kristoferson, "Dhurata Hyjnore e Pendimit", *Liahona*, nëntor 2011, f. 38–41; Përkthimi prej Joseph Smith-it, Mateu 26:24 (në Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta).
Ordinanca e sakramentit na jep "mundësi çdo javë për t'i ripërtërirë besëlidhjet e shenjtja që na lejojnë të jemi pjesëmarrës të hirit shlyes të Shpëtimtarit me të njëjtin ndikim pastrues të pagëzimit dhe konfirmimit nga ana shpirtërore" ("Understanding Our Covenants with God", *Liahona*, korrik 2012, f. 21). Shih edhe Dallin H. Oaks, "Always Have His Spirit", *Ensign*, nëntor 1996, f. 59–61.
23. Dallin H. Oaks, "The Aaronic Priesthood and the Sacrament", *Liahona*, janar 1999, f. 44.
24. Plaku Dejvid A. Bednar shpjegoi: "Ordinancat e shpëtimtimit dhe të ekzaltimit, të administruara në Kishën e rivendosur të Zotit, janë shumë më tepër sesa kryerje rituale apo simbolike. Përkundrazi, ato përbëjnë kanalet e autorizuara nëpërmjet të cilave bekimet dhe fuqitë e qiellit mund të rrjedhin brenda jetës sonë individuale" ("Gjithmonë Mbani një Heqje të Mëkateve Tuaja", *Liahona*, maj 2016, f. 60).
25. Doktrina e Besëlidhje 20:73.
26. Moisiu 1:39.
27. Mateu 3:11.
28. Shumë udhëheqës të Kishës e kanë përcaktuar Frymën e Shenjtë si dhuratën më të madhe të vdekshmërisë.
Presidenti Dallin H. Oaks tha: "Që të kemi shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë është zotërimi më i çmuar që mund ta kemi në vdekshmëri" ("The Aaronic Priesthood and the Sacrament", *Liahona*, janar 1999, f. 44).
Plaku Brus R. Mek-Konki dha mësim: "Duke folur nga këndvështrimi i përjetësisë, jeta e përjetshme është më e madhja nga të gjitha dhuratat e Perëndisë. Por duke e ngushtuar këndvështrimin vetëm te kjo jetë, dhurata e Frymës së Shenjtë është dhurata më e madhe që mund të gëzojë një njeri i vdekshëm" ("What Is Meant by 'The Holy Spirit'?" *Instructor*, shkurt 1965, f. 57).
Presidenti Uillford Udraf dëshmoi: "Nëse e keni Frymën e Shenjtë me ju – dhe çdonjëri duhet ta ketë – unë mund t'ju them se nuk ka dhuratë më të madhe, nuk ka bekim më të madh, nuk ka dëshmi më të madhe të dhënë ndonjë njeriu në tokë. Mund ta keni administrimin e engjëjve; mund të shihni shumë mrekulli; mund të shihni shumë çudira në tokë; por ju shpall se dhurata e Frymës së Shenjtë është dhurata më e madhe që mund t'i jepet njeriut" (*Teachings of Presidents of the Church: Wilford Woodruff* [2004], f. 49).
Dhe Plaku Dejvid A. Bednar shtoi: "Urdhërimet nga Perëndia që u bindemi, dhe këshilla e frymëzuar nga udhëheqësit e Kishës që e ndjekim, përqendrohen kryesisht mbi sigurimin e shoqërimt të Shpirtit. Në thelb, të gjitha mësimet dhe aktivitetet e ungjillit qëndërohen në vajten te Krishti duke marrë Frymën e Shenjtë në jetën tonë" ("Merrni Frymën e Shenjtë", *Liahona*, nëntor 2010, f. 97).
29. Thomas S. Monson, mbledhje e udhëheqjes së konferencës së përgjithshme, mars 2011.
30. Shih Moisiu 1:6.





Nga Presidenti Rasëll M. Nelson

Fjalët Paraqitëse

Ne shpallim një ristrukturim të rëndësishëm të kuorumeve tona të Priftërisë Melkizedeke, që ta përmbushim punën e Zotit në mënyrë më të efektshme.

Falenderit, Vëllai Holms, për mesazhin tuaj të rëndësishëm.

Të dashur vëllezër, na merr thellësisht malli për Presidentin Tomas S. Monson dhe Plakun Robert D. Hejls. Prapëseprapë ne “punës s’Zotit të gjith’ le t’i vihemi”¹.

Jam shumë mirënjohës për secilin burrë që mban priftërinë e shenjtë. Ju jeni shpresa e Shëlbuesit tonë, i cili dëshiron “që çdo njeri të mund të flasë në emër të Perëndisë, Zotit, madje Shpëtimtarit të botës”². Ai do që *të gjithë* bijtë e Tij të shuguruar ta përfaqësojnë Atë, të flasin për Të, të veprojnë për Të dhe ta bekojnë jetën e fëmijëve të Perëndisë anembanë botës, me qëllim që “besimi gjithashtu të mund të rritet në [të gjithë] tokën”³.

Disa prej jush shërbejnë atje ku Kisha ka qenë e ngritur për shumë breza. Të tjerë shërbejnë atje ku Kisha është relativisht e re. Për disa, lagjet tuaja janë të mëdha. Për të tjerë, degët tuaja janë të vogla dhe largësia është e madhe. Pavarësisht nga rrethanat tuaja individuale, secili prej jush është anëtar i një kuorumi priftërie me një mandat hyjnor për të mësuar dhe për të dhënë mësim, për t’i dashur të tjerët dhe për t’u shërbyer atyre.

Sonte ne shpallim një ristrukturim

të rëndësishëm të kuorumeve tona të Priftërisë Melkizedeke, që ta përmbushim punën e Zotit në mënyrë më të efektshme. *Në çdo lagje, priftërinjtë e lartë dhe pleqtë tani do të bashkohen në një kuorum pleqsh.* Kjo përshtatje do ta rritë më shumë aftësinë dhe mundësinë e burrave që mbajnë priftërinë për t’u shërbyer të tjerëve. Pleqtë e ardhshëm do të mirëpritën dhe do të shoqërohen nga ai kuorum. Në çdo kunj, presidenca e kunjit do të vazhdojë të kryesojë mbi kuorumin e priftërinjve të lartë të kunjit. Por përbërja e atij kuorumi do të bazohet në thirrjet *e tanishme* të priftërisë, siç do të shpjegohen më vonë.

Plaku D. Tod Kristoferson dhe Plaku Ronald A. Rasband, të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, do të na mësojnë tani më shumë rreth këtyre përshtatjeve të rëndësishme.

Këto modifikime kanë qenë në studim për shumë muaj. Ne kemi ndier një nevojë të ngutshme për ta përmirësuar mënyrën se si kujdesemi për anëtarët tanë dhe se si i raportojmë kontaktet tona me ta. Që ta bëjmë atë më mirë, na nevojitet t’i forcojmë kuorumet tona të priftërisë për t’i dhënë drejtim më të madh dhënies së shërbesës së dashurisë dhe përkrahjes, të cilën Zoti e ka si qëllim për shenjtoret e Tij.

Këto përshtatje janë frymëzuar nga Zoti. Teksa i vëmë në zbatim, ne vërtet do të jemi edhe më frytdhënës sesa kemi qenë ndonjëherë më parë.

Ne jemi të përfshirë në punën e Perëndisë së Plotfuqishëm. Jezusi është Krishti! Ne jemi shërbëtorët e Tij të përlulur! Perëndia ju bekoftë, vëllezër, teksa mësojmë për detyrën tonë dhe e bëjmë atë, unë lutem në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. “Punës Le t’i Vihemi”, *Himne*, nr. 154.
2. Doktrina e Besëlidhje 1:20.
3. Doktrina e Besëlidhje 1:21.





Nga Plaku D. Tod Kristoferson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Kuorumi i Pleqve

Pasja e një kuorumi të Priftërisë Melkizedeke në lagje krijon unitet te mbajtësit e priftërisë për t'i përmbushur të gjitha aspektet e punës së shpëtimit.

J o shumë kohë pasi u organizua Kisha në këtë periudhë të fundit ungjillore, Zoti tha në një zbulësë: “Dhe nëpërmjet lutjes së besimit tuaj ju do të merrni ligjin tim, që të mund të dini si të qeverisni kishën time dhe t’i keni të gjitha gjërat siç duhet përpara meje”¹. Ky parim është ndjekur në Kishë – dhe ai premtim është nderuar nga Zoti – që nga ajo kohë. Modellet për organizimin dhe shërbimin e priftërisë janë zbuluar herë pas here duke nisur me Profetin Jozef Smith kur u krijuan detyrat dhe kuorumet e priftërisë në kohën tonë. Përmirësime të rëndësishme u zbuluan dhe u vunë në zbatim gjatë kohës së shërbimit të Presidentëve Brigam Jang, Xhon Tejlor dhe Spenser W. Kimball, mes të tjerëve, lidhur me Kuorumin e Të Dymbëdhjetëve, Të Shtatëdhjetët, priftërinjtë e lartë, detyrat dhe kuorumet e tjerë si në Priftërinë Melkizedeke ashtu edhe në Priftërinë Aarone.² Tani, në një deklaratë historike vetëm pak çaste më parë, Presidenti Rasëll M. Nelson shpalli një përshtatje të mëtejshme jetike.

Nëse mund ta përsërit një pjesë të deklaratës të tij: “Sonte ne shpallim një ristrukturim të rëndësishëm të kuorumeve tona të Priftërisë Melkizedeke, që ta përmbushim punën e Zotit në

mënyrë më të efektshme. *Në çdo lagje, priftërinjtë e lartë dhe pleqtë tani do të bashkohen në një kuorum pleqsh . . . [dhe] përbërja e . . . kuorumi[t të priftërinjve të lartë të kunjit] do të bazohet në thirrjet e tanishme të priftërisë.”*

Presidenti Nelson shtoi:

“Këto modifikime kanë qenë në studim për shumë muaj. Ne kemi ndier një nevojë të ngutshme për ta përmirësuar mënyrën se si kujdesemi për anëtarët tanë. . . . Që ta bëjmë atë më mirë, na nevojitet t’i forcojmë kuorumet tona të priftërisë për t’i dhënë drejtim

më të madh dhënies së shërbesës së dashurisë dhe përkrahjes, të cilën Zoti e ka si qëllim për shenjtoret e Tij.

Këto përshtatje janë frymëzuar nga Zoti. Teksa i vëmë në zbatim, ne vërtet do të jemi edhe më frytdhënës sesa kemi qenë ndonjëherë më parë.”³

Nën drejtimin e Presidencës së Parë, unë dhe Plaku Ronald A. Rasband do të shtojmë disa hollësi që kemi besim se do t’u japin përgjigje pyetjeve që mund të keni.

Kuorumet e Pleqve dhe të Priftërinjve të Lartë

Së pari, për ta ritheksuar, cilat janë përshtatjet për grupet e priftërinjve të lartë dhe kuorumet e pleqve të lagjeve? Në lagjet, anëtarët e kuorumit të pleqve dhe të grupit të priftërinjve të lartë do të bashkohen tani në një kuorum të Priftërisë Melkizedeke me një presidencë kuorumi. Ky kuorum, me numër anëtarësh dhe unitet më të madh, do të emërtohet “kuorumi i pleqve”. Grupeve të priftërinjve të lartë u ndërpritet funksionimi. Kuorumi i pleqve përfshin të gjithë pleqtë, pleqtë e ardhshëm në lagje si edhe priftërinjtë e lartë të cilët *nuk*





janë duke shërbyer në këtë kohë në peshkopatë, në presidencën e kunjit, në këshillin e lartë ose si patriarkë veprues. Kuorumi i priftërinjve të lartë në kunj do të përbëhet nga ata priftërinj të lartë që *janë* duke shërbyer në presidencën e kunjit, në peshkopata, në këshillin e lartë dhe si patriarkë veprues.

Presidenca e Kuorumit të Pleqve

Si duhet të organizohet presidenca e kuorumit të pleqve? Presidenca e kunjit do t'i lirojë nga detyra udhëheqësit e tanishëm të grupeve të priftërinjve të lartë dhe presidencat e kuorumeve të pleqve dhe do të thërrasë një president të ri dhe këshilltarë të rinj të kuorumit të pleqve në secilën lagje. Presidenca e re e kuorumit të pleqve mund të përfshijë pleq dhe priftërinj të lartë, nga mosha dhe përvoja të ndryshme, duke shërbyer së bashku në një presidencë kuorumi. Një plak apo një prift i lartë mund të shërbejë si presidenti i kuorumit ose si këshilltar në presidencë. Kjo nuk është një “marrje nën kontroll” e

kuorumeve të pleqve nga priftërinjtë e lartë. Ne presim që pleqtë dhe priftërinjtë e lartë të punojnë së bashku në çfarëdo ndërthurjeje në presidencën e kuorumit dhe në shërbimin e kuorumit. Këto përshtatje të kuorumit duhet të vihen në zbatim sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të volitshme.

Detyrat e Priftërisë në Kuorumin e Pleqve

A e ndryshon kjo përshtatje në strukturën e kuorumit detyrën e priftërisë të mbajtur nga anëtarët e kuorumit? Jo, ky veprim nuk anulon asnjë detyrë priftërie në të cilën mund të jetë shuguruar në të shkuarën cilido anëtar i kuorumit. Siç e dini, një burrë mund të shugurohet në detyra të ndryshme të priftërisë gjatë gjithë jetës së vet dhe ai nuk e humbet ose shfuqizon ndonjë shugurim të mëparshëm kur merr një shugurim të ri. Ndërkohë që në disa raste një mbajtës i priftërisë mund të shërbejë në më shumë se një detyrë në një kohë të caktuar, siç është kur një prift i lartë shërben gjithashtu si patriark ose si peshkop, ai

praktikisht nuk ka funksion në të gjitha detyrat e tij të priftërisë në të njëjtën kohë. Peshkopët dhe Të Shtatëdhjetët, për shembull, nuk shërbejnë në mënyrë aktive në ato detyra kur lirohen ose bëhen anëtarë nderi. Prandaj, pavarësisht nga detyra ose detyrat e tjera të priftërisë që mund të mbajë një burrë, ndërkohë që është anëtar i kuorumit të pleqve, ai shërben si një plak.

Vite më parë, Presidenti Bojd K. Parker vërejti se “priftëria është më e madhe sesa cilado prej detyrave të saj. . . . Priftëria nuk mund të ndahet. Një plak mban po aq shumë priftëri sa mban një Apostull. (Shih DeB 20:38.) Kur një burri [i është dhënë priftëria], ai e merr atë të gjithën. Gjithsesi ka detyra brenda priftërisë – ndarje të autoritetit dhe të përgjegjësive. . . . Nganjëherë për një detyrë flitet se është ‘më e lartë se’ ose ‘më e ulët se’ një detyrë tjetër. Në vend që të jenë të ‘më të larta’ ose ‘më të ulëta’, detyrat në Priftërinë Melkizedeke përfaqësojnë fusha të ndryshme të shërbimit.”⁴ Vëllezër, unë sinqerisht shpresoj se ne nuk do të flasim më për “ngritjen në rang” në një detyrë tjetër në Priftërinë Melkizedeke.

Pleqtë do të vazhdojnë të shugurohen priftërinj të lartë kur ata thirren në një presidencë kunj, në këshillin e lartë ose në peshkopatë – ose në raste të tjera siç përcaktohet nga presidenti i kunjit nëpërmjet vlerësimit dhe frymëzimit plot lutje. Kur të përmbillen periudhat e tyre të shërbimit në një presidencë kunj, në këshillin e lartë ose në peshkopatë, priftërinjtë e lartë do të bashkohen sërish me kuorumin e pleqve në lagjen e tyre.

Udhëzim për Presidentin e Kuorumit të Pleqve

Kush e drejton punën e presidentit të kuorumit të pleqve? Presidenti i kunjit kryeson mbi Priftërinë Melkizedeke

në kunjën e tij. Si rrjedhim, presidenti i kuorumit të pleqve është drejtpërsëdrejti i përgjegjshëm ndaj presidentit të kunjës, i cili siguron trajnim dhe udhërrëfim nga presidenca e kunjës dhe nëpërmjet këshillit të lartë. Peshkopi, si prifti i lartë kryesues në lagje, gjithashtu takohet rregullisht me presidentin e kuorumit të pleqve. Peshkopi këshillohet me të dhe i jep udhëzimin e duhur lidhur me mënyrën se si t'u shërbehet më mirë anëtarëve të lagjes dhe të bekohen më shumë ata, duke punuar në harmoni me të gjitha organizatat e lagjes.⁵

Qëllimi i Këtyre Ndryshimeve

Cilat janë qëllimet e përshtatjeve në kuorumet e Priftërisë Melkizedeke? Pasa e një kuorumi të Priftërisë Melkizedeke në lagje krijon unitet të mbajtësive të priftërisë për t'i përmbushur të gjitha aspektet e punës së shpëtimit, përfshirë punën në tempull dhe punën e historisë familjare, që më parë bashkërendoheshin nga grupet e priftërinjve të lartë. Kjo u lejoi anëtarëve të kuorumit të të gjitha moshave dhe prejardhjeve që të përfitojnë nga këndvështrimi dhe përvoja e njëri-tjetrit dhe e atyre që janë në etapa të ndryshme të jetës. Kjo siguron gjithashtu mundësi shtesë që mbajtësive të priftërisë me përvojë t'i këshillojnë të tjerët, përfshirë pleqtë e ardhshëm, anëtarët e rinj, të rinjtë në moshë madhore dhe ata që po kthehen në aktivitet në Kishë. Nuk mund ta shpreh sa duhet sesa i emocionuar jam kur mendoj thellë për rolin jetik në rritje që kuorumet e pleqve do të luajnë në të ardhmen. Urtësia, përvoja, aftësia dhe forca që do të gjenden në këto kuorume, kumtojnë një fillim të ri dhe një standard të ri të shërbimit priftëror anëmbanë Kishës.

Njëzet vjet më parë në konferencën e përgjithshme, unë tregova një histori që fillimisht u tregua nga Plaku Von J.

Fedherston, i Të Shtatëdhjetëve, të cilën besoj se ia vlen të përsëritet këtu.

Në vitin 1918 Vëllai Xhorxh Gouts ishte një fermer që rriste panxhar sheqeri në Lihaj të Jutës. Dimri erdhi herët atë vit dhe i ngriu shumicën e bimëve të panxharit në tokë. Për Xhorxhin dhe djalin e tij të vogël, Frensisin, mbledhja e prodhimit ishte e ngadaltë dhe e vështirë. Ndërkohë, një epidemi gripi po përhapej shumë. Sëmundja e frikshme i mori jetën birit të Xhorxhit, Çarlsit, dhe tre fëmijëve të vegjël të Çarlsit – dy vajzave dhe një djali të vogël. Brenda vetëm gjashtë ditëve, Xhorxh Gouts i vrerosur bëri tre udhëtime të veçanta drejt Ogdenit të Jutës, që të sillte trupat në shtëpi për t'u varrosur. Në fund të kësaj periudhe të tmerrshme kohore, Xhorxhi dhe Frensis i mbrehën kuajt në karrocën e tyre dhe morën rrugën drejt fushës së panxharit.

“[Në udhë e sipër] përballë tyre kaluan njëra pas tjetrës karroca të ngarkuara me panxhar, të cilat po shkonin drejt fabrikës dhe drejtoreshin nga fermerë fqinjë. Teksa u kalonte pranë, secili karrocier do të dërgonte një përshëndetje: ‘Tungjatjeta, xhaxha Xhorxh’, ‘Na vjen vërtet keq, Xhorxh’, ‘Tronditje e fortë, Xhorxh’, ‘Ke shumë miq, Xhorxh’.

Në karrocën e fundit ishte . . . Xhaspër Rolfi me fytyrën plot quka. Ai bëri një përshëndetje të gëzueshme me dorë dhe thirri: ‘Ka q panxhar ka, xhaxha Xhorxh’.

[Vëllai Gouts] iu kthye Frensisit dhe tha: ‘Sikur të ishte i gjithi yni’.

Kur mbërritën te porta e fermës, Frensis i hodhi nga karroca e madhe, e kuqërremtë e panxharit dhe hapi portën ndërkohë që [babai i tij] e çoi karrocën në fushë. [Xhorxhi] i tërhoqi frerët, e ndali çiftin e kuajve . . . dhe i hodhi një vështrim të shpejtë fushës. . . . Nuk kishte asnjë panxhar sheqeri në tërë fushën. Atëherë ai e kuptoi se çfarë

donte të thoshte Xhaspër Rolfi kur thirri: ‘Ka q panxhar ka, xhaxha Xhorxh!’

[Xhorxhi] zbriti nga karroca, mori një grusht dheu të pasur, ngjyrë kafe, që e donte kaq shumë, dhe më pas . . . një bimë panxhari dhe i vështroi për një çast këto simbole të punës së tij, sikur të mos u besonte syve të vet.

Atëherë u ul mbi një grumbull bimësh panxhari – ky burrë që ktheu në shtëpi katër prej njerëzve të tij të dashur për t'u varrosur në një periudhë prej vetëm gjashtë ditësh; që bëri arkivole, gërmoi varre dhe madje ndihmoi me rrobat e varrimit – ky burrë mahnitës, i cili kurrë nuk kishte ngurruar, nuk ishte zbrapsur, as lëkundur gjatë gjithë kësaj sprove pikëlluese – u ul mbi një grumbull bimësh panxhari dhe qau me dënësë si fëmijë i vogël.

Më pas u ngrit në këmbë, i fshiu sytë, . . . hodhi vështrimin drejt qiellit dhe tha: ‘Faleminderit, Atë, për pleqtë e lagjes sonë.’⁶

Po, falënderim i qoftë Perëndisë për burrat e priftërisë dhe për shërbimin që ende do të japin në lartësimin e individëve e familjeve dhe në ngritjen e Sionit.



Presidenca e Parë, Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve dhe Presidenca e Të Shtatëdhjetëve i kanë marrë në shqyrtim këto përshtatje për një periudhë të gjatë kohe. Me shumë lutje, me studim të kujdesshëm të themeleve nga shkrimet e shenjta për kuorimet e priftërisë dhe me miratimin se ky është vullneti i Zotit, ne po shkojmë përpara njëzëri në atë që është më të vërtetë një hap më shumë në shpalljen e Rivendosjes. Udhëzimi i Zotit është shprehur dhe unë gëzohem në të, teksa jap dëshmi për Të, priftërinë e Tij dhe shugurimet tuaja në atë priftëri, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 41:3.
2. Shih, për shembull, William G. Hartley, "The Priesthood Reorganization of 1877: Brigham Young's Last Achievement", në *My Fellow Servants: Essays on the History of the Priesthood* (2010), f. 227–264; "To the Seventies", në James R. Clark, përmb., *Messages of the First Presidency of The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints* (1965), f. 352–354; Hartley, "The Seventies in the 1880s: Revelations and Reorganizing", në *My Fellow Servants*, f. 265–300; Edward L. Kimball, *Lengthen Your Stride: The Presidency of Spencer W. Kimball* (2005), f. 254–258; Susan Easton Black, "Early Quorums of the Seventies", në David J. Whittaker dhe Arnold K. Garr, red., *A Firm Foundation: Church Organization and Administration* (2011), f. 139–160; Richard O. Cowan, "The Seventies' Role in the Worldwide Church Administration", në *A Firm Foundation*, f. 573–593.
3. Rasëll M. Nelson, "Fjalët Paraqitëse", *Liahona*, maj 2018, f. 54.
4. Boyd K. Packer, "What Every Elder Should Know—and Every Sister as Well: A Primer on Principles of Priesthood Government", *Tambuli*, nëntor 1994, f. 17, 19.
5. Shih *Handbook 2: Administering the Church [Manuali 2: Administrimi i Kishës]* (2010), 7.3.1.
6. D. Todd Christofferson, "The Priesthood Quorum", *Liahona*, janar 1999, f. 47; shih edhe Vaughn J. Featherstone, "Now Abideth Faith, Hope, and Charity", *Ensign*, korrik 1973, f. 36–37.



Nga Plaku Ronald A. Rasband,
i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve

Shih! Një Ushtri Mbret'rore

Çfarë gëzimi do të jetë për të gjithë mbajtësit e Priftërisë Melkizedeke të kenë bekimin që të japin mësim, të mësojnë e të shërbejnë krah për krah!

Vëllezërit e mi të dashur në priftëri, është me përlësi të madhe që qëndroj përpara jush në këtë rast historik, me detyrë të caktuar nga profeti dhe Presidenti ynë i dashur, Rasëll M. Nelson. Sa e dua dhe e mbështet këtë burrë të mrekullueshëm të Perëndisë dhe Presidencën tonë të Parë të re! Ia shtoj dëshminë time asaj të Plakut D. Tod Kristoferson dhe Vëllezërve të mi të tjerë të Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve se ndryshimet e lajmëruara këtë mbrëmje janë vullneti i Zotit.

Siç u tha nga Presidenti Nelson, kjo është një çështje që është diskutuar dhe marrë në shqyrtim plot lutje nga Vëllezërit kryesues të Kishës për një kohë të gjatë. Dëshira ishte që të kërkonim vullnetin e Zotit dhe t'i forconim kuorimet e Priftërisë Melkizedeke. Frymëzimi u mor dhe këtë mbrëmje profeti ynë e bëri të njohur vullnetin e Zotit. "Sepse Zoti [Perëndi], nuk bën asgjë, pa ua treguar sekretin e tij shërbëtorëve të tij, profetëve!"¹ Sa të bekuar jemi që kemi një profet të gjallë sot!

Gjatë gjithë jetës sonë, unë dhe Motra Rasband kemi udhëtuar nëpër botë me detyra të ndryshme të Kishës dhe profesionale. Kam parë pothuaj

çdo lloj trajte njësisht në Kishë: një degë të vogël në Rusi ku numri i anëtarëve të Priftërisë Melkizedeke mund të numërohej me gishtat e një dore, një lagje të re dhe në rritje në Afrikë ku edhe priftërinjtë e lartë edhe pleqtë takohehin si një trup i vetëm ngaqë numri i përgjithshëm i mbajtësve të Priftërisë Melkizedeke ishte i ulët, dhe lagje të organizuara mirë ku numri i pleqve kërkonte ndarjen e kuorunit të tyre në dy kuorume!



Kudo që kemi shkuar, e kemi dëshmuar dorën e Zotit duke shkuar përpara shërbëtorëve të Tij, duke i përgatitur paraprkisht njerëzit dhe udhën në mënyrë që të gjithë fëmijët e Tij të mund të bekohen sipas çdo nevoje që kanë. A nuk na ka premtuar Ai se “do të shkojë përpara fytyrës s[onë]” dhe do të “jeltë] në të djathtën e në të majtën t[onë]” dhe se “Shpirti [i Tij] do të jetë në zemrat t[ona] e engjëjt e [Tij] përreth [nesh]”?²

Duke menduar për të gjithë ju, më vjen në mendje himni, “Shih! Një Ushtri Mbret’rore”.

*Shih! Një ushtri mbret’rore,
Me shpata dhe flamuj’,
Po marshon për fitore
Sot në t’jetës betej’.
E mbushur plot ushtarë,
T’bashkuar dhe të fort’,
Që ndjekin Komandantin
Dhe me gëzim këndojn’.*³

Plaku Kristoferson u ka dhënë përgjigje disa pyetjeve që me siguri do të ngrihen nga lajmërimi se grupet e priftërinjve të lartë dhe të kuorumeve të pleqve, në nivel lagjeje, po bashkohen në një ushtri të bashkuar, të fuqishme të vëllezërve të Priftërisë Melkizedeke.

Këto përshtatje do t’i ndihmojnë kuorumet e pleqve dhe Shoqatat e Ndhimës që ta harmonizojnë punën e tyre. Ato gjithashtu do ta thjeshtojnë bashkërendimin e kuorumit me peshkopatën dhe këshillin e lagjes. Dhe ato e lejojnë peshkopin që t’u delegojë më shumë përgjegjësi presidentit të kuorumit të pleqve dhe presidentes së Shoqatës së Ndhimës, në mënyrë që peshkopi dhe këshilltarët e tij të mund të përqendrohen te detyrat e tyre kryesore – veçanërisht te kryesimi mbi të rejtat dhe të rinjtë që mbajnë Priftërinë Aarone.

Ndryshimet në organizatat dhe funksionet e Kishës nuk janë të pazakonta.



Në vitin 1883, Zoti i tha Presidentit Xhon Tejlor: “[Lidhur] me administrimin dhe organizimin e Kishës dhe të Priftërisë sime . . . unë do t’ju zbuloj, herë pas here, nëpërmjet kanaleve që kam caktuar, çdo gjë që do të jetë e nevojshme për zhvillimin dhe përsosjen e ardhshme të Kishës sime, për përshtatjen dhe çuarjen përpara të mbretërisë sime”⁴.

Tani, ca fjalë për ju, vëllezër, që jeni priftërinj të lartë – dijeni se ju duam! Ati ynë në Qiell ju do! Ju jeni një pjesë e madhe e ushtrisë mbretërore të priftërisë dhe ne nuk mund ta çojmë përpara këtë punë pa mirësinë, shërbimin, përvojën dhe drejtësinë tuaj. Alma dha mësim se burrat thirren për të qenë priftërinj të lartë për shkak të besimit të tyre të jashtëzakonshëm dhe veprave të mira që t’u japin mësim dhe shërbesë të tjerëve.⁵ Ajo përvojë nevojitet tani ndoshta më shumë se kurrë.

Në shumë lagje, ne mund të kemi priftërinj të lartë që tani do të kenë mundësinë të kryesohen nga një plak si president i kuorumit të tyre. Ne kemi një praktikë të mëparshme të pleqve që kryesojnë mbi priftërinjtë e lartë: pleqtë aktualisht po shërbejnë si presidentë degësh në disa rajone të botës ku në

degë banojnë priftërinj të lartë, dhe ka degë në të cilat është organizuar vetëm një kuorum pleqsh dhe priftërinjtë e lartë janë të pranishëm.

Çfarë gëzimi do të jetë për të gjithë mbajtësit e Priftërisë Melkizedeke që të kenë bekimin e mësimdhënies, mësimi dhe shërbimit krah për krah me të gjithë anëtarët në lagjen e tyre! Kudo që jeni dhe cilatdo qofshin rrethanat tuaja, ne ju ftojme që plot lutje, besim e gëzim të pranoni mundësi të reja për të udhëhequr ose që të udhëhiqeni dhe të shërbeni bashkërisht si një trup i vëllezërve të priftërisë.

Tani do të flas për çështje të tjera, të cilat mund të kenë nevojë të sqarohen, ndërsa shkojmë përpara për ta vënë në zbatim vullnetin e Zotit lidhur me organizimin e kuorumeve të Tij të priftërisë së shenjtë.

Cilat janë përshtatjet për një kuorum të priftërinjve të lartë të kunjit? Kuorumet e priftërinjve të lartë të kunjit do të vazhdojnë të funksionojnë. Presidentat e kunjeve do të vazhdojnë të shërbejnë si presidenca të kuorumit të priftërinjve të lartë të kunjit. Gjithsesi, siç u vu në dukje nga Plaku Kristoferson, anëtarët e kuorumit të priftërinjve të lartë të



kunjtit do të përbëhen tani nga priftërinj të lartë që po shërbejnë *aktualisht* në presidencën e kunjtit, si anëtarë të peshkopatës së një lagjeje, si anëtarë të këshillit të lartë të kunjtit dhe si patriarku veprues. Nëpunësit dhe sekretarët ekzekutivë të lagjeve dhe të kunjeve nuk janë anëtarë të kuorumit të priftërinjve të lartë të kunjtit. Kur dikush që po shërben aktualisht si prift i lartë, patriark, I Shtatëdhjetë apo Apostull, e viziton një lagje dhe të dëshiron të marrë pjesë në mbledhjen e priftërisë, ai do të shkojë te kuorumi i pleqve.

Kur vëllezërit në këto thirrje të lirohen në kohën e duhur, ata do të kthehen në njësitë e tyre bazë si anëtarë të kuorumit të pleqve.

Cili është *rol* i kuorumit të priftërinjve të lartë të kunjtit? Presidenca e kunjtit mbledhet me anëtarë të kuorumit të priftërinjve të lartë për t'u këshilluar së bashku, për të dëshmuar dhe për të dhënë trajnim. Mbledhjet e kunjtit siç përvijohen në manualët tona, do të vazhdojnë me dy përshtatje:

Një: Lagjet dhe kunjët nuk do të kenë më mbledhje të komitetit ekzekutiv të priftërisë. Nëse ngrihet një problem i veçantë në lagje, i tillë si një çështje delikate familjare apo një sfidë e pazakontë mirëqenieje, ai mund të trajtohet në një mbledhje të zgjeruar të peshkopatës. Çështje të tjera më pak të ndjeshme mund të trajtohen në këshillin e lagjes. Ajo që ka qenë e njohur si mbledhja e komitetit ekzekutiv të priftërisë së kunjtit tani do të quhet

“mbledhja e këshillit të lartë”.

Dy: Mbledhja vjetore e gjithë priftërinjve të lartë, të shuguruar në kunj nuk do të bëhet më. Megjithatë, presidenca e kunjtit do të vazhdojë të bëjë një mbledhje vjetore të kuorumit të priftërinjve të lartë të kunjtit siç u lajmërua sot.

A mund të ketë një lagje më shumë se një kuorum pleqsh? Përgjigjja është: “Po”. Në frymën e Doktrinës e Besëlidhjeve 107, vargut 89, kur një lagje ka një numër jashtëzakonisht të madh të mbajtësve aktivë të Priftërisë Melkize-deke, udhëheqësit mund të organizojnë më shumë se një kuorum pleqsh. Në raste të tilla, çdo kuorum duhet të ketë një drejtpeshim të arsyeshëm në bazë të moshës, përvojës, detyrës dhe fuqisë së priftërisë.

Dëshmoj se ndërsa shkojmë përpara me këtë ristrukturim të frymëzuar të kuorumeve në lagjet dhe kunjët tona, ne do të shohim një mori bekimesh. Më lejoni të citoj disa shembuj.

Nën drejtimin e peshkopit, më shumë burime të priftërisë mund të ndihmojnë me punën e shpëtimit. Kjo do të përfshinte mbledhjen e Izraelit nëpërmjet punës në tempull dhe të historisë familjare, punën me familjet dhe individët nevojtarë dhe ndihmën ndaj misionarëve për të sjellë shpirtin e Jezu Krishti.

Kur udhëheqësit e mëparshëm kryesues kthehen për të ndarë përvojën e tyre me kuorumin e pleqve, kjo do të rezultojë në një anëtarësi më të fortë në kuorum.

Do të ketë larmi më të madhe dhuratash dhe zotësish brenda kuorumit.

Do të ketë më shumë përshtatshmëri e gatishmëri për të plotësuar nevojat të tanishme dhe të ngutshme brenda lagjes e kuorumit dhe për përmbushjen e detyrave tona të ndryshme të dhënies së shërbesës.

Do të ketë këshillim dhe unitet më të madh teksa një plak i ri dhe një prift i lartë me përvojë tregojnë përvoja, krahas krahas, në mbledhjet dhe detyrat e kuorumit.

Shpresojmë se peshkopët dhe presidentët e degëve do të lehtësohen për të lartësuar thirrjet e tyre për të qenë barinj të tufave të tyre dhe për t'u dhënë shërbesë njerëzve në nevojë.

Ne e kuptojmë se çdo lagje dhe kunj është i ndryshëm. Ndërkohë që i kuptojmë këto ndryshime, ne jemi plot shpresë se ju do ta ndiqni ecurinë e këtyre ndryshimeve menjëherë pas kësaj konference të përgjithshme. Neve na është dhënë udhëzim nga një profet i Perëndisë! Çfarë bekimi dhe përgjegjësie e jashtëzakonshme! Le ta përmbushim atë me gjithë drejtësinë dhe zellin!

Ju kujtoj: autoriteti i priftërisë vjen me anë të veçimit dhe shugurimit, por fuqia e vërtetë e priftërisë, fuqia për të vepruar në emrin e Zotit Jezu Krisht, mund të vijë vetëm nëpërmjet të jetuarit me drejtësi.

Zoti i shpalli Profetit Jozef Smithit, profetit të Rivendosjes:

“Vini re dhe shihni, unë do të kujdesem për tufat tuaja dhe do të ngre pleq e do t'i dërgoj ata.

Vini re, unë do ta përshpejtoj veprën time në këtë kohë.”⁶

Me të vërtetë, kjo është një kohë kur Zoti po e përshpejton veprën e Tij.

Le ta përdorë secili prej nesh këtë mundësi për të reflektuar e për ta përmirësuar jetën e tij që të përputhet më mirë me vullnetin e Tij, që të mund

t'i meritojmë bekimet e shumta që Ai ua ka premtuar të vërtetëve dhe besnikëve.

Vëllezër, faleminderit për gjithçka që po bëni për të qenë pjesë e kësaj veprë madhështore. Shkofshim përpara në këtë kauzë të madhe e të nderuar!

*O, kur lufta t'mbarojë,
Përleshja të pushoj',
Kur që të gjith' të mblidhen
Nën vellon e paqes,
Para Mbretit t'përrjetshëm,
Ai grup i fuqishëm
Emrin e Tij e laud'ron
Dhe këtë këng' këndon:*

*Fitore, fitore,
Përmes Shëlbuesit ton!
Fitore, fitore,
Përmes Krishtit, Zotit!
Fitore, fitore, fitore,
Përmes Krishtit, Zotit!*

Sot të gjithë ne qëndrojmë si dëshmitarë se Zoti po e zbulon vullnetin e Tij nëpërmjet profetit të Tij, Presidentit Rasëll M. Nelson. Dëshmoj se ai është profeti i Perëndisë këtu në tokë. Unë jap dëshminë time për Zotin Jezu Krisht, i cili është Shëlbuesi dhe Shpëtimtari ynë i madh. Kjo është vepra e Tij dhe ky është vullneti i Tij, për të cilin unë jap dëshmi solemne, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Amos 3:7.
2. Doktrina e Besëlidhje 84:88.
3. Shih! Një Ushtri Mbret'rore", *Himne*, nr. 160.
4. Në James R. Clark, përmb., *Messages of the First Presidency of The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints* (1965) 2:354.
5. Shih Alma 13.
6. Doktrina e Besëlidhje 88:72–73.
7. "Shih! Një Ushtri Mbret'rore", *Himne*, nr. 160.



Nga Presidenti Henri B. Ajring,

Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Dhënia e Frymëzuar e Shërbesës

Ne e marrim më mirë Shpirtin e Shenjtë kur përqendrohemi te shërbimi ndaj të tjerëve. Kjo është arsyeja përse ne kemi përgjegjësinë priftërore për të shërbyer për Shpëtimtarin.

Vëllezërit e mi të dashur, jam mirënjohës për privilegjin që kam të flas me ju në këtë konferencë të përgjithshme historike. Ne e kemi mbështetur Presidentin Rasëll M. Nelson si Presidentin e 17-të të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ndërsa kam pasur bekimin të punoj me të çdo ditë, kam ndier një pohim nga Shpirti se Presidenti Nelson është thirrur nga Perëndia për të

udhëhequr Kishën e vërtetë të Zotit.

Është gjithashtu dëshmia ime se Zoti i ka thirrur Plakun Gerrit W. Gong dhe Plakun Ulises Soares që të shërbejnë si anëtarë të Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve. Unë i dua dhe i mbështet ata. Ata, me anë të shërbesës së tyre, do të bekojnë jetë njerëzish anembanë botës dhe përgjatë brezave.

Kjo konferencë është historike edhe për një arsye tjetër. Presidenti Nelson



ka shpallur një hap të frymëzuar përpara në planin e organizuar të Zotit për Kishën e Tij. Ai plan përfshin një strukturë të re për kuorumet e priftërisë në lagje dhe kunje, në mënyrë që ne të mund t'i përmbushim më mirë përgjegjësitë tona të priftërisë. Të gjitha ato përgjegjësi kanë të bëjnë me përkujdesjen tonë priftërore për fëmijët e Atit tonë.

Plani i Zotit që shenjtorët e Tij të japin përkujdesje me dashuri, ka marrë shumë trajta me kalimin e viteve. Në ditët e hershme të Navusë, Profetit Jozef Smith i nevojitej një mënyrë e organizuar që të kujdesej për vërshimin e të kthyerve në besim kryesisht të varfër që po vinin në qytet. Katër prej stërgjyshërve të mi ishin mes tyre – familjet Ajring, Benion, Romni dhe Smith. Profeti e organizoi përkujdesjen për ata shenjtorë sipas gjeografisë. Në Illinois, ato ndarje të qytetit quheshin “lagje”.

Ndërsa shenjtorët lëviznin përgjatë rrafshnaltave, përkujdesja e tyre për njëri-tjetrin u organizua në “kompani”. Njëri prej stërgjyshërve të mi nga babai po kthehej nga misioni i tij në atë që tani quhet Oklahoma, kur përgjatë shtegut u takua me një kompani. Ai që kaq i pafuqishëm për shkak të sëmundjes sa që ai dhe shoku i tij ishin shtrirë në një karrocë të vogël.

Udhëheqësi i kompanisë dërgoi dy të reja për të ndihmuar këdo që mund të ishte në atë karrocë të braktisur. Njëra prej tyre, një motër e re e cila ishte kthyer në besim në Zvicër, i hodhi një vështrim njërit prej misionarëve dhe ndjeu dhembshuri. Ai u shpëtua nga ajo kompani shenjtorësh. Ai u shërua aq sa të ecte për pjesën e mbetur të rrugës deri në luginën e Solt-Lejikut me shpëtuesen e tij të re përkrah tij. Ata ranë në dashuri dhe u martuan. Ai u bë stërgjyshi im, Henri Ajring, dhe ajo u bë stërgjyshja ime, Maria Bomeli Ajring.



Vite më vonë, kur njerëzit komentnin rreth vështirësisë së madhe për t'u zhvendosur përmes një kontinenti, ajo tha: “O, jo, nuk ishte e vështirë. Ndërkohë që ecnim, gjatë gjithë rrugës bisedonim se çfarë mrekullie ishte që të dy ne e kishim gjetur ungjillin e vërtetë të Jezu Krishtit. Ishte koha më e lumtur që mund të kujtoj”.

Që prej asaj kohe, Zoti ka përdorur një larmi mënyrash për t'i ndihmuar shenjtorët e Tij që të përkujdesen për njëri-tjetrin. Tani Ai na ka bekuar me kuorume të forcuara e të bashkuara në nivele lagjeje dhe kunji – kuorume që funksionojnë në bashkërendim me të gjitha organizatat e lagjes.

Lagje brenda bashkisë, kompani dhe kuorume të forcuara, që të gjitha kanë kërkuar të paktën dy gjëra për të qenë të suksesshme në synimin e Zotit që shenjtorët e Tij të përkujdesen për njëri-tjetrin në mënyrën se si Ai përkujdeset për ta. Ato ia dalin mbanë kur shenjtorët e ndiejnë dashurinë e Krishtit për njëri-tjetrin mbi interesin e tyre [vetjak]. Shkrimet e shenjta e quajnë atë “dashuria hyjnore . . . dashuria e pastër e Krishtit” (Moroni 7:47). Dhe ato ia dalin mbanë kur Fryma e Shenjtë e udhërrëfen kujdestarin që të dijë se ajo që Zoti di, është më e mira për personin që Ai po përpiqet të ndihmojë.

Herë pas here në javët e fundit, anëtarë të Kishës kanë vepruar në praninë time sikur t'i paraprinin në njëfarë mënyre asaj që Zoti do të bënte, ashtu siç është lajmëruar sot këtu. Më lejoni t'ju jap vetëm dy shembuj. I pari, një bisedë e thjeshtë në një mbledhje sakramenti nga një mësues 14-vjeçar në Priftërinë Aarone, i cili e kupton atë që mund të arrijnë mbajtësit e priftërisë në shërbimin e tyre për Zotin. I dyti, një mbajtës i Priftërisë Melkizedeke i cili, me dashurinë e Krishtit, u frymëzua që t'i shërbente një familjeje.

Fillimisht, më lejoni t'ju them fjalët e një të riu që po fliste në mbledhjen e sakramentit të një lagjeje. Isha i pranishëm. Përpiquni të kujtoni se si qetë ju kur ishit 14 vjeç dhe mbani vesh për ta dëgjuar atë të thotë më shumë se sa mund të dijë logjikisht një djalë kaq i ri:

“Më ka pëlqyer vërtet të jem anëtar i kuorumit të mësuesve në lagjen tonë qëkurse mbusha 14 vjeç vitin e kaluar. Një mësues ka ende të gjitha përgjegjësitë e një dhjaku duke shtuar disa të reja.

Meqenëse disa prej nesh janë mësues, dhe të tjerë do të jenë një ditë, dhe çdokush në Kishë bekohet nga priftëria, prandaj është e rëndësishme që të gjithë ne të dimë më shumë rreth detyrave të një mësuesi.

Pikë së pari, Doktrina e Besëlidhje 20:53 thotë: ‘Detyra e mësuesit është të vëzhgojë mbi kishën gjithmonë dhe të jetë me ta e t'i forcojë ata’.

Më pas, Doktrina e Besëlidhje 20:54–55 thotë:

‘Dhe të kujdeset që nuk ka paudhësi në kishë, as ashpërsi me njëri-tjetrin, as gënjeshtër, të folur pas shpine apo të folur dashakeqës;

Dhe të kujdeset që kisha të mbledhet së bashku shpesh dhe gjithashtu të kujdeset që tërë anëtarët të bëjnë detyrën e tyre’.”

I riu vazhdoi:

“Zoti po na thotë se është përgjegjësia jonë që jo vetëm të përkujdesemi për Kishën, por edhe për njerëzit brenda Kishës në mënyrën që Krishti do ta bënte, sepse kjo është Kisha e Tij. Nëse po përqipemi t’i zbatojmë urdhërimet, të jemi mirëdashës ndaj njëri-tjetrit, të jemi të ndershëm, të jemi miq të mirë dhe të kënaqemi duke qenë së bashku, atëherë ne do të jemi në gjendje ta kemi Shpirtin me vete dhe të dimë atë që Ati Qiellor do që ne të bëjmë. Nëse nuk e bëjmë këtë, atëherë nuk mund ta përmbushim thirrjen tonë.”

Ai vazhdoi të thoshte:

“Kur një mësues zgjedh të japë shembullin e drejtë duke qenë një mësues i mirë shtëpie, duke i përshëndetur anëtarët në kishë, duke e përgatitur sakramentit, duke ndihmuar në shtëpi dhe duke qenë një paqebërës, ai po zgjedh ta nderojë priftërinë e tij dhe ta përmbushë thirrjen e tij.

Të qenit një mësues i mirë nuk nënkupton vetëm të qenit të përgjegjshëm kur jemi në kishë apo në veprimtaritë e Kishës. Apostulli Pal dha mësim: ‘Bëhu shembull për besimtarët në fjalë, në sjellje, në dashuri, në Frymë, në besim dhe dëlirësi’ (1 Timoteut 4:12).”

Më pas, i riu tha:

“Pavarësisht se ku jemi ose çfarë po bëjmë, ne mund të jemi një shembull i mirë i drejtësisë në të gjitha kohët e në të gjitha vendet.

Unë dhe babi im e bëjmë mësimin e shtëpisë te familja Braun.¹ Sa herë që shkojmë atje, ia kaloj shumë mirë duke biseduar dhe duke arritur t’i njoh ata. Një gjë që më pëlqen shumë nga familja Braun është se, sa herë që shkojmë atje, ata janë të gatshëm të dëgjojnë dhe gjithmonë kanë histori të bukura për të treguar.

Kur i njohim mirë njerëzit në lagje për shkak të mësimin të shtëpisë, bëhet më e lehtë që ta bëjmë detyrën tjetër si

mësues, dhe ajo është që t’i përshëndetim anëtarët në kishë. Kur i ndihmojmë njerëzit të ndihen të mirëpritur dhe të përfshirë në kishë, kjo i ndihmon të gjithë anëtarët e lagjes të ndiejnë dashuri dhe të ndihen të përgatitur për ta marrë sakramentit.

Pasi i përshëndetim anëtarët që kanë ardhur në kishë, mësuesit ndihmojnë çdo të diel duke përgatitur sakramentit. Më pëlqen shumë ta shpërndaj dhe ta përgatit sakramentit në këtë lagje, sepse gjithsecili është kaq nderues. E ndiej përherë Shpirtin kur e përgatit dhe e shpërndaj sakramentit. Është një bekim i vërtetë që jam në gjendje ta bëj atë çdo të diel.

Një shërbim, si për shembull shpërndarja e sakramentit, është diçka që njerëzit e shohin dhe na falënderojnë që e bëjmë, por shërbime të tjera si përgatitja e sakramentit zakonisht bëhen pa u vënë re nga askush. *Nuk* është e rëndësishme nëse njerëzit na *shohin* duke shërbyer; ajo çfarë është e rëndësishme është që Zoti e di se i kemi shërbyer Atij.

Si mësues, ne duhet të përqipemi gjithmonë që ta forcojmë Kishën, miqtë tanë dhe familjen tonë duke i përmbushur përgjegjësitë tona të priftërisë. Nuk është përherë e lehtë, por Zoti nuk na jep asnjë urdhërim ‘pa përgatitur një udhë për [ne], që [ne] të mund të plotësojnë gjënë, që ai [na] urdhëron’ (1 Nefi 3:7).

Kur ai i ri mbaroi, vazhdova të mahnitesha nga pjekuria dhe urtësia e tij. Ai e përmbloodhi duke thënë: “Unë e di se ne do të bëhemi më të mirë nëse zgjedhim ta ndjekim [Jezu Krishtin].”

Një histori tjetër e shërbimit të priftërisë u tregua një muaj më parë në mbledhjen e sakramentit të një lagjeje. Përsëri, isha i pranishëm. Në këtë rast, mbajtësi i regjuri i Priftërisë Melkizedeke nuk e dinte se ndërkohë që fliste, ai



po përshkruante saktësisht atë që Zoti dëshiron të ndodhë me forcimin e kuorumeve të priftërisë. Ja ku është thelbi i rrëfimit të tij:

Ai dhe një shok i mësimin të shtëpisë ishin caktuar që t’u shërbenin shtatë familjeve. Pothuajse të gjitha ato familje *nuk* donin vizita. Kur mësuesit e shtëpisë shkonin në apartamentet e tyre, ata nuk pranonin t’ua hapnin derën. Kur i merrnin në telefon, ata nuk përgjigjeshin. Kur u linin mesazh, telefonata nuk iu kthehej. Ky shok më i moshuar më së fundi vendosi të jepte shërbesë duke u shkruar letra. Ai madje filloi të përdorte zarfe me ngjyrë të verdhë, të shndritshme, me shpresën se do të merrte përgjigje.

Një prej shtatë familjeve ishte një motër beqare më pak aktive, e cila kishte emigruar nga Europa. Ajo kishte dy fëmijë të vegjël.

Pas shumë përpjekjesh për t’u lidhur me të, ai mori një mesazh me celular. Befas ajo e vuri në dijeni se ishte shumë e zënë për t’u takuar me mësuesit e shtëpisë. Ajo bënte dy punë dhe ishte edhe në ushtri. Puna e saj kryesore ishte si oficer e policisë dhe synimi i saj në karrierë ishte të bëhej një detektive, dhe më pas të kthehej në vendin e saj të lindjes e ta vazhdonte punën e saj atje.

Mësuesi i shtëpisë kurrë nuk mundi t’i bënte një vizitë në shtëpinë e saj. Ai



herë pas here i dërgonte mesazhe me celular. Çdo muaj i dërgonte një letër të shkruar me dorë dhe gjithashtu kartolina festash për çdo fëmijë.

Ai nuk merrte përgjigje. Por ajo e dinte se kush ishin mësuesit e saj të shtëpisë, si të lidhej me ta dhe se ata do të këmbëngulnin në shërbimin e tyre të priftërisë.

Më pas, një ditë ai mori një mesazh të ngutshëm prej saj. Ajo kishte tmerrësisht nevojë për ndihmë. Nuk e dinte se kush ishte peshkopi, po i njihje mësuesit e saj të shtëpisë.

Pas pak ditësh, asaj i duhej të largohesh nga shteti për një stërvitje trajnuese ushtarake njëmuajore. Nuk mund t'i merrte fëmijët me vete. E ëma, e cila do të kujdesej për fëmijët e saj, sapo kishte shkuar në Europë që të kujdesej për bashkëshortin e saj, i cili kishte një urgjencë mjekësore.

Kjo motër beqare më pak aktive kishte mjaft para sa të blinte një biletë për në Europë për fëmijën e saj më të vogël, por jo për djalin e saj 12-vjeçar, Erikun.² Ajo i kërkoi mësuesit të saj të shtëpisë nëse ai mund të gjente një familje të mirë shdm që ta merrte Erikun në shtëpinë e tyre për 30 ditët vijuese!

Mësuesi i shtëpisë i ktheu përgjigje dhe i tha se do të bënte më të mirën. Atëherë ai u lidh me udhëheqësit e tij të priftërisë. Peshkoi, i cili ishte prifti

i lartë kryesues, i dha miratimin që ta diskutonte me anëtarët e këshillit të lagjes, përfshirë presidenten e Shoqatës së Ndihmës.

Presidentja e Shoqatës së Ndihmës shpejt gjeti katër familje të mira shdm, që kishin fëmijë në moshën e Erikut, të cilët do ta merrnin në shtëpinë e tyre nga një javë secili. Gjatë muajit në vijim, këto familje e ushqyen Erikun, bënë vend për të në apartamentet e tyre apo në shtëpitë e vogla megjithëse ishin ngushtë, e morën në veprimtaritë e tyre familjare verore të planifikuara më parë, e çuan në kishë, e përfshinë në mbremjet e tyre familjare e kështu me radhë.

Familjet që kishin djem në moshën e Erikut e përfshinë atë në mbledhjet dhe veprimtaritë e kuorumit të dhjakëve. Gjatë kësaj periudhe 30 ditore, për herë të parë në jetën e tij, Eriku ishte në kishë çdo të diel.

Pasi nëna e tij u kthye në shtëpi nga trajnimi, Eriku vazhdoi ta frekuentonte kishën, zakonisht me njërin prej këtyre katër familjeve vullnetare shdm apo me të tjerë që e kishin shoqëruar atë, përfshirë mësueset vizitore të nënës së tij. Me kalimin e kohës, ai u shugurua dhjak dhe filloi ta shpërndante sakramentin rregullisht.

Tani, le të shohim të ardhmen e Erikut. Nuk do të habitemi nëse ai

bëhet një udhëheqës i Kishës në vendlindjen e nënës së tij kur familja e vet të kthehet atje – e gjitha për shkak të shenjtoreve të cilët punuan së bashku në unitet, nën drejtimin e një peshkopi, për të shërbyer për shkak të dashurisë hyjnore që është në zemrat e tyre dhe me fuqinë e Frymës së Shenjtë.

Ne e dimë se dashuria hyjnore është thelbësore që ne të shpëtohem në mbretërinë e Perëndisë. Moroni shkroi: “Në qoftë se nuk keni dashuri hyjnore, ju nuk mund të shpëtoheni në asnjë mënyrë në mbretërinë e Perëndisë” (Moroni 10:21; shih edhe Ethëri 12:34).


Ne e dimë gjithashtu se dashuria hyjnore është një dhuratë që na jepet pas gjithçkaje që mund të bëjmë. Ne duhet t'i "lut[emi] Atit me gjithë fuqinë e zemrës s[onë], që të mbush[em]i me këtë dashuri që ai ua jep të gjithë atyre që janë pasues të vërtetë të Birit të tij Jezu Krisht" (Moroni 7:48).

Mua më duket se ne e ndiejmë më së shumti Shpirtin e Shenjtë kur përqendrohemi te shërbimi ndaj të tjerëve. Kjo është arsyeja përse ne kemi përgjegjësinë priftërore për të shërbyer për Shpëtimtarin. Kur përfshihemi në shërbimin ndaj të tjerëve, ne mendojmë më pak për veten, dhe Fryma e Shenjtë mund të na vijë më shpejt dhe të na ndihmojë në përpjekjen tonë gjatë gjithë jetës që të marrim dhuratën e dashurisë hyjnore.

Ju jap dëshminë time se Zoti ka bërë tashmë një hap të madh përpara në planin e Tij që ne të bëhemi edhe më të frymëzuar e dashamirës në shërbimin tonë për dhënien e shërbesës priftërore. Jam mirënjohës për dashurinë e Tij, të cilën Ai na e jep bujarisht. Unë dëshmoj kështu, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Emri është ndryshuar.
2. Emri është ndryshuar.



Nga Presidenti Dallin H. Oaks,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Fuqitë e Priftërisë

Lartësimi i priftërisë së shenjtë që ju mbani është jetik për punën e Zotit në familjet tuaja dhe në thirrjet tuaja në Kishë.

Vëllezërit e mi të dashur, kemi dëgjuar një shpallje zbuluese nga Presidenti Rasëll M. Nelson. Kemi dëgjuar shtjellime të rëndësishme nga Plaku Kristoferson, Plaku Rasband dhe Presidenti Ajring. Ato që nuk janë thënë ende, përfshirë gjëra të tjera nga Presidenti Nelson, do të shtjellojnë atë që ju, udhëheqësit e Zotit dhe mbajtës të priftërisë, do të bëni tani në përgjegjësitë tuaja. Për të ndihmuar me këtë, unë do të rishikoj disa nga parimet themelore që e qeverisin priftërinë që ju mbani.

I. Priftëria

Priftëria Melkizedeke është autoriteti hyjnor që Perëndia e ka deleguar për të përmbushur veprën e Tij që “të bëjë [të] të ndodhë . . . jeta e përrjetshme e njeriut” (Moisiu 1:39). Në vitin 1829, priftëria iu dha Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit nga Apostujt e Shpëtimtarit, Pjetri, Jakobi e Gjoni (shih DeB 27:12). Ajo është e shenjtë dhe e fuqishme përtej fuqive tona për ta përshkruar.

Çelësat e priftërisë janë fuqitë për të drejtuar ushtrimin e autoritetit të priftërisë. Pra, kur Apostujt ia dhanë Priftërinë Melkizedeke Jozefit dhe Oliverit, ata u dhanë gjithashtu çelësat për ta drejtuar ushtrimin e saj (shih DeB 27:12–13). Por jo të gjithë çelësat e priftërisë u dhanë në atë kohë. Të gjithë çelësat

dhe njohuria e nevojshme për këtë “periudhë [të] plotësisë së kohëve” (DeB 128:18) janë dhënë “rresht pas rreshti” (vargu 21). Çelësa shtesë u dhanë në Tempullin e Kirtlandit shtatë vjet më vonë (shih DeB 110:11–16). Këta çelësa u dhanë për të drejtuar autoritetin e priftërisë në detyrat shtesë që u dhanë në atë kohë, të tilla si pagëzimi për të vdekurit.

Priftëria Melkizedeke nuk është një pozitë apo emërtim. Është një fuqi hyjnore që mbahet në mirëbesim, për ta përdorur në dobi të punës së Perëndisë

për fëmijët e Tij. Ne duhet të kujtojmë gjithmonë se burrat që e mbajnë priftërinë *nuk* janë “priftëria”. Nuk është e përshtatshme që t’i referohemi si “priftëria dhe gratë”. Ne duhet t’u referohemi si “*mbajtësit* e priftërisë dhe gratë”.

II. Një Shërbesë Shërbimi

Tani le të marrim në shqyrtim atë që Zoti Jezu Krisht pret nga ata që e mbajnë priftërinë e Tij – mënyrën se si duhet të sjellim shpirtra tek Ai.

Presidenti Jozef F. Smith dha mësim: “Është thënë me të vërtetë se Kisha është e organizuar në mënyrë të përsosur. I vetmi shqetësim është që këto organizata nuk janë plotësisht të ndërgjegjshme për detyrimet që qëndrojnë mbi to. Kur ato të bëhen plotësisht të ndërgjegjshme për kërkesat ndaj tyre, ato do t’i përmbushin detyrat e tyre me më shumë besnikëri dhe puna e Zotit do të jetë shumë më e vendosur, më e fuqishme dhe më me ndikim në botë.”¹

Presidenti Smith gjithashtu paralajmëroi:

“Titujt e nderit të dhënë nga Perëndia . . . që shoqërohen me disa detyra





në Priftërinë e Shenjtë dhe në urdhrat e saj, nuk duhet të përdoren e as të konsiderohen si tituj të krijuar nga njeriu; ato nuk janë për zbukurim, as nuk janë shprehje e zotërimit, por janë më tepër detyra për shërbim të përlulur në punën e të vetmit Mësues, të cilit ne shpallim se i shërbejmë. . . .

. . . Jemi duke punuar për shpëtimin e shpirtave dhe duhet ta ndiejmë se kjo është detyra më e madhe që bie mbi ne. Prandaj, ne duhet të ndihemi të gatshëm që të sakrifikojmë çdo gjë, nëse është e nevojshme, për dashurinë e Perëndisë, shpëtimin e njerëzve dhe ngadhënjimin e mbretërisë së Perëndisë në tokë.”²

III. Detyrat në Priftëri

Në Kishën e Zotit, detyrat në Priftërinë Melkizedeke kanë funksione të ndryshme. Doktrina e Besëlidhje u referohet priftërinjve të lartë si [priftërinj të lartë] që “qëndrojnë si presidentë ose shërbëtorë mbi kunjat të ndryshëm, të shpërndarë larg” (DeB 124:134). Ajo i përmend pleqtë si “shërbëtarë që qëndrojnë me kishën [e Zotit]” (DeB 124:137). Ja mësimet e tjera mbi këto funksione të veçanta.

Një prift i lartë kryeson dhe administron në gjëra shpirtërore (shih DeB 107:10,12). Gjithashtu, siç dha mësimi Presidenti Jozef F. Smith: “Për aq sa ai është shuguruar si prift i lartë, [ai] duhet

të ndiejë se është i detyruar . . . të japë një shembull përpara të moshuarve dhe të rinjve të denjë për t’u imituar dhe ta vendosë veten në një pozitë për të qenë një mësues i drejtësisë, jo vetëm me anë të parimit, por më veçanërisht me anë të shembullit – duke u dhënë më të rinjve dobinë e përvojës së moshës, dhe duke u bërë kështu individualisht një fuqi në mes të komunitetit ku ai banon.”³

Mbi detyrat e një plaku, Plaku Brus R. Mek-Konki, i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, dha mësim: “Një plak është një shërbëtar i Zotit Jezu Krisht. . . . Ai autorizohet të qëndrojë në vendin e duhur dhe në vend të Mësuesit të tij . . . duke u dhënë shërbesë bashkëqenieve të tij. Ai është vepruesi për Zotin”⁴.

Plaku Mek-Konki e kritikoi idenë se një burrë është “vetëm një plak”. “Çdo plak në Kishë mban po aq priftëri sa edhe Presidenti i Kishës . . .”, tha ai. “Çfarë është një plak? Ai është një bari, një bari që po shërben në vathën e Bariut të Mirë.”⁵

Në këtë funksion të rëndësishëm për të dhënë shërbesë në vathën e Bariut të Mirë, nuk ka dallim midis detyrave të priftit të lartë dhe plakut në Priftërinë Melkizedeke. Në të madhërismin seksion 107 të Doktrinës e Besëlidhjeve, Zoti shpall: “Priftërinjtë e lartë sipas urdhërit të Priftërisë Melkizedeke kanë të drejtë të veprojnë në detyrat e tyre, nën drejtimin e presidencisë, në

administrimin e gjërave shpirtërore dhe gjithashtu në detyrën e një plaku [ose në detyrat në Priftërinë Aarone]” (DeB 107:10; shih edhe vargu 12).

Parimi më i rëndësishëm për të gjithë mbajtësit e priftërisë është parimi i dhënë në mësim nga profeti Jakob në Librin e Mormonit. Pasi ai dhe vëllai i tij, Jozefi, u shuguruan priftërinj dhe mësues të popullit, ai shpalli: “Dhe ne lartësuam detyrën tonë ndaj Zotit, duke marrë përsipër përgjegjësinë, duke u përgjigjur me kokën tonë për mëkatet e popullit, po të mos u mësonim atyre fjalën e Perëndisë me gjithë zell” (Jakobi [LiM] 1:19).

Vëllezër, përgjegjësitë tona si mbajtës të priftërisë janë çështje të rëndësishme. Organizata të tjera mund të kënaqen me standarde veprimi si të botës kur i përçojnë mesazhet e tyre dhe kryejnë funksione të tyre të tjera. Por ne që e mbajmë priftërinë e Perëndisë, kemi fuqinë hyjnore që qeveris gjithashtu hyrjen në mbretërinë çelësiale të Perëndisë. Ne kemi qëllimin dhe përgjegjësinë që Zoti e përkufizoi në parathënien e zbuluar të Doktrina e Besëlidhjeve. Ne duhet t’i shpallim botës:

“Që çdo njeri të mund të flasë në emër të Perëndisë, Zotit, madje Shpëtimtarit të botës;

Që besimi gjithashtu të mund të rritet në tokë;

Që besëlidhja ime e përjetshme të mund të themelohet;

Që plotësia e ungujllit tim të mund t’u shpallet nga të dobëtit dhe të thjeshët fundeve të botës” (DeB 1:20–23).

Për ta përmbushur këtë porosi hyjnore, ne duhet të jemi besnikë në “lartësimin” e thirrjeve dhe përgjegjësisive tona në priftëri (shih DeB 84:33). Presidenti Harold B. Li shpjegoi se çfarë do të thotë të lartësosh priftërinë: “Kur dikush bëhet mbajtës i priftërisë, ai bëhet një veprues për Zotin. Ai duhet ta konsiderojë thirrjen e tij sikur të ishte

në punën e Zotit. Kjo është çfarë do të thotë të lartësosh priftërinë”⁶.

Prandaj, vëllezër, nëse Vetë Zoti do t’ju kërkonte të ndihmonit një nga bijtë ose bijat e Tij – gjë të cilën Ai e ka bërë nëpërmjet shërbëtorëve të Tij – a do ta bënit? Dhe nëse do ta bënit, a do të vepronit si vepruesi i Tij, “në punën e Zotit”, duke u mbështetur te ndihma e Tij e premtuar?

Presidenti Li dha një tjetër mësim rreth lartësimit të priftërisë: “Kur ju mbani një lupë zmadhuese mbi diçka, ajo e bën atë gjë të duket më e madhe sesa mund të shihet me sy të lirë; kjo është një lupë zmadhuese. Tani . . . nëse dikush e lartëson priftërinë e tij – domethënë, e bën më të madhe sesa mendoi fillimisht se ishte dhe më të rëndësishme sesa ajo që dikush mendoi se ishte – kjo është mënyra se si ju e lartësoni priftërinë tuaj”⁷.

Ja tek është një shembull i një mbajtësi të priftërisë që e lartësoi përgjegjësinë e tij priftërore. E dëgjova këtë nga Plaku Xhefri D. Erekson, shoqëruesi im në një konferencë kunji në Ajdaho. Si një i ri në moshë me detyrën e plakut, i martuar, tmerrsisht i varfër dhe duke

mos qenë në gjendje ta mbaronte vitin e fundit të kolegjit, Xhefri vendosi ta linte shkollën dhe të pranonte një ofertë joshëse për punë. Pak ditë më vonë, presidenti i kuorumit të tij të pleqve erdhi në shtëpinë e tij. “A e kupton domethënien e çelësave të priftërisë që unë mbaj?”; e pyeti presidenti i kuorumit të pleqve. Kur Xhefri tha se e kuptonte, presidenti i tha se qëkurse dëgjoi për qëllimin e tij që ta linte kolegjin, Zoti e kishte munduar gjatë netëve pa gjumë për t’i dhënë Xhefrit këtë mesazh: “Si president i kuorumit tënd të pleqve, të këshilloj të mos e lësh shkollën. Ky është një mesazh nga Zoti për ty”. Xhefri qëndroi në shkollë. E takova atë vite më vonë kur ishte një sipërmarrës i suksesshëm dhe e dëgjova t’i thoshte një publiku mbajtësish të priftërisë: “Ajo [këshillë] solli gjithë ndryshimin në jetën time”.

Një mbajtës i priftërisë e lartësoi priftërinë dhe thirrjen e tij, dhe solli “gjithe ndryshimin” në jetën e një fëmije tjetër të Perëndisë.


IV. Priftëria në Familje

Deri tani, kam qenë duke folur për funksionet e priftërisë në Kishë. Tani

do të flas për priftërinë në familje. Po e filloj me çelësat. Parimi se autoriteti i priftërisë mund të ushtrohet vetëm nën drejtimin e atij që i mban çelësat për atë funksion, është thelbësor në Kishë, por nuk gjen zbatim për ushtrimin e autoritetit të priftërisë në familje.⁸ Një baba që e mban priftërinë, kryeson në familjen e tij me anë të autoritetit të priftërisë që ai mban. Ai nuk ka nevojë të ketë drejtimin apo miratimin e çelësave të priftërisë me qëllim që të këshillojë pjesëtarë të familjes së tij, të mbajë mbledhje familjare, t’i japë bekime të priftërisë bashkëshortes dhe fëmijëve të tij, ose t’u japë bekime shëruese pjesëtarëve të familjes apo të tjerëve.

Nëse etërit do ta lartësonin priftërinë e tyre në vetë familjen e tyre, kjo do ta çonte përpara misionin e Kishës po aq sa çdo gjë që tjetër që mund të bëjnë. Etërit që e mbajnë Priftërinë Melkizedeke, duhet t’i zbatojnë urdhërimet, kështu ata do të kenë fuqinë e priftërisë për t’u dhënë bekime pjesëtarëve të familjes së tyre. Etërit duhet të kultivojnë gjithashtu marrëdhënie të dashura familjare në mënyrë që pjesëtarët e familjes do të duan t’u kërkojnë etërve të tyre bekime. Dhe prindërit duhet të nxitin më shumë bekime të priftërisë në familje.

Etër, funksiononi si “partnerë të barabartë” të bashkëshorteve tuaja, ashtu siç na mëson proklamata për familjen.⁹ Dhe, etër, kur ta keni privilegjin për ta ushtruar fuqinë dhe ndikimin e autoritetit tuaj të priftërisë, bëjeni këtë “nëpërmjet bindjes, nëpërmjet durimit, nëpërmjet mirësjelljes e zemërbutësisë dhe nëpërmjet dashurisë së pashtirur” (DeB 121:41). Ai standard i lartë për ushtrimin e autoritetit të priftërisë është më i rëndësishmi në familje. Presidenti Harold B. Li dha këtë premtim menjëherë pasi u bë President i Kishës:





Nga Presidenti Rasëll M. Nelson

“Asnjëherë nuk është fuqia e priftërisë, të cilën e mbani, më e mrekullueshme sesa kur ka një vështirësi në shtëpinë tuaj, një sëmundje të rëndë apo ndonjë vendim të madh që duhet të merret . . . E veshur me fuqinë e priftërisë, që është fuqia e Perëndisë së Plotfuqishëm, është fuqia për të kryer mrekulli nëse ky është vullneti i Zotit, por në mënyrë që ta përdorim atë priftëri, duhet të jemi të denjë për ta ushtruar atë. Kur nuk arrijmë ta kuptojmë këtë parim, nuk arrijmë t’i marrim bekimet e mbajtjes së asaj priftërie të madhe”¹⁰.

Vëllezërit e mi të dashur, lartësimi i priftërisë së shenjtë që mbani, është jetik për punën e Zotit në familjet tuaja dhe në thirrjet tuaja në Kishë.

Unë dëshmoj për Atë, priftëria e të cilit është kjo. Nëpërmjet vuajtjes dhe flijimit të Tij shlyes dhe ringjalljes së Tij, të gjithë burrat e gratë kanë sigurinë e pavdekësisë dhe mundësinë për jetë të përjetshme. Secili prej nesh duhet të jetë besnik dhe i zellshëm në bërjen e pjesës sonë në këtë vepër madhështore të Perëndisë, Atit tonë të Amshuar, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. *Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* (1998), f. 343.
2. *Teachings: Joseph F. Smith*, f. 340, 343.
3. Joseph F. Smith, *Gospel Doctrine*, bot. 5-të (1939), f. 182.
4. Bruce R. McConkie, “Only an Elder”, *Ensign*, qershor 1975, f. 66; theksimi në origjinal nuk është ruajtur.
5. Bruce R. McConkie, “Only an Elder”, f. 66; theksimi në origjinal nuk është ruajtur.
6. *Teachings of Presidents of the Church: Harold B. Lee* (2000), f. 93.
7. *Teachings of Harold B. Lee*, red. Clyde J. Williams (1996), f. 499.
8. Shih Dallin H. Oaks, “Autoriteti i Priftërisë në Familje dhe në Kishë”, *Liahona*, nëntor 2005, f. 24–27 [Konferenca e Përgjithshme, tetor 2005, f. 35–39].
9. Shih “Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”, *Liahona*, maj 2017, f. 145.
10. *Teachings: Harold B. Lee*, f. 97.

Dhënia e Shërbesës me Fuqinë dhe Autoritetin e Perëndisë

Ne do të japim shërbesë në emër të Tij, me fuqinë dhe autoritetin e Tij dhe me mirësinë e Tij plot dashuri.

Vëllezërit e mi të dashur, ju falënderoj për përkushtimin tuaj ndaj Zotit dhe punës së Tij të shenjtë.

Është vërtetë gëzim të jem me ju. Si një Presidentë e Parë e re, ne ju falënderojmë për lutjet tuaja dhe përpjekjet tuaja mbështetëse. Jemi mirënjohës për jetën tuaj dhe për shërbimin tuaj ndaj Zotit. Përkushtimi juaj ndaj detyrës dhe shërbimi juaj vetëmohues janë po aq të rëndësishëm në thirrjet tuaja sa janë përkushtimi dhe shërbimi ynë në thirrjet tona. Nëpërmjet një jete të tërë shërbimi në këtë Kishë, unë kam mësuar se me të vërtetë nuk ka rëndësi *vendi* se ku shërben dikush. Ajo për të cilën interesohet Zoti është *mënyra* se si shërben dikush.

Unë shpreh mirënjohje të thellë për Presidentin Tomas S. Monson, që ishte shembull për mua për më shumë se 50 vjet. Dhe për këshilltarët e tij, Presidentin Henri B. Ajring dhe Presidentin Diter F. Uhtdorf, shpreh admirim të thellë. I përgëzoj për shërbimin e tyre ndaj Zotit dhe profetëve të Tij. Që të dy këta shërbëtorë të devotshëm kanë marrë detyra të reja. Ata vazhdojnë të

shërbejnë me fuqi dhe zotim. I nderoj dhe i dua ata që të dy.

Është bekim i mrekullueshëm të shërbesh në Kishën e vërtetë dhe të gjallë të Zotit, me autoritetin dhe fuqinë e Tij. Rivendosja e priftërisë së Perëndisë, përfshirë çelësat e priftërisë, u hap shenjtoreve të denjë të ditëve të mëvonshme bekimet më të mëdha të të gjitha bekimeve shpirtërore. Ne i shohim ato bekime të derdhen mbi gratë, burrat dhe fëmijët anembanë botës.

Ne shohim gra besnike, të cilat e kuptojnë fuqinë e qenësishme në thirrjet e tyre dhe në dhurimin [indamentin] e tyre si dhe ordianca të tjera të tempullit. Këto gra e dinë se si t’u bëjnë thirrje fuqive të qiellit për t’i mbrojtur e forcuar bashkëshortët e tyre, fëmijët e tyre dhe njerëzit e tjerë që ato i duan. Këto janë gra të forta shpirtërisht, të cilat udhëheqin, japin mësim dhe shërbesë pa frikë në thirrjet e tyre me fuqi dhe autoritet nga Perëndia!¹ Sa mirënjohës jam për to!

Po ashtu, shohim burra besnikë të cilët jetojnë denjësisht për privilegjet e



tyre si mbajtës të priftërisë. Ata udhëheqin dhe shërbejnë duke sakrifikuar sipas mënyrës së Zotit, me dashuri, mirësi dhe durim. Ata i bekojnë, udhërrëfejnë, mbrojnë dhe forcojnë të tjerët me anë të fuqisë së priftërisë që mbajnë. Ata u sjellin mrekulli atyre të cilëve u shërbejnë, ndërkohë që i mbajnë të sigurt vetë martesat dhe familjet e tyre. Ata i japin fund ligësisë dhe janë pleq të fuqishëm në Izrael.² Jam jashtëzakonisht mirënjohës për ta!

Tani, a mund të shpreh një shqetësim? Është ky: Jashtë mase shumë prej vëllezërve dhe motrave tona nuk e kuptojnë tërësisht konceptin e fuqisë dhe autoritetit të priftërisë. Ata veprojnë sikur më tepër do të donin të kënaqnin dëshirat dhe orekset e veta egoiste në vend që ta përdornin fuqinë e Perëndisë për t'i bekuar fëmijët e Tij.

Kam frikë se jashtë mase shumë prej vëllezërve dhe motrave tona nuk ua rrok mendja privilegjet që mund të jenë të tyre.³ Disa nga vëllezërit tanë, për shembull, veprojnë sikur nuk e kuptojnë se çfarë është priftëria dhe se çfarë ajo i aftëson ata të bëjnë. Më lejoni t'ju jap disa shembuj të veçantë.

Jo shumë kohë më parë mora pjesë në një mbledhje sakramenti në të cilën një foshnjë të re do t'i jepej një emër

dhe një bekim nga babai. Babai i ri në moshë e mbajti foshnjën e tij të çmuar në krahët e vet, i dha asaj një emër dhe më pas ofroi një *lutje* të bukur. Por ai *nuk* i dha asaj fëmije një bekim. Ajo foshnjë e ëmbël vajzë mori një emër, por jo bekim! Ai plak i dashur nuk e dinte ndryshimin midis një lutjeje dhe një bekimi të priftërisë. Me autoritetin dhe fuqinë e tij të priftërisë, ai mund ta kishte bekuar foshnjën e tij, por nuk e bëri. Mendova: “Çfarë mundësie e humbur!”

Më lejoni të përmend disa shembuj të tjerë. Ne e dimë që disa vëllezër i veçojnë motrat si udhëheqëse dhe mësuese të Fillores, të Të Rejave ose të Shoqatës së Ndihmës, por nuk arrijnë t'i bekojnë ato – t'i bekojnë ato me fuqinë për t'i përmbushur thirrjet e tyre. Ata japin vetëm këshilla dhe udhëzime. Shohim një atë të denjë i cili nuk arrin që t'u japë bekime të priftërisë gruas së tij dhe fëmijëve të tij kur ajo është pikërisht gjëja që u nevojitet. Fuqia e priftërisë i është rivendosur tokës dhe prapëseprapë jashtëzakonisht shumë vëllezër e motra kalojnë përmes sprovave të tmerrshme në jetë pa marrë ndonjëherë një bekim të vërtetë të priftërisë. Çfarë tragjedie! Ajo është një tragjedi që ne mund ta mënjanojmë.

Vëllezër, ne mbajmë priftërinë e shenjtë të Perëndisë! Kemi autoritetin e Tij për t'i bekuar njerëzit e Tij. Thjesht mendoni për sigurinë mbresëlënëse që Zoti na e dha kur tha: “Këdo që ti do ta bekosh, unë do ta bekoj”⁴. Është privilegji ynë që të veprojmë në emrin e Jezu Krishtit për t'i bekuar fëmijët e Perëndisë sipas vullnetit të Tij për ta. Presidentë të kunjeve dhe peshkopë, ju lutemi sigurohuni që çdo anëtar i kuorumeve nën kujdestarinë tuaj ta kuptojë se si të japë një bekim priftërie – përfshirë denjësinë vetjake dhe përgatitjen shpirtërore që kërkohet për t'i bërë thirrje plotësisht fuqisë së Perëndisë.⁵

Të gjithë ju vëllezër që mbani priftërinë, ju ftoj t'i frymëzoni anëtarët që t'i mbajnë besëlidhjet e tyre, të agjërojnë e të lutën, t'i studiojnë shkrimet e shenjta, të adhurojnë në tempull dhe të shërbejnë me besim si burra e gra të Perëndisë. Ne mund t'i ndihmojmë të gjithë që të shohin me syrin e besimit se bindja dhe drejtësia do t'i sjellin më pranë Jezu Krishtit, do t'i lejojnë të gëzojnë shoqërimin e Frymës së Shenjtë dhe të përjetojnë gëzim në jetë!

Një tipar dallues i Kishës së vërtetë dhe të gjallë të Zotit do të jetë gjithmonë një përpjekje e organizuar, e drejtuar për t'u dhënë shërbesë fëmijëve



individualë të Perëndisë dhe familjeve të tyre.⁶ Ngaqë kjo është Kisha e Tij, ne si shërbëtorë të Tij do t'i japim shërbesë individit, pikërisht siç bëri Ai.⁷ Ne do të japim shërbesë në emër të Tij, me fuqinë dhe autoritetin e Tij dhe me mirësinë e Tij plot dashuri.

Një përvojë që e pata më shumë se 60 vjet më parë në Boston, më mësoi pikërisht se sa i fuqishëm mund të jetë privilegji i dhënies së shërbesës një-për-një. Unë isha në atë kohë një kirurg stazhier në Spitalin e Përgjithshëm të Masaçusetsit – në detyrë çdo ditë, një natë po, një natë jo dhe një fundjavë po, një fundjavë jo. Kisha kohë të kufizuar për gruan time, katër fëmijët tanë dhe aktivitetin në Kishë. Gjithsesi, presidenti i degës sonë më caktoi të vizitoja shtëpinë e Uillbër dhe Leonora Koksit me shpresën që Vëllai Koks mund të kthehej në aktivitet në Kishë. Ai dhe Leonora ishin vulosur në tempull.⁸ Megjithatë Uillbëri nuk kishte marrë pjesë prej shumë vitesh.

Unë dhe shoqëruesi im shkuam te shtëpia e tyre. Teksa hymë, Motra Koks na mirëpriti ngrohtësisht⁹, por Vëllai Koks shkoi vrazhdë në një dhomë tjetër dhe e mbylli derën.

Shkova te dera e mbyllur dhe trokita. Pas një çasti, dëgjova një "Hyr" të mbytur. Hapa derën dhe e gjeta Vëllanë Koks të ulur pranë një grumbulli pajisjesh

amatore për radio. Në atë dhomë të vogël, ai ndezi një puro. Ishte e qartë, vizita ime nuk ishte aspak e mirëpritur.

Hodha vështrimin nëpër dhomë plot habi dhe thashë: "Vëllai Koks, gjithmonë kam dashur të mësoj më shumë rreth punës amatore në radio. A do të jesh i gatshëm të më mësosh për të? Më vjen keq që s'mund të qëndroj më gjatë sonete, por a mund të vij një herë tjetër?"

Ai ngurroi për një çast dhe pastaj tha "po". Ky ishte fillimi i asaj që u bë një miqësi e mrekullueshme. U ktheva dhe ai më mësoi. Fillova ta dua dhe respektoj atë. Nëpërmjet vizitave tona pasuese, doli në pah madhështia e këtij burri. U bëmë miq shumë të mirë, sikurse u bënë edhe shoqërueset tona të përjetshme. Më pas, me kalimin e kohës, familja jonë u shpërngul. Udhëheqësit vendorë vazhduan ta ushqenin shpirtërisht familjen Koks.¹⁰

Gati tetë vjet pas asaj vizite të parë, u krijua Kunji i Bostonit.¹¹ A e merni dot me mend se kush ishte presidenti i parë i kunjit? Po! Vëllai Koks! Gjatë viteve pasuese, ai shërbeu gjithashtu si president misioni dhe president tempulli.

Vite më vonë, unë, si anëtar i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, u caktova të krijoja një kunj të ri në kontenë Sanpit të Jutës. Gjatë intervistave të zakonshme, u habita plot gëzim tek takova sërish mikun tim të dashur, Vëllanë Koks! Pata

mbresën ta thërrisja si patriarkun e kunjit të ri. Pasi e shugurova, ne u përqaftuam dhe derdhëm lot. Njerëzit në dhomë pyesnin veten përse po qanin këta burra në moshë. Por ne e dinim. Dhe Motra Koks e dinte. Lotët tanë ishin lot gëzimi! Në heshtje kujtuam udhëtimin e pabesueshëm të dashurisë e pendimit që filloi më shumë se 30 vjet më parë, një natë në shtëpinë e tyre.

Rrëfimi nuk mbaron atje. Familja e Vëllait dhe Motrës Koks u zmadhua duke përfshirë 3 fëmijë, 20 nipër e mbesa dhe 54 stërnipër e stërmbesa. Shtojini kësaj ndikimin e tyre mbi qindra misionarë, mbi mijëra të tjerë në tempull dhe mbi qindra të tjerë që kanë marrë bekime patriarkale nga duart e Uillbër Koksit. Ndikimi i Tij dhe i Leonorës do të vazhdojë të përhapet përmes shumë brezave anekënd botës.

Përvoja si kjo me Uillbër dhe Leonora Koks ndodhin çdo javë – shpresoj, çdo ditë – brenda kësaj Kise. Shërbëtorë të përkushtuar të Zotit Jezu Krisht e kryejnë punën e Tij, me fuqinë dhe autoritetin e Tij.

Vëllezër, ka dyer që mund t'i hapim, bekime të priftërisë që mund t'i japim, zemra që mund t'i shërojmë, barrë që mund t'i lehtësojmë, dëshmi që mund t'i forcojmë, jetë që mund t'i shpëtojmë dhe gëzim që mund ta sjellim në shtëpitë e shenjtorëve të ditëve të mëvonshme – të gjitha ngaqë mbajmë priftërinë e Perëndisë. Ne jemi burra që jemi "thirrur dhe . . . përgatitur, që nga krijimi i botës sipas paraditurisë së Perëndisë, për shkak të besimit [tonë] të jashtëzakonshëm" për ta bërë këtë punë.¹²

Sonte unë ju ftoj vërtet të çoheni me mua në vëllazërinë tonë të madhërisme dhe të përjetshme. Kur të them detyrën tuaj të priftërisë, ju lutem, çohuni dhe qëndroni në këmbë. Dhjakët, ju lutem ngrihuni! Mësuesit, ngrihuni! Priftërinjtë! Peshkopët! Pleqtë! Priftërinjtë



Autoritetet e Përgjithshme dhe Drejtuesit e Përgjithshëm të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

PRESIDENCA E PARË



Dallin H. Oaks
Këshilltar i Parë



Rasell M. Nelson
President



Henri B. Airing
Këshilltar i Dytë

KUORUMI I DYMBËDHJETË APOSTUJVE



M. Rasell Ballard



Xhefri R. Holland



Diter F. Uhrdorf



Dejvid A. Bednar



Kuentin L. Kuk



D. Tod Kristoferson



Nil L. Andersen



Ronald A. Rasband



Geri E. Stivenson



Dejll G. Renland



Gerit W. Gong



Ulises Soares

PRESIDENCA E TË SHTATËDHJETËVE



L. Uthri Klejton



Kreg C. Kfarsens



Lin G. Robbins



Huan A. Uceda



Patrik Kleron



Keni B. Kuk




Robert C. Geli

AUTORITETET E PËRGJITHSHME TË SHITATËDHJETË

(sipas rendit alfabetik në anglisht)

PESHKOPATA KRYESEUE



Dini M. Dejvis
Keshilltar i Pate
Zieradit Kosë
Peshkopë Kryesues
W. Kristofer Dabelli
Keshilltar i Dytë

DREJTUESIT E PËRGJITHSHËM

SHKOLLA E SË DIELËS	TË REJAT	SHOQATA E NDIHMËS	FILLORIA	TË RINITE





Nga Plaku Leri Y. Uilson,
i Të Shtatëdhjetëve

e lartë! Patriarkët! Të Shtatëdhjetët!
Apostujt!

Tani, vëllezër, ju lutem të qëndroni në këmbë dhe të bashkoheni me korin tonë për t'i kënduar që të tria strofat e himnit "Burra t'Per'ndis' Ço'uni!"¹³ Ndërkohë që këndon, mendoni për detyrën tuaj si ushtria e fuqishme e Perëndisë, që ndihmon për ta përgatitur botën për Ardhjen e Dytë të Zotit. Kjo është detyra jonë. Ky është privilegji ynë. Unë dëshmoj kështu, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Rasëll M. Nelson, "Një Lutje drejtuar Motrave të Mia", *Liahona*, nëntor 2015, f. 96.
2. Shih Rasëll M. Nelson, "Çmimi i Fuqisë së Priftërisë", *Liahona*, maj 2016, f. 66–69; shih edhe Alma 13:7–8; Doktrina e Besëlidhje 84:17–20, 35–38.
3. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:19–22; 107:18–19; Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 14:30–31 (në Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta).
4. Doktrina e Besëlidhje 132:47.
5. Lidhja midis fuqisë së priftërisë dhe drejtësisë vetjake trajtohet më tërësisht te Rasëll M. Nelson, "Çmimi i Fuqisë së Priftërisë", f. 66–69; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 121:34–37, 41–44.
6. Roli thelbësor i një përpjekjeje të organizuar, të drejtpërdrejtë për t'u dhënë shërbesë individëve dhe familjeve është e dukshme kudo dhe kurdoherë që është ngritur Kisha e Jezu Krishtit. Shih, për shembull, Lluca 10:1–20; Veprat e Apostujve 6:1–6; Efesianëve 4:11–14; Mosia 18:9, 18–19, 27–29; Doktrina e Besëlidhje 20:42, 51, 57.
7. Shih 3 Nefi 17:9–10, 20–21.
8. Tempulli i Mantit, Jutë, 15 qershor 1937.
9. Agjërimi dhe lutja e Leonorës çdo të hënë vite me radhë sigurisht pati një ndikim të fuqishëm për mirë.
10. Në vitin 1954, presidenti i degës, Ajra Teri, e thirri Uillbërin që të ishte mbikëqyrësi i Shkollës së Dielës për degën. Uillbëri e pranoi thirrjen dhe hoqi dorë përgjithmonë nga të gjitha zakonet që ishin në kundërshtim me Fjalën e Urtësisë. Ai ia përkushtoi pjesën e mbetur të jetës së tij shërbimit në punën e Shpëtimtarit.
11. Në vitin 1962.
12. Alma 13:3.
13. "Burra t'Per'ndis' Ço'uni!", *Himme*, nr. 209.

Merreni Shpirtin e Shenjtë si Udhërrëfyesin Tuaj

Çfarë dhurate e pakrahasueshme u vjen atyre që e vënë besimin e tyre te Jezu Krishti! Ajo dhuratë është Shpirti i Shenjtë.

Këtë të diel Pashke, mendimet tona shkojnë te Ringjallja e Zotit Jezu Krisht dhe te varri i zbrazët që i jep çdo besimtari shpresë në ngadhënjimin e Krishtit mbi disfatën e sigurt të vdekjes pa ringjallje. Unë, si apostulli Pal, besoj se ashtu siç Perëndia "e ringjalli Krishtin prej së vdekurish [ashtu] do t'u japë jetë edhe trupave [tanë] vdekatarë me anë të Frymës së tij që banon në [ne]".¹

T'u japë jetë do të thotë t'i bëjë të gjallë. Në të njëjtën mënyrë që Krishti i kthen sërish në jetë trupat tanë pas vdekjes fizike nëpërmjet fuqisë së Ringjalljes së tij, ashtu ai mund të na japë jetë, ose të na bëjë të gjallë nga vdekja shpirtërore.² Në librin e Moisiut, lexojmë për Adamin tek i nënshtrohet kësaj dhënieje të jetës: "[Adami] u pagëzua dhe Shpirti i Perëndisë zbriti mbi të e kështu ai u lind nga Shpirti dhe u gjallërua në njeriun e brendshëm".³

Çfarë dhurate e pakrahasueshme u vjen atyre që e vënë besimin e tyre te Jezu Krishti! Ajo dhuratë është Shpirti i Shenjtë që na jep atë që Dhiata e Re e

quan "jetë. . . në Jezu Krishtin".⁴ Por a e marrim ndonjëherë si të mirëqenë një dhuratë të tillë?

Vëllezër e motra, është një privilegj i jashtëzakonshëm ta "marr[im] Shpirtin e Shenjtë si udhëzuesin [tonë]"⁵ sikurse dëftohet me anë të përvojës vijuese.

Gjatë Luftës së Koresë, nëntogeri Frenk Bler shërbeu në një anije për transportin e trupave ushtarake me bazë në Japoni.⁶ Anija nuk ishte aq e madhe sa të kishte një kapelan në detyrë formale, ndaj kapiteni i kërkoi vëllait Bler që të ishte kapelani joformal i anijes, pasi kishte vërejtur se i riu ishte një njeri me besim dhe parime, tejet i respektuar nga i gjithë ekuipazhi.

Nëntogeri Bler shkroi: "Anijen tonë e zuri një tajfun i fuqishëm. Dallgët ishin rreth 14 m të larta. Isha duke vrojtuar . . . gjatë kohës kur një prej tre motorëve tanë ndaloi së funksionuari dhe u raportua një çarje në aksin qendror të anijes. Na mbetën dy motorë, një prej të cilëve po funksiononte vetëm me gjysmën e fuqisë. Ishim në telash të madh."

Nëntogeri Bler e mbaroi [turnin] e vrojtimit dhe po shkonte në shtrat kur kapiteni i trokiti në derë. Ai i kërkoi: “Të lutem, a do të lutesh për këtë anije?”. Sigurisht, nëntogeri Bler pranoi ta bënte.

Në atë pikë, nëntogeri Bler mund të ishte lutur thjesht: “Atë Qiellor, të lutem bekoje anijen tonë dhe na mbro” dhe më pas të kishte shkuar në shtrat. Përkundrazi, ai u lut që të dinte a kishte ndonjë gjë që *mund ta bënte* që të ndihmonte për të siguruar mbrojtjen e anijes. Në përgjigje të lutjes së vëllait Bler, Fryma e Shenjtë e nxiti që të shkonte në urën e komandimit, të fliste me kapitenin e të mësonte më shumë. Ai zbuloi se kapiteni po përpiqej të përcaktonte shpejtësinë me të cilën duhej të punonin motorët e mbetur të anijes. Nëntogeri Bler u rikthye në kabinën e tij për t’u lutur sërish.

Ai u lut: “*Çfarë mund të bëj* që të ndihmoj për ta zgjidhur problemin e motorëve?”

Në përgjigje, Fryma e Shenjtë i pëshpëriti që duhej të ecte rreth e qark anijes dhe të vëzhgonte që të mblidhte më shumë informacion. Ai u kthye sërish të kapiteni dhe kërkoi leje që të ecte për qark kuvertës. Pastaj, me një litar shpëtimi të lidhur në bel, doli jashtë në mes të stuhisë.

Duke qëndruar mbi kiç, ai vëzhgoi helikat gjigante teksa dilnin nga uji kur anija ngrihej mbi dallgë. Vetëm njëra po punonte plotësisht dhe po rrotullohej shumë shpejt. Pas këtyre vëzhgimeve, nëntogeri Bler u lut edhe një herë. Përgjigja e qartë që mori ishte se motori i mirë që kishte mbetur po sforcohej tej mase dhe duhej t’ia ulnin shpejtësinë. Ndaj ai u kthye te kapiteni dhe ia dha si rekomandim. Kapiteni u befasua, duke i thënë se inxhinieri i anijes sapo i kishte thënë të kundërtën – që t’ia shtonin shpejtësinë motorit të mirë në mënyrë që ta linin pas stuhinë.



Megjithatë, kapiteni zgjodhi të ndiqte sugjerimin e nëntogërit Bler dhe ia uli shpejtësinë motorit. Në të gdhirë, anija ishte e sigurt në ujëra të qeta.

Vetëm dy orë më vonë, motori i mirë pushoi së funksionuari një herë e mirë. Me gjysmën e fuqisë që kishte motori i mbetur, anija ia doli me mund të arrinte në port.

Kapiteni i tha nëntogërit Bler: “Nëse nuk do t’ia kishim ulur shpejtësinë motorit në atë kohë, do ta kishim humbur atë në mes të stuhisë”.

Pa atë motor, nuk do të kishim pasur asnjë mundësi për të manovruar. Anija do të ishte kthyer përmbys e do të ishte fundosur. Kapiteni e falënderoi oficerin e ri shdm dhe tha se e besonte që ndjekja e mbresave shpirtërore të nëntogërit Bler e kishin shpëtuar anijen dhe ekuipazhin e saj.

Tani, kjo histori është mjaft dramatike. Ndërkohë që nuk ka të ngjarë që ne të përballemi me rrethana kaq të llahtarshme, kjo histori përmban udhëzime të rëndësishme rreth mënyrës se si *mund ta marrim* më shpesh udhërrëfimin e Shpirtit.

Së pari, kur bëhet fjalë për zbuluesin, duhet ta rregullojmë siç duhet marrësin tonë që të kapë valët e qiellit. Nëntogeri Bler po jetonte një jetë të pastër e me besnikëri. Po të mos kishte qenë i bindur, *nuk* do të kishte pasur sigurinë e nevojshme shpirtërore për t’u lutur siç bëri për sigurinë e anijes së tij dhe për

të marrë një udhërrëfim kaq specifik. Secili prej nesh duhet të jetë duke bërë përpjekjen për ta përputhur jetën e vet me urdhërimet e Perëndisë në mënyrë që të drejtohet prej Tij.

Nganjëherë nuk mund ta dëgjojmë sinjalin e qiellit sepse nuk jemi të denjë. Pendimi dhe bindja janë mënyra për të arritur përsëri një komunikim të qartë. Fjala në Dhiatën e Vjetër *konvertohuni* do të thotë “të largohesh” ose “të ndryshosh drejtim”.⁷ Kur ndiheni larg nga Perëndia, ju nevojitet vetëm të merrni vendimin për t’u larguar nga mëkati, dhe të ktheheni në drejtim të Shpëtimtarit, ku do ta gjeni duke ju pritur, me krahë të zgjatur. Ai pret me padurim t’ju udhërrëfejë dhe ju jeni vetëm një lutje larg nga marrja e atij udhërrëfimi përsëri.⁸

E dyta, nëntogeri Bler nuk i kërkoi Zotit thjesht që t’ia *zgjidhte* problemin. Ai pyeti për atë që *mund të bënte* që të ishte pjesë e zgjidhjes. Në mënyrë të ngjashme ne mund të pyetim: “Zot, çfarë më duhet të bëj *që të jem pjesë e zgjidhjes*? Në vend që thjesht t’i renditim problemet tona në lutje dhe t’i kërkojmë Zotit të na i zgjidhë, ne duhet të kërkojmë mënyra më aktive për ta marrë ndihmën e Zotit dhe të zotohemi për të vepruar sipas udhërrëfimit të Shpirtit.

Ka një mësim të tretë të rëndësishëm në historinë e nëntogërit Bler. A mund të ishte lutur ai me një siguri kaq të qetë po të mos kishte marrë udhërrëfim nga Shpirti në raste të mëparshme? Ardhja e tajfunit nuk është koha për t’i shkundur pluhurin dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe për të zbuluar se si ta përdorim atë. Ky i ri po ndiqte qartazi një model që e kishte përdorur shumë herë më parë, përfshirë kohën kur ishte misionar kohëplotë. Kemi nevojë për Shpirtin e Shenjtë si udhërrëfyesin tonë në ujëra të qeta, që zëri i Tij të jetë i pangatërrueshëm për ne në stuhinë më të egër.

Disa mund të mendojnë se ne nuk duhet të presim udhërrëfim të përditshëm nga Shpirti sepse “nuk është e përshtatshme që [Perëndia] duhet të urdhëroj[ë] për gjithçka”, që të mos bëhemi shërbëtorë të ngathët.⁹ Sidoqoftë, ky shkrim i shenjtë iu dha disa misionarëve të hershëm që i kërkuan Jozef Smithit të merrte zbuluesën që ata duhej ta kishin marrë vetë për veten. Në një varg më sipër, Zoti u tha atyre të vinin në fushën e misionit: “*siç do të këshillohen mes tyre dhe meje*”.¹⁰

Këta misionarë dëshironin një zbuluesë të posaçme për planet e udhëtimit të tyre. Ata nuk kishin mësuar ende të kërkonin drejtim vetë për çështje vetjake. Zoti e quajti këtë qëndrim ashtu siç është: i ngathët. Anëtarët e hershëm të Kishës mund të kenë qenë kaq të lumtur që kishin një profet të vërtetë, sa rrezikonin të mos e mësonin dot se si të merrnin vetë zbuluesë. Të qenit i mbështetur te vetja shpirtërisht është të dëgjosh zërin e Zotit nëpërmjet Shpirtit të Tij për vetë jetën tënde.

Alma e këshilloi të birin që të “këshilloh[ej] me Zotin për të gjitha veprimet e tija”.¹¹ Të jetosh në këtë mënyrë – në mënyrën që shpesh e quajmë “të jetuarit me anë të Shpirtit” – është një privilegj i lartë. Ajo sjell një ndjesi qetësie dhe sigurie si dhe frytet e Shpirtit, të tilla si dashuria, gëzimi dhe paqja.¹²

Aftësia e nëntogerit Bler për të marrë zbuluesë e shpëtoi atë dhe shokët e tij të anijes nga një stuhi e tërbuar. Lloje të tjera stuhish po afrohen me tërbim sot. Shëmbëlltjyra e pemës së jetës në Librin e Mormonit¹³ jep një imazh të fuqishëm të mënyrës se si arrihet mbrojtja shpirtërore në një botë të tillë. Kjo ëndërr tregon për një mjegull të papritur errësire që po ngrihej për t’u sjellë shkatërrim shpirtëror anëtarëve të Kishës që po ecnin në shtegun e kthimit për te Perëndia.¹⁴



Duke e sjellë ndër mend këtë imazh, unë shoh me sytë e mendjes mizëri njerëzish që po udhëtojnë drejt shtegut, disa me duar të kapura fort pas shufrës së hekurt, por shumë të tjerë duke ndjekur gjurmët e njerëzve përpara tyre. Kjo qasja e dytë nuk kërkon shumë mendim ose përpjekje. Ju mundeni thjesht të bëni e të mendoni atë që të tjerët po bëjnë dhe mendojnë. Kjo funksionon fare mirë në mot me diell. Por stuhitë e mashtrimit dhe mjegullat e gënjeshtrove ngrihen pa paralajmërim. Në këto situata, familjarizimi me zërin e Frymës së Shenjtë është një çështje jete a vdekje shpirtërore.

Premtimi i fuqishëm i Nefit është që “ata që do të dëgjonin fjalën e Perëndisë, dhe . . . do të mbaheshin fort në të, . . . nuk do të mbaronin kurrë; as tundimet dhe shigjetat e flakta të kundërshtarit nuk do të mund t’i mposhtnin ata në verbëri, t’i çojnë ata në shkatërrim”.¹⁵

Ndjekja e gjurmëve të njerëzve që janë përpara jush në shteg, nuk mjafton. Ne nuk mundemi thjesht të bëjmë e të mendojmë atë që të tjerët po bëjnë dhe mendojnë; secili prej nesh duhet të

jetojë një jetë të udhërrëfyer. Secili prej nesh duhet të ketë dorën e vet te shufra e hekurt. Atëherë mund të shkojmë te Zoti me vetëbesim të përlurur, duke e ditur që Ai “do të [na] udhëheqë përdore dhe do t’u japë përgjigje lutjeve [tona]”.¹⁶ Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Romakëve 8:11; shih edhe Gjoni 14:16.
2. Shih 2 Nefi 2:21; Alma 42:9.
3. Moisiu 6:65.
4. Romakëve 8:2; shih edhe 2 Nefi 25:25.
5. Doktrina e Besëlidhje 45:57.
6. Histori e treguar me lejen e Frenk Blerit. Vëllai Bler, tashmë 89 vjeç, qe i pranishëm në Qendrën e Konferencave për këtë fjalim.
7. Fjala në hebraisht që është përkthyer “konvertohuni” për shembull tek, Ezekieli 14:6, është *shoob* (me përkthim të përafërt). Do të thotë “të kthehesh prapa” ose “të rikthehesh”. (Shih James Strong, *The Exhaustive Concordance of the Bible* [1890], nr. 7725.)
8. Shih Jakobi [LiM] 6:5; Mosia 16:12; Alma 5:33; 19:36; 29:10; 3 Nefi 9:14.
9. Doktrina e Besëlidhje 58:26.
10. Doktrina e Besëlidhje 58:25; theksimi i shtuar.
11. Alma 37:37; theksimi i shtuar.
12. Shih Galatasve 5:22.
13. Shih 1 Nefi 8; 12; 15.
14. Shih 1 Nefi 8:23–24; 12:17.
15. 1 Nefi 15:24; theksimi i shtuar.
16. Doktrina e Besëlidhje 112:10.



Nga Reina I. Aburto,
Këshilltare e Dytë në Presidencën e
Përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës

Me një Mendje të Vetme

Me qëllim që ta arrijmë vendmbërritjen tonë madhështore, kemi nevojë për njëri-tjetrin dhe kemi nevojë të jemi në unitet.

Një nga krijesat më të mrekullueshme në tokë është flutura monarke. Në një udhëtim në Meksikë për ta kaluar Krishtlindjen me familjen e bashkëshortit tim, vizituam një strehë fluturash, ku kalonin dimrin miliona flutura monarke. Ishte magjepsëse të shihje një pamje aq mbresëlënëse dhe

që ne të reflektonim mbi shembullin e unitetit dhe bindjes ndaj ligjeve hyjnore që shfaqin krijesat e Perëndisë.¹

Fluturat monarke janë fluturake mjeshtërore. Ato përdorin pozicionin e diellit për të gjetur drejtimin nga u duhet të shkojnë. Çdo pranverë, udhëtojnë për mijëra kilometra nga Meksika

deri në Kanada dhe çdo vjeshtë, kthehen tek të njëjtat pyje të shenja halore në Meksikë.² Ato e bëjnë këtë vit pas viti, me nga një rrahje të vocërr flatrash çdo herë. Gjatë udhëtimit të tyre, grumbullohen natën së bashku mbi pemë për t'u mbrojtur nga i ftohti dhe nga grabitqarët.³

Një grup fluturash quhet kaleidoskop.⁴ A nuk është ajo një pamje shumë e bukur? Secila flutur në një kaleidoskop është e pashoqe dhe e ndryshme, megjithatë këto krijesa në dukje të brishta, janë projektuar nga një Krijues i dashur me aftësinë për të mbijetuar, për të udhëtuar, për t'u shumuar dhe për ta përhapur jetën teksa shkojnë nga një lule tek tjetra duke shpërndarë pjalmin. Dhe ndonëse secila flutur është e ndryshme, ato punojnë së bashku për ta bërë botën një vend më të bukur dhe më të frytshëm.

Po ashtu si fluturat monarke, edhe ne jemi në një udhëtim për t'u kthyer te shtëpia jonë qiellore, ku do të bashkohemi me Prindërit tanë Qiellore.⁵ Po ashtu si fluturave, neve na janë dhënë tipare hyjnore që na lejojnë të orientohemi nëpër jetë, me qëllim që ta "përmbush[im] qëllimin e krijimit [tonë]"⁶. Ashtu si ato, nëse i thurim së bashku zemrat tona,⁷ Zoti do të na mbrojë "si një kllockë mbledh zogjtë e saj nën krahët e saj"⁸ dhe do të na bëjë të formojmë një kaleidoskop të bukur.

Vajza e djem, të reja e të rinj, motra e vëllezër, ne jemi së bashku në këtë udhëtim. Me qëllim që ta arrijmë vendmbërritjen tonë madhështore, kemi nevojë për njëri-tjetrin dhe kemi nevojë të jemi në unitet. Zoti na ka urdhëruar: "Jini një; dhe nëse nuk jeni një, nuk jeni të mitë"⁹.

Jezu Krishti është shembulli suprem i unitetit me Atin e Tij. Ata janë një në qëllim, në dashuri dhe në vepra, "vullneti i Birit duke u shkrirë në vullnetin e Atit"¹⁰.



Po ashtu si fluturat monarke që kthehen në shtëpinë e tyre në Meksikë, edhe ne jemi në një udhëtim për t'u kthyer te shtëpia jonë qiellore

Si mund ta ndjekim shembullin e përkryer të Zotit për unitetin me Atin e Tij dhe të jemi më shumë në unitet me Ata dhe me njëri-tjetrin?

Një model frymëzues gjendet te Veprat e Apostujve 1:14. Lexojmë: “Të gjithë [burrat] ngulmonin *me një mendje të vetme* në lutje dhe përgjërime së bashku me gratë”¹¹.

Mendoj se është domethënëse që fraza “me një mendje të vetme” shfaqet disa herë në librin e Veprave të Apostujve, ku lexojmë se çfarë bënë pasuesit e Jezu Krishtit menjëherë pasi Ai u ngjiti në qiell si një qenie e ringjallur, si dhe [për] bekimet që ata morën për shkak të përpjekjeve të tyre. Është gjithashtu domethënëse që ne e gjejmë një model të ngjashëm mes besnikëve të kontinentit amerikan në kohën kur Zoti i vizitoi dhe u dha shërbesë atyre. “Me një mendje të vetme” do të thotë në harmoni, në unitet dhe të gjithë së bashku.

Disa nga gjërat që shenjtorët besnikë i bënë në unitet në të dy vendet, ishin që ata dëshmuar për Jezu Krishtin, e studiuar fjalën e Perëndisë dhe i dhanë shërbesë njëri-tjetrit me dashuri.¹²

Pasuesit e Zotit ishin një në qëllim, në dashuri dhe në vepra. Ata e dinin se cilët ishin, ata e dinin se çfarë kishin për të bërë dhe e bënë atë me dashuri për Perëndinë dhe për njëri-tjetrin. Ata ishin pjesë e një kaleidoskopi madhështor që bënte përpara me një mendje të vetme.

Disa nga bekimet që morën ata, ishin se u mbushën me Frymën e Shenjtë, mrekulli ndodhën mes tyre, Kisha u rrit, nuk pati grindje mes njerëzve dhe Zoti i bekoji ata në të gjitha gjërat.¹³

Mund të hamendësojmë se arsyeja përse ata kishin kaq shumë unitet, ishte sepse ata e njihnin Zotin personalisht. Ata kishin qenë pranë Tij dhe kishin qenë dëshmitarë të misionit të Tij hyjnor, të mrekullive që kreu Ai,



dhe të Ringjalljes së Tij. Ata i panë e i prekën shenjat në duart e këmbët e Tij. Ata e dinin me siguri se Ai ishte Mesia i premtuar, Shëlbuesi i botës. Ata e dinin se “Ai është burimi i të gjithë shërimit, paqes dhe përparimit të përjetshëm”¹⁴.

Edhe pse mund të mos ta kemi parë Shpëtimtarin tonë me sytë tanë fizikë, ne mund ta dimë se Ai jeton. Teksa i afrohem më pranë Atij, teksa kërkojmë të marrim një dëshmi vetjake për misionin e Tij hyjnor me anë të Frymës së Shenjtë, ne do të kemi një kuptueshmëri më të mirë për qëllimin tonë; dashuria e Perëndisë do të jetojë në zemrat tona¹⁵; ne do të kemi vendosmërinë që të jemi një në kaleidoskopët e familjeve, lagjeve dhe komuniteteve tona; dhe ne do t'i japim shërbesë njëri-tjetrit “në mënyra më të reja, më të mira”¹⁶.

Mrekulli ndodhin kur fëmijët e Perëndisë punojnë së bashku të udhërrëfyer nga Shpirti për t'u ardhur në ndihmë njerëzve të tjerë në nevojë.

Dëgjojmë kaq shumë histori për dashuri miqësore që shfaqet mes njerëzve kur godasin katastrofa. Për shembull, kur qyteti i Hjustonit pësoi një përmbytje të madhe vitin e kaluar, njerëzit i harruan nevojat e veta dhe shkuan për të shpëtuar të tjerët. Një president

i kuorumit të pleqve i bëri komunitetit një thirrje për ndihmë dhe një flotë prej 77 barkash u organizua me të shpejtë. Grupet e shpëtimit shkuan nëpër lagjet e prekura të banimit dhe transportuan familje të tëra për në njërin prej shtëpive tona të mbledhjeve, ku ata morën strehimin dhe ndihmën shumë të nevojshme. Anëtarë dhe joanëtarë punuan së bashku me një qëllim.

Në Santiago të Kilit, një presidente e Shoqatës së Ndhmës pati dëshirën t'i ndihmonte emigrantët në komunitetin e saj, të cilët kishin ardhur nga Haiti. Duke u këshilluar së bashku me udhëheqësit e saj të priftërisë, ajo dhe udhëheqës të tjerë shprehën idenë që t'u ofronin atyre emigrantëve orë mësimi spanjishteje, duke i ndihmuar të bëhen më mirë pjesë përbërëse e shtëpisë së tyre të re. Çdo mëngjes të shtune, misionarët mblidhen së bashku me nxënësit e tyre të zellshëm. Ndjesia e unitetit në atë ndërtesë është një shembull frymëzues i njerëzve nga rrethana të ndryshme që shërbejnë me një mendje të vetme.

Në Meksikë, qindra anëtarë udhëtuan orë të tëra për të ndihmuar të mbijetuarit e dy tërmete të fuqishme. Ata erdhën me mjete, pajisje dhe dashuri për fqinjët e tyre. Teksa vullnetarët u mblodhën së bashku në njërin prej shtëpive tona të mbledhjeve duke pritur udhëzime, kryetari i bashkisë i qytetit Iksuatan shpërtheu në lot teksa pa një shfaqje të tillë të “dashuri[së së] pastër [të] Krishtit”¹⁷.

Zoti po na jep tani mundësinë që të këshillohemi së bashku çdo muaj në kuorumet tona të priftërisë dhe në Shoqatat tona të Ndhmës, kështu që, që të gjithë, të mund të bëhemi pjesëmarrës më aktivë në kaleidoskopin e lagjes apo degës sonë – një vend ku të gjithë përshtatemi dhe të gjithë jemi të nevojshëm.

Secili prej shtigjeve tona është i ndryshëm, por ne ecim në ta së bashku. Shtegu ynë nuk ka të bëjë me atë çfarë kemi bërë apo ku kemi qenë; ai ka të bëjë me atë ku po shkojmë dhe çfarë po bëhemi, në unitet. Kur këshillohemi së bashku të udhërrëfyer nga Fryma e Shenjtë, ne mund ta shohim se ku jemi dhe ku na duhet të jemi. Fryma e Shenjtë na jep një këndvështrim që sytë tanë natyrorë nuk mund ta shohin, sepse “zbulesa është e përhapur midis nesh”¹⁸ dhe, kur i vëmë bashkë ato zbulues, ne mund të shohim më shumë.

Teksa punojmë në unitet, qëllimi ynë duhet të jetë që ta kërkojmë dhe ta bëjmë vullnetin e Zotit; shtysa jonë duhet të jetë dashuria që ndiejmë për Perëndinë dhe për fqinj tonë¹⁹; dhe dëshira jonë më e madhe duhet të jetë që të “punojmë zellshmërisht”²⁰, që të mund të përgatitim udhën për kthimin e lavdishëm të Shpëtimtarit tonë. E vetmja mënyrë se si do të jemi në gjendje që ta bëjmë këtë, është “me një mendje të vetme”.

Ashtu si fluturat monarke, le të vazhdojmë në udhëtimin tonë së bashku në qëllim, secili prej nesh me vetë tiparet dhe ndihmesat tona, duke punuar që ta bëjmë këtë një botë më të bukur dhe më të frytshme – me nga një hap të vogël për çdo herë dhe në harmoni me urdhërimet e Perëndisë.

Zoti ynë Jezu Krishti na ka premtuar se, kur mblidhemi së bashku në emrin e Tij, Ai është mes nesh.²¹ Unë dëshmoj se Ai jeton dhe se Ai u ringjall në një mëngjes të bukur pranverë si sot. Ai është Monarku mbi të gjithë monarkët, “Mbreti i mbretërve dhe Zot[i] i zotërve”²².

Qofshim ne një në Atin dhe në Birin e Tij të Vetëmlindur, siç udhërrëfëhemi nga Fryma e Shenjtë, është lutja ime e përlulur, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Abraham 3:26; 4:7, 9–12, 15, 18, 21, 24–25.
2. Një fakt interesant mbi fluturat monarke është se duhen deri tre breza për ta kryer udhëtimin drejt veriut për në Kanada. Megjithatë, një “brez superior” e bën të gjithë udhëtimin drejt jugut për në Meksikë, e kalon dimrin aty dhe bën pjesën e parë të udhëtimit sërish drejt veriut. (Shih “Flight of the Butterflies” [material filmik, 2012]; “Flight: A Few Million Little Creatures That Could”, WBUR News, 28 shtator 2012, wbur.org.)
3. Shih “Why Do Monarchs Form Overnight Roosts during Fall Migration?” learner.org/jnorth/tm/monarch/sl/17/text.html.
4. Shih “What Is a Group of Butterflies Called?” amazingbutterflies.com/frequentlyaskedquestions.htm; shih edhe “kaleidoscope”, merriam-webster.com. *Kaleidoscope* vjen nga fjalët greke *kalos* (“e bukur”) dhe *eidos* (“formë”).
5. Shih “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, *Liahona*, maj 2017, f. 145.
6. Doktrina e Besëlidhje 88:19; shih gjithashtu Doktrina e Besëlidhje 88:25.
7. Shih Mosia 18:21.
8. 3 Nefi 10:4.
9. Doktrina e Besëlidhje 38:27.
10. Mosia 15:7.
11. Veprat e Apostujve 1:14; theksimi i shtuar.
12. Disa nga gjërat që shenjtoret bënë në Jerusalem: zgjodhën një Apostull të ri dhe “shtatë burra me dëshmi të mirë”, si dhe i përkrahën ata (shih Veprat e Apostujve 1:26; 6:3–5); u mblodhën së bashku në ditën e Rrëshajëve (shih Veprat e Apostujve 2:1); dëshmuar për Jezu Krishtin (shih Veprat e Apostujve 2:22–36; 3:13–26; 4:10, 33; 5:42); u bënë thirrje njerëzve për pendim dhe i pagëzuan ata (shih Veprat e Apostujve 2:38–41); vazhduan në bashkësi, në thyerjen e bukës dhe në lutje (shih Veprat e Apostujve 2:42); rrinin bashkë dhe çdo gjë e kishin të përbashkët (shih Veprat e Apostujve 2:44–46; 4:34–35); morën pjesë në tempull (shih Veprat e Apostujve 2:46); e “merrnin ushqimin me gëzim dhe me thjeshtësi zemre” (Veprat e Apostujve 2:46); lavdëruan Perëndinë dhe gëzuan simpatinë e gjithë popullit (shih Veprat e Apostujve 2:47); i bindeshin besimit (shih Veprat e Apostujve 6:7); iu kushtuan vazhdimisht lutjes dhe “shërbesës së fjalës” (Veprat e Apostujve 6:4). Disa nga gjërat që shenjtoret bënë në kontinentin amerikan: predikuan ungjillin e Krishtit (shih 3 Nefi 28:23); formuan një kishë të Krishtit (shih 4 Nefi 1:1); pagëzuan njerëz (shih 4 Nefi 1:1); të gjithë njerëzit e trajtonin me drejtësi njëri-tjetrin (shih 4 Nefi 1:2); i kishin të gjitha gjërat e përbashkëta (shih 4 Nefi

- 1:3); ndërtuan përsëri qytete (shih 4 Nefi 1:7–9); u martuan (shih 4 Nefi 1:11); ecën sipas urdhërimeve që kishin marrë nga Zoti (shih 4 Nefi 1:12); vazhduan në agjërime dhe lutje (shih 4 Nefi 1:12); u mblodhën shpesh së bashku për t’u lutur dhe për të dëgjuar fjalën e Zotit (shih 4 Nefi 1:12).
13. Disa nga bekimet që shenjtoret morën në Jerusalem: u mbushën me Frymën e Shenjtë (shih Veprat e Apostujve 2:4; 4:31); morën dhuratën e gjuhëve e të profesisë dhe folën “për gjërat e mëdha të Perëndisë” (shih Veprat e Apostujve 2:4–18); shumë shenja e mrekulli u bënë nga Apostujt (shih Veprat e Apostujve 2:43); mrekulli ndodhën (shih Veprat e Apostujve 3:1–10; 5:18–19; 6:8, 15); më shumë njerëz u bashkuan me Kishën (shih Veprat e Apostujve 2:47; 5:14). Disa nga bekimet që morën shenjtoret në kontinentin amerikan: njerëzit u kthyen në besim te Zoti (shih 3 Nefi 28:23; 4 Nefi 1:2); një brez u bekua (shih 3 Nefi 28:23); nuk pati grindje dhe debate mes tyre (shih 4 Nefi 1:2, 13, 15, 18); nuk kishte të pasur dhe të varfër (shih 4 Nefi 1:3); “ata të gjithë ishin bërë të lirë dhe pjesëmarrës të dhuratës hyjnore” (4 Nefi 1:3); kishte paqe në tokë (shih 4 Nefi 1:4); u bënë mrekulli të mëdha (shih 4 Nefi 1:5, 13); Zoti i begatoi ata . . . jashtëzakonisht (shih 4 Nefi 1:7, 18); u bënë të fortë, u shtuan jashtëzakonisht shpejt dhe u bënë jashtëzakonisht të bardhë dhe të këndshëm (shih 4 Nefi 1:10); qenë të bekuar sipas premtimeve të shumta që u kishte bërë Zoti (shih 4 Nefi 1:11); “nuk pati grindje në tokë, për shkak të dashurisë së Perëndisë që jetonte në zemrat e njerëzve” (4 Nefi 1:15); “nuk pati zili, as luftime, as trazira, as lavirësi, as gënjeshtër, as vrasje, as ndonjë lloj ndyrësie; dhe me siguri nuk mund të kishte një popull më të lumtur mes gjithë njerëzve të krijuar nga dora e Perëndisë” (4 Nefi 1:16); “nuk kishte as vjedhës, as vrasës, as nuk kishte Lamanitë, as ndonjë lloj tjetër -itësh; por ata ishin të gjithë një, fëmijë të Krishtit dhe trashëgimtarë të mbretërisë së Perëndisë” (4 Nefi 1:17); Zoti i bekoji në të gjitha veprimet e tyre (shih 4 Nefi 1:18).
14. Xhin B. Bingham, “Që Gëzimi Juaj të Jetë i Plotë”, *Liahona*, nëntor 2017, f. 85.
15. Shih 4 Nefi 1:15.
16. Xhefri R. Holland, “Emisarë për Kishën”, *Liahona*, nëntor 2016, f. 62.
17. Moroni 7:47.
18. Nil L. Andersen, në “Panelet e Organizatave Ndihmëse Përdorin Bibliotekën e Re të Trajnimit”, *Liahona*, prill 2011, f. 76.
19. Shih Mateu 22:37–40.
20. Jakobi [LiM] 5:61.
21. Shih Mateu 18:20.
22. 1 Timoteu 6:15.



Nga Plaku Masimo De Feo,
i Të Shtatëdhjetëve

Dashuria e Pastër: Shenja e Vërtetë e Çdo Dishepulli të Vërtetë të Jezu Krishtit

Ungjilli i Jezu Krishtit përqendrohet te dashuria e Atit dhe e Shpëtimtarit për ne dhe te dashuria jonë për Ata dhe njëri-tjetrin.

Ne e duam Presidentin Monson dhe na ka marrë malli për të dhe, e duam dhe e mbështetim Presidentin Rasëll M. Nelson. Presidenti Nelson zë një vend të veçantë në zemrën time.

Kur isha baba i ri në moshë, djali ynë i vogël, i cili ishte pesë vjeç, një ditë erdhi në shtëpi nga shkolla dhe e pyeti nënën e tij: “Çfarë pune bën babi?” Ai më pas shpjegoi se shokët e tij të rinj të klasës filluan të debatonin rreth punës së baballarëve të tyre. Njëri tha se babai i tij ishte drejtori i policisë së qarkut, ndërsa një tjetër shprehu me krenari se babai i tij ishte drejtori i një kompanie të madhe.

Kështu që kur e pyetën për babanë e tij, im bir thjesht u përgjigj: “Babi im punon në një zyrë me kompjuter”. Më pas, duke vërejtur se përgjigja e tij nuk u bëri shumë përshtypje shokëve të tij të rinj të vegjël, ai shtoi: “Dhe meqë ra fjala, babi im është drejtori i universit”.

Ma mori mendja se ky ishte fundi i diskutimit.

I thashë bashkëshortes sime: “Ka ardhur koha që t’i mësojmë atij disa hollësi më shumë për planin e shpëtimit dhe se kush kryeson në të vërtetë”.

Por ndërsa ua mësonim fëmijëve tanë planin e shpëtimit, dashuria e tyre për Atin Qiellor dhe Shpëtimtarin u rrit teksa mësuam se ai është një plan dashurie. Ungjilli i Jezu Krishtit përqendrohet te dashuria e Atit dhe e Shpëtimtarit për ne dhe te dashuria jonë për Ata dhe njëri-tjetrin.

Plaku Xhefri R. Holland tha: “*Urdhërimi* i parë i madh i gjithë përjetësisë është që ta duam Perëndinë me të gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën *tonë* – ai është urdhërimi i parë i madh. Por e *vërteta* e parë e madhërisme e gjithë përjetësisë është që Perëndia *na* do me gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën e *Tij*. Ajo dashuri është guri themeltar i përjetësisë dhe duhet të jetë guri themeltar i jetës sonë të përditshme.”¹

Duke qenë guri themeltar i jetës sonë të përditshme, dashuria e pastër është një kusht për çdo dishepull të vërtetë të Jezu Krishtit.

Profeti Mormon dha mësim: “Prandaj, vëllezër të mi të dashur, lutiuini Atit me gjithë fuqinë e zemrës suaj, që të mbusheni me këtë dashuri që ai ua jep të gjithë atyre që janë pasues të vërtetë të Birit të tij, Jezu Krisht”.²





Dashuria njëmend është shenja e vërtetë e çdo dishepulli të vërtetë të Jezu Krishtit.

Dishepujt e vërtetë dëshirojnë shumë të shërbejnë. Ata e dinë se shërbimi është një shenjë e dashurisë së vërtetë dhe e një besëlidhjeje që kanë bërë në pagëzim³. Pavarësisht thirrjeve të tyre në Kishë apo rolit të tyre në komunitet, ata ndiejnë një dëshirë më shumë për ta dashur Zotin dhe për t'i shërbyer [Atij] dhe njëri-tjetrit.

Dishepujt e vërtetë dëshirojnë shumë të falin. Ata e dinë se Shlyerja e Shpëtimtarit i përfshin të gjitha mëkatet dhe gabimet e çdonjërit prej nesh. Ata e dinë se çmimi që Ai pagoi është një “çmim gjithëpërfshirës”. Taksat, tarifat, komisionet dhe detyrimet shpirtërore që lidhen me mëkatet, gabimet apo keqbërjet janë të gjitha të përfshira. Dishepujt e vërtetë janë të shpejtë për të falur dhe për të kërkuar falje.

Vëllezërit e motrat e mia të dashura, nëse po hasni vështirësi që të gjeni forcën për të falur, mos mendoni për atë që të tjerët kanë bërë ndaj jush, por mendoni për atë që Zoti ka bërë për ju, dhe do të gjeni paqe nga bekimet shëlbuese të Shlyerjes së Tij.

Dishepujt e vërtetë dëshirojnë shumë t'ia nënshtrojnë veten Zotit me paqe në zemrën e tyre. Ata janë të përlurur dhe të nënshtroar për shkak se e duan Atë. Ata kanë besim aq sa ta pranojnë

plotësisht vullnetin e Tij, jo vetëm tek ajo që Ai bën, por edhe te mënyra dhe koha. Dishepujt e vërtetë e dinë se bekimet e vërteta nuk janë gjithnjë ato që ata dëshirojnë, por përkundrazi, ato që Zoti dëshiron për ta.

Dishepujt e vërtetë e duan Zotin më shumë sesa botën dhe janë të qëndrueshëm dhe të palëkundur në besimin e tyre. Ata qëndrojnë të fortë e të patundur brenda një bote që po ndryshon dhe po [bëhet] pështjelluese. Dishepujt e vërtetë dëshirojnë shumë ta dëgjojnë zërin e Shpirtit dhe të profetëve dhe nuk hutohen nga zërat e botës. Dishepujt e vërtetë dëshirojnë shumë të “qëndrojnë në vende të shenja”⁴ dhe duan shumë t'i bëjnë të shenja vendet ku ata qëndrojnë. Kudo që shkojnë, ata sjellin dashurinë e Zotit dhe paqe në zemrën e të tjerëve. Dishepujt e vërtetë dëshirojnë shumë t'u binden urdhërimeve të Zotit dhe ata binden për shkak se e duan Zotin. Teksa i duan shumë besëlidhjet e tyre dhe i mbajnë ato, zemra e tyre ripërtërihet dhe vetë natyra e tyre ndryshon.

Dashuria e pastër është shenja e vërtetë e çdo dishepulli të vërtetë të Jezu Krishtit.

Unë mësova për dashurinë e pastër nga nëna ime. Ajo nuk ishte anëtare e Kishës.

Një ditë, shumë vite më parë, unë i shkova për vizitë nënës sime, e cila po luftonte me kancerin. E dija se ajo do të vdiste, por isha i shqetësuar se po vuante. Nuk i thashë asgjë, por ajo duke më njohur mirë, tha: “Shoh se je i shqetësuar”.

Më pas, si për çudi, ajo më pyeti me një zë të pafuqishëm: “A mund të më mësosh se si të lutem? Dua të lutem për ty. E di se ju e nisni duke thënë: ‘Atë i dashur Qiellor’, po më pas çfarë duhet të them?”

Kur u gjunjëzova pranë shtratit të saj dhe ajo u lut për mua, unë ndjeva një

dashuri që nuk e kisha ndier më parë. Ajo ishte e thjeshtë, e vërtetë, dashuri e pastër. Ndonëse nuk kishte njohuri për planin e shpëtimt, ajo kishte në zemrën e vet planin e saj vetjak për dashurinë, planin e dashurisë së një nëne për birin e vet. Ajo kishte dhembje, e prapë u mundua të gjente forcën për t'u lutur. Mezi ia dëgjoja zërin, por pa dyshim e ndjeva dashurinë e saj.

Më kujtohet që mendova: “Si mund të lutet për dikë tjetër dikush që po vuan kaq shumë? Është ajo që ka nevojë për ndihmë”.

Më pas përgjigja më erdhi qartësisht në mendjen time: Nga dashuria e pastër. Ajo më deshi kaq shumë sa që e harroi veten. Në çastin e saj më të vështirë, ajo më deshi më shumë se veten.

Tani, vëllezër e motra të dashura, a nuk është kjo ajo që bëri Shpëtimtari? Sigurisht, në një këndvështrim të përjetshëm e shumë më të gjerë. Por në mes të vuajtjes së Tij më të madhe, në kopsht atë natë, ishte Ai që kishte nevojë për ndihmë, duke vuajtur në një mënyrë që as nuk mund ta përfytyrojmë apo ta kuptojmë. Por në fund, Ai e harroi Vetën dhe u lut për ne derisa e pagoi çmimin e plotë. Si mundi Ai ta bënte atë? Për shkak të dashurisë së Tij të pastër për Atin, i cili e dërgoi Atë, dhe për ne. Ai e deshi Atin dhe ne më shumë se Vetën.

Ai pagoi për diçka që nuk e kishte bërë. Ai pagoi për mëkate që nuk i kishte kryer. Përse? Nga dashuria e pastër. Duke qenë se e pagoi çmimin e plotë, Ai ishte gati të na i jepte bekimet për të cilat Ai pagoi, nëse do të pen-doheshim. Përse e ofroi Ai këtë? Sërish dhe përherë nga dashuria e pastër.

Dashuria e pastër është shenja e vërtetë e çdo dishepulli të vërtetë të Jezu Krishtit.

Presidenti Tomas S Monson tha: “Ju mund të filloni tani, pikërisht sot,



Nga Plaku Klaudio D. Zivic,
i Të Shtatëdhjetëve

të shprehni dashuri për gjithë fëmijët e Perëndisë, qofshin ata pjesëtarët e familjeve tona, miqtë tanë, thjesht të njohur apo krejtësisht të panjohur. Kur ngrihemi çdo mëngjes, ne duhet të marrim vendim që t'i përgjigjemi me dashuri dhe mirësi çfarëdo gjëje që mund të na ndodhë.”⁵

Vëllezër e motra, ungjilli i Jezu Krishtit është ungjill dashurie. Urdhërimi më i madh ka të bëjë me dashurinë. Për mua, gjithçka ka të bëjë me dashurinë. Dashurinë e një Ati, që sakrifikoi Birin e Tij për ne. Dashurinë e Shpëtimtarit, që i sakrifikoi të gjitha për ne. Dashurinë e një nëne apo të një ati, që do të jepte gjithçka për fëmijët e vet. Dashurinë e atyre që shërbejnë pa u ndier dhe shumica prej nesh nuk i njeh, por Zoti i njeh më së miri. Dashurinë e atyre që i falin të gjithë dhe përherë. Dashurinë e njerëzve që japin më shumë se sa marrin.

Unë e dua Atin tim Qiellor. E dua Shpëtimtarin tim. E dua ungjillin. E dua këtë Kishë. E dua familjen time. E dua këtë jetë të mrekullueshme. Për mua, gjithçka ka të bëjë me dashurinë.

Qoftë kjo ditë përkujtimore për Ringjalljen e Shpëtimtarit një ditë riptëritjeje shpirtërore për secilin prej nesh! Qoftë kjo ditë fillimi i një jete të mbushur me dashuri, “guri themeltar i jetës sonë të përditshme”!

Qoftë zemra jonë e mbushur me dashurinë e pastër të Krishtit, shenjën e vërtetë të çdo dishepulli të vërtetë të Jezu Krishtit! Kjo është lutja ime në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Xhefri R. Holland, “Nesër Zoti Ka për të Bërë Mrekulli midis Jush”, *Liahona*, maj 2016, f. 126.
2. Moroni 7:48.
3. Shih Mosia 18:10.
4. Doktrina e Besëlidhje 45:32.
5. Tomas S. Monson, “Dashuria – Thelbi i Ungjillit”, *Liahona*, maj 2014, f. 94.

Ai që do të Ngulmojë deri në Fund, do të Shpëtohet

Le të jemi besnikë ndaj asaj që kemi besuar dhe dimë.

Të dashur vëllezër dhe motra, e vlerësoj shumë mundësinë për t'ju shprehur disa nga ndjenjat e mia.

Disa vite më parë, unë dhe bashkëshortja ime ishim të pranishëm në ceremoninë e përrimit të ekspozitës së fëmijëve në Muzeun Historik të Kishës në Solt-Lejk-Siti. Në fund të ceremonisë, Presidenti Tomas S. Monson eci drejt nesh dhe ndërsa na i shtrëngoi duart,

tha: “Duron i dhe ju do të ngadhënjoni” – një mësim i thellë, vërtetësinë e të cilit, me siguri mund ta pohojmë të gjithë.

Jezu Krishti na siguroi se “ai që do të ngulmojë deri në fund do të shpëtohet”¹.

Të durosh do të thotë “të mbetesh i vendosur në zotimin për të qenë i vërtetë ndaj urdhërimeve të Perëndisë,



pavarësisht nga tundimi, kundërshtimi [dhe] fatkeqësia”².

Edhe ata të cilët kanë pasur përvoja të fuqishme shpirtërore dhe kanë dhënë shërbim besnik, mundet që një ditë të humbasin rrugën ose të bëhen joaktivë nëse nuk durojnë deri në fund. E mbajtshim gjithmonë me fuqi në mendjen dhe në zemrën tonë frazën: “Kjo nuk do të më ndodhë mua”.

Kur Jezu Krishti dha mësim në Kapernaum, “shumë nga dishepujt e vet u tërhoqën dhe nuk shkuan më me të.

Atëherë Jezusi u tha të dymbëdhjetëve: ‘A doni edhe ju të largoheni?’³

Unë besoj se sot, Jezu Krishti na pyet të gjithëve ne që kemi bërë besëlidhje të shenjta me Të: “A doni edhe ju të largoheni?”

Lutem që të gjithë ne, me një reflektim të thellë rreth asaj që përjetësitë ruajnë për ne, të mund të përgjigjemi si Simon Pjetri: “Zot, te kush të shkojmë? Ti ke fjalë jete të përjetshme”⁴.

Le të jemi besnikë ndaj asaj që kemi besuar dhe dimë. Nëse nuk kemi jetuar sipas diturisë sonë, le të ndryshojmë. Mëkatarët që vazhdojnë në mëkatet e tyre dhe nuk pendohen, zhyten thellë e më thellë në fëlliqësi, derisa Satani i merr për vete, duke e vënë mjaft në rrezik mundësinë e tyre për t’u penduar, për të marrë falje dhe për t’u bekuar me të gjitha bekimet e përjetësisë.

Kam dëgjuar shumë shfaqësime prej atyre që kanë reshtur së marri pjesë në mënyrë aktive në Kishë dhe e kanë humbur largpamësinë e duhur të qëllimit që ka udhëtimi ynë në tokë. Unë i këshilloj ata të reflektojnë dhe të kthehen, sepse unë besoj se askush nuk do të jetë në gjendje të justifikohet përpara Zotit tonë, Jezu Krishtit.

Kur pagëzohemi, ne bëjmë besëlidhje – jo me ndonjë njeri por me Shpëtimtarin, duke pranuar të “marri[m] mbi vete emrin e Jezu Krishtit duke

patur vendosmërinë për t’i shërbyer atij deri në fund”⁵.

Pjesëmarrja në mbledhjet e sakramentit është një nga mënyrat kyç me anë të së cilës ne mund ta vlerësojmë vendosmërinë tonë për t’i shërbyer Atij, forcën tonë shpirtërore dhe rritjen e besimit tonë në Jezu Krisht.

Marrja e sakramentit është gjëja më e rëndësishme që bëjmë ditën e Shabatit. Zoti ua shpjegoi këtë ordinancë Apostujve të Tij pak para së të vdiste. Ai bëri të njëjtën gjë në kontinentin amerikan. Ai na thotë se nëse marrim pjesë në këtë ordinancë, kjo do të jetë një dëshmi ndaj Atit se ne e kujtojmë gjithmonë Atë dhe Ai na premtun se, si rrjedhojë, do ta kemi Shpirtin e Tij me vete.⁶

Te mësimet e Alma të Riut ndaj birit të tij Shilblonit, ne gjejmë këshilla të urta dhe paralajmërime që na ndihmojnë t’u qëndrojmë besnikë besëlidhjeve tona:

“Vër re të mos ngrihesh në krenari; po, shiko të mos lëvdohesh për zgjuarsinë tënde, as për fuqinë tënde të madhe.

“Ki guxim, por të mos jesh arrogant; dhe gjithashtu vër re të frenosh të gjitha

pasionet e tua, që të mund të mbushesh me dashuri; shih të përmbahesh nga përtacia”⁷.

Disa vite më parë, kur isha në pushime, dëshiroja të vozitja me kajak për herë të parë. Mora një kajak me qira dhe plot entuziazëm u hodha në det.

Pas disa minutash, një dallgë e përmbysi kajakun. Me shumë mundim, duke e mbajtur lopatën në njëren dorë dhe kajakun në dorën tjetër isha në gjendje ta gjej ekuilibrin.

E provova sërish të vozitja me kajak, por disa minuta më vonë, kajakun u kthye sërish përmbys. Me kokëfortësi vazhdova të përpiqesha, por më kot, derisa dikush që merrte vesh nga vozitja me kajak më tha se duhet të kishte një të çarë diku në trupin e kajakut dhe se kajakun duhet të ishte mbushur me ujë, duke e bërë atë të paqëndrueshëm dhe të pamundur për t’u kontrolluar. E tërhoqa zvarrë kajakun deri në breg të detit dhe e hoqa tapën, dhe sigurisht, doli një sasi e madhe uji.

Mendoj se me raste ne lëvizim në jetë me mëkate të tilla që, njësoj si rrjedhja në kajakun tim, e pengojnë përparimin tonë shpirtëror.





Nëse ngulmojmë në mëkatet tona, ne i harrojmë besëlidhjet që kemi bërë me Zotin, edhe pse vazhdojmë të gremisemi për shkak të mungesës së drejtpeshimit që ato mëkate krijojnë në jetën tonë.

Njësoj si të çarat në kajakun tim, të çarat në jetën tonë duhen ndrequr. Për disa mëkate do të kërkohen më shumë përpjekje për t'u penduar se për disa të tjerë.

Prandaj ne duhet ta pyetim veten: Ku jemi ne në lidhje me sjelljen tonë ndaj Shpëtimtarit dhe veprës së Tij? A jemi në situatën e Pjetrit kur ai e mohoi Jezun Krishtin? Apo kemi përparuar deri në pikën ku kemi sjelljen dhe vendosmërinë që ai kishte mbas porosisë së madhe që mori nga Shpëtimtari?⁸

Ne të gjithë duhet të përpiqemi fort që t'i bindemi të gjitha urdhërimeve dhe t'u kushtojmë rëndësi të veçantë atyre që janë më të vështira për t'u mbajtur. Zoti do të jetë në anën tonë, duke na ndihmuar në kohë nevojë dhe dobësie dhe, nëse tregojmë një dëshirë të sinqertë dhe veprojme siç duhet, Ai do të bëjë që "gjërat e dobëta të bëhen të forta".⁹

Bindja do të na japë forcën për ta mposhtur mëkatën. Ne duhet të

kuptojmë gjithashtu se sprova e besimit tonë kërkon që ne të bindemi, shpesh duke mos e ditur përfundimin.

Unë sugjeroj një formulë që do të na ndihmojë të durojmë deri në fund:

1. Të lutemi e t'i lexojmë shkrimet e shenjta çdo ditë.
2. Ta marrim sakramentin çdo javë, me një zemër të thyer e shpirt të penduar.
3. Të paguajmë të dhjetën dhe ofertat tona mujore të agjërimit.
4. Të përtërijmë çdo dy vjet – çdo vit për rininë – rekomandimin tonë të tempullit.
5. Të shërbejmë në veprën e Zotit gjatë gjithë jetës sonë.

Na e qetësofshin mendjen tonë të vërtetat e mëdha të ungjillit dhe e mbajtshim jetën tonë pa të çara të cilat mund të na e pengojnë udhëtimin e sigurt nëpër detin e kësaj jete!

Suksesi në udhën e Zotit ka një çmim dhe e vetmja mënyrë për ta marrë atë është që ta paguajmë atë çmim.

Sa mirënjohës jam që Shpëtimtari ynë duroi deri në fund, duke e përmbushur flijimin e Tij të madhërishtëm shlyes.

Ai vuajti për mëkatet tona, dhembjet, depresionin, ankthet, lëngatat dhe frikën, dhe kështu Ai e di si të na ndihmojë, si të na frymëzojë, si të na ngushëllojë dhe si të na forcojë në mënyrë që të mund të durojmë dhe të marrim kurorën që është ruajtur për ata të cilët nuk mposhten.

Jeta është ndryshe për secilin prej nesh. Të gjithë kemi një kohë sprovash, një kohë të lumtur, një kohë për marrje vendimesh, një kohë për kapërcim pengesash dhe një kohë për të përfituar nga mundësitë.

Cilado qoftë situata juaj vetjake, unë dëshmoj se Ati ynë Qiellor është duke thënë vazhdimisht: "Të dua. Të mbështet. Jam me ty. Mos u dorëzo. Pendohu dhe duro në rrugën që të kam treguar. Dhe Të siguroj se ne do ta shohim njëri-tjetrin sërish në shtëpinë tonë celestiale". Në emrin e Jezun Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Mateu 24:13.
2. Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, "Duroj," f. 35; scriptures.lds.org.
3. Gjoni 6:66–67.
4. Gjoni 6:68.
5. Doktrina e Besëlidhje 20:37.
6. Shih 3 Nefi 18:7.
7. Alma 38:11–12.
8. Shih Marku 16:15.
9. Ethëri 12:27.



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Të Keni Shpirtin e Tij me Ju

Lutem me gjithë zemër që ju do ta dëgjoni zërin e Shpirtit, që iu dërgohet me kaq bujari.

Vëllezërit dhe motrat e mia, jam mirënjohës për mundësinë që kam t'ju flas në ditën e Shabatit të Zotit, në konferencën e përgjithshme të Kishës së Tij, në këtë stinë Pashke. Falënderoj Atin tonë Qiellor për dhuratën e Birit të Tij të Dashur, i cili erdhi në tokë vullnetarisht që të bëhej Shëlbuesi ynë. Jam mirënjohës të di se Ai shleu për mëkatet tona dhe u ngrit sërish në Ringjallje. Çdo ditë bekothem



të di se, për shkak të Shlyerjes së Tij, unë mund të ringjallem një ditë që të jetoj përgjithnjë në një familje të dashur.

I di ato gjëra me anë të së *vetmes mënyrë* që mund t'i dijë secili prej nesh. Fryma e Shenjtë më ka folur në mendjen dhe zemrën time se ato janë të vërteta – jo thjesht një herë, por shpesh. Kam pasur nevojë për atë ngushëllim të vazhdueshëm. Ne të gjithë përjetojmë tragjedi gjatë së cilës kemi nevojë për t'u siguruar sërish nga Shpirti. E ndjeva një ditë teksa qëndroja me babanë tim në spital. E pamë nënën time duke bërë disa frymëmarrje të lehta – dhe më pas asnjë. Teksa e vështruam fytyrën e saj, ajo po buzëqeshte ndërkohë që dhimbja u largua. Pas disa çastesh heshtjeje, babai foli i pari. Ai tha: “Një vajzë e vogël u kthye në shtëpi”.

E tha butësisht. Dukej se ishte në paqe. Po thoshte diçka që e dinte se ishte e vërtetë. Qetësisht filloi të mblydhte gjërat vetjake të nënës. Doli në korridorin e spitalit që të falënderonte çdo ndihmësmjake dhe mjek që i kishte shërbyer asaj për ditë të tëra.

Babai im kishte shoqërimin e Frymës së Shenjtë në atë çast që të ndiente, të dinte dhe të bënte atë që

bëri atë ditë. Ai kishte marrë premtimin që e kanë marrë shumë veta: “Që të mund të kenë Shpirtin e tij me ta” (DeB 20:79).

Shpresa ime sot është që ta shtoj dëshirën tuaj dhe aftësinë tuaj për ta marrë Frymën e Shenjtë. Mbani mend, Ai është anëtar i tretë i Kreut-Perëndi. Ati dhe Biri janë qenie të ringjallura. Fryma e Shenjtë është një personazh i shpirtit. (Shih DeB 130:22.) Është zgjedhja juaj që ta merrni Atë dhe ta mirëpritni Atë në zemrën dhe mendjen tuaj ose jo.

Kushtet sipas të cilave ne mund ta marrim atë bekim të jashtëzakonshëm bëhen të qarta në fjalët që fliten çdo javë, por që ndoshta nuk futen thellë përherë në zemrat e mendjet tona. Që të na dërgohet Shpirti, ne duhet “gjithmonë ta kujtoj[më]” Shpëtimtarin dhe t'i “zbatoj[më] urdhërimet” e Tij (DeB 20:77).

Kjo kohë e vitit na ndihmon të kujtojmë flijimin e Shpëtimtarit dhe ngritjen e Tij nga varri si një qenie e ringjallur. Shumë prej nesh ruajnë në kujtesë pamje të atyre skenave. Dikur qëndrova me gruan time jashtë një varri në Jerusalem. Shumë njerëz besojnë se ai ishte varri nga i cili Shpëtimtari i kryqëzuar u ngrit si një Perëndi i ringjallur dhe i gjallë.

Atë ditë udhërrëfyti plot respekt bëri një lëvizje me dorë dhe na tha: “Ejani, shihni një varr të zbrazët”.

U përkulëm që të hynim. Pamë një stol guri të mbështetur te një mur. Por në mendjen time erdhi një figurë tjetër, po aq e vërtetë sa ajo që pamë atë ditë. Ishte Maria, e cila u la nga Apostujt te varri. Kjo është ajo që Shpirti më lejoi të shoh dhe madje të dëgjoj në mendjen time, po aq qartë sikur të kisha qenë atje:

“Por Maria kishte mbetur jashtë varrit, dhe po qante. Dhe, duke qarë,



u përkul brenda varrit, dhe pa dy engjëj, të veshur me të bardha, ndenjor njëri te kryet dhe tjetri te këmbët e vendit, ku qe trupi i Jezusit.

Ata i thanë: 'O grua, pse po qan?'. Ajo u përgjigj atyre: 'Sepse e kanë hequr Zotin tim, dhe nuk e di ku e kanë vënë'.

Si tha këtë, ajo u suall prapa dhe pa Jezusin, që qëndronte në këmbë; por ajo nuk e dinte se ishte Jezusi.

Jezusi i tha: 'O grua, pse po qan? Kë kërkon?' Ajo, duke menduar se ishte kopshtari, i tha: 'Zot, po e pate hequr ti, më trego ku e vure dhe unë do ta marr'.

Jezusi i tha: 'Mari!'. Dhe ajo atëherë u kthye dhe i tha: 'Rabboni!', që do të thotë: Mësues.

Jezusi i tha: 'Mos më prek, sepse ende nuk u ngjita te Ati im; por shko te vëllezërit e mi dhe u thuaj atyre se unë po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj' (Gjoni 20:11-17).

Jam lutur që të lejohesha të ndieja diçka si ajo që ndjeu Maria te varri dhe ajo që ndien dy dishepujt e tjerë rrugës për në Emaus teksa ecnin me Shpëtimtarin e ringjallur, duke menduar për Të si një vizitor nga Jerusalemi:

"Por ata e detyruan duke thënë: 'Rri me ne, sepse po ngriset dhe dita po mbaron'. Edhe ai hyri që të rrijë me ta.

Dhe, siç ishte në tryezë me ta, mori bukën, e bekoi dhe, si e theu, ua ndau atyre.

Atëherë atyre iu çelën sytë dhe e njohën, por ai u zhduk prej syve të tyre.

Dhe ata i thanë njëri-tjetrit: 'Po a nuk na digjej zemra përbrenda, kur ai na fliste udhës dhe na hapte Shkrimet?' (Lluka 24:29-32).

Disa prej atyre fjalëve u përsëritën në një mbledhje sakramenti që e ndoqa më shumë se 70 vjet më parë. Në ato ditë mbledhjet e sakramentit mbahehin në mbrëmje. Jashtë ishte errësirë. Bashkësia këndoi këto fjalë të mirënjohura. I kisha dëgjuar shumë herë. Por kujtimi im mbresëlënës është i një ndjenje në një natë të veçantë. Më afron më shumë me Shpëtimtarin. Ndoshta, nëse i recitoj fjalët, do të na vijë të gjithëve sërisht:

*Me mua rri; është muzg tani.
Dita mbaroi e shkoi;
Terri i mbrëmjes po afron;*

*Nata sapo fillon.
Ti mik zemre i mir'përitur,
Në shtëpin' time rri.*

*Me mua rri; është muzg tani.
Tek ecja sot me Ty,
Zemra më digjej n'kraharor,
Kur flisnim ne të dy.
Me t'vlefshmet fjal' shpirtin ma mbush,
Pran' Teje dua t'rri.*

*O Shpëtu's, pran' k'të nat' më rri;
Shiko, është muzg tani."
O Shpëtu's, pran' k'të nat' më rri;
Shiko, është muzg tani.¹*

Më i çmuar se një kujtim i ngjarjeve është kujtimi i Frymës së Shenjtë duke i prekur zemrat tona dhe pohimi i Tij i vazhdueshëm për të vërtetën. Më e çmuar se të parit me sytë tanë ose të kujtuarit e fjalëve që u thanë e u lexuan, është sjellja në mendje e ndjenjave që e shoqëruan zërin e qetë të Shpirtit. Rrallë kam ndier pikërisht atë që ndien udhëtarët rrugës për në Emaus – një si djegie të butë por të pagabueshme në zemër. Më shpesh ajo është një ndjenjë drite dhe sigurie të qetë.

Ne kemi premtimin e paçmuar të Frymës së Shenjtë si shoqërues dhe kemi gjithashtu udhëzime të vërteta se si ta marrim atë dhuratë. Këto fjalë thuhën nga shërbëtori i autorizuar i Zotit me duart e veta mbi kokën tonë: “Merr Frymën e Shenjtë”. Në atë çast unë dhe ju kemi sigurinë se Ai do të dërgohet. Por detyrimi ynë është të zgjedhim që t’i hapim zemrat tona për ta marrë shërbesën e Shpirtit gjatë gjithë jetës.

Përvojat e Profetit Jozef Smith ofrojnë udhërrëfim. Ai e filloi dhe e vazhdoi shërbesën e tij me vendimin se vetë urtësia e tij nuk ishte e mjaftueshme që të dinte se cilën udhë duhej të ndiqte. Ai zgjodhi të ishte i përlulur përpara Perëndisë.

Më pas, Jozefi zgjodhi të kërkonte nga Perëndia. U lut me besimin se Perëndia do t’i përgjigjej. Përgjigjja erdhi kur ishte një djalosh. Ato mesazhe erdhën kur i nevojitej të dinte se si do ta ngrinte Perëndia Kishën e Tij. Fryma e Shenjtë e ngushëlloi dhe e udhërrëfeu atë gjatë gjithë jetës së vet.

Ai iu bind frymëzimit kur ai ishte i vështirë. Për shembull, ai mori udhëzim që t’i dërgonte Të Dymbëdhjetët në Angli kur ai kishte më shumë nevojë për ta. I dërgoi.

Ai pranoi korrigjim dhe ngushëllim nga Shpirti kur u burgos dhe shenjtorët ishin tmerrësisht të shtypur. Dhe u bind kur shkoi në udhën drejt Karthixhit, edhe pse e dinte se do të përballej me një rrezik vdekjeprurës.

Profeti Jozef dha një shembull për ne se si të marrim udhëzim dhe ngushëllim të vazhdueshëm shpirtëror nëpërmjet Frymës së Shenjtë.

Zgjedhja e parë që bëri, që të ishte i përlulur përpara Perëndisë.

E dyta ishte që të lutej me besim në Zotin Jezu Krisht.

E treta ishte që të bindej me përpikëri. Bindja mund të nënkuptojë që



të veprojmë shpejt. Mund të nënkuptojë që të përgatitemi. Ose mund të nënkuptojë që të presim me durim për frymëzim të mëtejshëm.

Dhe e katërta është të lutemi që të dimë nevojat dhe zemrën e njerëzve të tjerë dhe mënyrën se si t’i ndihmojmë ata për Zotin. Jozefi u lut për shenjtorët në vuajtje, kur ishte në burg. Ka qenë mundësia ime t’i vëzhgoj profetët e Perëndisë kur luten, kërkojnë frymëzim, marrin udhëzim dhe veprojnë sipas tij.

Kam parë se sa shpesh lutjet e tyre janë për njerëzit që i duan dhe të cilëve u shërbejnë. Shqetësimi i tyre për të tjerët duket se i hap zemrat e tyre që të marrin frymëzim. Kjo mund të jetë e vërtetë për ju.

Frymëzimi do të na ndihmojë t’u japim shërbesë të tjerëve për Zotin. E keni parë atë në përvojën tuaj, sikurse e kam parë unë. Peshkopi im dikur më tha – në një kohë kur bashkëshortja ime ishte shumë e stresuar në vetë jetën e saj – “Sa herë që dëgjoj për dikë në lagje që ka nevojë për ndihmë, kur shkoj atje për të ndihmuar, mësoj se gruaja jote ishte atje përpara meje. Si e bën ajo këtë gjë?”

Ajo është si të gjithë ata që janë shërbëtarë të mëdhenj në mbretërinë e Zotit. Duket se ka dy gjëra që ata i bëjnë. Shërbëtarët e mëdhenj janë kualifikuar që ta kenë Frymën e Shenjtë si një shoqërues pothuajse të vazhdueshëm. Dhe ata janë kualifikuar

për dhuratën e dashurisë hyjnore, që është dashuria e pastër e Krishtit. Ato gjëra janë rritur brenda tyre ndërkohë që i kanë përdorur duke shërbyer për shkak të dashurisë për Zotin.

Mënyra se si lutja, frymëzimi dhe dashuria për Zotin veprojnë së bashku në shërbimin tonë përshkruhet për mua në mënyrë të përsosur në këto fjalë:

“Në qoftë se do të kërkonim diçka në emrin tim, unë do ta bëj.

Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia.

Dhe unë do t’i lutem Atit dhe ai do t’ju japë një Ngushëllues tjetër, që do të qëndrojë përgjithmonë me ju;

Frymën e së Vërtetës, që bota nuk mund ta marrë, sepse nuk e sheh dhe nuk e njeh; por ju e njihni, sepse qëndron me ju dhe do të jetë në ju.

Nuk do t’ju lë bonjakë, do të kthehem te ju.

Edhe pak kohë dhe bota nuk do të më shohë më, por ju do të më shihni; sepse unë jetoj, edhe ju do të jetoni.

Atë ditë do të mësoni se unë jam në Atin tim, dhe se ju jeni në mua dhe unë në ju.

Kush ka urdhërimet e mia dhe i zbaton, është ai që më do; dhe kush më do mua, Ati im do ta dojë; dhe unë do ta dua dhe do t’i dëftohem atij” (Gjoni 14:14–21).

Jap dëshminë time vetjake se Ati është në këtë çast i vetëdijshëm për ju, për ndjenjat tuaja dhe për nevojat



Nga Presidenti Dallin H. Oaks,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

shpirtërore dhe materiale të çdo njeriu përreth jush. Jap dëshmi se Ati dhe Biri po e dërgojnë Frymën e Shenjtë tek të gjithë ata që e kanë atë dhuratë, që e kërkojnë atë bekim dhe përpiqen të jenë të denjë për të. As Ati, as Biri, as Fryma e Shenjtë nuk hyjnë në jetën tonë me detyrim. Ne jemi të lirë të zgjedhim. Zoti u ka thënë të gjithëve:

“Ja, unë qëndroj te dera dhe trokas; nëse dikush dëgjon zërin tim dhe të hapë derën, unë do të hyj tek ai dhe do të ha darkë me të dhe ai me mua.

Kujt fiton do t'i jap të ulet me mua mbi fronin tim, sikurse edhe unë fitova dhe u ula me Atin tim mbi fronin e tij.

Kush ka veshë, le të dëgjojë atë që u thotë Fryma” (Zbulesa 3:20–22).

Lutem me gjithë zemër që ju do ta dëgjoni zërin e Shpirtit, që iu dërgohet me kaq bujari. Dhe lutem që ju do ta hapni zemrën tuaj gjithmonë që ta merrni Atë. Nëse kërkon frymëzim me qëllim të vërtetë dhe me besim te Jezu Krishti, ju do ta merrni atë sipas mënyrës së Zotit dhe në kohën e Zotit. Perëndia e bëri këtë gjë për të riun Jozef Smith. E bën atë sot për profetin tonë të gjallë, Presidentin Rasëll M. Nelson. Ai ju ka vendosur në udhën e fëmijëve të tjerë të Perëndisë që t'u shërbeni atyre për Të. E di këtë gjë jo vetëm nëpërmjet asaj që e kam parë me sytë e mi, por më fuqishëm nëpërmjet asaj që Shpirti më ka pëshpëritur në zemrën time.

E kam ndier dashurinë e Atit dhe të Birit të Tij të Dashur për të gjithë fëmijët e Perëndisë në botë dhe për fëmijët e Tij në botën e shpirtave. E kam ndier ngushëllimin dhe udhëzimin nga Fryma e Shenjtë. Lutem që ju të mund të keni gëzim në pasjen e Shpirtit me ju si shoqërues vazhdimisht. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIM

1. “Me Mua Rri; Është Muzg Tani”, *Himne*, nr. 93.

Gjëra të Vogla dhe të Thjeshta

Duhet të kujtojmë se në përgjithësi dhe gjatë një periudhe të rëndësishme kohore, gjëra në dukje të vogla bëjnë të ndodhin gjëra të mëdha.

I.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, ashtu si ju, unë jam prekur, lartësuar e frymëzuar thellësisht nga mesazhet, muzika dhe ndjenjat e kësaj kohe së bashku. Jam i sigurt se flas në emrin tuaj kur i shpreh falënderime vëllezërve dhe motrave, të cilët, si mjete në duart e Zotit, na kanë dhënë ndikimin forcues të kësaj kohe së bashku.

Jam mirënjohës që i flas këtij publiku në të dielën e Pashkës. Sot ne u bashkohemi të krishterëve të tjerë për të kremtuar Ringjalljen e Zotit Jezu Krisht. Për anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, Ringjallja e mirëfilltë e Jezu Krishtit është një shtyllë e besimit tonë.

Për shkak se i besojmë rrëfimet, si në Bibël ashtu edhe në Librin e Mormonit rreth Ringjalljes së mirëfilltë të Jezu Krishtit, ne gjithashtu i besojmë mesimet e shumta të shkrimeve të shenjta se një ringjallje e ngjashme do t'u ndodhë të gjithë të vdekshmëve që kanë jetuar ndonjëherë mbi këtë tokë. Ajo ringjallje na jep atë që Apostulli Pjetër e quajti “një shpresë të gjallë” (1 Pjetër 1:3). Ajo shpresë e gjallë është bindja jonë se vdekja nuk është fundi i identitetit

tonë, por thjesht një hap i nevojshëm në planin e mëshirshëm të Atit tonë Qiellor për shpëtimin e fëmijëve të Tij. Ai plan kërkon një kalim nga vdekshmëria në pavdekësi. Thelbësor për atë kalim është perëndimi i vdekjes dhe mëngjesi i lavdishëm, i mundësuar nga Ringjallja e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, që ne e kremtojmë këtë të diel Pashke.

II.

Një një himn madhështor, fjalët e të cilit u shkruan nga Eliza R. Snou, ne këndojmë:

*Sa i madh, i lavdishëm, i mir',
Është plan' i shëlbimit,
Ku drejt' si, dashuri, mëshir'
Takohen n'harmoni!*¹

Për ta çuar më tej atë plan dhe harmoni hyjnore, ne mblidhemi në kuvende, përfshirë këtë konferencë, për ta mësuar dhe për ta nxitur njëri-tjetrin.

Këtë mëngjes e kam ndier që të përdor si tekstin tim, mësimdhënien e Almës drejtuar birit të tij, Helamanit, të shënuar në Librin e Mormonit: “Nëpërmjet gjërave të vogla dhe të thjeshta gjëra të mëdha bëhen” (Alma 37:6).

Në ungjillin e Jezu Krishtit neve na mësohen shumë gjëra të vogla dhe të thjeshta. Duhet të kujtojmë se në përgjithësi dhe gjatë një periudhe të rëndësishme kohore, këto gjëra në dukje të vogla bëjnë të ndodhin gjëra të mëdha. Ka pasur shumë biseda mbi këtë temë nga Autoritetet e Përgjithshme dhe nga mësues të tjerë të respektuar. Tema është kaq e rëndësishme sa kam ndjesinë që të flas sërish për të.

U kujtova për fuqinë që gjërat e vogla dhe të thjeshta kanë me kalimin e kohës nga diçka që e pashë në një shëtitje në mëngjes. Kjo është fotogra-



fia që bëra. Trotuari i trashë dhe i fortë prej betoni po plasarit. A është kjo rrjedhojë e disa goditjeve të mëdha dhe të fuqishme? Jo, kjo plasaritje shkaktohet nga rritja e ngadaltë dhe e vogël e një rës prej rrënjëve që shtrihen nga pema aty pranë. Këtu është një shembull i ngjashëm që e pashë në një rrugë tjetër.

Fuqia goditëse që i plasariti këto trotuare betoni të rëndë, ishte shumë e vogël për t'u matur çdo ditë apo edhe çdo muaj, por efekti i saj me kalimin e kohës ishte jashtëzakonisht i fuqishëm.

Kështu është efekti i fuqishëm që kanë me kalimin e kohës gjërat e vogla dhe të thjeshta, të cilat na mësohen në shkrimet e shenja dhe nga profetët e gjallë. Merrni parasysh studimin e shkrimit të shenjtë që na është mësuar ta përfshijmë në jetën tonë të përditshme. Ose merrni parasysh lutjet vetjake dhe lutjet e gjunjëzuara familjare që janë praktika të rregullta për shenjtorët besnikë të ditëve të mëvonshme. Merrni parasysh pjesëmarrjen në seminar për rininë ose klasat e institutit për të rinjtë në moshë madhore. Edhe pse secila prej këtyre praktikave mund të du-



ket e vogël dhe e thjeshtë, me kalimin e kohës ato rezultojnë në një lartësim dhe rritje të fuqishme shpirtërore. Kjo ndodh ngaqë secila prej këtyre gjërave të vogla dhe të thjeshta e fton shoqërimin e Frymës së Shenjtë, të Dëshmitarit, i cili na ndriçon dhe na udhërrëfen drejt së vërtetës, ashtu siç ka shpjeguar Presidenti Ajring.

Një burim tjetër i lartësimit dhe rritjes shpirtërore është një praktikë e vazhdueshme e pendimit, edhe për shkelje në dukje të vogla.

Vetëvlerësimet tona të frymëzuara mund të na ndihmojnë që të shohim se si kemi dështuar dhe se si mund të përmirësohemi. Një pendim i tillë duhet të paraprijë marrjen e përjavshme të sakramentit nga ana jonë. Disa tema që mund të merren parasysh në këtë proces pendimi sugjerohen në himnin "A Kam Bër' Ndonjë të Mir'?"

A kam bër' sot në bot' un' ndonjë të mir'?

Kam ndihmuar dikë në nevoj'?

A e bëra t'pik'lluarin të ndjehet mir'?

N'se jo, un' vërtet dështoj.

A është m'e lehtë sot barra e dikujt,

Se të ndaj' dëshir' un' kisha?

A ndihmova të lodhur edhe të sëmur'?

Kur ndihm' iu duhej pran' a isha?²

Sigurisht këto janë gjëra të vogla, por me siguri janë shembuj të mirë të asaj që Alma i mësoi birit të tij, Helamanit: "Dhe Zoti Perëndi vepron me anë të mjeteve, që të realizojë qëllimet e tij të mëdha dhe të përrjetshme; dhe me mjete fare të vogla Zoti . . . realizon shpëtimin e shumë shpirtave" (Alma 37:7).

Presidenti Stiven C. Uillrajt, në një pritje në Universitetin "Brigam Jang – Havai", dha këtë përshkrim të frymëzuar të mësimdhënies së Almës: "Alma pohon për djalin e tij se vërtet modeli që Zoti ndjek kur ne ushtrojmë besim tek Ai dhe e ndjekim këshillën e tij në gjëra të vogla dhe të thjeshta, është se Ai na bekon me mrekulli të vogla, të përditshme dhe, me kalimin e kohës, me vepra të mrekullueshme"³.

Presidenti Hauard W. Hanter dha mësim se "shpesh janë detyrat e zakonshme . . . të cilat kanë ndikimin më të madh pozitiv në jetën e të tjerëve, krahasuar me gjërat që bota aq shpesh i lidh me madhësinë"⁴.

Një mësim bindës, laik i po këtëj parimi vjen nga ish-senatori Den Kouts

nga Indiana, i cili shkroi: “E vetmja përgatitje për atë vendim të madh që mund ta ndryshojë një jetë, apo madje një komb, janë ato qindra e mijëra vendime gjysmë të vetëdijshme, vetë-përcaktuese, në dukje të parëndësishme, të bëra në mënyrë personale”⁵.

Ato vendime personale, “në dukje të parëndësishme”, përfshijnë mënyrën se si e përdorim kohën tonë, atë që shohim në televizor dhe internet, atë që lexojmë, artin dhe muzikën me të cilat e rrethojmë veten në punë e në shtëpi, atë që kërkojmë për argëtim dhe mënyrën se si e vëmë në jetë zotimin tonë për të qenë të ndershëm e të vërtetë. Një tjetër gjë e vogël dhe e thjeshtë në dukje është të qenit të sjellshëm dhe të gëzuar në ndërveprimet tona vetjake.

Asnjë nga këto gjëra të dëshirueshme, të vogla dhe të thjeshta nuk do të na lartësojnë në gjëra të mëdha nëse nuk praktikohen në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme. Presidenti Brigam Jang u raportua të ketë thënë: “Jeta jonë përbëhet nga rrethana të vogla, të thjeshta që, kur mbledhen së bashku, janë shumë të rëndësishme, dhe përbëjnë tërë jetën e burrit ose të gruas”⁶.

Ne jemi të rrethuar nga ndikime të medias dhe përqësime kulturore që do të na bëjnë t’i ulim vlerat tona nëse nuk u bëjmë ballë vazhdimisht. Për të shkuar lart drejt synimit tonë të përjetshëm, ne duhet që të vozitim vazhdimisht. Ndhomon në qoftë se jemi pjesë e një skuadre që vozit së bashku, si një ekuipazh në veprim. Për ta çuar atë shembull edhe më tej, rrymat kulturore janë aq të forta saqë nëse ndalojmë së vozituri, ne do të çohemi poshtë drejt një vendmbërritjeje që nuk e kërkojmë, por që bëhet e pashmangshme nëse nuk përpiqemi vazhdimisht për të ecur përpara.

Pasi tregoi për një ngjarje të vogël në dukje që pati pasoja të mëdha, Nefi



shkroi: “Dhe kështu ne shikojmë se nëpërmjet mjeteve të vogla, Zoti mund të shkaktojë gjëra të mëdha” (1 Nefi 16:29). Dhiata e Vjetër përmban një shembull të paharrueshëm të kësaj. Atje ne lexojmë se si izraelitët u munduan nga gjarpërinjtë flakërues. Shumë njerëz vdiqën nga pickimet e tyre (shih Numrat 21:6) Kur Moisiu u lut për ndihmë, ai u frymëzua që të bënte “një gjarpër prej bronzi dhe e vuri mbi një shtizë”. Më pas, “nëse një gjarpër kafshonte dikë, në rast se ky shikonte gjarpërin prej bronzi, ai vazhdonte të jetonte” (vargu 9). Një gjë kaq e vogël për një rezultat kaq mrekullibërës! Megjithatë, ashtu siç e shpjegoi [edhe] Nefi kur ua mësoi këtë shembull atyre që po ngrinin krye ndaj Zotit, madje edhe kur Zoti kishte përgatitur një mënyrë të

thjeshtë me anë të së cilës të mund të shëroheshin, “për shkak të thjeshtësisë së udhës ose lehtësisë së saj, kishte shumë që mbaruan” (1 Nefi 17:41).

Ai shembull dhe ai mësim na kujtojnë se thjeshtësia e udhës ose lehtësia e detyrës së urdhëruar nuk nënkuptojnë se është e parëndësishme që ta arrijmë dëshirën tonë të drejtë.

Në mënyrë të ngjashme, edhe veprime të vogla të mosbindjes ose dështime të vogla për të ndjekur praktika të drejta, mund të na tërheqin drejt një rezultati që jemi paralajmëruar ta shmangim. Fjala e Urtësisë jep një shembull të kësaj. Ka mundësi që efekti në trup i një cigareje ose pijeje alkoolike të vetme apo i një doze të një droge tjetër mund të mos matet. Por me kalimin e kohës, efekti është i fuqishëm



dhe mund të jetë i pakthyeshem. Mos harroni plasaritjen e trotuarit nga zgjerimet e vogla, të ngadalshme të rrënjës së pemës. Një gjë është e sigurt, pasojat e tmerrshme të marrjes së çdo gjëje që mund të krijojë varësi, si drogat që e sulmojnë trupin tonë apo materialet pornografike që i zvetënojnë mendimet tona, janë krejtësisht të shmangshme nëse nuk i provojmë kurrë ato për herë të parë – madje as edhe një herë.

Shumë vite më parë, Presidenti M. Rasëll Ballard u përshkroi dëgjuesve në konferencën e përgjithshme “se si gjëra të vogla dhe të thjeshta mund të jenë negative dhe shkatërruese për shpëtimin e një personi”. Ai dha mësim: “Ashtu si fibrat e dobëta që formojnë një fill, pastaj një spango dhe më së fundi një litar, këto gjëra të vogla, të ndërthurura së bashku, mund të bëhen shumë të forta për t’u copëtuar. Ne duhet të jemi përherë të vetëdijshëm për fuqinë që gjërat e vogla dhe të thjeshta mund të kenë në ndërtimin e shpirtmërisë”, tha ai. “Në të njëjtën kohë, duhet të jemi të vetëdijshëm se Satani do të përdorë gjëra të vogla dhe të thjeshta për të na udhëhequr në dëshpërim e mjerim.”⁷

Presidenti Uillrajt i dha një paralajmërim të ngjashëm publikut të tij në

UBJ – Havai: “Është në mosbërjen e gjërave të vogla dhe të thjeshta që besimi lëkundet, mrekullitë ndalojnë dhe përparimi drejt Zotit dhe mbretërisë së Tij vihet fillimisht në pritje dhe pastaj fillon të përkeqësohet teksa të kërkuarit për mbretërinë e Perëndisë zëvendësohet me përpjekje tokësore dhe ambicie të kësaj bote”⁸.

Për t’u mbrojtur ndaj efekteve negative të ndërthurura që janë shkatërruese për përparimin tonë shpirtëror, ne kemi nevojë të ndjekim modelin shpirtëror të gjërave të vogla dhe të thjeshta. Plaku Dejvid A. Bednar e përshkroi këtë parim në një Konferencë për Gratë në UBJ: “Ne mund të mësojmë shumë për natyrën dhe rëndësinë e këtij modeli shpirtëror nga teknika e . . . derdhjes së ujit në tokë me ritme shumë të ngadalta”, në dallim nga vërshimi ose spërkatja e sasive të mëdha të ujit atje ku mund të mos jetë e nevojshme.

Ai shpjegoi: “Pikat e vazhdueshme të ujit zhyten thellë në tokë dhe sigurojnë një nivel të lartë lagështie në tokë në të cilën bimët mund të lulëzojnë. Në të njëjtën mënyrë, nëse unë dhe ju jemi të përqendruar dhe të shpeshtë në marrjen e pikave të qëndrueshme të ushqimit shpirtëror, atëherë rrënjët e ungjillit mund të zhyten thellë në shpirtin tonë, mund të bëhen të vendosura e të ngulitura fort dhe mund të prodhojnë fryte të jashtëzakonshme e të shijshme.”

Duke vazhduar, ai tha: “Modeli shpirtëror i gjërave të vogla dhe të thjeshta që sjellin gjëra të mëdha, prodhon qëndrueshmëri dhe vendosmëri, përkushtim që thellohet dhe kthim më të plotë në besim në Zotin Jezu Krisht dhe në ungjillin e Tij.”⁹

Profeti Jozef Smith e dha mësim këtë parim me fjalë që tani përfshihen te Doktrina e Besëlidhje: “Askush të mos i numërojë ato gjëra si të vogla; sepse

ka shumë . . . lidhur me shenjtoret, që vare[n] nga këto gjëra” (DeB 123:15).

Lidhur me përpjekjet më të hershme për ta ngritur Kishën në Misuri, Zoti këshilloi durim pasi të “gjitha gjërat duhet të ndodhin në kohën e tyre” (DeB 64:32). Më pas Ai dha këtë mësim të madhërishtëm: “Prandaj, mos u lodhni së bëri mirë, sepse ju po ngrini themelin e një veprë të madhe. Dhe nga gjëra të vogla vjen ajo që është e madhe” (DeB 64:33).

Unë besoj se të gjithë ne dëshirojmë ta ndjekim sfidën e Presidentit Rasëll M. Nelson për të ecur përpara “në rrugën e besëlidhjes”¹⁰. Angazhimi ynë për ta bërë këtë forcohet nga ndjekja vazhdimisht e “gjëra[ve të] vogla” që na janë mësuara nga ungjilli i Jezu Krishtit dhe udhëheqësit e Kishës së Tij. Unë dëshmoj për Të dhe i kërkoj bekimet e Tij për të gjithë ata që përpiqen të vazhdojnë në shtegun e Tij të besëlidhjeve, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. “Oh, sa Urti dhe Dashuri”, *Himne*, nr. 110.
2. “A Kam Bër’ Ndonjë të Mirë?” *Himne*, nr. 139.
3. Steven C. Wheelwright, “The Power of Small and Simple Things” (takim shpirtëror në Universitetin “Brigam Jang – Havai”, 31 gusht 2007), f. 2, devotional.byuh.edu.
4. *Mësim të Presidentëve të Kishës: Hauard W. Hanter* (2015), f. 165.
5. Dan Coats, “America’s Youth: A Crisis of Character”, *Imprimis*, vëll. 20, nr. 9 (shtator 1991), f. 4; shih edhe Plaku Uilford Andersen në kolonën e tij në gazetën *Mesa Tribune*, maj 1996.
6. Brigham Young, fjalim në Tabernakullin e Ogdenit, 19 korrik 1877, siç raportohet në “Discourse”, *Deseret News*, 17 tetor 1877, f. 578.
7. M. Russell Ballard, “Small and Simple Things”, *Ensign*, maj 1990, f. 7, 8.
8. Steven C. Wheelwright, “The Power of Small and Simple Things”, f. 3.
9. David A. Bednar, “By Small and Simple Things Are Great Things Brought to Pass” (Konferenca e Grave në Universitetin “Brigam Jang”, 29 prill 2011), womensconference.byu.edu.
10. Rasëll M. Nelson, “Teksa Ecim Përpara së Bashku”, *Liahona*, prill 2018, f. 7.



Nga Presidenti Rasëll M. Nelson

Zbulesë për Kishën, Zbulesë për Jetën Tonë

Në ditët e ardhshme, nuk do të jetë e mundur të mbijetojmë shpirtërisht pa ndikimin udhërrëfyes, drejtues, ngushëllues dhe të vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë.

Cfarë privilegji i lavdishëm ka qenë të krenrojmë Pashkën me ju në këtë të diel të konferencës së përgjithshme! Asgjë nuk mund të jetë më e përshtatshme sesa të përkujtojmë ngjarjen më të rëndësishme që ndodhi ndonjëherë në këtë tokë, nëpërmjet adhurimit të qenies më të rëndësishme që eci ndonjëherë në këtë tokë. Në këtë, Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, ne adhurojmë Atë që e filloi Shlyerjen e Tij të pafundme në Kopshtin e Gjetsemanit. Ai ishte i gatshëm të vuante për mëkatet dhe dobësitë e secilit prej nesh, vuajtje e cila e bëri Atë t'i "d[ilte] gjak nga çdo por"¹. Ai u kryqëzua në kryqin e Kalvarit (Kafkës)² dhe u ngrit në ditën e tretë si qenia e parë e ringjallur e fëmijëve të Atit tonë Qiellor. Unë e dua Atë dhe dëshmoj se Ai jeton! Është Ai që e udhëheq dhe udhërrëfën Kishën e Tij.

Pa Shlyerjen e pafundme të Shpëtimtarit tonë, as edhe njëri prej nesh nuk do të kishte shpresë që të kthehej ndonjëherë tek Ati ynë Qiellor. Pa Ringjalljen, vdekja do të ishte fundi. Shlyerja e Shpëtimtarit tonë e bëri jetën

e përzetshme një mundësi dhe pavdekësinë një realitet për të gjithë.

Është për shkak të misionit të Tij të jashtëzakonshëm dhe paqes që Ai u jep pasuesve të Tij, që bashkëshortja ime, Uendi, dhe unë ndiem ngushëllim natën e 2 janarit 2018, kur u zgjuam nga një telefonatë që na tha se Presidenti Tomas S. Monson kishte kaluar përmes velit.

Sa na merr malli, Presidenti Monson! Ne e nderojmë jetën e tij dhe trashëgiminë e tij. Si një gjigant shpirtëror, ai la një gjurmë të pashlyeshme mbi të gjithë ata që e njihnin dhe mbi Kishën që ai e donte.

Të dielën, më 14 janar 2018, në dhomën e sipërme të Tempullit të Solt-Lejkut, Presidenca e Parë u riorganizua sipas modelit të thjeshtë, prapëseprapë të shenjtë, të vendosur nga Zoti. Më pas, në kuvendin solemn dje në mëngjes, anëtarët e Kishës anëmbanë botës ngritën duart e tyre që të konfirmonin veprimin e mëparshëm, të ndërmarre nga Apostujt. Jam përvuilësisht mirënjohës për përkrahjen tuaj mbështetëse.

Gjithashtu jam mirënjohës për ata, mbi supet e të cilëve unë qëndroj. Ka qenë privilegji im të shërbej në

Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve për 34 vjet dhe të njihja personalisht 10 nga 16 Presidentët e mëparshëm të Kishës. Mësova shumë nga secili prej tyre.

Gjithashtu u detyrohem shumë paraardhësve të mi. Që të tetë stërgjyshërit dhe stërgjyshet e mia ishin të kthyer në besimin në Kishë nga Europa. Secili prej këtyre njerëzve guximtarë sakrifikoi gjithçka që të vinte në Sion. Gjithsesi, gjatë brezave pasues, jo të gjithë paraardhësit e mi mbetën kaq të zotuar. Si rrjedhojë, unë nuk u rrita në një shtëpi që ishte e përqendruar tek ungjilli.

I adhuroja prindërit e mi. Ata ishin jashtëzakonisht të shtrenjtë për mua dhe më dhanë mësim vendimtar. Nuk mund t'i falënderoj sa duhet për jetën e lumtur familjare që krijuan për mua, për vëllanë tim dhe për motrat e mia. Dhe prapëseprapë, edhe si djalosh, e dija se më mungonte diçka. Një ditë hipa në një tramvaj dhe shkova në një dyqan shdm për të gjetur një libër





rreth Kishës. Më pëlqente shumë të mësoja për ungujillin.

Kur arrita ta kuptoj Fjalën e Urtësisë, doja që prindërit e mi ta jetonin atë ligj. Prandaj, një ditë kur isha shumë e vogël, shkova në bodrum dhe i theva mbi dyshtet prej betoni të gjitha shishet e pijeve alkoolike. Prisja që babai të më ndëshkonte, por ai kurrë nuk tha asnjë fjalë.

Kur u rrita dhe fillova të kuptoj madhështinë e planit të Atit Qiellor, shpesh i thashë vetes: “Nuk dua asnjë dhuratë tjetër për Krishtlindje! Dua vetëm të jem i vulosur me prindërit e mi.” Ajo ngjarje që e prisja me shumë dëshirë, nuk ndodhi gjersa prindërit e mi i kishin kaluar të 80-at, dhe atëherë ajo vërtet ndodhi. Nuk mund ta shpreh plotësisht gëzimin që ndjeva atë ditë³ dhe çdo ditë e ndiej atë gëzim të vulosjes së tyre dhe vulosjes sime me ta.

Në vitin 1945, ndërsa isha në shkollën e mjekësisë, u martova me Denzel Uajtin në Tempullin e Solt-Lejkut. Ajo dhe unë u bekuam me nëntë bija të shkëlqyera dhe një bir të çmuar. Sot familja jonë gjithnjë në rritje është një nga gëzimet më të mëdha të jetës sime.

Në vitin 2005, pas gati 60 vjet martese, Denzeli im e dashur u thirr papritur

në shtëpi. Për njëfarë kohe, pikëllimi im ishte pothuajse paralizues. Por mesazhi i Pashkës dhe premtimi i ringjalljes më mbështetën.

Më pas Zoti solli Uendi Uatsonin përkrah meje. Ne u vulosëm në Tempullin e Solt-Lejkut më 6 prill 2006. Sa shumë e dua atë! Ajo është një grua e jashtëzakonshme – një bekim i madh për mua, për familjen time dhe për të gjithë Kishën.

Secili prej këtyre bekimeve ka ardhur si rrjedhojë e kërkimit të nxitjeve të Frymës së Shenjtë dhe të bindjes ndaj tyre. Tha Presidenti Lorenzo Snou: “Ky është privilegji i madh i çdo shenjtori të ditëve të mëvonshme . . . se është e drejta jonë të kemi shfaqje të Shpirtit në çdo ditë të jetës sonë”⁴.

Një prej gjërave që Shpirti ma ka sjellë si mbresë në mënyrë të përsëritur në mendjen time që nga thirrja ime e re si Presidenti i Kishës, është sesa i gatshëm është Zoti për ta zbuluar mendjen dhe vullnetin e Tij. Privilegji i marrjes së zbulesës është një nga dhuratat më të mëdha të Perëndisë për fëmijët e Tij.

Me anë të shfaqjeve të Frymës së Shenjtë, Zoti do të na ndihmojë në të gjitha përpjekjet tona të drejta. Më kujtohet në një sallë operacioni, kam qëndruar

mbi një pacient – i pasigurt për mënyrën se si ta kryeja një procedurë që nuk ishte bërë kurrë më parë – dhe e kam përjetuar Frymën e Shenjtë duke ma skicuar teknikën në mendjen time.⁵

Që ta forcoja propozimin që i bëra Uendit, i thashë asaj: “Di për zbulesën dhe di se si ta marr atë”. Për meritën e saj – dhe, siç kam arritur të mësoj, tipike për të – ajo tashmë e kishte kërkuar dhe e kishte marrë zbulesën e vet për ne, gjë që i dha kurajën të thoshte “po”.

Si anëtar i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, lutesha çdo ditë për zbulesë dhe e falënderoja Zotin çdo herë që Ai i fliste zemrës dhe mendjes sime.

Përfytyrojemi mrekullinë e saj! Cilado qoftë thirrja jonë në Kishë, ne mund t'i lutemi Atit tonë Qiellor dhe të marrim udhërrëfim e drejtim, të paralajmërohemi për rreziqet e shpërqendrimet dhe të aftësohemi për të përmbushur gjëra që thjesht nuk mund t'i bënim vetë. Nëse me të vërtetë do ta marrim Frymën e Shenjtë dhe do të mësojmë t'i dallojmë e kuptojmë nxitjet e Tij, ne vërtet do të udhërrëfemi në çështje të mëdha e të vogla.

Kur kohët e fundit u përballa me detyrën e vështirë të zgjedhjes së dy këshilltarëve, pyesja veten se si mund

të zgjidhja vetëm dy prej dymbëdhjetë burrave që i dua dhe i respektoj.

Ngaqë e di se frymëzimi i mirë bazohet mbi informacion të mirë, unë plot lutje u takova një e nga një me secilin Apostull.⁶ Më pas e izolova veten në një dhomë private në tempull dhe kërkova vullnetin e Zotit. Unë dëshmoj se Zoti më udhëzoi të përzgjidhja Presidentin Dallin H. Oaks dhe Presidentin Henri B. Ajring që të shërbejnë si këshilltarët e mi në Presidencën e Parë.

Në mënyrë të ngjashme, unë dëshmoj se Zoti e frymëzoi thirrjen e Plakut Gerrit W. Gong dhe të Plakut Ulises Soares që të shuguroheshin si Apostuj të Tij. Unë dhe ne i mirëpresim ata në këtë vëllazëri të pashoqe shërbimi.

Kur mbledhemi si Këshill i Presidencës së Parë dhe i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, dhomat tona të mbledhjeve bëhen dhoma zbuluese. Shpirti është i pranishëm në mënyrë të dukshme. Teksa ndeshemi me çështje të ndërlikuara, një proces emocional shpalolet ndërkohë që secili Apostull shpreh lirisht mendimet dhe

pikëpamjen e tij. Edhe pse mund të ndryshojmë në këndvështrimet tona fillestare, dashuria që ndiejmë për njëri-tjetrin është e pandryshueshme. Uniteti ynë na ndihmon të dallojmë vullnetin e Zotit për Kishën e Tij.

Në mbledhjet tona, kurrë nuk sundon shumica! Ne e dëgjojmë plot lutje njëri-tjetrin dhe flasim me njëri-tjetrin derisa jemi të njëzëshëm. Më pas kur kemi arritur të jemi tërësisht të një zëri, ndikimi bashkues i Frymës së Shenjtë është tepër rrëqethës! Ne përjetojmë atë që Profeti Jozef Smith e dinte kur dha mësim: “Nga uniteti i ndjenjës ne marrim fuqi nga Perëndia”⁷. Asnjë anëtar i Presidencës së Parë ose i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve nuk do t’ia lërë kurrë vendimet për Kishën e Zotit gjykimit të vet më të mirë!

Vëllezër e motra, si mund të bëhemi burrat dhe gratë – shërbëtorët si Krishti – që Zoti ka nevojë që ne të bëhemi? Si mund të gjejmë përgjigje për pyetje që na pësjtjellojnë? Nëse përvoja e pashoqe e Jozef Smithit në Korijen e Shenjtë na mëson ndonjë gjë, është se qiejt janë hapur dhe se Perëndia u flet fëmijëve të Tij.

Profeti Jozef Smith caktoi një model për ne që ta ndjekim në zgjidhjen e pyetjeve tona. I tërhequr drejt premtimit të Jakobit që, në qoftë se na mungon urtia, ne mund të kërkohet nga Perëndia⁸, djaloshi Jozef e çoi pyetjen e tij drejtpërsëdrejti tek Ati Qiellor. Ai kërkoi zbuluesë vetjake dhe kërkimi i tij e hapi këtë periudhë të fundit ungjillore.

Në mënyrë të ngjashme, çfarë do të hapë kërkimi juaj për ju? Çfarë urtësie ju mungon? Çfarë mendoni se keni nevojë të ngutshme për të ditur ose kuptuar? Ndiqni shembullin e Profetit Jozef. Gjeni një vend të qetë ku mund të shkoni rregullisht. Përujeni veten përpara Perëndisë. Hapjani zemrën Atit tuaj Qiellor. Drejtojuni Atij për përgjigje e ngushëllim.



Lutuni në emrin e Jezu Krishtit për shqetësimet tuaja, frikën tuaj, dobësitë tuaja – po, pikërisht dëshirat e zemrës suaj. Dhe më pas dëgjoni! Shkruajini mendimet që ju vijnë në mendje. Shënojin ndjenjat dhe pasojini me veprimet që nxiteni t’i bëni. Kur e përsëritni këtë proces ditë pas dite, muaj pas muaji, vit pas viti, ju do të “rriteni drejt parimit të zbuluesës”⁹.

A *do* Perëndia vërtet të flasë me ju? Po! “Po aq sa njeriu mundet ta shtrijë krahun e tij të dobët për të ndaluar lumin Misuri në udhën e tij të përcaktuar . . . aq mund të pengohet i Plotfuqishmi nga derdhja e diturisë së tij prej qiellit mbi kokat e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.”¹⁰

Nuk keni përse ta pyetni veten se çfarë është e vërtetë.¹¹ Nuk keni përse ta pyesni veten se kujt mund t’i mirëbesoni me siguri. Nëpërmjet zbuluesë vetjake, ju mund të merrni vetë dëshminë tuaj se Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë, se Jozef Smithi është një profet dhe se kjo është Kisha e Zotit. Pavarësisht nga ajo që mund të thonë ose bëjnë të tjerët, askush nuk mund ta largojë asnjëherë një dëshmi të lindur në zemrën dhe mendjen tuaj për atë që është e vërtetë.

Ju nxit të shtrihen përtej aftësisë suaj të tanishme shpirtërore për të marrë zbuluesë vetjake, sepse Zoti ka premtuar që “në qoftë se do të kërkosh, ti do të marrësh zbuluesë pas zbuluese, dituri pas diturie, që të mund të dish misteret dhe gjërat paqësore – ato që sjellin gëzim, ato që sjellin jetë të përjetshme”¹².

O, ka shumë më tepër që Ati juaj në Qiell dëshiron që ju të dini. Siç nga mësoi Plaku Nil A. Maksuell: “Atyre që kanë sy për të parë dhe veshë për të dëgjuar, është e qartë se Ati dhe Biri po ua zbulojnë të fshehtat e gjithësisë!”¹³

Asgjë nuk i hap qiejt ashtu si ndërthurja e pastërtisë më të madhe, bindjes së përpiktë, kërkimit të zellshëm, ushqimit me bollëk me fjalët e Krishtit në Librin e Mormonit¹⁴ dhe kohës së vazhdueshme, të zotuar për punën në tempull dhe punën e historisë familjare.

Sigurisht mund të ketë raste kur ndieni sikur qiejt janë mbyllur. Por ju premtoj se kur vazhdoni të jeni të bindur, duke shprehur mirënjohje për çdo bekim që ju jep Zoti, dhe kur e nderoni me durim kohën e Zotit, juve do t'ju jepet dituria dhe kuptueshmëria që kërkoni. Çdo bekim që Zoti e ka për ju – madje mrekullitë – do të pasojnë. Kjo është çfarë do të bëjë për ju zbulesa vetjake.

Unë jam optimist për të ardhmen. Do të jetë e mbushur me mundësi për secilin prej nesh që të përparojë, të japë ndihmesë dhe ta çojë ungjillin në çdo cep të tokës. Por gjithashtu nuk jam naiv për ditët përpara nesh. Jetojmë në një botë që është e ndërlikuar dhe gjithnjë e më shumë kundërshtuese. Fakti që mediat shoqërore janë përherë në dispozicion dhe cikli 24-orësh i lajmeve na bombardojnë me mesazhe të pamëshirshme. Nëse duam të kemi ndonjë shpresë për ta shoshitur morinë e zërave dhe filozofive të njerëzve që e sulmojnë të vërtetën, ne duhet të mësojmë të marrim zbulësë.

Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë, Jezu Krishti, do të kryejë disa nga veprat e Tij më të fuqishme midis kohës së tanishme dhe kohës kur Ai të vijë përsëri. Ne do të shohim tregues të mrekullueshëm se Perëndia, Ati, dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, kryesojnë mbi këtë Kishë në madhësi të lavdi. Por në ditët e ardhshme, nuk do të jetë e mundur të mbijetojmë shpirtërisht pa ndikimin udhërrëfyes, drejtues, ngushëllues dhe të vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, ju lutem që ta rritni aftësinë tuaj



shpirtërore për të marrë zbulësë. Qoftë kjo e diel Pashke një çast përcaktues në jetën tuaj. Zgjidhni të bëni punën shpirtërore që kërkohet për ta pasur dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe për ta dëgjuar zërin e Shpirtit më shpesh e më qartë.

Sikurse bëri Moroni, unë ju këshilloj këtë Shabat Pashke “të vini te Krishti dhe të merrni çdo dhuratë të mirë”¹⁵, duke filluar me dhuratën e Frymës së Shenjtë, dhuratë e cila mund dhe do ta ndryshojë jetën tuaj.

Ne jemi pasues të Jezu Krishtit. E vërteta më e rëndësishme që Fryma e Shenjtë do t'ju dëshmojë ndonjëherë është se Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë. Ai jeton! Ai është Avokati ynë me Atin, Shembulli ynë dhe Shëlbuesi ynë. Këtë të diel Pashke, ne përkujtojmë fljimin e Tij shlyes, Ringjalljen e Tij të mirëfilltë dhe hyjninë e Tij.

Kjo është Kisha e Tij, e rivendosur nëpërmjet Profetit Jozef Smith. Dëshmoj kështu, duke shprehur dashurinë time për secilin prej jush, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 19:18.
2. Shih Lluca 23:33.
3. Shih Alma 26:16.
4. *Mësime të Presidentëve të Kishës: Lorenzo Snou* (2012), f. 78.
5. Shih Russell M. Nelson, “Sweet Power of Prayer”, *Liahona*, maj 2003, f. 7–8.
6. Shih 3 Nefi 28:1.
7. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 421.
8. Shih Jakob [Bibël] 1:5.
9. *Mësimet: Jozef Smith*, f. 136.
10. Doktrina e Besëlidhje 121:33.
11. Shih Moroni 10:5.
12. Doktrina e Besëlidhje 42:61.
13. Neal A. Maxwell, “Meek and Lowly” (takim shpirtëror në Universitetin “Brigam Jang”, 21 tetor 1986), f. 9, speeches.byu.edu.
14. Shih 2 Nefi 32:3.
15. Moroni 10:30.



Nga Plaku Gerit W. Gong,
i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve

Zoti Krisht Ësht’ Ngritur Sot

Kjo është e diela e Pashkës. Unë me nderim jap dëshmim dhe solemnisht dëshmoj për Krishtin e gjallë - për Atë i cili “vdiq, u varros dhe u ngrit sërish ditën e tretë dhe u ngjiti në qiell”.

Të dashur vëllezër dhe motra, kur djemtë tanë ishin shumë të vegjël, u tregoja histori për qenusha të vegjël para se të flinin dhe u këndoja nën zë himne për t’i vënë në gjumë, përfshirë “Zoti Krisht Ësht’ Ngritur Sot”¹. Nganjëherë me shaka i ndryshoja fjalët: “Erdhi koha t’shkojm’ për gjum’, aleluja”. Zakonisht djemtë tanë binin në gjumë me të shpejtë, ose të paktën ata e dinin se po të mendoja që ishin në gjumë, do të pushoja së kënduari.

Fjalët – të paktën fjalët e mia – nuk mund t’i shprehin ndjenjat mbizotëruese që kur Presidenti Rasëll M. Nelson me dashuri i mori duart e mia në duart e tij, me Suzanën time të dashur në kra-hun tim, dhe më drejtoi këtë thirrje të shenjtë nga Zoti, e cila më la pa frymë dhe më ka bërë që të derdh lot shumë herë në këto ditë të kaluara.

Këtë Shabat Pashke, unë këndoj plot gëzim “Aleluja”. Kënga e dashurisë shëlbuese² të Shpëtimtarit tonë të ngritur kremton harmoninë e besëlidhjeve (që na lidhin me Perëndinë dhe njëri-tjetrin) dhe Shlyerjen e Jezu Krishtit (që na ndihmon ta zhveshim burrin dhe gruan

e natyrshme dhe t’i dëgjojmë thirrjet e Frymës së Shenjtë³).

Së bashku, besëlidhjet tona dhe Shlyerja e Shpëtimtarit na bëjnë të zotë dhe fisnikë. Së bashku, ato na ndihmojnë të mbahemi fort tek ungjilli dhe t’i largohemi mëkatit. Së bashku, ato ëmbëlsojnë, ruajnë, shenjtërojnë, shëlbojnë.

Tha Profeti Jozef Smith: “Disave mund t’iu duket si një doktrinë shumë e guximshme ajo për të cilën po flasim – një fuqi që regjistron ose lidh në tokë dhe lidh në qiell. Megjithatë, në të gjitha epokat e botës, kurdoherë që Zoti ia ka dhënë një kujdestari të priftërisë një njeriu ose një grupi njerëzish, me anë të zbulesës aktuale, kjo fuqi është dhënë gjithmonë.”⁴

Dhe kështu është sot. Besëlidhjet dhe ordinancat e shenjta, që nuk janë në dispozicion askund tjetër, merren në 159 shtëpi të shenjta të Zotit në 43 vende. Bekimet e premtuara vijnë nëpërmjet çelësave të rivendosur të priftërisë, doktrinës dhe autoritetit, duke pasqyruar besimin, bindjen tonë dhe premtimet e Shpirtit të Tij të Shenjtë, për ne në brezat tanë, në kohë e përjetësi.

Të dashur vëllezër dhe motra në çdo komb, fis dhe gjuhë, kudo në Kishën tonë mbarëbotërore, ju falënderoj për besimin tuaj të gjallë, shpresën dhe dashurinë tuaj hyjnore në çdo hap. Falënderit që jeni mbledhur së bashku plot dëshmi dhe përvojë për ungjillin e rivendosur.

Vëllezër dhe motra të dashura, ne i përkasim njëri-tjetrit. Ne mund të jemi “të thurur në bashkim dhe dashuri”⁵, në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet⁶. Sikurse Zoti Jezu Krisht e fton secilin prej nesh, kudo ku jemi, cilatdo qofshin rrethanat tona, ju lutem “ejani e shikoni”⁷.

Këtë ditë me përlësi unë ia zotoj gjithë energjitë dhe aftësinë e shpirtit tim⁸, cilatdo të jenë ose të mund të bëhen ato, Shpëtimtarit tim, Suzanës sime të dashur, familjes sonë, Vëllezërve të



mi dhe secilit prej jush, vëllezërit dhe motrat e mia të dashura.

Çdo gjë e denjë dhe e përjetshme është e përqendruar në realitetin e gjallë të Perëndisë, Atit tonë të Përjetshëm e të dashur, dhe Birit të Tij, Jezu Krishtit, dhe të Shlyerjes së Tij, që dëshmohej nga Fryma e Shenjtë.⁹ Kjo është e diela e Pashkës. Me nderim jap dëshmim dhe solemnisht dëshmoj për Krishtin e gjallë – për Atë i cili “vdiq, u varros dhe u ngrit sërish ditën e tretë dhe u ngjiti në qiell”¹⁰. Ai është Alfa dhe Omega¹¹ – me ne që nga fillimi, Ai është me ne deri në mbarim.

Unë dëshmoj për profetët e ditëve të mëvonshme, që nga Profeti Jozef Smith e deri te Presidenti ynë i dashur, Rasëll M. Nelsoni, të cilin e mbështetim plot gëzim. Siç këndojnë fëmijët tanë të Fillores: “Ndiqe profetin; udhën ai di”¹². Unë dëshmoj se, sikurse u profetizua në shkrimet e shenjta, përfshirë në Librin e Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit, “mbretëria e Zotit [është] e ngritur sërish mbi tokë, për të përgatitur për Ardhjen e Dytë të Mesias”¹³. Në emrin e shenjtë dhe të shenjtëruar të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. “Zoti Krisht Është Ngritur Sot”, *Himne*, nr. 119.
2. Shih Alma 5:26.
3. Shih Mosia 3:19.
4. Doktrina e Besëlidhje 128:9.
5. Mosia 18:21.
6. Shih Mosia 18:9.
7. Gjoni 1:39.
8. Shih 1 Nefi 15:25.
9. “Ju keni marrë Frymën e Shenjtë që dëshmon për Atin dhe Birin, deri në plotësimin e premtimit të cilin ai ka bërë, që në qoftë se ju do të hynit nëpërmjet udhës, ju do të merrni” (2 Nefi 31:18).
10. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 52.
11. Shih Doktrina e Besëlidhje 19:1.
12. “Follow the Prophet”, *Children’s Songbook*, f. 111.
13. Parathënia për Librin e Mormonit.



Nga Plaku Ulises Soares,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Profetët Flasin nëpërmjet Fuqisë së Shpirtit të Shenjtë

Profetët që ne i kemi, janë shenjë e dashurisë së Perëndisë për fëmijët e Tij. Ata bëjnë të ditur premtimet dhe natyrën e vërtetë të Perëndisë dhe të Jezu Krishtit.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, kudo qofshi, unë do të doja t’ju shprehja falënderimet e mia të sinqerta dhe të thella për votën tuaj mbështetëse dje. Edhe pse si Moisiu nuk ndihem njeri i gojës dhe ndihem i ngathtë në fjalë, unë e ngushëlloj veten me fjalët e Zotit drejtuar atij:



“Kush e ka bërë gojën e njeriut, ose kush e bën njeriun të pagojë, të shurdhër, me sy ose të verbër? A nuk jam unë vallë, Zoti?”

Dhe tani shko, unë do të jem me gojën tënde dhe do të të mësoj atë që duhet të thuash” (Eksodi 4:11–12; shih edhe vargun 10).

Marr gjithashtu lehtësim nga dashuria dhe mbështetja e bashkëshortes sime të dashur. Ajo ka qenë shembull i mirësisë, dashurisë dhe përkushtimit tërësor ndaj Zotit për mua dhe familjen time. E dua atë me çdo grimë të zemrës sime dhe jam mirënjohës për ndikimin pozitiv që ajo ka pasur mbi ne.

Vëllezër e motra, unë dua t’ju dëshmoj se Presidenti Rasëll M. Nelson është profeti i Perëndisë në tokë. Nuk kam parë kurrë asnjë njeri më të mirë dhe më të dashur sesa është ai. Edhe pse unë u ndjeva i papërshtatshëm për këtë thirrje të shenjtë, fjalët e tij dhe vështrimi i dhembshur në sytë e tij, tek sa ma drejtoi këtë përgjegjësi, më bënë të ndihem i përqaftuar nga dashuria e

Shpëtimtarit. Faleminderit, Presidenti Nelson. Unë ju mbështet dhe ju dua.

A nuk është bekim të kemi profetë, shikues dhe zbulues në tokë në këto ditë në të cilat jetojmë, të cilët kërkojnë të dinë vullnetin e Zotit dhe ta ndjekin atë vullnet? Është ngushëlluese të dimë se nuk jemi vetëm në botë, pavarësisht nga sfidat me të cilat përballemi në jetë. Profetët që ne i kemi, janë shenjë e dashurisë së Perëndisë për fëmijët e Tij. Ata ua bëjnë të ditur premtimet dhe natyrën e vërtetë të Perëndisë dhe të Jezu Krishtit popullit të Tyre. E kam mësuar këtë gjë nëpërmjet përvojave të mia vetjake.

Tetëmbëdhjetë vjet më parë, bashkëshortja ime dhe unë morëm një telefonatë nga Presidenti Xhejms E. Faust, në atë kohë Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë. Na thirri që të shërbenim në Portugali si president misioni dhe shoqja e presidentit të misionit. Na tha se kishim vetëm gjashtë javë përpara se ta fillonim misionin. Edhe pse u ndiem të papërgatitur dhe të papërshtatshëm, ne e pranuan thirrjen. Shqetësimi ynë më i rëndësishëm në atë kohë ishte që të merrnim vizat e kërkuara për të shërbyer në atë vend ngaqë, sipas përvojave tona të shkuara, ne e dinim se procesi kërkonte gjashtë deri në tetë muaj që të përfundohej.

Presidenti Faust atëherë na pyeti nëse kishim besim që Zoti do të kryente një mrekulli dhe që do të ishim në gjendje ta zgjidhnim problemin e vizave më shpejt. Përgjigja jonë ishte një "po" e madhe dhe filluam t'i bënim përgatitjet menjëherë. I përgatitëm dokumentet e kërkuara për vizat, i morëm fëmijët tanë të vegjël dhe shkuam në konsullatë sa më shpejt që mundeshim. Një zonjë shumë e mirë u takua me ne atje. Pasi i shqyrtoi dokumentet tona dhe pasi mësoi se çfarë do të bënim në Portugali, ajo u kthye nga ne dhe



pyeti: "A do ta ndihmoni me të vërtetë popullin e vendit tim?" U përgjigëm "po" me vendosmëri dhe shpjeguan se do të përfaqësonim Jezu Krishtin dhe do të dëshmonim për Të dhe misionin e Tij hyjnor në botë. U kthyem atje katër javë më vonë, i morëm vizat tona dhe hymë në fushën e misionit brenda gjashtë javësh, siç na kishte kërkuar të bënim një profet i Zotit.

Vëllezër dhe motra, nga thellësia e zemrës, unë dëshmoj se profetët flasin me anë të fuqisë së Shpirtit të Shenjtë. Ata dëshmojnë për Krishtin dhe misionin e Tij hyjnor në tokë. Ata përfaqësojnë mendjen dhe zemrën e Zotit dhe thirren për ta përfaqësuar Atë dhe për të na mësuar se çfarë duhet të bëjmë që të kthehemi për të jetuar në praninë e Perëndisë dhe Birit të Tij, Jezu Krishtit. Ne bekohemi kur e ushtrojmë besimin tonë dhe i ndjekim mësimet e

tyre. Duke i ndjekur ata, jeta jonë është më e lumtur dhe më pak e ndërlkuar, vështirësitë dhe problemet tona janë më të lehta për t'u mbajtur dhe ne krijojmë një armaturë shpirtërore përreth nesh, e cila do të na mbrojë nga sulmet e armikut në kohën tonë.

Në këtë ditë Pashke, solemnisht dëshmoj që Jezu Krishti është ngritur, Ai jeton dhe që Ai e drejton Kishën e Tij mbi tokë nëpërmjet profetëve, shikuesve dhe zbuluesve të Tij. Unë dëshmoj se Ai është Shpëtimtari dhe Shëlbuesi i botës dhe se nëpërmjet Tij ne mund të shpëtohem dhe të ekzaltohem në praninë e Perëndisë sonë të dashur. Unë e dua Atë; unë e adhuroj Atë. Dua ta ndjek Atë dhe të bëj vullnetin e Tij dhe të bëhem më shumë si Ai. I them përulësisht këto gjëra në emrin e shenjtë të Zotit tonë, Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Presidenti Rasëll M. Nelson

Dhënia e Shërbesës

Ne do të vëmë në zbatim një qasje më të re, më të shenjtë ndaj përkujdesjes dhe dhënies së shërbesës për të tjerët.

Faleminderit, Plaku Gong dhe Plaku Soares, për shprehjen tuaj të përzemërt të besimit. Jemi shumë mirënjohës për ju dhe shoqërueset tuaja të dashura.

Vëllezër dhe motra të dashura, ne kërkojmë vazhdimisht drejtim nga Zoti mbi mënyrën se si mund t'i ndihmojmë anëtarët tanë që t'i zbatojnë urdhërimet e Perëndisë, veçanërisht ato dy urdhërimet të mëdha për t'i dashur Perëndinë dhe të afërmit tanë.¹

Për muaj me radhë kemi qenë duke kërkuar një mënyrë më të mirë për t'u dhënë shërbesë nevojave shpirtërore e materiale të njerëzve tanë sipas mënyrës së Shpëtimtarit.

Kemi marrë vendimin për t'i ndërprerë mësimet e shtëpisë dhe vizitat mësimore siç i kemi njohur deri tani. Në vend të tyre, do të vëmë në zbatim një qasje më të re, më të shenjtë ndaj përkujdesjes e dhënies së shërbesës për të tjerët. Këtyre përpjekjeve do

t'u referohemi thjesht si “dhënia e shërbesës”.

Përpjekjet e efektshme për dhënie e shërbesës mundësohen nga dhuratat e lindura të motrave dhe nga fuqia e pakrahasueshme e priftërisë. Ne të gjithë kemi nevojë për një mbrojtje të tillë nga kurthet djallëzore të kundërshtarit.

Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe Motra Xhin B. Bingham, Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, do të shpjegojnë mënyrën se si do të funksionojnë tani vëllezërit e caktuar të priftërisë dhe motrat e caktuara të Shoqatës së Ndihmës në shërbimin dhe kujdesin ndaj anëtarëve të Kishës në mbarë botën.

Presidenca e Parë dhe Të Dymbëdhjetët janë të bashkuar për përkrahjen e mesazheve të tyre. Me mirënjohje dhe plot lutje, ne hapim këtë kapitull të ri në historinë e Kishës. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIM

1. Shih Lluka 10:27.





Nga Plaku Xhefri R. Holland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

“Jini me Ta e Forcojini Ata”

Lutja jonë sot është që çdo burrë e çdo grua të largohet nga kjo konferencë e përgjithshme i/e zotuar më thellësisht për një përkujdesje të përzemërt ndaj njëri-tjetrit.

Për të parafrazuar Ralf Ualdo Emersonin, “Çastet më të paharrueshme në jetë janë ato në të cilat ndiejmë një mësymje zbuluese”¹. President Nelson, nuk e di edhe sa “mësymje” të tjera mund të durojmë këtë fundjavë. Disa prej nesh kanë zemra të dobëta. Por tani që e mendoj, ti mund të kujdesesh edhe për këtë gjithashtu. Çfarë profeti!

Në të njëjtën frymë të shpalljeve dhe dëshmime të mrekullueshme të Presidentit Nelson natën e kaluar dhe këtë mëngjes, unë jap dëshminë time që këto përshtatje janë shembuj të zbulësive që e kanë udhëhequr këtë Kishë që prej fillimit të saj. Ato janë sidoqoftë prova të mëtejshme se Zoti po e përshejton punën e Tij në kohën e vet.²

Për të gjithë ata që mezi po presin të mësojnë hollësi për këto çështje, ju lutemi dini se menjëherë pas përfundimit të këtij sesi të konferencës, do të fillojë një sekuencë që përfshin, jo domosdoshmërisht sipas kësaj radhe, dërgimin e një letre nga Presidenca e Parë çdo anëtar/eje të Kishës të cilit/ës i kemi një adresë të postës elektronike. Një dokument shtatë faqesh pyetjesh

dhe përgjigjesh do t’i bashkëngjitet [letres] për të gjithë udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse. Së fundmi, këto materiale po afshohen menjëherë në faqen ministering.lds.org. “Lypni dhe do t’ju jepet; kërkoni dhe do të gjeni”³.

Tani [do flas] rreth detyrës së mrekullueshme që Presidenti Nelson na ka dhënë mua dhe Motrës Xhin B. Bingham. Vëllezër e motra, ndërsa puna e kuorumeve dhe organizatave ndihmëse bëhet më e pjekur nga ana institucionale, del që ne duhet të piqemi personalisht po ashtu – duke u ngritur individualisht mbi çdo rutinë mekanike e të përsëritur të bërë pa ndjenjë të një dishepullim i bërë me zemër, të shprehur qartësisht nga Shpëtimtari në përmbylljen e shërbesës së Tij tokësore. Ndërsa përgatitja ta linte grupin e Tij të vogël, ende të pafajshëm dhe disi të pëshqjelluar të pasuesve, Ai nuk renditi një duzinë hapash administrativë që ata duhej të ndërmerrnin ose nuk u dorëzoi një tufë raportesh që duheshin plotësuar në tri kopje. Jo, Ai e përmbodhi detyrën e tyre në një urdhërim themelor: “Ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam

dashur . . . Prej kësaj do t’ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin”⁴.

Në përpjekje për të na afruar më pranë atij ideali të ungjillit, ky koncept i saposhpallur i dhënies së shërbesës nga priftëria dhe Shoqata e Ndhmës do të përfshijë, mes të tjerash, elementët vijues, disa prej të cilave Shoqata e Ndhmës i ka zbatuar tashmë me një sukses të mahnitshëm⁵.

- Nuk do të përdorim më terminologjinë mësim shtëpie dhe vizitë mësimore. Kjo bëhet pjesërisht sepse shumë prej përpjekjes sonë për të dhënë shërbesë do të jetë në mjedise të tjera përveçse shtëpisë dhe pjesërisht sepse kontaktet tona nuk do të përcaktohen nga mësimet të përgatitura për t’u dhënë mësim, edhe pse një mësim sigurisht që mund të jepet nëse ka nevojë për një të tillë. Qëllimi kryesor i kësaj ideje për dhënie të shërbesës do të jetë, ashtu siç u tha për njerëzit



në kohën e Almës, që të “kujdes[el] n për njerëzit e tyre dhe [të] ushq[eh] en me gjëra që kishin të bënin me drejtësinë”⁶.

- Ne do të vazhdojmë t’i vizitojmë shtëpitë kur të jetë e mundur, por rrethana vendore të tilla si një numër i madh vizitash, largësi të mëdha, siguria vetjake dhe kushte të tjera sfiduese mund ta pengojnë të bërit e një vizite në çdo shtëpi çdo muaj. Ashtu si Presidenca e Parë na këshilloi vite më parë, bëni më të mirën që mundeni.⁷ Përveçse çfarëdo orari që vendosni për vizitat aktuale, ai kalendar mund të plotësohet me telefonata, shënime të shkruara, mesazhe me celular, postë elektronike, biseda me video, bashkëbisedime në mbledhjet e Kishës, projekte shërbimi të përbashkëta, veprimtari shoqërore dhe një mori mundësish në botën e mjeteve shoqërore. Megjithatë, duhet të theksoj se kjo pamje e re e zgjeruar nuk përfshin ndjesinë e keqardhjes që e pashë kohët e fundit në një ngjithëse që ishte vendosur në një makinë. Ajo thoshte: “Nëse unë i bie borisë, ti e ke marrë mësimin e shtëpisë.” *Ju lutemi*, ju lutemi, vëllezër (motrat nuk do të jenë kurrë fajtores për këtë – u drejtohem vëllezërve të Kishës), me këto përshtatje ne duam më shumë përkujdesje dhe interesim, jo më pak.
- Me këtë koncept më të ri të dhënies së shërbesës, më të bazuar në ungjill, mendoj se po fillon t’ju zërë ankthi rreth asaj që llogaritet në raport. Epo, qetësohuni, sepse nuk ka asnjë raport – të paktën nuk ka raport të datës 31 të muajit që thotë: “Mezi ia dola mbanë t’u hyj në derë”. Edhe këtu gjithashtu po përpiqemi të piqemi. I vetmi raport që do të bëhet është numri i intervistave që udhëheqësit patën me dyshet



shërbestare në lagje për atë tremujor. Ashtu të thjeshta si duken, miqtë e mi, ato intervista janë absolutisht vendimtare. Pa atë informacion, peshkopi nuk do të ketë asnjë mënyrë ta marrë informacionin që i nevojitet në lidhje me kushtet shpirtërore dhe materiale të njerëzve të tij. Mbajeni mend: vëllezërit shërbetarë përfaqësojnë peshkopatën dhe presidencën e kuorunit të pleqve; ata nuk i zëvendësojnë ato. Çelësat e një peshkopi dhe presidentit të kuorunit shkojnë përtej këtij parimi të dhënies së shërbesës.

- Për shkak se ky raport është ndryshe nga çdo gjë që keni dorëzuar më parë, më lejoni të theksoj se *ne* në zyrat qendrore të Kishës nuk kemi nevojë të dimë se *si* ose se *ku* apo se *kur* u vutë në kontakt me njerëzit tuaj; neve thjesht na nevojitet ta dimë dhe të kujdesemi që ju *njëmend* ta bëni atë dhe që t’i bekonin ata në çdo mënyrë që mundeni.

Vëllezër e motra, ne kemi një mundësi qiellore si një Kishë e tërë të tregojmë “fe [të] pastër . . . pa njollë përpara Perëndisë”⁸ – “të mbajmë] barrat e njëri-tjetrit, që ato të mund të jenë të lehta” dhe “të ngushëllojmë] ata që kanë nevojë të ngushëllohen”⁹, t’u

shërbejmë të vejave dhe jetimëve, të martuarve dhe beqarëve, të fuqishmëve dhe të shqetësuarve, të shtypurve dhe të shëndetshmëve, të lumturve dhe të trishtuarve – me pak fjalë, të gjithëve ne, secilit prej nesh, sepse ne të gjithë kemi nevojë ta ndiejmë dorën e ngrohëse të miqësisë dhe të dëgjojmë një shpallje të palëkundur të besimit. Sidoqoftë, ju paralajmëroj, një emër i ri, një përshtatshmëri e re dhe më pak raporte nuk do të sjellin asnjë grimë ndryshimi në shërbimin tonë, nëse nuk e shohim këtë si një ftesë për t’u përkujdesur për njëri-tjetrin në një mënyrë guximtare, të re dhe më të shenjtë, ashtu siç sapo tha Presidenti Nelson. Ndërsa i ngremë sytë tanë shpirtërorë drejt të jetuarit të ligjit të dashurisë në mënyrë më tërësore, ne i nderojmë brezat që kanë shërbyer në atë mënyrë për vite të tëra. Më lejoni të tregoj një shembull të kohëve të fundit të një përkushtimi të tillë, me shpresën se legjione më shumë do ta rrokin urdhërimin e Zotit që “të jelmij me ta e t’i forcojmë”¹⁰ vëllezërit e motrat tona.

Në 14 janar të këtij viti, një të diel, pak pas orës 17:00, miqtë e mi të rinj në moshë, Bret dhe Kristina Hamblin, po bisedonin në shtëpinë e tyre në Tempi të Arizonës, pasi Breti e kishte kaluar ditën duke shërbyer në peshkopatë dhe Kristina duke pasur një ditë të zënë me përkujdesjen për pesë fëmijët e tyre.

Papritur Kristina, një e mbijetuar në dukje me sukses e kancerit të gjirit gati një vit më parë, ra pa ndjenja. Një telefonatë që iu bë urgjencës solli një ekip të ndihmës së shpejtë që u përpoq dëshpërimisht për ta sjellë në vete. Ndërsa Breti lutej dhe përgjerohej, ai me të shpejtë bëri vetëm dy telefonata të tjera: njëra ishte për nënën e tij duke i kërkuar që ta ndihmonte me fëmijët, tjetra ishte për Eduin Poterin, mësuesin e tij të shtëpisë. Biseda e dytë në tërësinë e saj vijoi si më poshtë:

Eduini, duke vënë re emrin që u shfaq në telefon, tha: “Po, Bret, ç’kemi?”

Përgjigja e Bretit që u tha gati duke bërëtitur ishte: “Të dua këtu – tani!”

Sa hap e mbyll sytë, shoku i Bretit në priftëri ishte duke qëndruar përkrah tij, duke e ndihmuar me fëmijët dhe më pas duke e çuar Vëllanë Hamblin në spital prapa ambulancës që po transportonte bashkëshorten e tij. Atje, në më pak se 40 minuta pasi ajo fillimisht i kishte mbyllur sytë, mjekët e shpallën Kristinën të vdekur.

Ndërsa Breti qante me dënësë, Eduini e mbajti në krahët e tij dhe qau me të – për një kohë mjaft të gjatë. Pastaj, duke e lënë Bretin të vajtonte me pjesëtarë të tjerë të familjes që ishin mbledhur, Eduini shkoi me makinë te shtëpia e peshkopit për t’i treguar atë që sapo kishte ndodhur. Një peshkop i mrekullueshëm u nis menjëherë për në spital ndërkohë që Eduini shkoi për në shtëpinë e familjes Hamblin. Atje, ai dhe bashkëshortja e tij, Sharlota, e cila kishte ardhur gjithashtu duke vrapuar, luajtën me të pesë fëmijët tani pa nënë të familjes Hamblin, të moshës 12 deri në 3 vjeç. Ata u dhanë vaktin e mbrëmjes, bënë një koncert muzikor të improvizuar dhe i ndihmuan që të bëheshin gati për të fjetur.

Breti më vonë më tha: “Pjesa e mahnitshme e kësaj historie nuk është se Eduini erdhi kur i telefonova. Në një rast të ngutshëm, ka gjithmonë njerëz që janë të gatshëm të ndihmojnë. Jo, pjesa e mahnitshme e kësaj historie është se ai që i vetmi për të cilin mendova. Kishte njerëz të tjerë përreth. Kristina ka një vëlla dhe një motër që janë më pak se pesë kilometra larg. Ne kemi një peshkop të mrekullueshëm, më të mrekullueshmin. Por marrëdhënia midis meje dhe Eduinit është e tillë sa që ndjeva instinktivisht t’i telefonoja kur kisha nevojë për ndihmë. Kisha na

siguron një mënyrë të strukturuar për ta jetuar më mirë urdhërimin e dytë – t’i duam, t’u shërbejmë dhe të zhvillojmë marrëdhënie me vëllezërit dhe motrat tona të cilat na ndihmojnë të afrohem më pranë Perëndisë.”¹¹

Eduin tha për përvojën: “Plaku Holland, ironia e gjithë kësaj është se Breti kishte qenë mësuesi ynë i shtëpisë për më shumë kohë sesa kisha qenë unë mësuesi i tyre. Gjatë asaj kohe, ai na ka vizituar më shumë si mik se sa nga detyra. Ai ka qenë një shembull i mrekullueshëm, mishërimi i asaj që duhet të jetë një mbajtës aktiv dhe i përfshirë i priftërisë. Bashkëshortja ime, djemtë tanë – ne nuk e shohim atë si një njeri që detyrohet të na sjellë një mesazh në fund të çdo muaji; ne e shohim atë si një mik i cili jeton pak metra më tutje dhe në kthesë të rrugës, i cili do të bënte çdo gjë në këtë botë për të na bekuar. Jam i lumtur që munda të shlyej fare pak nga borxhi që i detyrohem atij.”¹²

Vëllezër e motra, bashkohem me ju për të përshëndetur çdo mësues



të bllokut dhe çdo mësues të lagjes dhe të shtëpisë, si dhe çdo mësuese vizitore që ka dashur dhe ka shërbyer kaq besnikërisht gjatë gjithë historisë sonë. Lutja jonë sot është që çdo burrë e çdo grua – dhe të rinjtë e të rejtat tona më të rritura – do të largohen nga kjo konferencë e përgjithshme të zotuar më thellësisht për një përkujdesje të përzemërt ndaj njëri-tjetrit, të shtyrë vetëm nga dashuria e pastër e Krishtit për ta bërë këtë gjë. Pavarësisht se çfarë ne të gjithë ndiejmë se janë kufizimet dhe papërshtatshmëritë tona – dhe të gjithë kemi sfida – megjithatë, punofshim krah për krah me Zotin e vreshtit,¹³ për t’i dhënë Perëndisë dhe Atit tonë një dorë ndihmuese në këtë detyrë shumë kërkuese të Tij për t’iu përgjigjur lutjeve, për të dhënë ngushëllim, për të tharë lot dhe për të forcuar gjunjët e këputur.¹⁴ Nëse do ta bëjmë atë, ne do të jemi më shumë si dishepujt e vërtetë të Krishtit që kemi për qëllim të jemi. Këtë të dielë Pashke, le ta duam njëri-tjetrin ashtu si na ka dashur Ai¹⁵, unë lutem në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Ralph Waldo Emerson, *The Conduct of Life* (1860), f. 268.
2. Shih Doktrina e Besëlidhje 88:73.
3. Lluca 11:9.
4. Gjoni 13:34–35.
5. Shih “Mbajini Lidhjet me Të në Çdo Kohë”, në *Çdo Vend dhe në Çdo Mënyrë*, *Liahona*, janar 2018, f. 7.
6. Mosia 23:18; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 20:53.
7. Shih “Watching Over and Strengthening Members”, letër e Presidencës së Parë, 10 dhjetor 2001.
8. Jakobi [Bibël] 1:27.
9. Mosia 18:8–9.
10. Doktrina e Besëlidhje 20:53.
11. Brett Hamblin, korrespondencë vetjake, shkurt 2018.
12. Edwin Potter, korrespondencë vetjake, shkurt 2018.
13. Shih Jakobi 5:70–72.
14. Shih Doktrina e Besëlidhje 81:5.
15. Shih Gjoni 15:12.



Nga Xhin B. Bingham,
Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndhmës

Dhënia e Shërbesës ashtu siç e Jep Shpëtimtari

E tregofshim mirënjohjen dhe dashurinë tonë për Perëndinë duke u dhënë shërbesë me dashuri motrave dhe vëllezërve tanë të përrjetshëm!

Çfarë bekimi i mrekullueshëm është të jetosh në një kohë zbuluese të vazhdueshme nga Perëndia! Ndërkohë që mezi e presim dhe e pranojmë “ripërtëritje[n e] të gjitha gjërave”¹, e cila ka ardhur dhe do të vijë nëpërmjet ngjarjeve të profetizuara për kohën tonë, ne po përgatitemi për Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit.²

Dhe ku ka mënyrë më të mirë për t’u përgatitur që ta takojmë Atë sesa të përpiqemi fort për t’u bërë si Ai nëpërmjet dhënies së shërbesës me dashuri ndaj njëri-tjetrit! Ashtu si Jezu Krishti u mësoi pasuesve të Tij në fillim të kësaj periudhe ungjillore: “Nëse më do[ni], duhet të më shërbe[ni]”³. Shërbimi ynë ndaj të tjerëve është një shprehje e dishepullimit, e mirënjohjes dhe e dashurisë sonë për Perëndinë dhe Birin e Tij, Jezu Krishtin.

Nganjëherë ne mendojmë se duhet të bëjmë diçka madhështore dhe heroike që të “llogaritet” si shërbim ndaj të afërmeve tanë. Sidoqoftë, veprime të thjeshta të shërbimit mund të kenë një ndikim të thellë tek të tjerët – si edhe te ne vetë. Çfarë bëri Shpëtimtari?

Nëpërmjet dhuratave të Tij hyjnore të Shlyerjes dhe Ringjalljes – të cilën ne e kremtojmë këtë të diel të bukur Pashke – “asnjë tjetër nuk ka pasur një ndikim kaq të thellë mbi të gjithë njerëzit që kanë jetuar dhe që ende do të jetojnë në tokë”⁴. Por Ai gjithashtu u buzëqeshi njerëzve, bisedoi me ta, eci me ta, i dëgjoi, gjeti kohë për ta, i



nxiti, u dha mësim, i ushqeu dhe i fali ata. Ai u shërbeu njëlloj familjes dhe miqve, të afërmeve dhe të huajve, dhe i ftoi të njohurit dhe njerëzit e dashur që të gëzonin bekimet e pasura të ungjillit të Tij. Ato veprime “të thjeshta” shërbimi dhe dashurie japin një model për dhënien e shërbesës sonë sot.

Ndërsa keni privilegjin ta përfaqësoni Shpëtimtarin në përpjekjet tuaja për të dhënë shërbesë, pyeteni veten tuaj: “Si mund ta ndaj dritën e ungjillit me këtë individ apo familje? Çfarë po më frymëzon Shpirti të bëj?”

Dhënia e shërbesës mund të bëhet në një llojshmëri të madhe mënyrash të individualizuara. Pra, cilët janë disa shembuj të dhënies së shërbesës?

Shembuj të dhënies së shërbesës janë kur presidenca e kuorumit të pleqve dhe presidenca e Shoqatës së Ndhmës këshillohen plot lutje rreth detyrave. Në vend që thjesht të shpërndajnë fleta letre, udhëheqësit, kur të caktojnë vëllezër dhe motra shërbestare, mund të këshillohen me ta rreth individëve e familjeve. Dhënia e shërbesës mund të jetë të bëni një shëtitje, të mbledhjeni së bashku për një mbrëmje lojërash, të ofroni shërbim ose madje të shërbeni së bashku. Mund të jetë të bëni një vizitë ose të flisni në telefon apo të bisedoni nëpërmjet internetit ose me mesazhe në celular. Mund të jetë të dërgoni një kartolinë ditëlindjeje dhe të bëni tifozllëk në një lojë futbolli. Mund të jetë të ndani një shkrim të shenjtë apo citim nga një bisedë konference që do të ishte domethënëse për atë individ. Mund të jetë të diskutoni për një pyetje mbi ungjillin dhe të jepni dëshmi për të sjellë qartësi e paqe. Mund të jetë të bëheni pjesë e jetës së dikujt dhe të kujdeseni për të. Mund të jetë një intervistë për dhënien e shërbesës në të cilën diskutohen nevojat dhe anët e forta me ndjeshmëri

dhe në mënyrën e duhur. Mund të jetë organizimi i këshillit të lagjes për t'iu përgjigjur një nevoje më të madhe.

Kjo lloj shërbese e forcoi një motër që u shpërngul shumë larg shtëpisë, kur bashkëshorti i saj filloi shkollën pasuniversitare. Ngaqë nuk kishte një telefon funksional dhe me një foshnjë të vogël për t'u kujdesur, ajo u ndje e çorientuar në vendndodhjen e re, krejtësisht e humbur dhe e vetme. Pa njoftim paraprak, një motër e Shoqatës së Ndihmës erdhi në derë duke i sjellë një palë këpucë për foshnjën, i futi të dyja në makinën e vet dhe i çoi për të gjetur dyqanin e ushqimeve. Motra mirënjohëse raportoi: "Ajo ishte mjeti im i shpëtimit!"

Dhënia e vërtetë e shërbesës ilustruhet nga një motër e moshuar në Afrikë, e cila u caktua të kërkonte një motër që nuk i kishte ndjekur mbledhjet e Kishës për një kohë të gjatë. Kur shkoi në shtëpinë e motrës, ajo mësoi se gruaja ishte rrahur e grabitur, kishte shumë pak për të ngrënë dhe nuk zotëronte asnjë veshje që mendonte se ishin të përshtatshme për mbledhjet e së dielës në Kishë. Gruaja që u caktua t'i shërbente asaj, solli dëshirën për të mbajtur vesh, prodhime nga kopshti i saj, shkrime të shenjta për të lexuar dhe miqësi. Motra "e humbur" shpejt u kthye në kishë dhe tani mban një thirrje, sepse ajo e di që të tjerët e duan dhe e çmojnë.

Ndërthurja e përpjekjeve të tilla të Shoqatës së Ndihmës me kuorumin e pleqve tashmë të ristrukturuar do të sjellë një unitet që mund të prodhojë rezultate të mahnitshme. Dhënia e shërbesës bëhet një përpjekje e bashkërenduar për të përmbushur detyrën e priftërisë që të "vizitojë shtëpinë e çdo anëtarit" dhe të "vëzhgojë mbi kishën gjithmonë dhe të jetë me ta e t'i forcojë ata"⁵, si dhe për të arritur qëllimin e Shoqatës së Ndihmës që ta ndihmojmë



njëri-tjetrin të përgatitemi për bekimet e jetës së përjetshme.⁶ Duke punuar së bashku nën drejtimin e peshkopit, presidentat e kuorunit të pleqve dhe të Shoqatës së Ndihmës mund të frymëzohen ndërsa kërkojnë mënyrat më të mira për të vëzhguar e për t'u kujdesur për çdo individ e familje.

Më lejoni t'ju jap një shembull. Një nënë u diagnostikua me kancer. Shpejt ajo filloi trajtimin dhe menjëherë motrat e Shoqatës së Ndihmës iu futën punës, duke planifikuar se si të ndihmonin më së miri me vaktet, transportin në takimet mjekësore dhe përkrahje në forma të tjera. Ato e vizitonin atë rregullisht, duke i dhënë shoqërim plot hare. Në të njëjtën kohë, kuorumi i Priftërisë Melkizedeke u hodh në veprim. Ata punuan duke shtuar një dhomë gjumi dhe tualet të rimodeluar që ta bënin më të lehtë përkujdesjen për motrën e sëmurë. Të rinjtë iu futën punës fizikisht për të marrë pjesë në atë përpjekje të rëndësishme. U përfshinë edhe të rejtat: ato u organizuan me gëzim që ta nxirrnin me besnikëri qenin çdo ditë për shëtitje. Ndërsa koha kalonte, lagjja e vazhdoi shërbimin e saj, duke e shtuar dhe duke e përshtatur aty ku ishte e nevojshme. Ishte dukshëm një punë dashurie, ku secili anëtar dha nga vetja, duke treguar në mënyrë të bashkuar përkujdesje në mënyra individuale, që bekuan jo vetëm motrën që po vuante por secilin pjesëtar të familjes së saj.

Pas një përpjekjeje plot kurajë, motra më në fund vdiq dhe gjeti prehje

nga kanceri. A nxori lagjja një pshe-rëtimë lehtësuese dhe a e konsideroi punën të bërë mirë dhe të marrë fund një herë e mirë? Jo, të rejtat vazhduan ta nxirrnin qenin çdo ditë për shëtitje, kuorumet e priftërisë vazhduan t'i jepnin shërbesë babait dhe familjes së tij dhe motrat e Shoqatës së Ndihmës vazhduan t'i ndihmonin me dashuri për të përcaktuar anët e forta dhe nevojat. Vëllezër e motra, kjo është dhënia e shërbesës – kjo është të duash ashtu siç do Shpëtimtari!

Një bekim tjetër i këtyre shpalljeve të frymëzuara është mundësia që kanë të rejtat e moshave 14–18 vjeç të marrin pjesë në dhënie e shërbesës si shoqëruese të motrave të Shoqatës së Ndihmës, ashtu si të rinjtë e të njëjtës moshë shërbejnë si shoqërues shërbestarë për vëllezërit e Priftërisë Melkizedeke. Të rinjtë dhe të rejtat mund t'i përdorin dhuntitë e tyre të pasqoqve dhe të rriten shpirtërisht teksa shërbejnë së bashku me të rriturit në punën e shpëtimit. Përfshirja e rinisë në detyrat e shërbesës mund ta zgjerojë gjithashtu shtrirjen përkujdesëse të Shoqatës së Ndihmës dhe të kuorunit të pleqve për të tjerët duke e shtuar numrin e anëtarëve që marrin pjesë.

Ndërsa mendoj për të rejtat e mahnitshme që kam njohur, emocionohem për ato motra të Shoqatës së Ndihmës të cilat do të kenë privilegjin të bekoen nga entuziazmi, talentet dhe ndjeshmëria shpirtërore e një të reje teksa shërbejnë krah për krah me to apo ndërsa marrin



shërbesë prej tyre. Dhe jam po aq e kënaqur nga mundësia që të rejat do të kenë për t'u këshilluar, mësuar e forcuar nga motrat e tyre në Shoqatën e Ndhimës. Kjo mundësi për të marrë pjesë në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë do të jetë një përfitim i jashtëzakonshëm për të rejat, duke i ndihmuar ato që të përgatiten më mirë për t'i përmbushur rolet e tyre si udhëheqëse në Kishë e komunitet dhe si partnere kontribuuese në familjet e tyre. Ashtu siç u shpreh Motra Boni L. Oskarson dje, të rejat “*duan* të jenë në shërbim. Ato duhet ta dinë se janë të çmueshme dhe thelbësore në punën e shpëtimit”⁷.

Në fakt, të rejat tashmë po u japin shërbesë të tjerëve, pa qenë caktuar ose pa bërë bujë. Unë njoh një familje që u shpërngul qindra kilometra në një vend të ri ku nuk njihnin askënd. Brenda javës së parë, një vajzë 14-vjeçare nga lagjja e tyre e re u shfaq në pragun e derës me një pjatë me biskota, duke i mirëpritur ata në atë zonë. Nëna e saj qëndronte duke buzëqeshur pas saj si një shofere e gatshme, duke e për-krahur dëshirën e vajzës së saj për të dhënë shërbesë.

Një tjetër nënë u shqetësua një ditë që vajza e saj 16-vjeçare nuk ishte në shtëpi në orën e zakonshme. Kur vajza mbërriti më në fund, nëna e saj paksa e irrituar, i bëri disa pyetje se ku kishte qenë. 16-vjeçarja gati me ndrojtje iu përgjigj se i kishte çuar lule një vejushë që jetonte aty pranë. Ajo kishte vënë re se motra e moshuar dukej e vetmuar dhe pati nxitjen ta vizitonte atë. Me miratimin e plotë të nënës së saj, e reja vazhdoi ta vizitonte gruan e moshuar. Ato u bënë mikeshë të mira dhe shoqëria e tyre e ëmbël vazhdoi me vite.

Secila prej këtyre të rejave dhe shumë më tepër si ato, e vënë re nevojën e dikujt dhe punojnë për ta përmbushur atë. Të rejat kanë një dëshirë të natyrshe për t'u kujdesur e për të dhënë, e cila mund të drejtohet mirë nëpërmjet dhënies së shërbesës në bashkëpunim me një motër të rritur.

Pavarësisht nga mosha jonë, kur marrim në shqyrtim se si të japim shërbesë në mënyrë më të efektshme, ne pyetim: “Çfarë i nevojitet asaj [ose atij]?” Duke e bashkuar atë pyetje me një dëshirë të sinqertë për të shërbyer, atëherë ne udhëhiqemi nga Shpirti për të bërë atë që do ta lartësonte dhe forconte individin. Kam dëgjuar histori të panumërta të vëllezërve dhe motrave që u bekuan nga një gjest i thjeshtë i përfshirjes dhe mirëpritjes në kishë, nga një mesazh elektronik apo nga një mesazh në celular i menduar, nga një kontakt vetjak në një kohë të vështirë, nga një ftesë për të marrë pjesë në një veprimtari në grup apo nga një ofertë për të ndihmuar në një situatë sfiduese. Prindërit e vetëm, të kthyerit e rinj në besim, anëtarët më pak aktivë, të vejat dhe vejanët, apo të rinjtë e të rejat që po hasin vështirësi, mund të kenë nevojë për vëmendje shtesë dhe ndihmë me përparësi prej vëllezërve dhe motrave shërbestare. Bashkërendimi midis presidencave të

kuorumit të pleqve dhe të Shoqatës së Ndhimës lejon pikërisht që të caktohen detyrat e duhura.

Pasi gjithçka të jetë thënë e bërë, dhënia e vërtetë e shërbesës arrihet një e nga një, me dashurinë si shtysë. Vlera, merita dhe mrekullia e dhënies së sinqertë të shërbesës është që ajo e ndryshon vërtet jetën! Kur zemrat tona janë të hapura dhe të gatshme për të dashur e për të përfshirë, për të nxitur e për të ngushëlluar, fuqia e dhënies së shërbesës sonë do të jetë magjepsëse. Me dashurinë si shtysë, do të ndodhin mrekulli, dhe ne do të gjejmë mënyra për t'i sjellë motrat dhe vëllezërit e “humbur” në përqaftimin gjithëpërfshirës të ungjillit të Jezu Krishtit.

Shpëtimtari është shembulli ynë për çdo gjë – jo vetëm për atë që duhet të bëjmë, por edhe për *arsyen* përse duhet ta bëjmë atë gjë.⁸ “Jeta e Tij në tokë ishte [një] ftesë për ne – që ta ngremë veshtrimin tonë pak më lartë, për t'i harruar problemet tona e për t'i ndihmuar tjerët.”⁹ Ndërsa e pranojmë mundësinë që t'u japim shërbesë me gjithë zemër motrave dhe vëllezërve tanë, ne bekohemi që të bëhemi më të pastruar shpirtërisht, më në harmoni me vullnetin e Perëndisë dhe më në gjendje për ta kuptuar planin e Tij që e ndihmon secilin prej nesh të kthehet tek Ai. Ne do t'i njohim më shpejt bekimet e Tij dhe do të jemi më të zellshëm që t'ua shtrijmë ato bekime të tjerëve. Zemrat tona do të këndojnë njëzëri me zërat tanë:

*Shpëtimtar, ta dua vëllan’
Siç e di se më do Ti,
Tek Ti forcën time të gjej
Që për Ty të jap shërbim.
Shpëtimtar, ta dua vëllan’ –
Zot, un’ Ty do të t’ndjek.*¹⁰

E tregofshim mirënjohjen dhe dashurinë tonë për Perëndinë duke u dhënë

shërbesë me dashuri motrave dhe vëllezërve tanë të përjetshëm!¹¹ Përfundimi do të jetë një unitet ndjenjash i tillë si ai që përjetuan njerëzit në Amerikën e lashtë 100 vjet pas shfaqjes së Shpëtimtarit në tokën e tyre.

“Dhe ndodhi që nuk pati grindje . . . , për shkak të dashurisë së Perëndisë që jetonte në zemrat e njerëzve.

. . . Nuk pati zili, as luftime, . . . dhe me siguri nuk mund të kishte një popull më të lumtur mes gjithë njerëzve të krijuar nga dora e Perëndisë.”¹²

Me gëzim jap dëshminë time vetjake që këto ndryshime të zbuluara janë të frymëzuara nga Perëndia dhe që, ndërsa i pranojmë me zemra të gatshme, ne do të bëhemi më të përgatitur për ta takuar Birin e Tij, Jezu Krishtin, në ardhjen e Tij. Ne do të jemi më afër bërjes një popull i Sionit dhe do të ndiejmë gëzim të jashtëzakonshëm me ata që kemi ndihmuar përgjatë shtegut të dishepullimit. Që ne të mund ta bëjmë këtë është lutja ime e zjarrtë dhe e përlur, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Veprat e Apostujve 3:19–21.
2. Shih Robert D. Hales, “Preparations for the Restoration and the Second Coming: ‘My Hand Shall Be over Thee’”, *Liahona*, nëntor 2005, f. 88–92.
3. Doktrina e Besëlidhje 42:29.
4. “Krishti i Gjallë: Dëshmia e Apostujve”, *Liahona*, maj 2017, brenda kapakut të përparmë.
5. Doktrina e Besëlidhje 20:47, 53.
6. Shih *Handbook 2: Administering the Church [Manuali 2: Administrimi i Kishës]* (2010), 9.1.2.
7. Boni L. Oskarson, “Të Rejat në Punë”, *Liahona*, maj 2018, f. 38.
8. Shih Efesianëve 5:2.
9. Russell T. Osguthorpe, “What If Love Were Our Only Motive?” (takim shpirtëror në Universitetin “Brigam Jang”, 8 mars 2011), f. 7, speeches.byu.edu.
10. “Zot, Un’ Ty do të t’Ndjek”, *Himne*, nr. 137.
11. Shih Mosia 2:17.
12. 4 Nefi 1:15–16.



Nga Plaku Diter F. Uhtdorf,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Shiheni Njeriun!

Ata që gjejnë një mënyrë se si ta shohin vërtet Njeriun, gjejnë udhën drejt gëzimeve më të mëdha të jetës dhe balsamin për dëshpërimet më të vështira të jetës.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, miq të dashur, jam mirënjohës që jam me ju në këtë fundjavë të mrekullueshme të konferencës së përgjithshme. Unë dhe Harieta gëzohemi me ju që të mbështetim Pleqtë Gong e Soares dhe shumë vëllezër e motra që kanë marrë thirrje të reja, të rëndësishme gjatë kësaj konference të përgjithshme.

Edhe pse më merr malli për mikun tim të shtrenjtë, Presidentin Tomas S.

Monson, unë e dua, e mbështet dhe e përkrah profetin dhe Presidentin tonë, Rasëll M. Nelsonin, dhe këshilltarët e tij fisnikë.

Jam gjithashtu mirënjohës dhe i nderuar që të punoj sërish më nga afër me Vëllezërit e mi të dashur të Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve.

Mbi të gjitha, jam thellësisht i përlur dhe shumë i gëzuar që jam anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, ku miliona burra, gra e fëmijë janë të gatshëm të *ngrenë atje ku ndodhen* – në çfarëdo mundësie ose thirrjeje – dhe përpiqen fort me gjithë zemër që t’i shërbejnë Perëndisë dhe fëmijëve të Tij, duke ndërtuar mbretërinë e Perëndisë.

Sot është një ditë e shenjtë. Është e diela e Pashkës, kur ne përkujtojmë atë mëngjes të lavdishëm kur Shpëtimtari ynë i këputi lidhjet e vdekjes¹ dhe doli ngadhënjimtar prej varrit.

Dita më e Madhërisme në Histori

Kohët e fundit e pyeta internetin: “Cila ditë e ndryshoi më shumë udhën e historisë?”

Përgjigjet u radhitën nga habitëse e të çuditshme deri në kuptimplotë dhe që nxitën mendim. Mes tyre, dita kur një asteroid parahistorik goditi





gadishullin Jukatan; ose kur në vitin 1440 Johan Gutenbergu përfundoi shtypshkronjën e tij; dhe sigurisht dita në vitin 1903 kur vëllezërit Rajt i treguan botës se njeriu me të vërtetë mund të fluturojë.

Nëse po ajo pyetje ju bëhej juve, çfarë do të thoshit?

Në mendjen time përgjigjja është e qartë.

Për ta gjetur ditën më të rëndësishme në histori, ne duhet të kthehemi në atë mbrëmje gati 2 000 vjet më parë në Kopshtin e Gjetsemanit kur Jezu Krishti ra në gjunjë në lutje të thellë dhe e ofroi veten e Tij si shpengim për mëkatet tona. Ishte gjatë atij flijimi të madh dhe të pafundmë të një vuajtjeje të pakrahueshme si në trup dhe në shpirt që Jezu Krishti, madje Perëndi, derdhi gjak nga çdo por. Për shkak të dashurisë së përsosur, Ai dha gjithçka që ne të mund të merrnim gjithçka. Flijimi i Tij hyjnor, i vështirë për t'u kuptuar, për t'u ndier me gjithë zemrën dhe mendjen tonë, na sjell ndërmend borxhin e gjithësishtëm të mirënjohjes që ia detyrojmë Krishtit për dhuratën e Tij hyjnore.

Më vonë atë natë, Jezusin e sollën përpara autoriteteve fetare dhe politike të cilët e tallën, e goditën dhe e dënuan me një vdekje të turpshme. Ai qëndroi

i varur në agoni në kryq derisa, më së fundi, “u krye”². Trupi i Tij i pajetë u vendos në një varr të marrë hua. Dhe më pas, në mëngjesin e ditës së tretë, Jezu Krishti, Biri i Perëndisë së Plotfuqishëm, doli nga varri si një qenie e përlevduar, e ringjallur plot shkëlqim, dritë dhe madhështi.

Po, ka shumë ngjarje gjatë gjithë historisë që kanë ndikuar thellë në fatin e kombeve dhe të njerëzve. Por bashkoi-ni të gjitha dhe ato nuk mund të fillojnë të krahasohen me rëndësinë e asaj që ndodhi në atë mëngjes të Pashkës së parë.

Çfarë është ajo që e bën flijimin e pafundmë dhe Ringjalljen e Jezu Krishtit ngjarjen më të rëndësishme në histori – më ndikuese se luftërat botërore, fatkeqësitë katastrofike dhe zbulimet shkencore jetëndryshuese?

Në Saje të Jezu Krishtit, Ne Mund të Jetojmë Përsëri

Përgjigjja gjendet në dy sfida të mëdha, të pakapërcyeshme, me të cilat përballet secili prej nesh.

Së pari, ne të gjithë vdesim. Pavarësisht nga sa të rinj, të bukur, të shëndetshëm apo të kujdesshëm të jeni, një ditë trupi juaj do të bëhet i pajetë. Miqtë dhe familja do të vajtojnë për ju. Por nuk mund t'ju kthejnë në jetë.

Megjithatë, në saje të Jezu Krishtit, vdekja juaj do të jetë e përkohshme. Shpirti juaj një ditë do të bashkohet sërisht me trupin tuaj. Ky trup i ringjallur nuk do t'i nënshtrohet vdekjes³ dhe ju do të jetoni në përjetësitë, i çliruar nga dhembja dhe vuajtja fizike⁴.

Kjo do të ndodhë për shkak të Jezusit, Krishtit, i cili e dha jetën e Tij dhe e mori atë përsëri.

Ai e bëri këtë për të gjithë ata që besojnë tek Ai.

Ai e bëri këtë për të gjithë ata që nuk besojnë tek Ai.

Ai e bëri këtë edhe për ata që e tallin, e përqeshin dhe e mallkojnë emrin e Tij.⁵

Në Saje të Jezu Krishtit, Ne Mund të Jetojmë me Perëndinë

Së dyti, ne të gjithë kemi mëkatuar. Mëkatet tona do të na mbajnë larg përgjithmonë prej të jetuarit me Perëndinë, sepse “asgjë e papastër nuk mund të hyjë në mbretërinë e tij”⁶.

Si rrjedhojë, çdo burrë, grua dhe fëmijë u la jashtë nga prania e Tij – që është, derisa Jezu Krishti, Qengji pa njollë, e ofroi jetën e Tij si shpengim për mëkatet tona. Ngaqë Jezusi nuk i kishte asnjë borxh drejtësisë, Ai mund ta paguante borxhin tonë dhe të plotësonte kërkesat e drejtësisë për çdo njeri. Dhe kjo përfshin mua dhe ju.

Jezu Krishti pagoi çmimin për mëkatet tona.

Të gjitha ato.

Në atë ditë, më të rëndësishmen në histori, Jezusi, Krishti, i hapi portat e vdekjes dhe i hodhi tej pengesat që nuk na lejonin të kalonim në korridoret e shenjtja dhe të shenjtëruara të jetës së pafundme. Në saje të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, juve dhe mua na jepet një dhuratë, më e çmueshmja dhe më e paçmuara – pavarësisht nga e shkuara jonë, ne mund të pendohejmë dhe ta ndjekim shtegun që çon drejt dritës dhe lavdisë çelestiale, të rrethuar nga fëmijët besnikë të Atit Qiellor.

Përse Gëzojmë Ne

Kjo është ajo që kremtojmë të dielën e Pashkës – ne kremtojmë jetën!

Për shkak të Jezu Krishtit, ne do të ngrihemi prej dëshpërimit të vdekjes dhe do t'i përqafojmë ata që i duam, duke derdhur lot gëzimi të madh dhe mirënjohjeje gjithëpushtuese. Në saje të Jezu Krishtit, ne do të ekzistojmë si qenie të përjetshme, botëve pa fund.

Në saje të Jezu Krishtit, mëkatet tona jo vetëm mund të fshihen; ato mund të harrohen.

Ne mund të bëhemi të dëlirë dhe të ekzaltuar.

Të shenjtë.

Në saje të Shpëtimtarit tonë të dashur, ne mund të pimë përherë nga burimi i ujit që buron në jetë të përjetshme.⁷ Ne mund të banojmë përherë në banesat e Mbretit tonë të përjetshëm, në lavdi të papërfytyrueshme dhe lumturi të përsosur.

A e “[Shohim] Njeriu[n]”?

Pavarësisht nga e gjithë kjo, ka shumë njerëz në botë sot që ose nuk janë të vetëdijshëm për dhuratën që na ka dhënë Jezu Krishti, ose nuk besojnë në atë dhuratë. Ata mund të kenë dëgjuar për Jezu Krishtin dhe e njohin Atë si një figurë historike, por nuk e shohin Atë për atë që Ai është me të vërtetë.

Kur mendoj për këtë gjë, më vjen ndërmend Shpëtimtari duke qëndruar

përpara guvernatorit romak të Judesë, Ponc Pilatit, vetëm pak orë përpara vdekjes së Shpëtimtarit.

Pilati e pa Jezusin nga një këndvështrim tërësisht si i botës. Pilati kishte një punë për të bërë dhe ajo përfshinte dy detyra të mëdha: mbledhjen e taksave për Romën dhe ruajtjen e paqes. Tani sinedri judeas kishte sjellë përpara tij një burrë i cili, shpallën ata, ishte një pengesë për të dyja detyrat.⁸

Pasi e mori në pyetje të burgosurin e vet, Pilati shpalli: “Unë nuk po gjej në të asnjë faj!”⁹ Por e ndjeu se i duhej të kënaqte akuzuesit e Jezusit, prandaj Pilati përdori një zakon vendor i cili lejonte që një i burgosur të lirohej gjatë stinës së Pashkës judease. A nuk do ta bënin të lironte Jezusin në vend të kuarit dhe vrasësit famëkeq, Barabës?¹⁰

Por turma e trazuar kërkoi që Pilati të lironte Barabën dhe të kryqëzonte Jezusin.

“Përse?” pyeti Pilati. “Ç’të keqe ka bërë?”

Por ata bëritën edhe më shumë. “Kryqëzoje!”¹¹

Në një përpjekje të fundit për ta kënaqur turmën, Pilati i urdhëroi njerëzit e tij që ta fshikullonin Jezusin.¹² Këtë e bënë, duke e lënë Atë të gjakosur dhe të shtypur. Ata e tallën, i vendosën mbi kokë një kurorë me gjemba dhe i veshën sipër një mantel të purpurt.¹³

Ndoshta Pilati mendoi se kjo do ta kënaqte dëshirën e turmës për gjak. Ndoshta do t’u vinte keq për burrin. “Ja, po jua nxjerr jashtë”, tha Pilati, “që ta dini se nuk gjej në të asnjë faj. . . . [Shiheni] njeriu[n]!”¹⁴

Biri i Perëndisë qëndroi vetë përpara njerëzve në Jerusalem.

Ata mund ta shihnin Jezusin, por nuk e panë me të vërtetë Atë.

Ata nuk kishin sy që të shihnin.¹⁵

Në një kuptim figurativ, ne gjithashtu ftohemi që ta “[shohim] njeriu[n]”. Opinione për Të ndryshojnë në botë. Profetët e lashtë dhe modernë dëshmojnë se Ai është Biri i Perëndisë. Edhe unë e bëj këtë gjë. Është domethënëse dhe e rëndësishme që secili prej nesh të arrijë të dijë vetë për Të. Prandaj, kur përsiatni për jetën dhe shërbesën e Jezu Krishtit, çfarë shihni?

Ata që gjejnë një mënyrë se si ta shohin vërtet Njeriun, gjejnë udhën drejt gëzimeve më të mëdha të jetës dhe balsamin për dëshpërimet më të vështira të jetës.

Prandaj, kur rrethoheni nga hidhërimet dhe pikëllimi, shiheni Njeriun.

Kur ndiheni të humbur ose të harruar, shiheni Njeriun.

Kur jeni të dëshpëruar, të braktisur, dyshues, të dëmtuar ose të shkurajuar, shiheni Njeriun.

Ai do t’ju ngushëllojë.

Ai do t’ju shërojë dhe do t’i japë kuptim udhëtimit tuaj. Ai do ta derdhë Shpirtin e Tij dhe do ta mbushë zemrën tuaj me gëzim të jashtëzakonshëm.¹⁶





Ai i jep “forcë të lodhurit dhe rrit fuqinë e të këputurit”¹⁷.

Kur e shohim me të vërtetë Njeriun, ne mësojmë për Të dhe përpiqemi ta përputhim jetën tonë me Të. Ne pendohemi dhe përpiqemi fort ta përmi- rësojmë natyrën tonë dhe çdo ditë të afrohem pak më shumë tek Ai. Ne i mirëbesojmë Atij. Ne e tregojmë dashurinë tonë për Të duke i zbatuar urdhëri- met e Tij dhe duke jetuar të denjë për besëlidhjet tona të shenjta.

Me fjalë të tjera, ne bëhemi dishe- pujt e Tij.

Drita e Tij përmirësuese i mbush qeniet tona. Hiri i Tij na lartëson. Barrët tona lehtësohen, paqja jonë thellohet. Kur vërtet e shohim Njeriun, ne kemi premtimin e një të ardhmeje të bekuar e cila na frymëzon dhe na lartëson për- mes kthesave dhe pengesave në udhë- timin e jetës. Duke e hedhur vështrimin pas, ne do ta kuptojmë se ka një model hyjnor, se pikat vërtet lidhen.¹⁸

Kur e pranoni flijimin e Tij, bëheni dishepulli i Tij dhe më së fundi arrini në fund të udhëtimit tuaj tokësor, çfarë do të ndodhë me hidhërimet që keni duruar në këtë jetë?

Ato do të jenë larguar.

Po zhgënjimet, tradhtitë, përndjekjet që i keni hasur?

Të larguara.

Po vuajtja, dhembja, faji, turpi dhe ankthi përmes të cilave keni kaluar?

Të larguara.

Të harruara.

A është çudi që “ne flasim për Krishtin, ne gëzohemi në Krishtin, ne predikojmë për Krishtin, ne profetizojmë mbi Krishtin . . . që fëmijët tanë të mund të dinë se cilit burim t’i drejtohen për heqjen e mëkateve të tyre?”¹⁹

A është çudi që ne përpiqemi fort, me gjithë zemrën tonë, që vërtet ta shohim Njeriun?

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, unë dëshmoj se dita më e rëndësishme në historinë e njerëzimit ishte dita kur Jezu Krishti, Biri i gjallë i Perëndisë, arriti fitore mbi vdekjen dhe mëkatin për të gjithë fëmijët e Perëndisë. Dhe dita më e rëndësishme në jetën tuaj dhe timen është dita kur ne mësojmë ta “[shohim] njeriu[n]”; kur e shohim Atë si njeriun që Ai është vërtet; kur ne marrim me gjithë zemrën dhe mendjen tonë nga fuqia e Tij shlyese; kur me entuziazëm dhe forcë të ripërtërirë, ne zotohemi ta ndjekim Atë. Qoftë ajo një ditë që ndodh pa pushim gjatë gjithë jetës sonë.

Ju lë dëshminë dhe bekimin tim që, kur ta “[shohim] njeriu[n]”, ne vërtet do të gjejmë domethënie, gëzim e paqe në

këtë jetë tokësore dhe jetë të përjet- shme në botën që vjen. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Mosia 15:23.
2. Gjoni 19:30.
3. Shih Alma 11:45.
4. Shih Zbulesa 21:4.
5. Shih 1 Korintasve 15:21–23.
6. 3 Nefi 27:19.
7. Shih Gjoni 4:14.
8. Shih Lluca 23:2.
9. Gjoni 18:38. Për t’iu shmangur detyrimit që ta gjykonte Jezusin, Pilati u përpoq t’ia kalonte çështjen Herod Antipës. Nëse Herodi, i cili kishte urdhëruar vdekjen e Gjon Pagëzorit (shih Mateu 14:6–11), do ta dënonte Jezusin, Pilati mund t’i vinte vulën gjykimit dhe të shpallte se ishte thjesht një çështje vendore për të cilën ra dakord me qëllim që të ruante paqen. Por Jezusi nuk i tha asnjë fjalë Herodit (shih Lluca 23:6–12) dhe Herodi e ktheu sërish te Pilati.
10. Shih Marku 15:6–7; Gjoni 18:39–40. Një studiues i Dhiatës së Re shkruan: “Duket se ka qenë zakoni, që në Pashkën judease guvernatori romak t’i lironte popullsisë judease njëfarë të burgosuri famëkeq që ishte i dënuar me vdekje” (Alfred Edersheim, *The Life and Times of Jesus the Messiah* [1899], 2:576). Emri *Baraba* do të thotë “bir i atit”. Është interesante ironia që njerëzve të Jerusalemit t’u jepej një zgjedhje midis këtyre dy burrave.
11. Shih Marku 15:11–14.
12. Ky fshikullim ishte kaq i tmerrshëm sa që quhej “vdekja e ndërmjetme” (Edersheim, *Jesus the Messiah*, 2:579).
13. Shih Gjoni 19:1–3.
14. Gjoni 19:4–5.
15. Më parë, Jezusi kishte vërejtur se “zema e këtij populli është bërë e pandjeshme, ata janë bërë të rëndë nga veshët dhe kanë mbyllur sytë, që nuk shohin me sy dhe nuk dëgjojnë me vesh, dhe nuk gjykojnë me zemër dhe nuk kthehen, dhe unë t’i shëroj”. Dhe më pas, me dhembshurinë e Tij, Ai u tha dishepujve të Tij: “Por lum sytë tuaj që shohin dhe veshët tuaj që dëgjojnë” (Mateu 13:15–16). A do ta lejojmë zemrën tonë të ngurtësohet apo do t’i hapim sytë dhe zemrat tona që të mund ta shohim vërtet Njeriun?
16. Shih Mosia 4:20.
17. Isaia 40:29.
18. Shih Diter F. Uhtdorf, “Aventura e Vdekshmërisë” (takim shpirtëror mbarëbotëror për të rinjtë në moshë madhore, 14 janar 2018), broadcasts.lds.org.
19. 2 Nefi 25:26.



Nga Peshkopi Zherald Kosé,
Peshkopi Kryesues

E Gjitha Ka të Bëjë me Njerëzit

Kisha ka të bëjë e gjitha me ju, dishepujt e Zotit – me ata që e duan dhe e ndjekin Atë dhe që e kanë marrë emrin e Tij mbi vete.

Unë pata një përvojë që nuk do ta harroj kurrë, ndërsa po përgatiteshim për ndërtimin e Tempullit të mrekullueshëm të Parisit në Francë. Në vitin 2010, kur prona për tempullin u gjet, kryetari i bashkisë kërkoi të takohej me ne për të ditur më shumë rreth Kishës sonë. Kjo mbledhje ishte një hap vendimtar për të marrë një leje ndërtimi. Me shumë kujdes përgatitëm një paraqitje që përfshinte disa pamje mbresëlënëse të tempujve të shenjtoreve të ditëve të mëvonshme. Shpresa ime e zjarrtë ishte që bukuria e tyre arkitekturore ta bindte kryetarin që ta përkrahte projektin tonë.

Për habinë time, kryetari sugjeroi që në vend që ta shqyrtonte paraqitjen tonë, ai dhe skuadra e tij parapëlqyen të bënin vetë hetime për të zbuluar se çfarë lloj kisha ishim ne. Muajin vijues, na ftuan sërish që të dëgjonim një raportim të dhënë nga një këshilltare bashkiake, e cila rastisi të ishte edhe profesoreshë e historisë së fesë. Ajo tha: “Mbi gjithçka tjetër, ne donim të kuptonim se kush janë anëtarët e Kishës suaj. Së pari, ne frekuentuam një nga mbledhjet tuaja të sakramentit. U ulëm në fund të godinës kishtarë dhe i vëzhguam me vëmendje

njerëzit në bashkësi dhe se çfarë po bënin ata. Më pas takuam fqinjët tuaj – ata që jetonin rrotull qendrës suaj të kunjtit – dhe i pyetëm se çfarë lloj njerëzish jeni ju mormonët.”

“Pra çfarë përfundimesh nxorët?”
E pyeta, duke u ndier pak në ankth.
Ajo u përgjigj: “Ne zbuluam se Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të



Mëvonshme është më e përafërta me Kishën e hershme të Jezu Krishtit nga çdo kishë tjetër për të cilën jemi në dijeni”. Gati kundërshtova duke thënë: “Kjo nuk është plotësisht e saktë! Nuk është kisha që i përafrohet më shumë; ajo është Kisha e Jezu Krishtit – e njëjta Kishë, Kisha e vërtetë!” Por e përmbajta veten dhe në vend të kësaj bëra një lutje të heshtur mirënjohjeje. Kryetari më pas na tha se, duke u bazuar në zbulimet e tyre, ai dhe skuadra e tij nuk kishin asnjë kundërshtim për ndërtimin e një tempulli në komunitetin e tyre.

Sot, kur mendoj për atë përvojë të mrekullueshme, ndihem mirënjohës për urtësinë e kryetarit dhe shpirtin e dallimit. Ai e dinte se çelësi për ta kuptuar Kishën nuk është duke e parë atë nga pamja e jashtme e ndërtesave të saj apo qoftë si një institucion i mirëorganizuar, por nëpërmjet miliona anëtarëve të saj besnikë, që përpiqen çdo ditë ta ndjekin shembullin e Jezu Krishtit.

Përkufizimi i *Kishës* mund të bazohet te një fragment në Librin e Mormonit që shpall: “Dhe ata [domethënë dishepujt e Zotit] që u pagëzuan në emrin e Jezusit, u quajtën kisha e Krishtit”¹.

Me fjalë të tjera, Kisha ka të bëjë e gjitha me njerëzit. E gjitha ka të bëjë me ju, dishepujt e Zotit – me ata që e duan dhe e ndjekin Atë dhe që e kanë marrë emrin e Tij mbi vete me anë të besëlidhjes.

Presidenti Rasëll M. Nelson dikur e krahasoi Kishën me një mjet të këndshëm automobilistik. Të gjithëve na pëlqen shumë kur makina jonë është e pastër dhe e shndritshme. Por qëllimi i veturës nuk është që të duket si një mjet tërheqës; është që t'i lëvizë *njerëzit* që janë brenda në veturë². Në mënyrë të ngjashme, ne, si anëtarë të Kishës, e vlerësojmë që kemi vende të bukura adhurimi, që janë të pastra dhe të mirëmbajtura dhe, ne gjithashtu

i gëzohemi pasjes së programeve që funksionojnë siç duhet. Por këto janë thjesht sisteme ndihmëse. Synimi ynë kryesor është ta ftojme çdo bir dhe bijë të Perëndisë që të vijë te Krishti dhe ta udhërrëfjmë atë përgjatë shtegut të besëlidhjes. Asgjë tjetër nuk është më e rëndësishme. Puna jonë ka të bëjë e gjitha me njerëzit dhe besëlidhjet.

A nuk është e mrekullueshme se emri që i është dhënë Kishës së rivendosi me anë të zbulësës i lidh bashkë dy elementët më të rëndësishëm në secilën besëlidhje të ungjillit? Së pari, është emri *Jezu Krisht*. Kjo Kishë i përket Atij dhe, Shlyerja dhe besëlidhjet e Tij shenjtëruese janë i vetmi shteg drejt shpëtimit dhe ekzaltimit. Emri i dytë na referohet *ne*: shenjtoreve ose me fjalë të tjera, dëshmitarëve të Tij dhe dishepujve të Tij.

E mësova rëndësinë e përqendrimit të njerëzit kur shërbeva si president kunji në Francë. Në fillim të shërbimit tim, unë kisha në mendje disa synime shumë ambicioze për kunjin: Krijimin e lagjeve

të reja, ndërtimin e shtëpive të reja të mbledhjeve dhe madje ndërtimin e një tempulli në zonën tonë. Kur u lirova gjashtë vite më vonë, asnjë nga këto objektiva nuk ishte arritur. Kjo mund të më dukej si një dështim i plotë, veçse gjatë ecurisë së atyre gjashtë viteve, objektivat e mia dolën krejt ndryshe.

Ndërsa isha ulur në panel ditën e lirim tim, më mbërtheu një ndjenjë e thellë mirënjohjeje dhe përmbushjeje. Vështrova fytyrat e qindra anëtarëve të pranishëm. Mund të kujtoj një përvojë shpirtërore që lidhet me çdonjërin prej tyre.

Ishin ata vëllezër e motra, që kishin hyrë në ujërat e pagëzimit, ata të cilëve u kisha nënshkruar rekomandimet e tyre të para, që të mund të merrnin ordinancat e shenjta të tempullit dhe ato njerëz dhe çifte të reja që i kisha veçuar ose liruar si misionarë kohëplotë. Kishte shumë të tjerë të cilëve u krewa shërbesë ndërsa po kalonin sprova dhe vështirësi në jetën e tyre. Ndjeva

dashuri të fortë vëllazërore për secilin prej tyre. Kisha gjetur gëzim të mirëfilltë të shërbimi ndaj tyre dhe u gëzova nga rritja e besnikërisë dhe besimit të tyre te Shpëtimtari.

Presidenti M. Rasëll Ballard dha mësim: “Ajo çka është më e rëndësishme në përgjegjësitë tona në Kishë, nuk janë statistikatat që raportohen apo mbledhjet që mbahen, por nëse njerëz individualë – të shërbyer një e nga një ashtu sikurse bëri Shpëtimtari – janë lartësuar e nxitur dhe si përfundim janë ndryshuar”³.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, a jemi ne aktivë në ungjill apo jemi thjesht të ngarkuar me detyra në Kishë? Çelësi është ta ndjekim shembullin e Shpëtimtarit në të gjitha gjërat. Nëse e bëjmë atë, ne do të përqendrohemi vetvetiu në shpëtimin e individëve, në vend që të kryejmë detyra dhe të vëmë programe në zbatim.

A e keni pyetur ndonjëherë veten se si do të ishte po t’ju vinte Shpëtimtari për vizitë në lagjen apo degën tuaj të dielën e ardhshme? Çfarë do të bënte Ai? A do të shqetësohej për të ditur a mjaftonin mjetet ndihmëse pamore apo, a ishin vendosur karriget siç duhej në klasë? Apo do të gjente dikë të cilit mund t’i falte dashuri, ta mësonte dhe ta bekonte? Ndoshta Ai do të kërkonte një anëtar ose mik të ri për t’i uruar mirëseardhjen, një vëlla apo motër të sëmurë që kishte nevojë për ngushëllim ose një të ri të pasigurt që kishte nevojë të ngrihej moralisht dhe të merrte zemër.

Çfarë klasash do të vizitonte Jezusi? Nuk do të habitësha nëse Ai do të vizitonte Filloren së pari. Ai me gjasë do të gjunjëzohej dhe do t’u fliste atyre sy për sy. Ai do t’u shprehte atyre dashurinë, do t’u tregonte histori, do t’i përgëzonte për vizatimet e tyre dhe do të dëshmonte për Atin e Tij në Qiell. Sjellja e Tij do të ishte e thjeshtë, e çiltër dhe pa lajka. A mund të veprojmë edhe ne po kështu?



Unë ju premtoj se ndërsa përpiqeni t'i përmbaheni asaj që Zoti do që të bëni, asgjë nuk do të bëhet më e rëndësishme se sa gjetja e atyre njerëzve që mund t'i ndihmoni apo bekonit. Në kishë ju do të përqendrohemi te mësimdhënia e individëve dhe te prekja e zemrës së tyre. Shqetësimi juaj do të jetë që të krijoni një përvojë shpirtërore, në vend që të organizoni një veprimtari të përsosur, t'u jepni shërbesë bashkëanëtarëve tuaj në vend që të hiqni një kryq te numri i vizitave që keni kryer. Kjo nuk ka të bëjë me veten por me *ata* të cilët i quajmë vëllezër e motra.

Ndonjëherë ne flasim për *shkuarjen* në kishë. Por Kisha është më tepër se një ndërtesë apo një vend i veçantë. Ajo është po aq e vërtetë dhe e gjallë në banesat më të përlulura në zonat më të thella të botës, sa është edhe në zyrat qendrore të Kishës në Solt-Lejk-Siti. Vetë Zoti tha: "Sepse, kudo që dy a tre janë bashkuar në emrin tim, unë jam në mes të tyre"⁴.

Ne e marrim Kishën me vete kudo që shkojmë: në punë, në shkollë, me pushime dhe veçanërisht në shtëpitë tona. Vetë prania dhe ndikimi ynë mund të jenë të mjaftueshme për ta bërë çdo vend ku gjendemi, një vend të shenjtë.

Më kujtohet një bashkëbisedim që kisha me një mik që nuk është anëtar i besimit tonë. Ai u habit kur mësoi se çdo burrë i denjë në Kishën tonë mund ta merrte priftërinë. Ai pyeti: "Po sa mbajtës të priftërisë keni në lagjen tuaj?"

Iu përgjigja: "Rreth 30 a 40 veta".

I hutuar, vijoi: "Në bashkësinë time, ne kemi vetëm një prift. Përse keni nevojë për kaq shumë priftërinj të dielën në mëngjes?"

I ngacmuar nga pyetja e tij, ndjeva frymëzimin t'i përgjigjesha: "Jam dakord me ty. Nuk mendoj se kemi nevojë për aq shumë mbajtës priftërie në kishë të dielën. Por *kemi* nevojë për një mbajtës



priftërie në çdo shtëpi. Dhe kur në një shtëpi nuk ka asnjë mbajtës të priftërisë, thirren mbajtës të tjerë të priftërisë për t'u kujdesur për atë familje dhe për t'i dhënë shërbesë asaj."

Kisha jonë nuk është vetëm të dielave. Adhurimi ynë vazhdon çdo ditë të javës, kudo që jemi dhe në çfarëdo gjëje që bëjmë. Shtëpitë tona në veçanti janë "shenjtëroret parësore të besimit tonë"⁵.

Më shpesh na ndodh në shtëpitë tona që të lutemi, bekojmë, studiojmë, ta japim mësim fjalën e Perëndisë e të shërbejmë me dashuri të pastër. Unë mund t'ju dëshmoj nga përvoja ime vetjake se shtëpitë tona janë vende të shenjta ku Shpirti mund të qëndrojë – po aq sa, e ndonjëherë madje më shumë se në vendet tona të mirëfillta të adhurimit.

Unë jap dëshmi se kjo Kishë është Kisha e Jezu Krishtit. Forca dhe gjallëria

e saj vjen nga veprimet e përditshme të miliona dishepujve të Tij, që përpiqen çdo ditë ta ndjekin shembullin e Tij madhështor duke u kujdesur për të tjerët. Krishti jeton dhe Ai e drejton këtë Kishë. Presidenti Rasëll M. Nelson është profeti të cilin Ai e ka zgjedhur ta na drejtojë dhe udhërrëfejë në kohën tonë. Për këto gjëra unë dëshmoj, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

- 3 Nefi 26:21.
- Shih Rasëll M. Nelson, mbledhje e udhëheqjes së konferencës së përgjithshme, prill 2012.
- M. Rasëll Ballard, "O, Jini të Urtë", *Konferenca e Përgjithshme*, Tetor 2006, f. 25.
- Mateu 18:20.
- Russell M. Nelson, "The Doctrinal Importance of Marriage and Children", (mbledhje e trajnimit mbarëbotëror të udhëheqjes, shkurt 2012), broadcasts.lds.org.



Nga Plaku Kuentin L. Kuk,
i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve

Përgatituni që të Takoni Perëndinë

Ndjekja e përgjegjësisë të caktuara në mënyrë hyjnore, me drejtësi, unitet dhe barazi do të na përgatitë që të takojmë Perëndinë.

Eliza R. Snou, duke folur për përkushtimin e Tempullit të Kirtlandit (në të cilin ajo mori pjesë) tha: “Ceremonitë e atij përkushtimi mund të ritregohen, por asnjë gjuhë tokësore nuk mund të përshkruajë shfaqjet qiellore të asaj dite të paharrueshme. Disave iu shfaqën engjëj, ndërkohë që një ndjesi e pranisë hyjnore u kuptua nga të gjithë të pranishmit dhe çdo zemër u mbush me një hare të patregueshme dhe plot lavdi.”¹

Shfaqjet hyjnore që ndodhën në Tempullin e Kirtlandit ishin themelore për qëllimin e Kishës së rivendosur të Jezu Krishtit që të bëjë të ndodhë shpëtimi dhe ekzaltimi i fëmijëve të Atit tonë Qiellor.² Kur përgatitemi të takojmë Perëndinë, ne mund të dimë se cilat janë përgjegjësitë tona të caktuara në mënyrë hyjnore nëpërmjet shqyrtimit të çelësave të shenjtë, të rivendosur në Tempullin e Kirtlandit.

Në lutjen përkushtuese, Profeti Jozef Smith me përlulesi i kërkoi Zotit që “ta prano[nte] këtë shtëpi . . . të cilën ti vërtet na urdhërove ta ndërtojmë”³.

Një javë më vonë, në të dielën e Pashkës, Zoti u shfaq në një vegim madhështor dhe e pranoi tempullin e Tij.

Kjo ndodhi më 3 prill 1836, pothuajse saktësisht 182 vjet më parë nga kjo e diel Pashke. Ishte gjithashtu stina e Pashkës judease – një nga ato raste të rralla kur Pashka e krishterë dhe Pashka judease bien në të njëjtën kohë. Pasi u mbyll vegimi, tre profetë të lashtë, Moisiu, Elia dhe Elija, u shfaqën dhe

u dorëzuan çelësa që ishin thelbësorë për ta përmbytur qëllimin e Zotit për Kishën e Tij të rivendosur në këtë periudhë ungjillore. Ai qëllim është përcaktuar thjeshtë, por qartësisht, si mbledhja e Izraelit, vulosja e tyre si familje dhe përgatitja e botës për Ardhjen e Dytë të Zotit.⁴

Shfaqja e Elijas si edhe e Moisiut ishte një “paralelizëm mbresëlënës . . . [me] traditën judease, sipas së cilës Moisiu dhe Elija do të vijnë së bashku në ‘fundin e kohës’”⁵. Në doktrinën tonë, kjo shfaqje përmbyshi rivendosjen themelore të çelësave të caktuar, të “dhënë . . . për ditët e fundit dhe për kohën e fundit, në të cilën është periudha e plotësisë së kohëve”⁶.

Tempulli i Kirtlandit, si në vendndodhje ashtu edhe në madhësi, relativisht nuk binte në sy. Për sa i përket rëndësisë së tij të pamasë për njerëzimin, ai ishte ndërtuar sipas *formës së përjetësisë*. Profetët e lashtë rivendosën çelësat e priftërisë për ordinarcat



shpëtuese të përjetshme të ungjillit të Jezu Krishtit. Kjo shkaktoi një gëzim të jashtëzakonshëm për anëtarët besnikë.

Këta çelësa japin “fuqi nga lart”⁷ për përgjegjësi të caktuara në mënyrë hyjnore, të cilat përbëjnë qëllimin kryesor të Kishës.⁸ Në atë ditë të mrekullueshme Pashke në Tempullin e Kirtlandit, u rivendosën tre çelësa:

Së pari, Moisiu u shfaq dhe dorëzoi çelësat e mbledhjes së Izraelit nga të katër cepat e tokës, që është puna misionare.⁹

Së dyti, Eliaja u shfaq dhe dorëzoi çelësat e periudhës së kujdestarisë së ungjillit të Abrahamit, e cila përfshin rivendosjen e besëlidhjes së Abrahamit.¹⁰ Presidenti Rasëll M. Nelson ka dhënë mësim se qëllimi i çelësave të besëlidhjes është t’i përgatitë anëtarët për mbretërinë e Perëndisë. Ai tha: “Ne e dimë cilët jemi dhe [e dimë] se çfarë pret Perëndia nga ne”¹¹.

Së treti, Eliaja u shfaq dhe dorëzoi çelësat e fuqisë vulosëse në këtë periudhë ungjillore, që është puna për historinë familjare dhe ordinancat e tempullit që e mundësojnë shpëtimin për të gjallët dhe të vdekurit.¹²

Nën drejtimin e Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve ka tre këshilla ekzekutive në zyrat qendrore të Kishës, të cilët i mbikëqyrin këto përgjegjësi të caktuara në mënyrë hyjnore, nisur nga çelësat që u rivendosën në Tempullin e Kirtlandit. Ata janë Këshilli Ekzekutiv i Misionarëve, Këshilli Ekzekutiv i Priftërisë dhe Familjes dhe Këshilli Ekzekutiv i Tempullit dhe Historisë Familjare.

Çfarë po Bëjmë Sot për t’i Përbushur Këto Përgjegjësi të Caktuara në Mënyrë Hyjnore?

Së pari, për sa i përket rivendosjes së çelësave të mbledhjes së Izraelit nga Moisiu, sot gati 70 000 misionarë janë



të shpërndarë anëmbanë tokës duke predikuar ungjillin e Tij për t’i mbledhur të zgjedhurit e Tij. Ky është fillimi i përbushjes së punës së madhe dhe të mrekullueshme që Nefi e parashikoi mes johebrenjve si edhe shtëpisë së Izraelit. Nefi e pa kohën tonë kur shenjtorët e Perëndisë do të ishin mbi gjithë faqen e tokës, por numri i tyre do të ishte i vogël për shkak të ligësisë. Megjithatë ai parashikoi se ata do të “ishin armatosur me drejtësi dhe me fuqinë e Perëndisë në lavdi të madhe”¹³. Kur hidhet vështrimi përmes historisë së shkurtër të rivendosjes së Kishës, përpjekja misionare ka qenë më mbresëlënëse. Ne po e shohim përbushjen e vegimit të Nefit. Edhe pse numrat tanë janë relativisht të pakët, ne do ta vazhdojmë përpjekjen tonë dhe shtrirjen tonë drejt atyre që do t’i përgjigjen mesazhit të Shpëtimtarit.

Së dyti, Eliaja u shfaq dhe dorëzoi periudhën e kujdestarisë së ungjillit të Abrahamit, duke shpallur se në ne dhe në farën tonë gjithë brezat pas nesh do të bekoheshin. Në këtë konferencë, është paraqitur udhërrëfim domethënës për të ndihmuar në përsosjen e shenjtorëve dhe përgatitjen e tyre për mbretërinë e Perëndisë.¹⁴ Njoftimi në sesionin e priftërisë lidhur me kuorumet e pleqve dhe të priftërinjve të lartë do ta çlirojë fuqinë dhe autoritetin e priftërisë. Mësimi i shtëpisë dhe vizitat mësimore, tani “dhënia e shërbesës”, sikurse na u dha mësim kaq rrjedhshëm në këtë sesion, do t’i përgatitë shenjtorët e ditëve të mëvonshme të takohen me Perëndinë.

Së treti, Eliaja dorëzoi çelësat e vulosjes së kësaj periudhe ungjillore. Për ata prej nesh që janë gjallë në këtë kohë, rritja e numrit të tempujve dhe e punës për historinë familjare është fenomenale. Ky ritëm do të vazhdojë dhe do të përshpejtohet deri në Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit, përndryshe e gjithë toka do të “shkatërrohet [t] tërësisht në ardhjen e tij”¹⁵.

Puna e historisë familjare, e bekuar nga qielli nëpërmjet teknologjisë, është shtuar jashtëzakonisht në disa vite të fundit. Do të ishte e pamend të bëheshim të vetëkënaqur për këtë përgjegjësi të caktuar në mënyrë hyjnore dhe të pritnim që teto Xheni ose një tjetër i afërm i përkushtuar të kujdesej për këtë punë. Më lejoni të them komentet e qarta të Presidentit Jozef Filding Smith: “Askush nuk përjashtohet nga ky detyrim i madh. Ai kërkohet nga apostulli si edhe nga plaku [ose motra] më e përulur. Vendi ose fama, apo shërbimi për shumë kohë në Kishë . . . nuk do ta cilësojnë dikë që nuk e përfill shpëtimin e një njeriu të vdekur.”¹⁶

Ne tani kemi tempuj anekënd botës dhe burimet në fondin e ndihmës për përkrahjen për tempujt që t’i ndihmojmë njerëzit nevojtarë që janë larg nga një tempull.

Si individë, ne do të bënim mirë ta vlerësonim përpjekjen tonë në kryerjen e punës misionare, punës në tempull dhe punës për historinë familjare dhe në përgatitjet për të takuar Perëndinë.

Drejtësia, Uniteti dhe Barazia përpara Zotit Janë Themeli i Këtyre Përgjegjësive të Shenjta

Për sa i përket drejtësisë, kjo jetë është koha për ne të gjithë që të përgatitemi për ta takuar Perëndinë.¹⁷ Libri i Mormonit jep shembuj të shumtë të pasojave tragjike kur individë ose grupe dështojnë në zbatimin e urdhërimeve të Perëndisë.¹⁸

Gjatë kohës së jetës sime, çështjet dhe shqetësimet e botës kanë shkuar nga njëri skaj në tjetrin – nga veprimtari të pavlera dhe të parëndësishme drejt imoralitetit të rëndë. Është për t'u lavdëruar që imoraliteti pa pëlqimin e të dyja palëve është ekspozuar dhe dënuar.¹⁹ Një imoralitet i tillë pa pëlqimin e të dy palëve është kundër ligjeve të Perëndisë dhe të shoqërisë. Ata që e kuptojnë planin e Perëndisë duhet të kundërshtojnë edhe imoralitetin me pëlqim, i cili gjithashtu është mëkat. Proklamata për familjen drejtuar botës paralajmëron “se individët që shkelin besëlidhjet e dëlirësisë, që abuzojnë me bashkëshorten ose fëmijët [ose, për këtë arsye, cilindo tjetër] . . . do të qëndrojnë një ditë përgjegjës përpara Perëndisë”²⁰.

Kur e hedhim vështrimin përreth, ne shohim shkatërrimin e ligësisë dhe të varësisë në çdo cep. Në qoftë se, si individë, vërtet shqetësohemi rreth gjykimit përfundimtar nga Shpëtimtari, ne duhet të kërkojmë pendimin. Kam frikë se shumë njerëz nuk ndihen më përgjegjës ndaj Perëndisë dhe nuk u kthehen shkrimeve të shenjta ose profetëve për udhërrëfim. Në qoftë se ne, si shoqëri, do të mendonim për pasojat e mëkatit, do të kishte kundërshtim të fuqishëm publik ndaj pornografisë dhe konsiderimit të grave si objekt.²¹ Sikurse i tha Alma birit të tij, Koriantonit, në Librin e Mormonit: “Ligësia kurrë nuk ka qenë lumturi”²².



Për sa i përket unitetit, Shpëtimtari shpalli: “Nëse nuk jeni një, nuk jeni të mitë”²³. E dimë që shpirti i grindjes është nga djalli.²⁴

Në kohën tonë, porosia e shkrimeve të shenjta për unitet shpërfillet gjerësisht dhe për shumë njerëz theksimi është te besnikëria fisnore²⁵, shpesh nisur nga pozita, gjinia, raca dhe pasuria. Në shumë vende, për të mos thënë në shumicën, njerëzit janë të ndarë thellësisht sipas mënyrës se si jetojnë. Në Kishën e Zotit, e vetmja kulturë që e mbështetim dhe e japim mësim, është kultura e ungjillit të Jezu Krishtit. Uniteti që kërkojmë, është të bëhemi një me Shpëtimtarin dhe mësimet e Tij.²⁶

Kur marrim parasysh qëllimet kryesore të Kishës, ato të gjitha bazohen te **barazia përpara Zotit**²⁷ dhe ndjekja e kulturës së ungjillit të Jezu Krishtit. Për sa i përket punës misionare, kualifikimet kryesore për pagëzim janë ta përulim veten para Perëndisë dhe të vijmë me një zemër të thyer dhe shpirt të penduar.²⁸ Shkollimi, pasuria, raca ose origjina kombëtare as nuk merren në konsideratë.

Përveç këtyre, misionarët shërbejnë me përulësi atje ku thirren. Ata nuk përpiqen të shërbejnë bazuar në standardet sipas botës për gjendjen apo përgatitjen për karrierat e ardhshme. Ata shërbejnë me gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën e tyre kudo ku caktohen. Ata nuk i zgjedhin shoqëruarit e tyre misionarë dhe kërkojnë plot zell të zhvillojnë tipare si të Krishtit²⁹,

gjëra të cilat janë në thelb të kulturës së Jezu Krishtit.

Shkrimet e shenjta na japin udhëzim për marrëdhëniet tona me të rëndësishme. Shpëtimtari dha mësim se urdhërimi i parë ishte: “Duaje Zotin, Perëndinë tënd”. Dhe i dyti është: “Duaje të afërmin tënd porsivetveten”³⁰.

Shpëtimtari shpjegoi përveç kësaj se çdo njeri është i afërmi ynë.³¹ Libri i Mormonit e bën të qartë se nuk duhet të ketë asnjë lloj -itësh, fisesh apo klasash shoqërore.³² Duhet të jemi të bashkuar dhe të barabartë përpara Perëndisë.

Ordinancat e shenjta dhe përgjegjësitë hyjnore ngrihen mbi atë kusht paraprak. Do të prisja që vetë përvojat tuaja në tempull do të ishin të ngjashme me të mijat. Kur e lija botën time të punëve të përditshme në San-Francisko dhe mbërrija në Tempullin e Oklandit, përjetoja një ndjenjë mbizotëruese të dashurisë e paqes. Një pjesë e madhe e kësaj ishte ndjesia se isha më pranë Perëndisë dhe qëllimeve të Tij. Ordinancat shpëtuese ishin përqendrimi im kryesor, por një pjesë domethënëse e atyre ndjenjave të bukura ishte barazia dhe uniteti që e përshkojnë tempullin. Gjithkush vishet me rroba të bardha. Nuk ka dukje të pasurisë, rangut ose arritjeve arsimore; ne jemi të gjithë vëllezër e motra duke e përulur veten tonë përpara Perëndisë.

Në dhomën e shenjtë të vulosjes, ordinanca e martesës së përjetshme është e njëjtë për të gjithë. Më pëlqen shumë fakti që çifti nga prejardhja më e përulur dhe çifti nga prejardhja më e pasur kanë saktësisht të njëjtën përvojë. Ata veshin të njëjtin lloj rrobash dhe bëjnë të njëjtat besëlidhje përballë njëri-tjetrit tek i njëjti altar. Ata gjithashtu marrin të njëjtat bekime të përjetshme të priftërisë. Kjo kryhet në një tempull të bukur, të ndërtuar nga të dhjetat e shenjtorëve, si shtëpia e shenjtë e Zotit.

Përmbushja e përgjegjësive të caktuara në mënyrë hyjnore, mbi bazën e drejtësisë, unitetit dhe barazisë përpara Zotit, sjell lumturi dhe paqe vetjake në këtë botë dhe na përgatit për jetën e përjetshme në botën që vjen.³³ Na përgatit për të takuar Perëndinë.³⁴

Lutemi që secili prej jush, pavarësisht nga rrethanat tuaja të tanishme, do të këshillohet me peshkopin tuaj dhe do të jetë i/e denjë për një rekomandim tempulli.³⁵

Ne jemi mirënjohës që shumë më tepër anëtarë po përgatiten për të shkuar në tempull. Ka pasur një rritje domethënëse në numrin e të rriturve të denjë që mbajnë rekomandim tempulli për shumë vite. Rekomandimet me përdorim të kufizuar për rininë e denjë janë rritur jashtëzakonisht në dy vitet e fundit. Qartësisht pjesa thelbësore e anëtarësisë besnike të Kishës nuk ka qenë kurrë më e fortë.

Në përfundim, ju lutem jini të sigurt që udhëheqësit drejtues të Kishës, të cilët kryesojnë mbi qëllimet e caktuara në mënyrë hyjnore të Kishës, marrin ndihmë hyjnore. Ky udhërrëfim vjen nga Shpirti dhe nganjëherë drejtpërdrejt nga Shpëtimtari. Janë dhënë të dyja llojet e udhërrëfimit shpirtëror. Jam mirënjohës që e kam marrë një ndihmë të tillë. Por udhërrëfimi jepet në kohën e Zotit, rresht pas rreshti dhe parim pas parimi³⁶, kur “një Zot i gjithëdijshëm qëllimisht zgjedh të na shkollojë”³⁷. Udhërrëfimi për Kishën si një e tërë vjen vetëm nga profeti i Tij.

Ne të gjithë e patëm privilegjin ta mbështetnim Presidentin Rasëll M. Nelson si profetin tonë dhe Presidentin e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtoreve të Ditëve të Mëvonshme në këtë konferencë. Të Dymbëdhjetët, si grup dhe individualisht, patën një përvojë të rëndësishme shpirtërore kur ne i vumë duart tona mbi kokën e Presidentit


Nelson dhe Presidenti Dallin H. Oaks, duke vepruar si zëri, e shuguroi atë dhe e veçoi atë si Presidentin e Kishës. Unë dëshmoj se ai u parashuguroi dhe është përgatitur gjatë gjithë jetës së tij që të jetë profeti i Zotit për kohën tonë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Eliza R. Snow, në Janiece Johnson dhe Jennifer Reeder, *The Witness of Women: Firsthand Experiences and Testimonies from the Restoration* (2016), 124; shih edhe Eliza R. Snow, në Edward Tullidge, *The Women of Mormondom* (1877), f. 65.
2. Shih *Manuali 2: Administrimi i Kishës* (2010), 2.2.
3. Doktrina e Besëlidhje 109:4.
4. Shih Russell M. Nelson, “Epistles of the Lord” (fjalim i mbajtur në seminarin për presidentët e rinj të misioneve, 25 qershor 2014), f. 1–2.
5. Stephen D. Ricks, “The Appearance of Elijah and Moses in the Kirtland Temple and the Jewish Passover”, *BYU Studies*, vëll. 23, nr. 4 (vjeshtë 1983), f. 485.
6. Doktrina e Besëlidhje 112:30.
7. Doktrina e Besëlidhje 38:38; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 43:16; 84:20–21.
8. Shih *Manuali 2*, 2.2. Përgjegjësia e katërt, kujdesuni për të varfrit dhe nevojtarët,



- nuk kishte nevojë për çelësa të rivendosur, por gjen mbështetje në organizimin e frymëzuar në mënyrë hyjnore të Kishës.
9. Këshilli Ekzekutiv i Misionarëve e mbikëqyr këtë përgjegjësi të caktuar në mënyrë hyjnore. Shih Doktrina e Besëlidhje 110:11.
 10. Këshilli Ekzekutiv i Priftërisë dhe Familjes e mbikëqyr këtë përgjegjësi të caktuar në mënyrë hyjnore. Shih Doktrina e Besëlidhje 110:12.
 11. Rasëll M. Nelson, “Besëlidhjet”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 88.
 12. Këshilli Ekzekutiv i Tempullit dhe Historisë Familjare e mbikëqyr këtë përgjegjësi të caktuar në mënyrë hyjnore. Shih Doktrina e Besëlidhje 110:13–16.
 13. 1 Nefi 14:14; shih 1 Nefi 14:5, 7, 12.
 14. Shih Mosia 18:9; Alma 6:1; 32:37; shih edhe Xhefri R. Holland, “Emisarë për Kishën”, *Liahona*, nëntor 2016, f. 61–62, 67.
 15. Doktrina e Besëlidhje 2:3.
 16. Joseph Fielding Smith, *Doctrines of Salvation*, përmb. Bruce R. McConkie (1955), 2:148–149.
 17. Shih Alma 34:32.
 18. Një temë e përsëritur në Librin e Mormonit është që, nëse njerëzit i zbatojnë urdhërimet, ata do të përparojnë në tokë, por nëse nuk i zbatojnë urdhërimet, ata do të përjashtohen nga prania e Zotit. Shih, mes të tjerave, 2 Nefi 1:9; 4:4; Alma 9:13.
 19. Kjo ka ndodhur në lëvizjen #MeToo.
 20. “Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”, *Liahona*, maj 2017, f. 145.
 21. Shih Ross Douthat, “Let’s Ban Porn”, *New York Times*, 11 shkurt 2018, SR11.
 22. Alma 41:10.
 23. Doktrina e Besëlidhje 38:27.
 24. Shih 3 Nefi 11:29.
 25. Shih David Brooks, “The Retreat to Tribalism”, *New York Times*, 2 janar 2018, A15.
 26. Shih Gjoni 17:21–22.
 27. Shih 2 Nefi 26:33: “Të gjithë janë njësoj para Perëndisë”, përfshirë “të zinj dhe të bardhë, skllëvër dhe të lirë, burra dhe gra”.
 28. Shih Doktrina e Besëlidhje 20:37.
 29. Shih *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2004), kapitulli 6.
 30. Shih Mateu 22:36–39.
 31. Shih Lluca 10:29–37.
 32. Shih 4 Nefi 1:17.
 33. Shih Doktrina e Besëlidhje 59:23.
 34. Shih Alma 34:32.
 35. Pyetjet e intervistës për rekomandimin e tempullit janë një vlerësim i mirë i mënyrës se si po veprojmë në të jetuarin e ungjillit.
 36. Shih 2 Nefi 28:30; Doktrina e Besëlidhje 98:12; 128:21.
 37. Neal A. Maxwell, *All These Things Shall Give Thee Experience* (2007), f. 31.



Nga Presidenti Rasëll M. Nelson

Punës Le t'i Vihemi

Dëshira juaj për t'u bindur do të shtohet kur e mbani mend dhe mendoni për atë që e keni ndier këto dy ditë të fundit.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, teksa arrijmë në mbylljen e kësaj konference historike, unë bashkohem me ju për ta falënderuar Zotin për udhëzimin dhe ndikimin e Tij frymëzues. Muzika ka qenë e bukur dhe lartësuese shpirtërisht. Mesazhet jo vetëm që kanë qenë lartësuese, por ato kanë qenë jetëndryshuese!

Në kuvendin solemn ne mbështetëm një Presidencë të Parë të re. Dy burra të mëdhenj janë vendosur në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve. Dhe tetë Autoritete të reja të Përgjithshme Të Shtatëdhjetë janë thirrur.

Tani një himn i parapëlqyer e përmbledh vendosmërinë tonë të ripërtërirë, sfidën tonë dhe detyrën tonë në ecjen përpara:

*Punës s'Zotit të gjith' le t'i vihemi,
Që kur jeta t'mbaroj' shpërblim ne
të kemi;
N'luftën për drejt'si ne një shpat' le
t'nxjerrim,
Shpat'n e fort' të s'vërtetës.*

*Frik' kurr' dhe armiku në na tallt';
Guxim, sepse Zotin kemi pran'.
Ne s'do t'dëgjojm' çfar' të ligjt' mund
të thon';
Por vetëm Zotin ton' do t'dë-gjojm'.¹*

Unë ju nxit t'i studioni mesazhet e kësaj konference vazhdimisht – madje në mënyrë të përsëritur – gjatë gjashtë muajve që vijnë. Me vetëdije kërkoni mënyra se si t'i përfshini këto mesazhe në mbrëmjet tuaja familjare, në mësimdhënien tuaj të ungjillit, në bashkëbisedimet tuaja me familjen e miqtë dhe në diskutimet tuaja me njerëz jo të besimit tonë. Shumë njerëz të mirë do t'u përgjigjen të vërtetave të dhëna mësim në këtë konferencë kur ato ofrohen me dashuri. Dhe dëshira juaj për t'u bindur do të shtohet kur e mbani mend dhe mendoni për atë që e keni ndier këto dy ditë të fundit.

Kjo konferencë e përgjithshme shënon fillimin e një epoke të re të dhënies së shërbesës. Zoti ka bërë përshtatje të rëndësishme në mënyrën se si përkujdesemi për njëri-tjetrin. Motrat dhe vëllezërit – të moshuarit e të rinjtë – do t'i shërbejnë njëri-tjetrit në një mënyrë të re, më të shenjtë. Kuorumet e pleqve do të forcohen për të bekuar jetën e burrave, grave dhe fëmijëve anembanë botës. Motrat e Shoqatës së Ndihmës do të vazhdojnë të japin shërbesë në mënyrën e tyre të dashur e të pashoqe duke iu dhënë mundësi motrave të reja të bashkohen me to sipas caktimit të përshtatur.

Mesazhi ynë drejtuar botës është i thjeshtë dhe i sinqertë: ne i ftojme të gjithë fëmijët e Perëndisë në të dyja anët e velit të vijnë te Shpëtimtari i tyre, të



marrin bekimet e tempullit të shenjtë, të kenë gëzim të përhershëm dhe të kualifikohen për jetën e përjetshme.²

Ekzaltimi më së fundmi kërkon tani besnikërinë tonë tërësore ndaj besëlidhjeve që i bëjmë dhe ordinancave që i marrim në shtëpinë e Zotit. Në këtë kohë, kemi 159 tempuj në funksionim dhe më shumë janë në ndërtim. Ne duam t'i sjellim tempujt më pranë anëtarësisë në zgjerim të Kishës. Kështu që tani kemi kënaqësinë të shpallim planet për ndërtimin e shtatë tempujve të tjerë. Këta tempuj do të gjenden në vendndodhjet vijuese: Salta, Argjentinë; Bengaluri, Indi; Managua, Nikaragua; Kagajan de Oro, Filipine; Lejtën, Juta; Riçmond, Virxhinia; dhe një qytet kryesor ende për t'u përcaktuar në Rusi.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, ndërtimi i këtyre tempujve mund të mos e ndryshojë jetën tuaj, por koha juaj në tempull sigurisht do të ndryshojë. Në këtë frymë, ju bekoj t'i dalloni ato gjëra të cilat mund t'i vini mënjandë që të mund të harxhoni më shumë kohë në tempull. Ju bekoj me harmoni dhe dashuri më të madhe në shtëpitë tuaja dhe dëshirë më të thellë për t'u kujdesur për marrëdhëniet tuaja familjare të përjetshme. Ju bekoj me besim më të madh te Zoti Jezu Krisht dhe aftësi më të madhe për ta ndjekur Atë si dishepujt e vërtetë të Tij.

Ju bekoj që ta ngrini zërin tuaj në dëshmi, sikurse e bëj unë tani, që ne jemi të përfshirë në veprën e Perëndisë së Plotfuqishëm! Jezusi është Krishti. Kjo është Kisha e Tij, të cilën Ai e drejton nëpërmjet shërbëtorëve të Tij të vajosur. Dëshmoj kështu, duke shprehur dashurinë time për secilin prej jush, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. "Punës Le t'i Vihemi", *Himne*, nr. 154.
2. E përcaktuar te Doktrina e Besëlidhje 14:7 si "më e madhja nga të gjitha dhuratat e Perëndisë".

marrin bekimet e tempullit të shenjtë, të kenë gëzim të përhershëm dhe të kualifikohen për jetën e përjetshme.²

Ekzaltimi më së fundmi kërkon tani besnikërinë tonë tërësore ndaj besëlidhjeve që i bëjmë dhe ordinancave që i marrim në shtëpinë e Zotit. Në këtë kohë, kemi 159 tempuj në funksionim dhe më shumë janë në ndërtim. Ne duam t'i sjellim tempujt më pranë anëtarësisë në zgjerim të Kishës. Kështu që tani kemi kënaqësinë të shpallim planet për ndërtimin e shtatë tempujve të tjerë. Këta tempuj do të gjenden në vendndodhjet vijuese: Salta, Argjentinë; Bengaluri, Indi; Managua, Nikaragua; Kagajan de Oro, Filipine; Lejtën, Juta; Riçmond, Virxhinia; dhe një qytet kryesor ende për t'u përcaktuar në Rusi.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, ndërtimi i këtyre tempujve mund të mos e ndryshojë jetën tuaj, por koha juaj në tempull sigurisht do të ndryshojë. Në këtë frymë, ju bekoj t'i dalloni ato gjëra të cilat mund t'i vini mënjane që të mund të harxhoni më shumë kohë në tempull. Ju bekoj me harmoni dhe dashuri më të madhe në shtëpitë tuaja dhe dëshirë më të thellë për t'u kujdesur për marrëdhëniet tuaja familjare të përjetshme. Ju bekoj me besim më të madh te Zoti Jezu Krisht dhe aftësi më të madhe për ta ndjekur Atë si dishepujt e vërtetë të Tij.

Ju bekoj që ta ngrini zërin tuaj në dëshmi, sikurse e bëj unë tani, që ne jemi të përfshirë në veprën e Perëndisë së Plotfuqishëm! Jezusi është Krishti. Kjo është Kisha e Tij, të cilën Ai e drejton nëpërmjet shërbëtorëve të Tij të vajosur. Dëshmoj kështu, duke shprehur dashurinë time për secilin prej jush, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. "Punës Le t'i Vihemi", *Himne*, nr. 154.
2. E përcaktuar te Doktrina e Besëlidhje 14:7 si "më e madhja nga të gjitha dhuratat e Perëndisë".

Raporti Statistikor, 2017

Për informimin e anëtarëve të Kishës, Presidenca e Parë ka nxjerrë raportin statistikor që vijon lidhur me rritjen dhe gjendjen e Kishës deri më 31 dhjetor 2017.

Njësi të Kishës

Kunje	3 341
Misione	421
Distrikte	553
Lagje dhe Degë	30 506

Anëtarësia e Kishës

Anëtarësia e Përgjithshme	16 118 169
Fëmijë të Vegjël të Shtuar në Dokumente	106 771
Të Kthyer në Besim të Pagëzuar	233 729

Misionarë

Misionarë Kohëplotë	67 049
Misionarë Shërbimi në Kishë	36 172

Tempuj

Tempuj të Përkushtuar gjatë vitit 2017 (Paris në Francë, Tuson në Arizonë, Meridian në Ajdaho, Sidër-Siti në Jutë)	4
Tempuj të Ripërkushtuar gjatë vitit 2017 (Ajdaho-Folls në Ajdaho)	1
Tempuj në Funksionim në Fund të Vitit	159

Sa vijon është një listë me përvoja të përzgjedhura, të treguara gjatë konferencës së përgjithshme. Numri i referohet faqes së parë të bisedës.

Folësi	Ngjarja
Reina I. Aburto	(78) Shenjtorë të ditëve të mëvonshme në Kili, Peru, Meksikë dhe Shtetet e Bashkuara ofrojnë ndihmë pas fatkeqësive natyrore.
Nil L. Andersen	(24) Kathi Anderseni lexon bisedat e Presidentit Rasëll M. Nelson nga konferencat e përgjithshme të shkuara dhe lutet për një siguri më të thellë për rolin e tij profetik.
M. Rasëll Ballard	(9) Kur sheh madhësinë e një fare sinapi në Jerusalem, M. Rasëll Ballard rikujton mësimet e Shpëtimtarit mbi besimin.
Dejvid A. Bednar	(30) Rasëll M. Nelsoni dhe Henri B. Ajringu ndjekin ftesën e Presidentit Tomas S. Monson për ta studiuar Librin e Mormonit dhe për t'i vënë në zbatim të vërtetat e tij.
Xhin B. Bingham	(104) Një motër e Shoqatës së Ndhmës i jep shërbesë një nëne të re "të humbur e të vetme". Një motër afrikane i jep shërbesë një motre që e kanë rrahur dhe grabitur. Anëtarë të lagjes përkujdesen për një motër që po lufton me kancerin. Të reja punojnë për të përbushur nevojat e një fqinje.
Zherald Kosé	(111) Përpara se të jepte miratimin për ndërtimin e Tempullit të Parisit në Francë, kryetari i bashkisë dhe punonjësit e tij vizitojnë një mbledhje sakramenti. Si president kunji, Zherald Koséja gëzohet për besnikërinë dhe besimin e shtuar të anëtarëve të kунjit të Shpëtimtarit. Zherald Koséja i thotë një miku se çdo familje ka nevojë për një mbajtës të priftërisë në shtëpi.
D. Tod Kristoferson	(55) Një kuorum pleqsh mbledh të korrat e një fermeri pasi disa pjesëtarë të familjes së tij vdiqën nga gripi.
Kuentin L. Kuk	(114) Shfaqje hyjnore i mbushin me gëzim anëtarët në përkushtimin e Tempullit të Kirtlandit. Kuentin L. Kuku ndien dashuri dhe paqe në Tempullin e Oklandit në Kaliforni.
Masimo De Feo	(81) I biri i Masimo De Feos u thotë shokëve të klasës se babai i tij është "drejtori i universit". Nëna që po vdes e Masimo De Feos, i tregon se ajo e do atë më shumë se veten.
Devin G. Durrant	(42) Një lojë në mbrëmjen familjare ndërton vetëbesimin e vogëlushit Devin G. Durrant. Familja Durrant del në fotografi në mjedisin jashtë tempullit.
Leri J. Eko Houk	(15) Familja Eko Houk ngushëllon prindërit e një shoferi të dehur që shtypi me makinë vëllanë dhe kunatën e Leri J. Eko Houkut.
Henri B. Ajring	(61) Stërgjyshërit e Henri B. Ajringut bien në dashuri teksa udhëtojnë përmes rrafshnaltave. Një i ri e kupton se çfarë mund të përbushin mbajtësit e priftërisë në shërbimin për Zotin. Një mësues i frymëzuar shtëpie i shërben një familjeje në nevojë të skajshme. (86) Pasi nëna e Henri B. Ajringut ndërron jetë, babai i tij merr ngushëllim nga Fryma e Shenjtë.
Tejlor G. Godoi	(34) Vdekja e birit të një miku të tij e nxit Tejlor G. Godoin që ta përdorë me urtësi secilën "ditë më shumë" të jetës. Një motër peruane i merr në konsideratë seriozisht besëlidhjet e saj pasi sakrifikon që ta frekuentojë tempullin. Tejlor G. Godoi dëshiron të jetë studenti më i mirë pasi nëna e tij sakrifikon për studimet e tij për dentist.
Gerit W. Gong	(97) Gerit W. Gongu u tregon të bijve histori para se të flinin dhe u këndon që t'i vërë në gjumë.
Xhefri R. Holland	(101) Një vëlla, bashkëshortja e të cilit sëmuret, pa e menduar i telefonon mësuesit të tij të shtëpisë që ta ndihmojë.
Daglas D. Holms	(50) Mbajtës të Priftërisë Aarone ua tregojnë dëshminë e tyre bashkëmoshatarëve. Anëtarë të kuorumit të priftërinjve mësojnë se çfarë do të thotë të jenë të "autorizuar nga Jezu Krishti".
Rasëll M. Nelson	(68) Mbajtës të priftërisë nuk ia dalin t'u japin bekime të vërteta pjesëtarëve të familjes ose motrave me thirrje të reja. Rasëll M. Nelsoni e ndihmon një burrë që të kthehet në Kishë. (93) Si djalosh, Rasëll M. Nelsonit i pëlqen shumë të mësojë mbi ungjillin dhe është i etur të vulozet me prindërit e tij. I riu Rasëll M. Nelsoni i thyen shisheet me pije alkoolike, sepse dëshiron që prindërit e tij ta jetojnë Fjalën e Urtësisë.
Dallin H. Ouks	(65) Një president i kuorumit të pleqve e këshillon një anëtar të kuorumit që të mos ta braktisë kolegjin.
Boni L. Oskarson	(36) Kur ishte tek Të Rejat, Boni L. Oskarsonit i kërkojnë të përbushë detyra dhe thirrje që normalisht kryhen nga të rriturit.
Dejll G. Renland	(46) Dashuria e Parli dhe Orson Pratit për paraardhësit e vet, i ndihmon ta ndreqin marrëdhënien e tyre. Bekimet e tempullit e ndihmojnë të shërohet një familje, zemra e birit të vdekur të së cilës u dhurua për transplantim.
Lin G. Robins	(21) Profesori i kolegjit i Lin G. Robinsit i nxit studentët që ta shohin dështimin si një këshillues dhe të vazhdojnë të përipien.
Ulises Soares	(98) Ulises Soaresi dhe bashkëshortja e tij marrin viza në një kohë të përshpejtuar pasi tregojnë besim se Zoti do të bënte një mrekulli për ta.
Geri E. Stivenson	(17) Geri E. Stivensonin merr një dëshmi për vijimësinë e profetëve pas vdekjes së Presidentit Dejvid O. Mek-Kei. Një ish-student e lavdëron stilin e mësimdhënies të dr. Rasëll M. Nelson.
Brajën K. Tejlor	(12) Brajën K. Tejlorigu kujton mësueset e tij të duruara të Fillores. Pas shkakimit të një aksidenti me makinë, një e re gjen paqe në njohurinë se ajo është fëmijë i Perëndisë.
Taniela B. Uakolo	(39) Pasi e frekuenton kishën për 39 vjet, një burrë pagëzohet e konfirmohet dhe më vonë vulozet në tempull me bashkëshorten e tij.
Leri Y. Uilson	(75) Duke vepruar sipas mbresave të tij shpirtërore, një kapelan shdm ndihmon për ta shpëtuar nga një tajfun një anije transporti dhe ekuipazhin e saj.
Klaudio D. Zivic	(83) "Duronit dhe ju do të ngadhënjeni", u thotë Presidenti Tomas S. Monson Klaudio D. Zivicit dhe bashkëshortes së tij. Një e çarë në kajakun e Klaudio D. Zivicit e bën të pamundur që ta kontrollojë atë.



Plaku Gerit W. Gong

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve

“Këtë Shabat Pashke, unë këndoj plot gëzim ‘Aleluja’”, tha Plaku Gerit W. Gong në bisedën e tij të parë në konferencën e përgjithshme si anëtar i Kuorimit të Dymbëdhjetëve Apostujve. “Kënga e dashurisë shëlbuese të Shpëtimtarit tonë të ngritur kremton harmoninë e besëlidhjeve . . . dhe Shlyerjen e Jezu Krishtit.”

Plaku Gong ka kaluar një jetë të tërë duke u gëzuar në atë harmoni. Ai e di se fuqia e besëlidhjeve tona, e shoqëruar me Shlyerjen e Shpëtimtarit, na “bëjnë të zotë dhe fisnikë”. “Së bashku, ato ëmbëlsojnë, ruajnë, shenjtërojnë [dhe] shëlbajnë”, tha ai.

Në një martesë në tempull një ditë, fuqia e besëlidhjeve, e shoqëruar me Shlyerjen, u pasqyrua në pasqyrat e tempullit. Ai i përfytyroi brezat e familjes së tij të shtrira përmes përjetësisë, nga i afërmi i tij më i hershëm i njohur, Dragoi i Parë Gong, i lindur në vitin 837 ps.K., përmes 36 brezave deri tek vetë fëmijët e tij dhe pastaj më tej e më tej në të dy drejtimet.

“Unë fillova t’i kuptoj bashkëshorten time dhe veten njëkohësisht si fëmijë të prindërve tanë dhe prindër të fëmijëve tanë, si nipër të gjyshërve tanë dhe si gjyshër të nipërve tanë”, tha ai. “Mësimet e mëdha të vdekshmërisë përvetësohen gradualisht në shpirtrat tanë ndërsa mësojmë dhe japim mësim në rolet tona të përjetshme, përfshirë fëmijë dhe prind, prind dhe fëmijë.”

Plaku Gong ka shërbyer si Autoritet i Përgjithshëm i Shtatëdhjetë që nga prilli 2010 dhe si anëtar i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve që nga tetori 2015. Ai u mbështet si anëtar i Kuorimit të Dymbëdhjetë Apostujve më 31 mars 2018, gjë që ai e përshkroi si një “thirrje të shenjtë nga Zoti, e cila më la pa frymë”.

Nga viti 2011 deri në 2015, Plaku Gong shërbeu si anëtar i Presidencës së Zonës së Azisë, duke përfshirë edhe shërbimin si President i Zonës. Ai ka shërbyer si misionar kohëplotë në Misionin e Tajvanit, Taipei, si këshilltar i lartë, udhëheqës i grupit të priftërinjve të lartë, president i Shkollës të së Dieles për kunjin, mësues seminari, peshkop,

president i misionit të kunjit, president kunji dhe I Shtatëdhjetë Zonal.

Plaku Gong mori diplomën e shkencave shoqërore në degën e studimeve aziatike dhe studimeve universitare në Universitetin “Brigam Jang” në vitin 1977. Në vitin 1979 ai mori një diplomë pasuniversitare në filozofi dhe në vitin 1981 doktoratën për marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin e Oksfordit, ku ishte me bursën Rouds. Në vitin 1985 ai shërbeu si ndihmës i posaçëm i zëvendësministrit të punëve të jashtme në Departamentin e Shtetit të SHBA-së dhe në vitin 1987 si ndihmës i posaçëm për ambasadorin e SHBA-së në Pekin të Kinës. Duke filluar nga viti 1989 ai shërbeu në disa pozita në Qendrën për Studimet Strategjike dhe Ndërkombëtare në Uashington, D.K. Ai ishte ndihmës i presidentit për planifikimin dhe vlerësimin në Universitetin “Brigam Jang” deri në prill të 2010-ës.

Gjyshërit e Plakut Gong emigruan nga Kina për në Shtetet e Bashkuara. Plaku Gong u lind në Redud-Siti të Kalifornisë në SHBA në vitin 1953. Ai u martua me Suzan Lindsin në janar 1980 dhe ata janë prindërit e katër fëmijëve dhe kanë tre nipër e mbesa.

“Çdo gjë e denjë dhe e përjetshme është e përqendruar në realitetin e gjallë të Perëndisë, Atit tonë të Përjetshëm e të dashur, dhe Birit të Tij, Jezu Krishtit, dhe të Shlyerjes së Tij, që dëshmohet nga Fryma e Shenjtë”, tha Plaku Gong në këtë kon-

ferencë. “Unë me nderim jap dëshmim dhe solemnisht dëshmoj për Krishtin e gjallë – për Atë i cili [ishte] . . . me ne që nga fillimi, Ai është me ne deri në mbarim.” ■





Plaku Ulises Soares

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve

Profetët e gjallë, përfshirë Presidentin Rasëll M. Nelson, janë shenjë e dashurisë së Perëndisë për fëmijët e Tij, dëshmoi Plaku Ulises Soares gjatë bisedës së tij të parë në konferencën e përgjithshme si anëtar i Kuorunit të Dymbëdhjetëve Apostujve.

“A nuk është bekim të kemi profetë, shikues dhe zbulues në tokë në këto ditë në të cilat jetojmë, të cilët kërkojnë të dinë vullnetin e Zotit dhe ta ndjekin atë vullnet? Është ngushëlluese të dimë se nuk jemi vetëm në botë, pavarësisht nga sfidat me të cilat përballemi në jetë.”

Edhe pse u ndje i papërshtatshëm për thirrjen e tij si Apostull, tha Plaku Soares, “fjalët e [Presidentit Nelson] dhe vështrimi i dhembshur në sytë e tij, teksa ma drejtoi këtë përgjegjësi, më bënë të ndihem i përqafuar nga dashuria e Shpëtimtarit”.

Me mbështetjen e tij më 31 mars 2018, Plaku Soares u bë Apostulli i parë i Kishës nga Amerika Latine. Përpara thirrjes së tij, ai kishte qenë anëtar i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve që nga 6 janari 2013 dhe po shërbente në një detyrë të veçantë për Peshkopatën Kryesuese në Solt-Lejk-Siti.

Plaku Soares u thirr si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetëve më 2 prill 2005. Në këtë detyrë, ai shërbeu si këshilltar në Zonat e Afrikës Juglindore dhe të Brazilit të Jugut, si edhe si President i Zonës së Brazilit.

Plaku Soares ka shërbyer në shumë thirrje të tjera të Kishës. Ai ka qenë misionar kohëplotë në Misionin e Brazilit, Rio-de-Zhanejro, president i kuorunit të pleqve, këshilltar në peshkopatë, këshilltar i lartë, sekretar ekzekutiv i kunjit, vepërues krahinor për mirëqenien, president kunji dhe president i Misionit të Portugalisë, Lisbonë nga viti 2000 deri në 2003.

Një nga thirrjet e tij më të rëndësishme i erdhi në moshën 15-vjeçare kur peshkopi i tij i kërkoi që përkohësisht të jepte mësim në një klasë të Shkollës të së Dielës për rininë. Në përgatitje për një mësim se si të marrim dëshmi, djaloshi Ulises vendosi të lutej për pohim të vërtetësisë së ungjillit.

“Kur rashë në gjuhë dhe e pyeta Zotin a është i vërtetë ungjilli”, solli ndërmend ai, “më erdhi në zemër një ndjenjë shumë e ëmbël, një zë i ulët që

më vërtetoi se unë duhej të vazhdoja në të. Ishte kaq e fortë sa nuk mundesha kurrë të thosha se nuk e dija.”

Në vitin 1985 ai mori diplomën universitare për kontabilitet dhe ekonomik në Shkollën e Shkencave Ekonomike të Universitetit Katolik Pontifikal të San-Paolos. Pas marrjes së diplomës pasuniversitare për administrim biznesi, ai punoi si financier dhe kontrollor financiar për korporata ndërkombëtare në Brazil dhe si drejtor për çështjet materiale në zyrën zonale të Kishës në San-Paolo.

Ulises Soares u lind në San-Paolo të Brazilit më 2 tetor 1958. Ai u martua me Rosana Fernandesin në tetor 1982. Në bisedën e tij në konferencën e përgjithshme, Plaku Soares i dha merita bashkëshortes së tij për dashurinë dhe përkrahjen e saj.

“Ajo ka qenë shembull i mirësisë, dashurisë dhe përkushtimit tërësor ndaj Zotit për mua dhe familjen time”, përfshirë tre fëmijët e çiftit dhe tre nipër e mbesa, tha ai në bisedën e tij në konferencë. “E dua atë me çdo grimë të zemrës sime dhe jam mirënjohës për ndikimin pozitiv që ajo ka pasur mbi ne.” ■





Plaku Karl B. Kuk

Presidenca e Të Shtatëdhjetëve

Plaku Karl B. Kuk beson se privilegji i shërbimit është një nga bekimet e mëdha të anëtarësisë në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Por, siç bëri të ditur ai, pranimi dhe lartësimi i thirrjeve kërkon besim.

Plaku Kuk, i mbështetur si anëtar i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve më 31 mars 2018, i krahason anëtarët e Kishës – të cilët shërbejnë së bashku në degë dhe lagje, kuorume dhe organizata ndihmëse – me një “marsh për malore” në një automobil, i cili prodhon më shumë tërheqje.

Një marsh për malore, së bashku me një sistem transmissiioni për katër rrota aktive, “ju lejon që ta ulni marshin, të fuqizoheni dhe të lëvizni”, tha ai në konferencën e përgjithshme të tetorit 2016. “Ashtu siç ndërthuren ingranazhet për të dhënë fuqi më të madhe kur puqen, edhe ne kemi fuqi më të madhe kur bashkohemi së bashku. Kur ne bashkohemi për t’i shërbyer njëri-tjetrit, ne arrijmë të përmbushim shumë më tepër së bashku sesa po të ishim vetëm. Është drithëruese të jemi të përfshirë dhe të bashkuar ndërsa shërbejmë dhe ndihmojmë në punën e Zotit.”

Plaku Kuk u mbështet si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë më 2 prill 2011. Përpara detyrës së tij të re, Plaku Kuk shërbeu në zyrat qendrore të Kishës, ku ai ndihmonte në mbikëqyrjen e Zonës Perëndimore të Amerikës së Veriut, mes përgjegjësive të tjera. Përpara kësaj, ai shërbeu si President i Zonës së Afrikës Juglindore.

Plaku Kuk i ka nxitur shenjtorët e ditëve të mëvonshme që të mbajnë mend se thirrjet në Kishë vijnë nga Perëndia nëpërmjet shërbëtorëve të Tij të caktuar.

“Bekime vijnë kur ne ngulmojmë në thirrjet dhe përgjegjësi të tona dhe durojmë me gjithë besimin që kemi.”

Plaku Kuk mori një diplomë universitare për shkencat shoqërore në Kolegjin Shtetëror të Uibërit në Jutë dhe një diplomë pasuniversitare për administrim biznesi në Universitetin Shtetëror të Jutës. Përpara se të thirrej në Të Shtatëdhjetët, ai punoi në zhvillimin e pasurive të patundshme tregtare.

Thirrjet e Plakut Kuk përfshijnë shërbimin si misionar kohëplotë në Hamburg të Gjermanisë dhe si peshkop, president kunji, I Shtatëdhjetë Zonal dhe si president i Misionit të Zelandës së Re, Okland.

Ai u lind në Ogden të Jutës në SHBA më 15 tetor 1957. U martua me Linet Hensenin në dhjetor të vitit 1979. Ata janë prindër të pesë fëmijëve. ■



Plaku Robert C. Gei

Presidenca e Të Shtatëdhjetëve

Ndërsa shërbente si president misioni në Ganë, Plaku Robert C. Gei mori një mbresë një ditë që të ndalonte dhe të ndihmonte një djalë që po qante. Fillimisht, ai e shpërfilli atë mbresë, por më vonë dërgoi një anëtar të Kishës që ta gjente dhe ta sillte djalin tek ai.

Plaku Gei, i mbështetur si anëtar i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve më 31 mars 2018, mësoi se djali shiste peshq të tharë për kujdestarin e tij. Atë ditë djali i kishte humbur paratë e fituara për shkak të një vrimë në xhepin e vet.

“Nëse do të kthehej pa paratë, atë do ta quanin gënjeshtar, me shumë gjasa do ta rrihnin dhe më pas do ta flaknin në rrugë”, tha Plaku Gei. “Ne e qetësuam nga ajo gjendje frike, ia zëvendësuam fitimin e humbur dhe e kthyem në shtëpi të kujdestari i tij.”

Sikurse shpjegoi ai në konferencën e përgjithshme të tetorit 2012, ajo përvojë i mësoi Plakut Gei dy të vërteta të mëdha: “Së pari, e dija si asnjëherë më parë se Perëndia di çdo gjë rreth secilit prej nesh dhe nuk do të na braktisë kurrë; dhe së dyti, e dija se ne gjithmonë duhet t’ia vëmë veshin zërit të Shpirtit brenda nesh dhe të shkojmë ‘menjëherë’ kudo që ai na çon, pavarësisht nga frikërat tona apo ndonjë shqetësim”.

Plaku Gei u mbështet si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë më 31 mars 2012. Në kohën kur u thirr në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve, ai po shërbente si President i Zonës së Azisë Veriore. Më përpara ai shërbeu në zyrat qendrore të Kishës si kryetar i Komitetit të Shërbimeve të Mbështetjes te Vetja dhe Fondit të Qarkullueshëm Arsimor, me përgjegjësi për shërbimet mbarëbotërore të mbështetjes te vetja.

Përpara thirrjes së tij në Të Shtatëdhjetët, ai ishte drejtori ekzekutiv kryesues i një firme investimesh në të cilën ishte njëri nga themeluesit. Ai gjithashtu ishte njëri nga themeluesit dhe shërbeu si drejtor i disa organizatave humanitare mbarëbotërore dhe punoi në bankën investuese në Uoll-Strit, si këshilltar administrimi dhe si profesor i lëndës së ekonomisë në Universitetin e Harvardit.

Plaku Gei mori një diplomë universitare për ekonomi me një theksim në statistikat nga Universiteti i Jutës dhe një doktoratë për ekonominë e biznesit nga Universiteti i Harvardit.

Plaku Gei ka shërbyer si misionar kohëplotë në Spanjë, si udhëheqësi i grupit të priftërinjve të lartë, president i Të Rinjve të lagjes, këshilltar i lartë, këshilltar në peshkopatë dhe I Shtatëdhjetë Zonal.

Ai u lind në Los Anxhelos të Kalifornisë në SHBA më 1 shtator 1951. U martua me Linet Nilsenin në prill të vitit 1974. Ata janë prindërit e shtatë fëmijëve. ■



Plaku Terens M. Vinson

Presidenca e Të Shtatëdhjetëve

Plaku Terens M. Vinson beson se Shpëtimtari nuk është kurrë larg. “Ai është gjithmonë pranë, veçanërisht në vende të shenjta dhe në kohë nevoje”, dëshmoi ai në konferencën e përgjithshme të tetorit 2013. “Ndonjëherë, kur unë e pres më pak, unë ndiej thujse sikur Ai më prek në supe që të më tregojë se Ai më do.”

Një herë, teksa Plaku Vinson po ecte me Plakun Xhefri R. Holland, të Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve, Plaku Holland ia hodhi krahun mbi supe Plakut Vinson dhe i tha se e donte atë. Plaku Vinson tha: “Unë besoj se nëse do të mund të kishim privilegjin të ecnim fizikisht me Shpëtimtarin, ne do të ndienim krahun e Tij të hedhur mbi supin tonë po ashtu”.

Plaku Vinson, i mbështetur si anëtar i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve më 31 mars 2018, thotë se dashuria e Perëndisë “është ndjenja më e ëmbël”.

Plaku Vinson, i cili do ta fillojë thirrjen e tij të re më 1 gusht 2018, u mbështet si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë i Kishës më 6 prill 2013. Në atë kohë ai po shërbente si anëtar i Kuorunit të Tetë të Të Shtatëdhjetëve në Zonën e Paqësorit. Tani po shërben si President i Zonës së Afrikës Perëndimore.

Plaku Vinson mori një diplomë universitare për matematikë dhe statistikë, një diplomë për arsimim e mësimdhënie dhe një diplomë pasuniversitare për financën e zbatuar. Karriera e tij ka përfshirë mësimdhënie, trajnim dhe dhënie leksionesh në universitete. Ai ka punuar kryesisht si këshilltar financiar dhe administrator fondesh.

Ndërkohë që ishte kërkues në Kishë kur qe një i ri në moshë madhore, Plaku Vinson mori një mbresë të fortë shpirtërore. E ndjeu qartësisht se duhej të bashkohej me Kishën me qëllim që të përparonte dhe të gjente përgjigje për pyetjet që i kishte akoma. Ai u pagëzua dhe u konfirmua javën pasuese.

Që nga ajo kohë “e dija se çfarë priste Zoti që të bëja dhe zbulova se të gjitha pyetjet e mia kishin vërtet përgjigje”.

Që nga pagëzimi i tij në vitin 1974, Plaku Vinson ka shërbyer si këshilltar në peshkopatë, peshkop, këshilltar i lartë, këshilltar në një presidencë kunj, përfaqësues krahinor, këshilltar në një presidencë misioni, punonjës ordinancash në tempull dhe I Shtatëdhjetë Zonal.

Ai u lind në Sidnei të Australisë më 12 mars 1951. U martua me Kei En Kardenin në maj të vitit 1974. Ata janë prindër të gjashtë fëmijëve. ■



Plaku Zhozé A. Teisheira

Presidenca e Të Shtatëdhjetëve

Plaku Zhozé A. Teisheira sjell ndërmend një mësim që e mori kur ishte djalë i vogël në Portugali. Gjatë një takimi të familjeve të të afërmeve të tij, ai u largua fshehurazi që të shkonte për peshkim. Pati ndjenjën që duhej t’u thoshte prindërve të tij se ku po shkonte, por vendosi të mos u thoshte se ishin të zënë duke biseduar.

Orë më vonë, prindërit e tij të shqetësuar e gjetën në buzë të lumit. Nga ajo përvojë mësoi t’u bindej jo vetëm prindërve të vet, por edhe pëshpëritjeve të Frymës së Shenjtë.

Që nga ajo kohë, Plaku Teisheira e ka bërë zakon t’ia vërë veshin zërit të qetë, të ulët. Ai dhe familja e tij u njohën me ungjillin në vitin 1976, pasi Portugalia u hap si vend për punën misionare. Ai u pagëzua në moshën 16-vjeçare dhe më vonë shërbeu si misionar në Misionin e Portugalisë, Lisbonë.

“Zgjedhjet tona kanë fuqi të pamohueshme në ndryshimin e jetës sonë”, tha Plaku Teisheira, i mbështetur si anëtar i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve më 31 mars 2018. “Kjo dhuratë është një shenjë e jashtëzakonshme e mirëbesimit te ne dhe njëkohësisht një përgjegjësi e gëzueshme vetjake për të shërbyer me urtësi”, dha mësim ai në konferencën e përgjithshme të prillit 2009.

Plaku Teisheira mori diploma universitare për financë e administrim biznesi dhe punoi për Kishën si kontrollor ndërkombëtar. Ai gjithashtu shërbeu në Forcën Ajrore Portugeze si pjesë e një njësie të NATO-s. Gjatë asaj kohe, ai u thirr si drejtori kombëtar i çështjeve publike për Kishën. Shpejt pas kësaj ai u takua me bashkëshorten e tij, Maria Filomena Lopes Teles Grilon. Ata u martuan në vitin 1984 në Tempullin e Bernës në Zvicër dhe janë prindër të tre fëmijëve.

Zhozé Augusto Teisheira da Silva lindi në Vila Real, Portugali, më 24 shkurt 1961. Ai ka shërbyer si këshilltar në peshkopatë, president distrikti, president kunj, I Shtatëdhjetë Zonal dhe president i Misionit të Brazilit, San-Paolo Jugore. U mbështet si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë më 5 prill 2008. Ai shërben tani si President i Zonës Jugore të Amerikës së Jugut dhe do ta fillojë shërbimin e tij në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve më 1 gusht 2018.

Mbi të gjitha, Plaku Teisheira na këshilloi në konferencën e përgjithshme të prillit 2015 që ta “thellojmë kuptueshmërinë tonë për Shpëtimtarin. . . . Të mos e lëmë për nesër atë që mund ta bëjmë sot. Është tani që ne duhet të vijmë te Krishti.” ■



Plaku Karlos A. Godoi

Presidenca e Të Shtatëdhjetëve

Nga fundi i viteve 1980, Plaku Karlos A. Godoi sapo ishte liruar nga detyra si peshkop. Ai gjithashtu ishte diplomuar në kolegji, po punonte për një kompani të suksesshme dhe mendonte se jeta nuk mund të bëhej më e mirë – derisa një mik i vjetër i erdhi për vizitë.

Ai mik e përgëzoi, por më pas i bëri një pyetje që e la të përshtjelluar: “Nëse vazhdon të jetosh në mënyrën si po jeton, a do t’i përmbushësh bekimet e premtuara në bekimin tënd patriarkal?”

Plaku Godoi e kuptoi se kishte nevojë të bënte ndryshime nëse dëshironte t’i merrte të gjitha bekimet që i ishin premtuar. Pavarësisht se ishte i kënaqur, vendosi të ndiqte studimet pasuniversitare. E la punën, shiti gjithçka që zotëronte, dhe së bashku me familjen e vet, u largua nga gjithçka që e njihnte në Brazil, dhe ndoqi shkollën në Shtetet e Bashkuara.

Plaku Godoi, i thirrur në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve më 31 mars 2018, tha se kjo përvojë i mësoi atij shumë rreth mirëbesimit në planin e Zotit dhe të qenit i gatshëm për ta lënë zonën e tij të rehatisë.

“Unë e di se Zoti ka një plan për ne në këtë jetë”, dëshmoi ai në konferencën e përgjithshme të tetorit 2014. “Ai na njeh. Ai e di se ç’është më e mir[a] për ne. Vetëm ngaqë gjërat po shkojnë mirë, nuk do të thotë se nuk duhet që herë pas here të marrim parasysh nëse mund të ketë diçka më të mirë.”

Plaku Godoi u mbështet si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë më 5 prill 2008. Ai po shërben si President i Zonës Veriperëndimore të Amerikës së Jugut dhe do ta zërë vendin e tij në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve më 1 gusht 2018.

Përpara thirrjes së tij në Të Shtatëdhjetët, Plaku Godoi punonte si administrator i burimeve njerëzore për dy korporata të mëdha, përpara se të hapte kompaninë e vet të këshillimit. Ai mori një diplomë universitare për shkencë ekonomike dhe politike në Universitetin Katolik Pontifikal të San-Paolos në vitin 1987 dhe një diplomë pasuniversitare për sjelljen organizative në Universitetin “Brigam Jang” në 1994-ën.

Plaku Godoi ka shërbyer si misionar kohëplotë në Misionin e Brazilit, San-Paolo Jugor, si peshkop, këshilltar i lartë, veprues krahinor i mirëqenies, I Shtatëdhjetë Zonal dhe president i Misionit të Brazilit, Belem.

U lind në Porto-Alegre të Brazilit më 4 shkurt 1961. Ai u martua me Monika Soares Brandaon në mars të vitit 1984 dhe kanë katër fëmijë. ■



Plaku Stiven R. Bangerter

Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë

Gjatë një udhëtimit kampimi në fëmijëri, Plaku Stiven R. Bangerter dhe familja e tij nganë motorët për rrugë të pashtruara drejt majës së një mali. Duke zbritur ai e humbi udhën dhe u veçua nga të tjerët.

Teksa ra në gjunjë atë pasdite dhe iu lut Atit të tij në Qiell për ndihmë, me sytë e mendjes ai pa shtegun që e kishte humbur. Kur sapo fillova të zbrisja, “vëllai im e arriti kreun e shtegut me motoçikletën e vet, më përqafoi dhe më rrefeu udhën nëpër errësirë drejt kampit, i cili ishte disa orë larg”.

Ky rast ishte thjesht njëri prej shumë rasteve që e bënë të ndiente dashuri gjatë fëmijërisë së tij. “Nuk pati kurrë asnjë çast në jetën time kur e pyeta veten a më donin ose kujdeseshin për mua”, tha Plaku Bangerter.

Plaku Bangerter u lind në Solt-Lejck-Siti të Jutës në SHBA, nga Maks E. dhe Telma R. Bangerteri më 29 korrik 1961. Ai u rrit në Grenxhër të Jutës.

Brenda pak javësh pas kthimit nga shërbimi në Misionin e Kanadasë, Vankuver, Plaku Bangerter u takua me Suzan Aleksis Hjuzin. Në daljen e tyre të parë në një takim, ai ndjeu tek ajo një dëshirë të përlulur për të shërbyer që e nxiti t’i propozonte për martesë në takimin e tyre të dytë. Ata u vulosën në Tempullin e Solt-Lejkut në 17 mars 1983. Ata janë prindër të gjashtë djemve.

Plaku Bangerter mori një diplomë universitare në Universitetin Shtetëror të Arizonës për studime fetare dhe një gradë doktori për drejtësi në Kolegjin e Universitetit Shtetëror Perëndimor të Ligjit. Gjatë 25 vjetëve të shkuar, Plaku Bangerter ka përfaqësuar kisha dhe organizata me baza fetare në praktika ligjore në Kaliforninë e Jugut dhe në Jutën jugore. Ai ishte ortak në firmën Kuksi, Tulën, Gejxh, Dafi dhe Ug nga viti 1993 deri në 2003 dhe u bë ortak administrues i firmës Bangerter, Freizër dhe Graf në 2004-ën.

Plaku Bangerter ka shërbyer si I Shtatëdhjetë Zonal, president kunji, këshilltar në një presidencë kunji, peshkop, president i kuorumit të pleqve dhe president i Të Rinjve të lagjes. ■



Plaku Methju L. Karpenter

Autoritet i Përgjithshëm / Shtatëdhjetë

Plaku Methju L. Karpenter mban mend herën e parë që e dalloi kur e ndjeu Frymën e Shenjtë. Ishte djalë i vogël, rreth shtatë vjeç, i ulur në grupin e fëmijëve më të vegjël të Filllores. Një dritë po hynte në dhomë dhe ai pati një ndjenjë ngrohtësie që nuk e kishte dalluar më parë.

“Ndjeva ngacmime në zemrën time – dhe jo ngaqë ndjeva të ngrohtë”, tha ai. “E dija se Perëndia është i vërtetë; e ndjeva atë.”

Kur ishte 11 vjeç, ai mori pjesë në një sesion të konferencës së përgjithshme në Tabernakullin e Solt-Lejkut me babanë e vet. Ishte hera e parë që ai ishte në të njëjtën dhomë me një profet, Presidentin Jozef Filding Smith.

“Kur e pashë atë”, tha ai, “Shpirti më dha dëshmi se ai ishte profeti.”

Këto pohime të thjeshta shpirtërore në një moshë të vogël e ndihmuan të shihte drejt Shpirtit si një ndikim udhërrëfyes gjatë gjithë jetës së vet.

“Dëshmia ime nuk ka qenë një përvojë e vetme engjëllorë”, tha Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë, i cili u mbështet më 31 mars 2018, “por është zhvilluar dhe përmirësuar me kalimin e kohës.”

Methju Lesli Karpenteri u lind në Solt-Lejk-Siti të Jutës, në SHBA më 21 tetor 1959, nga Liona Ekersoni dhe Robert Ollred Karpenteri. Ai është më i vogli i tetë fëmijëve të çiftit dhe u rrit në një familje me pesë motra më të mëdha.

Muajin e fundit të shkollës së mesme, ai u takua me Mishell “Shelli” Braunin. Ata filluan të dilnin në takime, por e lanë pezull shoqërimin e tyre ndërkohë që ai shërbeu në Misionin e Zvicrës, Gjenevë nga viti 1979 deri në 1981. Pas kthimit të tij, çifti u martua në Tempullin e Solt-Lejkut më 9 korrik 1982. Ata janë prindër të pesë fëmijëve.

Plaku Karpenter mori një diplomë universitare për financë në Universitetin “Brigam Jang” dhe një diplomë pasuniversitare për administrim biznesi në Shkollën e Biznesit të Harvardit. Në kohën më të fundit ai ishte drejtori administrues i Fondit të Financimit të Fondacioneve të Specializuara.

Plaku Karpenter ka shërbyer si peshkop, këshilltar në peshkopatë, president i Të Rinjve të kunjit, këshilltar i lartë, president kunji dhe I Shtatëdhjetë Zonal. ■



Plaku Xhek N. Xherard

Autoritet i Përgjithshëm / Shtatëdhjetë

Kur ishte djalosh, Plaku Xhek N. Xherard zgjohej çdo ditë rreth orës 5:00 në mëngjes që të ndihmonte për t’u kujdesur për lopët e familjes që përdorëshin për bulmet. Rritja në një komunitet të vogël fermer pranë liqenit Mad në Ajdaho të SHBA-së i mësoi atij jo vetëm që të punonte shumë dhe të mbante përgjegjësi, por edhe ta dallonte vlerën e të gjithë individëve si fëmijë të Perëndisë.

“Kushdo kishte një rol për ta luajtur dhe kushdo ishte këtu për një qëllim, pavarësisht nga gjendja ose pozita në jetë”, tha Plaku Xherard, i cili u mbështet më 31 mars 2018 si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë. Ai mësim ka qenë një dhuratë gjatë gjithë jetës së tij.

Karriera e tij, e cila ka përfshirë role të shquara udhëheqjeje për disa subjekte – të tilla si Shoqata Kombëtare e Minierave, Këshilli Amerikan i Kimisë dhe, kohën e fundit, Instituti Amerikan i Naftës – i ka siguruar mundësi që të bashkëpunojë me njerëz nga të gjitha fushat e jetës.

Plaku Xherard u lind në vitin 1957 nga Xhejms dhe Sesil Gejzër Xherardi. Pasi shërbeu në Misionin e Australisë, Sidnei, Plaku Xherard ndoqi Universitetin e Ajdahos, ku bëri stazhin dhe më pas punoi në një pozitë me kohë të plotë si nëpunës i një kongresmeni të Ajdahos.

Teksa punonte në Uashington, D.K., u takua me Klodet Nefin, e cila po punonte si ndihmësnëpunëse për një senator të Jutës. “Ajo e rrezatonte dritën e ungjillit”, tha Plaku Xherard për takimin e tyre. Ata u martuan më 4 prill 1984 në Tempullin e Solt-Lejkut. Kanë tetë fëmijë dhe katër nipër e mbesa.

Plaku Xherard mori një diplomë universitare për shkencë politike dhe një gradë doktori për drejtësi në Universitetin “Xhorxh Uashington”.

Plaku Xherard ka shërbyer si peshkop, president kunji, I Shtatëdhjetë Zonal, mësues i Doktrinës së Ungjillit dhe si president i Shkollës të së Dielës.

Plaku Xherard tha se ai dhe gruaja e tij kanë dëshirë të bëjnë vullnetin e Zotit. “Si njerëz të vdekshëm, të dobët, ne zotohemi ndaj çfarëdo gjëje që Zoti do të na donte të bënim dhe jemi të përlurur e të nderuar . . . t’ia përkushtojmë kohën dhe përpjekjet tona punës së Zotit.” ■



Plaku Matias Held

Autoritet i Përgjithshëm / Shtatëdhjetë

Plaku Matias Held dhe bashkëshortja e tij, Irena, me vend mund të quhen mishërime të Kishës mbarëbotërore. Ata janë kolumbianë me origjinë gjermane. Punët dhe shkollimi i kanë çuar nga atdheu i tyre në Amerikën Latine drejt Kanadasë, Gjermanisë, Guatemalës e Brazilit dhe më së fundi përsëri në Kolumbi. Në çdo vend, ata iu përshtatën gjuhëve dhe kulturave të reja.

“Por Kisha ishte saktësisht e njëjtë kudo ku shkuam”, tha Plaku Held, i cili u mbështet si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë më 31 mars 2018.

Ajo “njëtrajtshmëri” shpirtërore krijoi themelin për çiftin teksa i rritnin tre fëmijët e tyre dhe forcoheshin në ungjill.

Ata ishin shokë klase në një shkollë në gjuhën gjermane në qytetin e tyre të lindjes në Bogota të Kolumbisë. U vulosën më 13 qershor 1989 në Tempullin e Frankfurtit në Gjermani, pasi Matias mori një diplomë universitare për inxhinieri mekanike në Bogota dhe një diplomë pasuniversitare për administrim biznesi në Kanada.

Mundësitë për punë më pas e çuan çiftin e ri në Hanover të Gjermanisë ku Motra Held mori një mbresë të fuqishme që jeta e tyre ishte gati për të ndryshuar.

“I thashë Matiasit se pata një ndjenjë që do të merrnim një lajm nga qielli”, tha ajo. Ai lajm qiellor mbërriti në një pasdite me shi të vitit 1987 me një trokitje në derën e hyrjes. Jashtë po qëndronin misionarë mormonë që flisnin gjermanisht me theks amerikan.

Gjatë 10 muajve të ardhshëm, çifti Held studioi me misionarët dhe bëri miq në bashkësinë vendore shdm. Pas shumë lutjeje, ata morën pohimin shpirtëror të vërtetësisë së ungjillit dhe u pagëzuan në vitin 1988.

Plaku Held punoi për më shumë se 25 vjet për prodhuesin e makinave Daimler-Benz, ku detyrat e tij si administrator e çuan anembanë botës. Çifti Held është mbështetur te Zoti në çdo vendndalesë.

“Nuk ka rëndësi se përmes çfarë sprovash po kalon”, tha ai. “Në qoftë se po komunikon me qiellin, do të jesh në rregull.”

I lindur më 5 qershor 1960 nga Mikael dhe Elizabet Heldi, Plaku Held ka shërbyer si këshilltar në një presidencë kunji, këshilltar në peshkopatë dhe I Shtatëdhjetë Zonal në Zonën Veriperëndimore të Amerikës Jugore. ■



Plaku Dejvid P. Homer

Autoritet i Përgjithshëm / Shtatëdhjetë

Një nga kujtimet më të hershme të Plakut Dejvid P. Homer lidhur me ungjillin është kur u caktua në moshën 14-vjeçare si shoqërues i mësuesit të shtëpisë për një anëtar të lagjes së tij, mësues i cili “ndërmori një metodë të pazakontë për mësimin e shtëpisë”, tha Plaku Homer. “Nuk kishte të bënte me shkuarjen në shtëpi dhe vizitat nëpër njerëz; kishte të bënte me dhënien e shërbesës ndaj nevojave të tyre.”

Si dyshe shoqëruese, ata luteshin dhe flisnin për familjet që u ishin caktuar, jo si një i rritur dhe një i ri, por si bashkëpunëtorë në shërbimin e priftërisë. “Mësova se Shpirti vjen me shërbimin dhe është i lidhur me të”, tha Plaku Homer.

Ai mësim ka qëndruar gjatë gjithë jetës së tij me të dhe me shërbimin në Kishë që ka rrjedhur prej tij, qoftë kur shërbente si I Shtatëdhjetë Zonal, si udhëheqës i çerdhes apo si specialisti i stendës së lajmërimeve – një thirrje që e përmbushi ndërkohë që ai dhe bashkëshortja e tij jetonin në Melburn të Australisë.

Dejvid Paul Homeri u lind më 25 prill 1961 në Solt-Lejk-Siti të Jutës në SHBA nga Frederik dhe Fillis LeNajla Homeri. Pas misionit të tij në Hong-Kong nga viti 1980 deri në 1982, ai u takua me Nensi Dransfilldin, një të diplomuar në Universitetin “Brigam Jang”, në një mbledhje rreth vatrës të institutit në Solt-Lejk-Siti, ku ajo po punonte dhe ndiqte klasa tek Universiteti i Jutës. Ata u martuan në Tempullin e Solt-Lejkut më 31 korrik 1984. Kanë rritur pesë vajza dhe një djalë.

Plaku Homer mori një diplomë universitare për ekonomi në Universitetin e Jutës dhe një diplomë pasuniversitare për administrim biznesi në Shkollën Uarthën tek Universiteti i Pensilvanisë.

Gjatë karrierës së tij 30-vjeçare si drejtues i kompanisë General Mills, ai dhe bashkëshortja e tij jetuan në Majemi të Floridës në SHBA, Mineapolis të Minesotës në SHBA, Bërlington të Ontarios në Kanada dhe San-Sulpis të Vaudit në Zvicër.

Plaku Homer ka shërbyer si president kunji, peshkop, president i kuorumit të pleqve dhe sekretar ekzekutiv i lagjes. Si I Shtatëdhjetë Zonal ai e filloi shërbimin e tij në Kanada dhe e vazhdoi në Europë, ku shërbeu katër vitet e fundit përpara se të mbështetej si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë më 31 mars 2018. ■



Plaku Kajl S. Mek-Kei

Autoritet i Përgjithshëm / Shtatëdhjetë

Përveç familjes së tij dhe Kishës, pasioni më i madh i Plakut Kajl S. Mek-Kei është të ngasë kalin e vet nëpër male.

“Nuk është feja ime”, tha ai, “por nuk ka aspak dyshim që ma ka forcuar [besimin] tim. Shkoj nga malet e Zotit tek mali i shtëpisë së Zotit. Ai takohet me mua në të dyja vendet.”

Plaku Mek-Kei i krahason malet mbi Hantsvill të Jutës në SHBA, me ujërat dhe lumin e Mormonit dhe rëndësinë e tyre për popullin e Almës – ato janë vendi ku, në rininë e vet, ai arriti të një njohuri për Shëlbuesin e tij.

Plaku Mek-Kei u lind më 14 shkurt 1960 në Çikago të Illinoisit në SHBA nga Beri Gan Mek-Kei dhe Ilejn Stërlend Mek-Kei, të cilëve u jep meritën që e formuan në njeriun që ai është.

Ai i ndërpreu studimet në Universitetin “Brigam Jang” në vitin 1979 që të shërbente në një mision kohëplotë në Kobe të Japonisë. Pak kohë pasi u kthye nga misioni që të mbaronte diplomën për anglisht, Plaku Mek-Kei u takua me Xhenifer Stonin, e cila kohët e fundit ishte kthyer nga Misioni i Anglisë, Bristol. Edhe ajo po studioje për anglisht. Ata të dy u martuan në Tempullin e Oklandit në Kaliforni më 12 qershor 1984.

Me familjen në qendër të jetës së vet, thotë Plaku Mek-Kei, ai dhe Motra Mek-Kei e marrin gëzimin e vet më të madh nga pasardhësit e tyre. Ndërkohë që familja Mek-Kei jeton në Kejsvill të Jutës në SHBA, ata rregullisht kalojnë kohë me nëntë fëmijët e tyre në Hantsvill, ku paraardhësit e tyre u vendosën në fillim të viteve 1860.

Plaku Mek-Kei u diplomua me një gradë doktori në juridik në vitin 1987 në Shkollën e Ligjit “J. Ruben Klark” të UBJ-së dhe menjëherë pranoi një punë në një firmë ligjore të madhe krahinore në Portland të Oregonit në SHBA. Më vonë u kthye në Jutë që të ndiqte një mundësi punësimi me një tjetër firmë ligjore përpara se të pranonte një pozicion në kompaninë Kroger. Ai punoi si zëvendëspresident për Smiths dhe Frajs, dy nënndarje të kompanisë Kroger në Jutë dhe Arizonë të SHBA-së nga viti 2000 deri në 2017.

Plaku Mek-Kei ka shërbyer si peshkop, këshilltar i lartë, president kunji dhe I Shtatëdhjetë Zonal. ■



Plaku Huan Pablo Vijar

Autoritet i Përgjithshëm / Shtatëdhjetë

Njohja e Plakut Huan Pablo Vijar me Kishën ndodhi në Santiago të Kilit, kur vëllai i tij më i madh, Ivani, i shpalli familjes se ishte pagëzuar pa miratimin e prindërve të tij dhe më vonë tha se kishte në plan të shërbente në një mision. Kur e pyetën përse, Ivani shprehu dëshminë dhe dëshirën e tij për të shërbyer.

“Nuk e kuptova gjithë domethënien e saj”, kujtoi Plaku Vijar, në atë kohë 17-vjeçar. “Por në atë çast, ai vendosi një farë në zemrën time.”

Asaj fare iu dha mundësi të rritej kur vëllai i tij e referoi atë të misionarët. Gjatë mësimit të tij të parë, Plaku Vijar mori dëshminë e vet për vërtetësinë e Librit të Mormonit.

“Për mua, nuk ishte e nevojshme të bija një gjunjë dhe të lutesha, sepse në çastin që ata shprehën dëshminë e tyre, e dija në zemrën time që ishte e vërtetë”, tha ai. “Kur e dija atë, gjithçka tjetër duhej të ishte e vërtetë.”

Ivani, që shërbente në një mision fqinjë, mori leje ta pagëzonte Plakun Vijar në vitin 1988. Më vonë, nëna e tyre dhe një vëlla tjetër, Klaudioja, gjithashtu u bashkuan me Kishën.

Një vit pas pagëzimit të tij, Plaku Vijar filloi të shërbente në Misionin e Kilit, Vinja del Mar, duke filluar një jetë shërbimi e cila, që nga ajo kohë, ka përfshirë shërbimin si president kunji, peshkop, këshilltar në peshkopatë, këshilltar në Misionin e Kilit, Santiago Lindore dhe I Shtatëdhjetë Zonal në Zonën Jugore të Amerikës Jugore. Ai u mbështet më 31 mars 2018 si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë.

Plaku Vijar u lind më 11 shtator 1969 në Valparaiso të Kilit nga Serhio Vijar Vera dhe Henoveva Saverdra. Ai u martua me Karola Kristina Bariosin më 31 mars 1994, në Tempullin e Santiagos në Kili. Ata janë prindërit e tre fëmijëve.

Pasi mori një diplomë universitare për komunikime shoqërore e marrëdhënie publike dhe një diplomë pasuniversitare për marketing, ai punoi në industrinë farmaceutike dhe të pajisjeve mjekësore. Në vitin 2007 ai mori edhe një diplomë pasuniversitare për administrim biznesi në Universitetin “Brigam Jang”. Më pas u kthye në Kili që të punonte për Orikën, një kompani shërbimesh minerare, në kohën më të fundit si menaxher drejtues. ■



Plaku Takashi Uada

Autoritet i Përgjithshëm / Shtatëdhjetë

Një ditë të ftohtë nëntori, një pyetje nga një misionar amerikan që kërkonte rrugën për te posta vendore, e zuri në befasi Takashi Uadën.

15-vjeçari ishte paralajmëruar nga babai i tij që t'iu shmangej mormonëve, të cilët ishin duke u takuar me njerëz në rrugët e Naganos në Japoni, vetëm tri minuta larg shtëpisë së tyre. Por Takashit i bëri përshtypje japonishtja e misionarit amerikan.

Disa ditë më vonë, një tjetër misionar e ndaloi Takashin. Nuk kishte qenë në Japoni për shumë kohë. Me një japonishte të çalë ai u përpoq të tregonte historinë e Jozef Smithit.

Takashi nuk e kuptoi gjithçka, “por e ndjeva se duhej të dëgjoja”, sjell ndërmend ai.

Misionarët i mësuan atij hapat e lutjes dhe mësimet. Ai i frekuentoi mbledhjet e Kishës dhe u prek nga dëshmitë e anëtarëve vendorë. Duke u ndier i detyruar prej gjërave që priteshin nga familja e tij budiste, Takashi vazhdoi t'u thoshte misionarëve: “Nuk mund të bashkohem me Kishën, por do të më pëlqente të mësoja më shumë”.

Dy vjet më vonë, përpara se Takashi të largohej për të studiuar në Shtetet e Bashkuara në moshën 17-vjeçare, prindërit e tij e dhanë pëlqimin dhe ai u bashkua me Kishën.

Plaku Uada, i cili u lind më 5 shkurt 1965 nga Kenzo dhe Kazuko Uada, mori një diplomë universitare për gjuhësi në vitin 1990 dhe një diplomë pasuniversitare për administrim biznesi në vitin 1996, që të dyja në Universitetin “Brigam Jang”.

Ai shërbeu në një mision në Misionin e Jutës, Solt-Lejk-Siti Verior dhe u martua me Najomi Uenon më 18 qershor 1994 në Tempullin e Tokios në Japoni. Çifti ka dy djem.

Karriera e Plakut Uada përfshiu disa pozita me korporata ndërkombëtare në Shtetet e Bashkuara dhe në Japoni, si edhe detyrën e drejtorit për çështjet materiale për Kishën në Zonat Perëndimore e Veriperëndimore të Amerikës së Veriut dhe Zonën Veriore të Azisë.

Plaku Uada është një ish-peshkop, ish-këshilltar i lartë dhe ish-mësues seminari. Ai shërbeu si president i Misionit të Japonisë, Tokio Jugore nga viti 2013 deri në 2016. U mbështet si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë më 31 mars 2018. ■



Boni H. Kordën

Presidente e Përgjithshme e Të Rejave

Një shkrim i shenjtë shumë i dashur për Motrën Boni H. Kordën gjendet te Doktrina e Besëlidhje 123:17: “Le të bëjmë me gëzim të gjitha gjërat që janë në fuqinë tonë; dhe atëherë qëndroftim të patundur, me sigurinë më të madhe, për të parë shpëtimin e Perëndisë dhe që krahu i tij të zbulohet”.

Për të ky varg përmbledh mësimet që i ka mësuar gjatë gjithë jetës së vet. “Ne mund të bëjmë gjëra të vështira, por gjithashtu mund t'i bëjmë ato plot gëzim”, tha Motra Kordën, e cila u mbështet më 31 mars 2018 si Presidentja e re e Përgjithshme e Të Rejave.

Ajo dijani hodhi rrënjë brenda saj gjatë një “fëmijërie përrallore” duke punuar në një fermë të vogël në Ajdahon juglindore dhe më pas përsëri teksa haste vështirësi për të mësuar një gjuhë të re si misionare në Portugali. Ishte një mesazh që ua përsëriti shpesh edhe misionarëve teksa shërbeu me bashkëshortin e saj ndërkohë që ai kryesonte Misionin e Brazilit, Kuritibë. Dhe është një mesim që tani ka në plan t'ua tregojë të rejave anembanë botës.

Të rejave të sotme, tha ajo, po u kërkohet të bëjnë më shumë dhe ta çojnë përpara veprën e Zotit. “Dhe ne mund ta bëjmë këtë”, shtoi ajo.

Boni Hillëm Kordëni u lind më 11 mars 1964 nga Harold dhe Kerëll Rasmusen Hillami në Ajdahon-Folls të Ajdahos në SHBA. Pas misionit të saj ajo mori diplomën e saj universitare për pedagogji në Universitetin “Brigam Jang”, ku u takua me Derek Lejn Kordënin. Ata u martuan më 25 prill 1986 në Tempullin e Solt-Lejkut. Ata kanë katër fëmijë dhe katër nipër e mbesa.

Shërbimi i saj në Kishë gjatë gjithë jetës ka përfshirë kohë si udhëheqëse e çerdhes dhe mësuese seminari. Përpara thirrjes para dy vjetësh për të shërbyer si këshilltare në Presidencën e Përgjithshme të Fillores, Motrës Kordën i pëlqente të shërbente si presidente kunji e Të Rejave. Edhe pas lirimt nga ajo detyrë, “unë nuk e kam ndalur kurrë lutjen për të rejat”, tha ajo.

Një mesazh që mezi pret t'ua japë të rejave anembanë botës, është që ajo i do ato dhe, më e rëndësishme, që Perëndia i do ato. ■



Mishel D. Krejg

Këshilltare e Parë, Presidenca e Përgjithshme e Të Rejave

Kur ishte 16 vjeçe, Motra Mishel D. Krejg mësoi se familja e saj do të shpërngulej nga Provo e Jutës në SHBA për në Herisbërg të Pensilvanisë në SHBA, që babai të fillonte një detyrë për të shërbyer si president misioni.

Qe e lumtur se ishte me familjen e vet, por lëvizja e la Mishelën e re “të vetmuar nga ana shoqërore” gjatë vitit të saj të tretë dhe të katërt të shkollës së mesme.

“Ato ishin vite vërtet formuese”, tha Motra Krejg. “Në vend që të mbështetesh te shoqëria, u mbështeta te familja ime e dëshmia ime dhe kisha u bë një litar shpëtimi.” Ajo e vlerësoi më shumë marrëdhënien e saj me Atin Qiellor dhe Shpëtimtarin.

Mishel Deins Krejgu u lind më 13 korrik 1963 në Provo të Jutës dhe është më e madhja e shtatë fëmijëve të lindur nga Xhanet Landgreni dhe Robert Henri Deins III. Ajo jetoi në Provo derisa familja u shpërngul në Pensilvani. Dy vjet më vonë, Motra Krejg u kthye në Provo për të vazhduar Universitetin “Brigam Jang”, ku mori një diplomë universitare për arsimin fillor. Në vitin 1984 ajo pranoi një thirrje për të shërbyer në Misionin e Republikës Dominikane, Santo-Domingo.

“Kam qenë gjithmonë një besimtare”, tha Motra Krejg, e cila u mbështet si Këshilltare e Parë e Presidencës së Përgjithshme të Të Rejave më 31 mars 2018. “Që në moshë të vogël e dija se isha bijë e Perëndisë. Por më kujtohet [në misionin tim] se çdo herë që jepja dëshmi për Profetin Jozef Smith, do ta ndieja Shpirtin. Pata një pohim të bukur që e forcoi dëshminë time.”

Vetëm pak ditë pas kthimit të saj, vëllai i Motrës Krejg i tha se kishte nevojë të dilte në një takim me Boyd Krejgun, një shok nga misioni i tij. Tetë muaj më vonë çifti u fejuan. Ata u martuan më 19 dhjetor 1986 në Tempullin e Solt-Lejkut. Ata janë prindërit e tre fëmijëve dhe kanë gjashtë nipër e mbesa.

Ajo ka shërbyer në shumë thirrje, përfshirë thirrjen si punonjëse ordinancash në Tempullin e Provos në Jutë dhe si mësuese e Doktrinës së Ungjillit. Në kohën e thirrjes së saj në Presidencën e Përgjithshme të Të Rejave, ajo po shërbente në kryesinë e përgjithshme të Fillores. ■



Beki Krejvën

Këshilltare e Dytë, Presidenca e Përgjithshme e Të Rejave

Ka një thënie që Motra Beki Krejvën e shprehu shpesh si misionare: “Kur e di se kush je, vepron ndryshe”.

“Dhe kjo është në çfarëdo aspekti – nga mënyra se si vëshesh, si flet, si e paraqet vetveten dhe veprimtaritë në të cilat merr pjesë”, tha Motra Krejvën, e cila shërbeu me bashkëshortin e saj, Ronald L. Krejvënin, ndërkohë që ai kryesoi mbi Misionin e Karolinës së Veriut, Sharlotë, nga viti 2012 deri në 2015.

Motra Krejvën u mbështet si Këshilltare e Dytë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rejave më 31 mars 2018. “Kur të rejat fillojnë ta shohin veten në planin e Perëndisë, ato do të jenë në gjendje të shohin një vegim për veten e tyre”, tha ajo. “Ju duhet të keni një vegim. Nëse nuk keni një vegim, ju nuk e dini ku po shkoni dhe nuk dini se çfarë të bëni që të arrini atje.”

Rebeka Lin Krejvëni u lind më 26 tetor 1959 në Kardon të Ohajos në SHBA nga Korlis Uolltër Miçëlli dhe Linda Luiz Kasuk Miçëlli. Krenare ta quajë veten “një fëmijë ushtrie”, ajo u rrit në Teksas të SHBA-së, ku familja e saj u bashkua me Kishën; në Gjermani, kohë gjatë së cilës familja e saj u vulos në Tempullin e Zvicrës; në Angli; në Jutë të SHBA-së, ku ajo u pagëzua gjatë shërbimit të parë ushtarak të babait të saj në Vietnam; dhe në shtetet e Merilendit, Kentakit, Misurit dhe Kansasit në SHBA.

Të martuar më 5 gusht 1980 në Tempullin e Solt-Lejkut, çifti Krejvën janë prindër të pesë fëmijëve.

Përpara se të mbështetej në thirrjen e saj të re, ajo po shërbente si këshilltare në presidencën e Shoqatës së Ndhmës të lagjes dhe si punonjëse ordinancash në Tempullin e Bauntifullit në Jutë. Ajo gjithashtu ka shërbyer si presidente e Të Rejave të lagjes, anëtare e kryesisë së Shoqatës së Ndhmës të kunjit, si misionare kunji dhe udhëheqëse e Uebelos [në programin e skautizmit].

Motra Krejvën ka diplomë universitare për dekorim të mjedisëve të brendshme nga Universiteti “Brigam Jang”, ku ajo ka shërbyer në komitetin këshillues të atletikës. Gjithashtu ka shërbyer si anëtare e kryesisë ekzekutive të CHOICE Humanitarian, një organizatë bamirëse ndërkombëtare me bazë në Jutë.

Asaj i pëlqejnë ngjitja në mal, sportet e ujit, ecja në dëborë, udhëtimet, piktura, bërja e jorganëve dhe lojëra e veprimtari me familjen e saj. ■



Liza L. Harknes

Këshilltare e Parë, Presidenca e Përgjithshme e Fillores

Liza L. Harknes gjithmonë ka pasur dashuri për të mësuar dhe për botën përreth saj, diçka që ajo e mori prej prindërve të saj. Ajo ka studiuar për shkencë politike dhe madje mësoi se si të mbante në duar zvarranikë ndërkohë që punonte në Muzeun e Shkencës së Jetës “Monti L. Bin” gjatë kohës së saj në Universitetin “Brigam Jang” – përfshirë gjarpërinjtë.

“Ata kanë personalitete, besojeni apo jo”, tha ajo. “Ishte njëri që më njihje çdo herë që e mbaja.” Hauardi, një gjarpër boa shtrëngues me bisht të kuq, do të zvarritej mbi supin e saj, përdridhej rreth qafës së saj dhe e vendoste kokën e vet mbi të sajën, ndërkohë që ajo u jepte mësim grupeve që kishin ardhur në muze.

Edhe tani ajo ende mund të dallojë e përcaktojë një larmi gjarpërinjsh – për aq sa ata nuk i fishkëllejnë.

Motra Harknes u lind në Los Anxhelos të Kalifornisë në SHBA nga Ronald dhe LëRe Longu më 13 janar 1965. Më e madhja e pesë fëmijëve, ajo dhe familja e saj ishin “gjithmonë gati për aventura, për të qenë në natyrë dhe për të eksploruar botën”. Ajo tha se ngaqë gjithmonë mund t’u bënte pyetje prindërve të saj, “tërësisht e besoja dhe e mirëbesoja se mund të shkoja tek Ati Qiellor dhe të gjeja përgjigje”.

Pasi shërbeu në një mision spanjishtfolës në Misionin e Luizianës, Baton-Ruzh, Motra Harknes mbaroi UBJ-në me një diplomë universitare për shkencë politike dhe si dytësore mësimdhënien. Ajo u martua me Dejvid S. Harknesin më 22 prill 1988 në Tempullin e Solt-Lejkut. Ata kanë pesë fëmijë dhe dy nipë e mbesa.

Motra Harknes – e cila u thirr si Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Fillores më 31 mars 2018 – gjithashtu ka shërbyer si anëtare e kryesisë së përgjithshme të Fillores, si presidente e Të Rejave të kunjit, presidente e Shoqatës së Ndihmës së lagjes, këshilltare në presidencën e Të Rejave të lagjes, këshilltare e Trëndafileve, drejtuese e kampit të Të Rejave, drejtuese e historisë familjare të kunjit, këshilltare e historisë familjare të lagjes dhe mësuese e Doktrinës së Ungjillit.

Ajo gjithashtu ka qenë vullnetare në shoqatën vendore të prindërve dhe mësuesve, këshillin e komunitetit, Simfoninë e Jutës dhe Festivalin e Tregimit të Historive në Timpanogos të Jutës, si edhe me qeverinë vendore në pozicione të ndryshme. ■



Theksi mbi Dhënien e Shërbesës

Mësimi i shtëpisë dhe vizitat mësimore do të ndërpriten, shpalli Presidenti Rasëll M. Nelson gjatë sesionit të pasdites të së dielës në konferencën e përgjithshme. “Dhënia e shërbesës”, një “qasje e re, më e shenjtë” ndaj kujdesit si të Krishtit për të tjerët, do të sigurojë përpjekje të bashkërenduar për të ndihmuar në plotësimin e nevojave shpirtërore dhe materiale të anëtarëve.

Motra Xhin B. Bingham, Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndhimës, dhe Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, gjithashtu folën rreth mënyrës se si kjo metodë e re do t’i përqendrojë më mirë përpjekjet e kuorumeve të Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatave të Ndhimës lidhur me dhënien e shërbesës siç bëri Shpëtimtari (shih faqet 101 dhe 104).

Dafinat dhe Trëndafilët mund të

shërbejnë tani si shoqëruese shërbestare të motrave të Shoqatës së Ndhimës. Në një intervistë tremujore, vëllezërit dhe motrat shërbestare do të këshillohen me udhëheqësit rreth nevojave dhe anëve të forta të atyre njerëzve që u caktohen. Numri i intervistave që patën udhëheqësit gjatë një tremujori, do të jetë i vetmi raport zyrtar që bëhet. Vizitat janë të rëndësishme kur është e mundur, por dhënia e shërbesës nuk përfshin një mënyrë të përshkruar që të viheni në kontakt çdo muaj.

“Të rinjtë dhe të rejtat mund t’i përdorin dhuntitë e tyre të pashoqe dhe të rriten shpirtërisht teksa shërbejnë së bashku me të rriturit në punën e shpëtimtari”, tha Motra Bingham. Përfshirja e rinisë gjithashtu e rrit numrin e anëtarëve që kujdesen për të tjerët dhe i ndihmon të rinjtë e të rejtat “që të përgatiten më mirë për t’i përmbushur

rolet e tyre si udhëheqëse në Kishë e komunitet dhe si partnere kontribuese në familjet e tyre”.

“Ne në zyrat qendrore të Kishës nuk kemi nevojë të dimë se *si* ose se *ku* apo se *kur* u vutë në kontakt me njerëzit tuaj”, tha Plaku Holland, “neve na intereson që ju *njëmend* ta bëni atë dhe që t’i bekonin ata në çdo mënyrë që mundeni.”

Sipas një letre nga Presidenca e Parë, përshtatjet në dhënien e shërbesës mund të kërkojnë ca kohë, por duhet të bëhen sa më shpejt që të jetë e mundur. **Ministering.Ids.org** siguron hollësi shtesë, përfshirë pyetje që bëhen rëndom. Materiale filmike udhëzuese dhe burime të tjera do të shtohen në faqen e internetit në javët e ardhshme.

Duke filluar nga qershori, *Liahona* do të përfshijë një rubrikë mujore të quajtur “Parimet e Dhënies së Shërbesës”, për t’i ndihmuar anëtarët të kuptojnë se si mund të jenë më shumë si Krishti ndërkohë që i japin shërbesë njëri-tjetrit. ■



Kuorumet e Ristrukturuar

Grupi i priftërinjve të lartë dhe kuorumi i pleqve të lagjes (ose të degës), tani do të bashkohen në një kuorum të pleqve shpalli Presidenti Rasëll M. Nelson gjatë sesionit të priftërisë në konferencën e përgjithshme. Presidenca e kunjit do të vazhdojë të shërbejë si presidencë e kuorumit të priftërinjve të lartë të kunjit, por ai kuorum do të përfshijë priftërinj të lartë që po shërbejnë aktualisht në presidencën e kunjit, në peshkopata, në këshillin e lartë dhe si patriarkë veprues.

Kuorumi i pleqve do të udhëhiqet nga një presidencë që mund të përbëhet nga pleq dhe priftërinj të lartë. Presidenti i kuorumit të pleqve do t'i raportojë presidentit të kunjit dhe do të takohet rregullisht me peshkopin. Detyrat e priftërisë do të mbeten të njëjta. Presidenca e tanishme e kuorumit të pleqve të lagjes (ose të degës) dhe udhëheqja e grupit të priftërinjve të lartë do të lirohen nga detyrat dhe presidenti i kunjit do të thërrasë një presidencë të re të kuorumit të pleqve. ■

Njoftohen Shtatë Tempuj të Rinj

Do të ndërtohen tempuj në Salta, Argjentinë; Bengaluri, Indi; Managua, Nikaragua; Kagajan-de-Oro, Filipine; Lejtën, Juta; Riçmond, Virxhinia; dhe në një qytet kryesor ende për t'u përcaktuar në Rusi, shpalli Presidenti Rasëll M. Nelson në fund të sesionit të pasdites të së dielës në konferencën e përgjithshme.

Pikërisht përpara konferencës Presidenca e Parë shpalli se Tempulli i Romës në Itali do të përkushtohet të dielën më 10 mars 2019 deri të dielën më 17 mars 2019. Kisha gjithashtu paraqiti një skicë artistike të Tempullit të Bangkokut në Tajlandë.

Në tetor 2017 filluan punimet për Tempullin e Port-o-Prensit në Haiti; Tempulli i Meridianit në Ajdahoa u përkushtua në nëntor 2017; dhe Tempulli i Sidër-Sitit në Jutë (SHBA) u përkushtua në dhjetor 2017.

Dy tempuj do të ripërkushtohen së shpejti: Tempulli i Hjustonit në Teksas, të dielën më 22 prill 2018, pas riparimeve për shkak të përmbytjes; dhe Tempulli i Xhordan Riverit në Jutë, të dielën më 20 maj 2018, pas bërjes së rinovimeve. Dhe dy tempuj të tjerë do të përkushtohen më vonë këtë vit: Tempulli i Konsepsionit në Kili, të dielën më 28 tetor 2018 dhe Tempulli i Barankijës në Kolumbi, të dielën më 9 dhjetor 2018.

Tempulli i Hamiltonit në Zelandën e Re do të mbyllet në korrik 2018 për riparim të gjerë dhe do të ripërkushtohet në vitin 2021.

Aktualisht janë 159 tempuj në funksionim në mbarë botën, me 30 tempuj të njoftuar ose në ndërtim e sipër. ■

Tempulli i Romës, Itali



Skicë Artistike e Tempullit të Bangkokut, Tajlandë





Historia Familjare: Zbuloni, Mblidhni, Lidhni

Këshilltarët vendorë të tempullit dhe historisë familjare mund t'i ndihmojnë anëtarët e Kishës dhe njerëz të tjerë që të gjejnë gëzimin që vjen nga zbulimi, mbledhja dhe lidhja me paraardhësit, sipas Plakut Bredli D. Foster, Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë dhe Drejtor Ekzekutiv i Sektorit të Kishës për Historinë Familjare.

Çdo njeri ka tregime nga historia e tij familjare. Dhe gjëra të mrekullueshme mund të ndodhin kur filloni t'i kërkoni dhe i gjeni ato.

"Theksimi ynë për vitin që vjen, është t'i ndihmojmë këshilltarët që ta kuptojnë rolin e tyre për t'i ndihmuar anëtarët që ta kenë këtë përvojë", tha Plaku Foster. "E bëjmë këtë një e nga një. Shkojmë te [njerëzit] kudo ku janë, me një theksim të veçantë për ata që po mbushin 12 vjeç dhe ata që janë të kthyer të rinj në besim." Të dyja grupet përfitojnë shpejt kur e kuptojnë se si puna e tempullit i forcon familjet përgjatë përjetësive dhe ata shpesh prodhojnë entuziazëm mes vetë miqve dhe familjeve të tyre.

Edhe ata që nuk janë anëtarë të Kishës, mund të kenë përvojën zbuloni-mblidhni-lidhni nëpërmjet ndihmës një për një në çdonjërin prej më shumë se 5 000 qendrave FamilySearch të historisë familjare në të gjithë botën. ■



Lehtësimi i Punës Misionare

Gjatë gjashtë muajve të fundit, Kisha ka ndërmarrë disa hapa për ta lehtësuar punën misionare.

Pyetje standarde. Presidenca e Parë paraqiti një grup pyetjesh standarde për peshkopët dhe presidentët e kunejve për t'u përdorur ndërkohë që intervistohen misionarët e ardhshëm kohëplotë. Ata i nxitën udhëheqësit, prindërit dhe rininë të familjarizohen me pyetjet.

Standardet e pasqyruara në pyetjet nuk i ndryshojnë ose u shtojnë kërkesave për shërbimin misionar kohëplotë, por rishikimi i tyre rregullisht do t'i aftësojë misionarët e ardhshëm dhe prindërit që të mësojnë parime dhe të përcaktojnë fusha ku mund të kërkohet përmirësim ose përgatitje shtesë.

Përdorimi i teknologjisë. Numri i misioneve që përdorin pajisje elektronike, po rritet nga 87 në 162 dhe kompjuterët e dorës po zëvendësohen me telefona inteligjentë. Telefonat do t'i ndihmojnë misionarët për studimin, gjetjen dhe mësimdhënien.

Teknologjia gjithashtu është duke u përdorur që të sigurojë përmbajtje në internet për njerëzit që kërkojnë përgjigje ndaj pyetjeve fetare. Kisha e filloi përdorimin e qendrave të mësimdhënies në internet gjashtë vjet më parë dhe sot ka në funksionim 20 qendra

mësimdhënieje në internet anembanë botës.

Falë teknologjisë, anëtarët të cilët u referojnë miq misionarëve, tani mund të komunikojnë me misionarët që po i japin mësim mikut/es të/së tyre. Ata mund të diskutojnë për nevojat me misionarët dhe të marrin pjesë në mësimet nëpërmjet internetit. Zbuloni se si të [lds.org/referrals](https://www.lds.org/referrals).

Plotësimi i nevojave aktuale. Duke filluar nga korriku 2018 Kisha do t'i ndryshojë kufijtë e 19 misioneve dhe do të krijohen 5 misione të reja. Kjo do ta ndryshojë numrin e misioneve nga 421 në 407. Misionet e reja do të jenë Brazil, Rio-de-Zhaneiro Jugor; Bregu i Fildishtë, Jamosukro; Nigeri, Ibadan; Filipine, Kabanatuan dhe Zimbabve, Bulauajo. Hollësi mbi shkrirjet e misioneve do t'u dërgohen në komunikimet e ardhshme prej presidentëve të misioneve prindërve të misionarëve në misionet e ndikuara prej kësaj.

Që kur u shpall ndryshimi i moshave për shërbim misionar në vitin 2012, Kisha krijoi 76 misione të reja për të mirëpritur valën e rritjes nga 58 000 në 88 000 misionarë. Vala fillestare e misionarëve është zvogëluar që atëherë, si kurse pritej, dhe aktualisht po shërbejnë rreth 68 000 misionarë. Kjo do të thotë

që për kohën e tanishme kërkohen më pak misione. Por do të thotë edhe që kërkon vëmendje të veçantë vendosja e duhur e misionarëve në zona ku ka nevojë anembanë botës.

Qendrat e trajnimit të misionarëve. Janë zgjeruar dhe përkushtuar që të dyja Qendrat e Trajnimit të Misionarëve në Provo të Jutës në SHBA dhe QTM-ja në Filipine dhe është përkushtuar edhe qendra e trajnimit të misionarëve në Ganë. Qendrat e trajnimit në Spanjë dhe Kili do të mbyllën në janar të vitit 2019 dhe misionarët që do të kishin frekuentuar ndonjëherë prej këtyre qendrave, do të trajnohen në 13 qendrat e trajnimit të misionarëve që ngelen nëpër botë. ■

Rregullore, Procedura dhe Prodhime të Reja

Rinia dhe puna në tempull. Presidenca e Parë ka shpallur ndryshime në rregulloret e tempullit që u japin të rinjve dhe të rejave më shumë mundësi për punën në tempull dhe i ndihmon fëmijët e Fillores që të përgatiten më mirë për të shërbyer në tempull.

Parandalimi, përcaktimi dhe veprimi ndaj abuzimit. Në përpjekje të vazhdueshme për t'i këshilluar udhëheqësit se si të parandalohet, përcaktohet dhe të veprohet ndaj abuzimit, më 26 mars 2018 Presidenca e Parë dërgoi një letër dhe një dokument burimor për udhëheqësit e Kishës në Shtetet e Bashkuara dhe në Kanada. Dokumenti përfshin udhëzime të përditësuara për mënyrën se si peshkopët dhe presidentët e kunjeve duhet t'i këshillojnë viktimat e abuzimit seksual dhe se si duhet të kryejnë intervista me anëtarët e Kishës.

Ndryshimet në kampin e Të Rejave. Ndryshimet në programin e Kishës për

kampin e Të Rejave, përfshirë një udhëzues të ri për kampin që do të njoftohet në muajt e ardhshëm, përfshijnë heqjen e certifikimit dhe theksimin e të rejave si udhëheqëse.

Me synimin që të jetë “i zbatueshëm botërisht” për të rejat që jetojnë në të gjitha zonat e botës, *Young Women Camp Guide [Udhëzuesi i ri për Kampin e Të Rejave]* është aktualisht në dispozicion në anglisht (dhe do të jetë edhe në 23 gjuhë të tjera) si burim për presidentat e Të Rejave, specialistet e kampit dhe udhëheqëset e kampit të të rejave te youngwomen.lds.org.


Dorëzimet muzikore. Ndryshimet e kohës së fundit në procesin e dorëzimit të muzikës e bëjnë tani të shpejtë dhe të lehtë për anëtarët që t'i dorëzojnë Kishës muzikë të shenjtë origjinale. Muzika mund të dorëzohet tek apps.lds.org/artcomp.

Kanali me material filmik “How To” [“Si Të”]. Kisha ka filluar një kanal të ri në YouTube të quajtur “How To”

[“Si Të”] që siguron ndihmë të thjeshtë praktike për sfidat e vërteta të jetës. I ndërtuar si një “kanal i vetëm për të gjetur ndihmën që ju nevojitet kur t’ju nevojitet”, kanali aktualisht ka më shumë se 600 materiale filmike të përzgjedhura sipas nëntë kategorive, secila me lista të shumta të materialeve filmike në një larmi temash që lidhen me sfidat, në gjuhën angleze, me një pjesë të përmbytjes në spanjisht dhe portugalisht. Kontrollojeni te HowTo.lds.org.

Përkthimet e shkrimeve të shenjta. Kisha ka shpallur projekte të planifikuara të përkthimeve për 34 gjuhë të tjera, duke shtuar një proces të ri që do t'i lejojë individët të studiojnë pjesë paraprake të përkthimeve përpara botimit të përkthimeve përfundimtare, gjë që do të thotë se anëtarët do të kenë mundësi përdorimi më të hershme të shkrimeve të shenjta në gjuhën e tyre. ■

Mund të lexoni më shumë rreth këtyre artikujve te news.lds.org.





EJA, MË NDIQ -

për Kuorumin e
Pleqve dhe Shoqatën
e Ndhmës

*Këto burime gjithashtu mund të gjenden te
programi kompjuterik Gospel Library [Bibli-
oteka e Ungjillit] dhe tek ejamendiq.lds.org.*

Përse Kemi

Mbledhje të Kuorumit dhe të Shoqatës së Ndhmës?

Në këto ditë të fundit, Perëndia i ka rivendosur priftërinë, kuorumet e organizuara të priftërisë dhe Shoqatën e Ndhmës për të ndihmuar në përmbushjen e veprës së Tij për shpëtimin. Për shkak të kësaj, çdo të diel kur mblihdemi në mbledhjet e kuorumit të pleqve dhe të Shoqatës së Ndhmës, ne diskutojmë dhe planifikojmë se çfarë do të bëjmë që të ndihmojmë në përmbushjen e veprës së Perëndisë. Që të jemi të efektshëm, këto mbledhje kanë nevojë të jenë më shumë sesa orë mësimore. Ato janë mundësi për t'u këshilluar rreth punës së shpëtimit, për të mësuar së bashku rreth asaj pune nga mësimet e udhëheqësve të Kishës dhe për të planifikuar e për t'u organizuar që ta përmbushim atë.



Mbledhjet e Këshillit të

Dielën e Parë

Të dielën e parë të çdo muaji, mbledhjet e kuorumit të pleqve dhe të Shoqatës së Ndhmës *nuk përfshijnë një mësim të dhënë nga një mësues/e*. Në vend të kësaj, presidentat e kuorumit të pleqve dhe të Shoqatës së Ndhmës drejtojnë mbledhje këshilli. Në këto mbledhje këshilli të së dielës së parë, secili kuorum i pleqve dhe secila Shoqatë e Ndhmës këshillohet së bashku rreth përgjegjësive, mundësive dhe sfidave vendore; mëson nga idetë dhe përvojat e njëri-tjetrit; dhe planifikon mënyra për të vepruar sipas mbresave të marra nga Shpirti. Këto diskutime duhet të mbështeten te shkrime të shenjta përkatëse dhe te mësimet e profetëve të gjallë.

Jo të gjitha mbledhjet e këshillit do të jenë njësoj. Këtu janë disa udhëzime që t'i ndihmojnë presidentat për të udhëhequr një këshill të suksesshëm.



Tema për Mbledhjet e Këshillit të Dielën e Parë

Ide për temat e diskutimit në mbledhjet e këshillit mund të vijnë nga mbledhjet e presidencës, mbledhjet e këshillit të lagjes, plani i zonës, mbresat që udhëheqësit i marrin kur u japin shërbesë anëtarëve, dhe nga nxitjet prej Frymës së Shenjtë. Temat më poshtë janë vetëm sugjerime. Udhëheqësit/et mund të jenë në dijeni për nevoja të tjera, të cilat ndihen të frymëzuar t'i diskutojnë.

- Çfarë mund të bëjmë ne që t'u japim shërbesë njerëzve përreth nesh? (Shih Mosia 23:18.)
- Si mund t'u japim përparësi përgjegjësive tona të ndryshme?
- Si do ta përhapim ungjillin te miqtë dhe fqinjët tanë? (Shih Alma 17.)
- Si mund të mbrohem vetë dhe t'i mbrojmë familjet tona nga mjetet e papërshtatshme të informacionit dhe pornografia?
- Çfarë do të bëjmë për t'i këshilluar e forcuar fëmijët tanë dhe rininë në lagjen tonë?
- Si mund të jemi më të përfshirë në punën për historinë familjare dhe adhurimin në tempull?
- Si mund ta ftojme ndihmën e Zotit kur kërkojmë përgjigje për pyetjet tona për ungjillin dhe kërkojmë kuptueshmëri më të thellë të ungjillit?
- Si mund t'i forcojmë dëshmitë tona për Zotin dhe ungjillin e Tij dhe t'i ndihmojmë familjet tona që të jenë të mbështetura shpirtërisht te vetja?

PËRPARA MBLEDHJES SË KËSHILLIT

BËNI:

- Përcaktoni nevojat, mundësitë dhe sfidat vendore.
- Me lutje zgjidhni një temë për ta diskutuar.
- Ftoni anëtarë të kuorumit ose motra të Shoqatës së Ndhmës që të vijnë të përgatitur për të treguar mendimet dhe përvojat e tyre.

MOS [BËNI]:

- Përgatitni mesazhin.
- Ejani me një zgjidhje të caktuar ose plan veprimi në mendje.

GJATË MBLEDHJES SË KËSHILLIT

BËNI:

- Ftoni anëtarë/e të *tregojnë përvojat* që i patën ngaqë vepruan sipas mbresave dhe planeve nga mbledhjet e mëparshme.
- Paraqiteni temën e mbledhjes dhe nxitini anëtarët/et që të *këshillohen së bashku* rreth saj, duke kërkuar zgjidhje dhe udhërrëfim nga shkrimet e shenjta, fjalët e profetëve dhe Fryma e Shenjtë.
- *Planifikoni të veproni* sipas asaj që u diskutua. Kjo mund të përfshijë plane grupesh ose plane që individët i bëjnë për veten e tyre.

MOS [BËNI]:

- E mbizotëroni diskutimin.
- U përpiqni t'i bindni të tjerët për idetë tuaja.
- Diskutoni çështje të ndjeshme ose konfidenciale.
- Jepni një mesazh.
- E shtyni askënd që të marrë pjesë.


PAS MBLEDHJES SË KËSHILLIT

BËNI:

- Ndiqeni ecurinë e planeve dhe detyrave të caktuara gjatë mbledhjes së këshillit.
- Gjeni mënyra që t'i përfshini ata që nuk mundën të marrin pjesë në mbledhje për shkak të thirrjeve ose arsye të tjera. Vëriti në dijeni për planet që u bënë.
- Jepuni anëtarëve mundësi që të tregojnë përvojat në mbledhjet e ardhshme.

“Një nga gjërat e bukura rreth kësaj mbledhjeje këshilli është që ju vërtet do të dilni me një plan veprimi në fund të mbledhjes.”

– Motra Xhin B. Bingham, Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndhmës



Mbledhjet e të

Dielës së Dytë dhe të Tretë

Në të dielat e dyta dhe të treta të çdo muaji, kuoromet e pleqve dhe Shoqatat e Ndihmës do të studiojnë mësimet e udhëheqësve të Kishës nga konferenca e përgjithshme më e fundit. *Theksim duhet t'u vihet mesazheve nga anëtarët e Presidencës së Parë dhe të Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve*. Gjithsesi, nisur nga nevojat vendore dhe frymëzimi nga Shpirti, mund të diskutohet çfarëdo mesazhi nga konferenca më e fundit.

Në shumicën e rasteve, presidenca e kuoromit të pleqve ose presidenca e Shoqatës së Ndihmës do të përzgjedhë një mesazh nga konferenca për t'u studiuar në bazë të nevojave të anëtarëve, ndonëse peshkopi ose presidenti i kishës mund të japë sugjerime. Udhëheqësit mund të zgjedhin një mesazh të lidhur me temën e diskutuar në një mbledhje të kohës së fundit të këshillit të dielën e parë ose mund të zgjedhin një mesazh me një temë të ndryshme nisur nga frymëzimi i Shpirtit.

Udhëheqësit dhe mësuesit duhet të gjejnë mënyra për t'i nxitur anëtarët që t'i lexojnë mesazhet e përzgjedhura paraprakisht dhe të vijnë të përgatitur për të shprehur të vërtetën e ungjillit dhe ide rreth mënyrës se si të veprohet me to. Veprimtaritë mësimore të sugjeruara më poshtë, të cilat bazohen në parimet e manualit *Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit*, mund t'i ndihmojnë anëtarët që të mësojnë nga mesazhet e konferencës së përgjithshme.

“Në mënyrë të ndër-gjegjshme kërkoni mënyra se si t'i përfshini . . . mesazhet [nga konferenca e përgjithshme] në mbrëmjet tuaja familjare, në mësimdhënien tuaj të ungjillit [dhe] në bashkëbisedimet tuaja me familjen e miqtë.”

Presidenti Rasëll M. Nelson, “Punës Le t'i Vihemi”, *Liahona*, maj 2018, f. 118.

M. Rasëll Ballard, *“Dhurata të Çmuara nga Perëndia”*, f. 9–11

Mesazhi i Presidentit Ballard flet për një larmi temash – përfshirë profetët, besimin te Krishti, sakramentin dhe shërbimin – dhe anëtarët e kuoromit tuaj ose të Shoqatës suaj të Ndihmës mund të gjejnë tema të ndryshme veçanërisht domethënëse. Ftojini anëtarët të tregojnë diçka nga ky mesazh që i frymëzon ata. Çfarë ftesash ose bekimesh të premtuara i gjejmë në mesazhin e Presidentit Ballard? Merreni parasysh t'i ftoni anëtarët të përsiatin për disa minuta atë që ndihen të frymëzuar ta bëjnë si rrjedhojë e këtij diskutimi.

Geri E. Stivenson, *“Zemra e një Profeti”*, f. 17–20

Për t'i ndihmuar anëtarët ta “kuptojnë madhësitinë” e thirrjes së një profeti të ri, ju mund t'i ftoni anëtarët të shqyrtojnë mesazhin e Plakut Stivenson, duke kërkuar të vërtetën dhe ide që i ndihmojnë ta kuptojnë

rëndësinë dhe shenjtërinë e këtij procesi hyjnor. Merreni parasysh t'i ftoni anëtarët të tregojnë se çfarë ndien gjatë kuvendit solemn në të cilin Presidenti Nelson u mbështet si President i Kishës. Ju gjithashtu mund të vizatoni një zemër në tabelë dhe t'u kërkon anëtarëve të shkruajnë brenda saj fjalë ose fraza që e përshkruajnë zemrën dhe karakterin e Presidentit Nelson. Çfarë na ka mësuar ai, gjë e cila na ka bekuar ne?

Nil L. Andersen, *“Profeti i Perëndisë”*, f. 24–27

Diskutimi i mesazhit të Plakut Andersen mund ta forcojë besimin e anëtarëve te profetët e gjallë. Ju mund t'i ftoni ta shqyrtojnë mesazhin e tij për diçka që i ndihmon ta kuptojnë përse Perëndia ka profetë në tokë dhe përse ne i ndjekim ata. Si jemi bekuar ngaqë kemi një profet? Anëtarët mund të tregojnë se si e kanë fituar dëshminë që Presidenti Rasëll M. Nelson është profeti i

Zotit dhe Presidenti i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Dejvid A. Bednar, *“Zemërbutë dhe të Përrulur nga Zemra”*, f. 30–33

Për të frymëzuar një diskutim rreth mesazhit të Plakut Bednar, ju mund të shkruani në tabelë *Zemërbutësia është . . .* dhe *Zemërbutësia nuk është . . .* Anëtarët më pas mund të shqyrtojnë mesazhin e Plakut Bednar dhe të shkruajnë në tabelë fraza që i gjejnë, të cilat i plotësojnë këto thënie. Çfarë mësojmë nga ky mesazh që na frymëzon të jemi më zemërbutë? Për çfarë shembujsh zemërbutësie mund të mendoni? Si mund ta vëmë në jetë këshillën e Plakut Bednar që të jemi më zemërbutë?

Boni L. Oskarson, *“Të Rejat në Punë”*, f. 36–38

Pyetjet janë një mënyrë për ta ftuar përsiatjen. Merreni parasysh të shkruani në tabelë

disa pyetje të cilave u jep përgjigje mesazhi i Motrës Oskarson, të tilla si sa vijon: *Si mund t'i përfshijmë të rejtat në punën e Zotit?* Ftojini anëtarët ta shqyrtojnë mesazhin e saj për përgjigje të këtyre pyetjeve dhe të diskutojnë se çfarë mësojnë. Çfarë bekimesh vijnë kur të rejtat përfshihen në dhënien e shërbesës? Ndoshta anëtarët e klasës mund të tregojnë përvoja që i kanë pasur për dhënien e shërbesës përkrah të reja. Nisur nga diskutimi ynë, çfarë ndihemi të frymëzuar të bëjmë?

Dejll G. Renland, *"Historia Familjare dhe Puna në Tempull: Vulosja dhe Shërimi"*, f. 46–49

Plaku Renland foli për vegimin e Ezekielit të një tempulli me ujë duke gulçuar jashtë prej tij (shih Ezekiel 47:8–9). Ndoshta një anëtar i kuorumit ose një anëtare e Shoqatës së Ndihmës mund të bëjë një vizatim të këtij vegimi në tabelë. Si janë bekimet e punës në tempull dhe të punës së historisë familjare të ngjashme me ujin në vegimin e Ezekielit? Ju mund t'i ftoni anëtarët e klasës të tregojnë për bekime të punës në tempull dhe të historisë familjare që i kanë përjetuar. Çfarë mund të bëjmë që ta bëjmë historinë familjare dhe punën në tempull një pjesë më të rregullt të jetës sonë?

D. Tod Kristoferson, *"Kuorumi i Pleqve"*, f. 55–58.

Në kuorumin e pleqve, ju mund të ftoni anëtarët të kuorumit që të lexojnë pjesën e mesazhit të Plakut Kristoferson të titulluar "Qëllimi i Këtyre Ndryshimeve". Çfarë mund të bëjmë që të sigurojmë që i përmbushim këto qëllime? Në Shoqatën e Ndihmës, ju mund t'i kërkoni dikujt t'i pëmbledhë ndryshimet e kuorumeve të Priftërisë Melkizedeke që i përshkruan Plaku Kristoferson. Më pas, motrat mund të përcaktojnë parime që nënkuptohen në këto ndryshime, të cilat mund të zbatohen në punën e Shoqatës suaj të Ndihmës. Në kuorumin e pleqve ose Shoqatën e Ndihmës, anëtarët mund të diskutojnë se çfarë mësojnë nga historia e Vëllait Gouts dhe se si ajo gjen zbatim në punën e tyre.

Ronald A. Rasband, *"Shih! Një Ushtri Mbretërore"*, f. 58–61

Ndoshta të kënduarit, dëgjimi ose leximi i fjalëve të himnit "Shih! Një Ushtri Mbretërore",



(*Himne*, nr. 160) së bashku mund të frymëzojnë diskutim rreth mesazhit të Plakut Rasband. Si janë kuoromet e priftërisë dhe Shoqatat e Ndihmës të ngjashme me një ushtri mbretërore? Anëtarët gjithashtu mund të kërkojnë dhe diskutojnë për "një numër të madh bekimesh" që Plaku Rasband i përmend se do të vijnë nga ristrukturimi i kuorumeve të priftërisë. Çfarë bekimesh të tjera kemi marrë – ose shpresojmë t'i marrim – nga vënia në zbatim e këtyre ndryshimeve? Si mund t'i marrin edhe Shoqatat e Ndihmës në mënyrë më të plotë bekime të tilla si "larmi . . . dhuratash" dhe "këshillim"?

Henri B. Ajring, *"Dhënia e Frymëzuar e Shërbesës"*, f. 61–64

Presidenti Ajring tregon për dy biseda mbledhjesh sakramenti rreth dhënies së shërbesës, të cilat i lanë mbresa atij. Ndoshta ju mund t'i kërkoni gjysmës së anëtarëve të kuorumit ose të Shoqatës së Ndihmës që të shqyrtojnë fjalët e djaloshit 14-vjeçar dhe gjysmës tjetër të shqyrtojnë historinë rreth mësuesit të shtëpisë. Teksa lexojnë, anëtarët mund të mendojnë për këshillën që mund t'ia japin një të riu ose të reje, që sapo është caktuar t'i japë shërbesë dikujt. Si mund "të bëhemi edhe më të frymëzuar e dashamirës në shërbimin tonë për dhënien e shërbesës"?

Dallin H. Ouks, *"Fuqitë e Priftërisë"*, f. 65–68

Për ta filluar diskutimin, ju mund t'i shkruani në tabelë titujt e katër pjesëve të

mesazhit të Presidentit Ouks. Më pas, ftojini secilin anëtar të lexojë një pjesë në heshtje dhe më pas shkruani në tabelë një fjali që e përmbledh mesazhin kryesor të asaj pjesë. Pastaj anëtarët mund të tregojnë se çfarë ndihen të frymëzuar të bëjnë për shkak të asaj që lexuan. Si mund të përmirësohet shërbimi ynë si mbajtës të priftërisë ose si motra të Shoqatës së Ndihmës kur i vëmë në jetë mësimet në mesazhin e Presidentit Ouks?

Rasëll M. Nelson, *"Dhënia e Shërbesës me Fuqinë dhe Autoritetin e Perëndisë"*, f. 68–75

Presidenti Nelson i fton mbajtësit e priftërisë të "çohen" dhe ta përdorin priftërinë për t'i bekuar fëmijët e Atit Qiellor. Ftojini anëtarët e kuorumit tuaj ose të Shoqatës suaj të Ndihmës të shqyrtojnë shembujt që jep ai, dhe të diskutojnë se si na ndihmojnë ata që të kuptojmë se si priftëria mund të përdoret për t'i bekuar familjet e tyre dhe të tjerët. Çfarë përvojash mund të tregojmë kur jemi bekuar nga fuqia e priftërisë? Si mund t'i ndihmojmë të tjerët ose veten tonë që të kemi besim për ta përdorur priftërinë e Perëndisë që të "japim shërbesë në emër të Tij"?

Rejna I. Aburto, *"Me një Mendje të Vetme"*, f. 78–80

Mesazhi i Motrës Aburto siguron një mundësi që kuorumi ose Shoqata juaj e Ndihmës ta vlerësojë se sa mirë po punojnë në unitet për ta bërë punën e Zotit. Për t'i ndihmuar anëtarët që ta bëjnë këtë gjë, ju mund të tregoni figura të fluturave monarke,

Një Model për Mbledhjet Tona

1. Tregoni përvoja për veprimin sipas mbresave dhe ftesave të marra në mbledhjet e mëparshme të priftërisë ose të Shoqatës së Ndihmës (të udhëhequr nga një anëtar/e i/e presidencës).

2. Mësoni së bashku (të udhëhequr nga një mësues/e i/e thirrur). Shpesh është e dobishme t'i ftoni anëtarët që:

- Të kërkojnë diçka në mesazhin e konferencës (të tillë si një përgjigje për një pyetje, një fragment frymëzues ose një shembull të një parimi).
- Të tregojnë dhe diskutojnë për atë që gjejnë.
- Të marrin parasysht se si mesazhi gjen zbatim në jetën dhe përvojat e tyre.

3. Planifikoni të veproni si individë ose si grup (të udhëhequr nga një anëtar/e i/e presidencës).



të vizitës së Shpëtimtarit të nefitët (shih *Libri i Figurave Artistike të Ungjillit*, nr. 82, 83, 84) dhe të punës humanitare të Kishës (shih LDS.org). Anëtarët mund ta shqyrtojnë mesazhin dhe të zbulojnë se si Motra Aburto i përdori këta shembuj që të jepte mësim rreth qëllimeve dhe bekimeve të punës në unitet. Çfarë mund të bëjmë që të punojmë “me një mendje të vetme”?

Henri B. Ajring, *“Të Keni Shpirtin e Tij me Ju”*, f. 86–89

Për të na e shtuar dëshirën dhe aftësinë për ta marrë Frymën e Shenjtë, Presidenti Ajring tregon disa përvoja vetjake dhe jep udhëzime të veçantë. Pasi t'i rishikoni përvojat e tij, çfarë kujtimesh të ngjashme mund të tregojnë anëtarët e kuorumit tuaj ose anëtarët e Shoqatës suaj të Ndihmës kur Fryma e Shenjtë ua preku zemrën dhe ua pohoi të vërtetën? Ndoshta anëtarët mund t'i renditin në tabelë udhërrëfimet që jep Presidenti Ajring për të na ndihmuar “që t'i hapim zemrat tona për ta marrë shërbesën e Shpirtit”. Si do të na ndihmojë ndjekja e udhëzimit të tij në jetën tonë dhe në familjet tona? Në kuorumin ose Shoqatën tonë të Ndihmës?

Dallin H. Ouks, *“Gjëra të Vogla dhe të Thjeshta”*, f. 89–92

Mesazhi i Presidentit Ouks përmban metafora që na mësojnë se si gjëra të vogla dhe të thjeshta mund të kenë ndikim të fuqishëm për mirë ose për keq. Këto metafora përfshijnë tri rrënjë, një ekip vozitësish, fibra litari dhe derdhjen e ujit. Anëtarët mund t'i lexojnë këto metafora dhe të diskutojnë atë që na japin mësim ato rreth fuqisë së bërjes së gjërave të vogla dhe të thjeshta vazhdimisht. Cilat janë gjërat e vogla dhe të thjeshta që e sjellin ndikimin e Frymës së Shenjtë në jetën tonë? Ftojini anëtarët që të përsiatin se çfarë kanë mbresë të bëjnë për ta ndjekur këshillën e Presidentit Ouks.

Rasëll M. Nelson, *“Zbulesë për Kishën, Zbulesë për Jetën Tonë”*, f. 93–96

Në mesazhin e tij Presidenti Nelson na lutet që ta rritim “aftësinë [tonë] shpirtërore për të marrë zbulesë”. Për t'i ndihmuar anëtarët ta ndjekin udhëzimin e tij, ju mund të shkruani në tabelë pyetje si ato që vijojnë:

Përse kemi nevojë për zbulesën? Si mund ta rritim aftësinë tonë për të marrë zbulesë – si në mënyrë individuale ashtu edhe kur këshillohemi së bashku? Çfarë bekimesh premtoi Presidenti Nelson nëse vërtet do të kërkojmë zbulesë? Ndajini anëtarët në grupe dhe ftojini secilin grup të gjejë dhe të japë përgjigje ndaj njërës prej pyetjeve.

Gerit W. Gong, *“Zoti Krisht Është Ngritur Sot”*, f. 97–98

Çfarë mund të mësojnë anëtarët e kuorumit tuaj ose Shoqatës suaj të Ndihmës nga mesazhi i Plakut Gong rreth besëlidhjeve tona dhe Shlyerjes së Jezu Krishtit? Ju mund t'i ftoni anëtarët ta shqyrtojnë mesazhin, të kërkojnë bekimet që Shlyerja e Shpëtimtarit dhe besëlidhjet tona – duke vepruar së bashku – na ofrojnë ne. Më pas merrni parasysht të bëni pyetje si ato që vijojnë, për atë që gjejnë: Si veprojnë së bashku besëlidhjet tona dhe Shlyerja që të na “bëjnë të zotë dhe fisnikë”? Te çfarë na ndihmojnë të mbahemi fort dhe nga çfarë të largohemi?

Ulises Soares, *“Profetët Flasin nëpërmjet Fuqisë së Shpirtit të Shenjtë”*, f. 98–99

Mesazhi i Plakut Soares mund të na frymëzojë të veprojmë me besim kur ndihemi të papërshtatshëm që të bëjmë vullnetin e Zotit. Si mori Plaku Soares ngushëllim dhe siguri kur mori thirrjen e tij të re si Apostull? Çfarë mësoi nga përvoja e tij kur u thirr si president misioni? Çfarë mund të mësojmë ne nga përvojat e tij? Jepuni anëtarëve kohë të tregojnë përvoja kur ata u ndien të pasigurt rreth diçkaje që Zoti i donte të bënin. Çfarë bënë për të gjetur besimin që të ecnin përpara?

Xhefri R. Holland, *“Jini me Ta e Forcojini Ata”*, f. 101–103

Kur anëtarët e kuorumit tuaj ose anëtarët e Shoqatës suaj të Ndihmës mësuan rreth ndryshimeve në “koncept[in e] saposhpallur [të] dhënies së shërbesës nga priftëria dhe Shoqata e Ndihmës”, çfarë pyetjesh kishin ata? Mesazhi i Plakut Holland mund të japë përgjigje. Anëtarët mund të kërkojnë parime të ungjillit që Plaku Holland na mëson se janë themeli i këtyre ndryshimeve. Çfarë ftesash i gjejmë në mesazhin e

tij? Çfarë bekimesh premtohen? Si mund të na ndihmojnë këto mënyra të reja të dhënies së shërbesës që të bëhemi “dishepujt e vërtetë të Krishtit”?

Xhin B. Bingham, “*Dhënia e Shërbesës Ashtu Siç e Jep Shpëtimtari*”, f. 104–107

Në mesazhin e saj, Motra Bingham na fton t’i bëjmë vetes pyetje që mund t’i udhërrëfejnë përpjekjet tona për dhënien e shërbesës. Anëtarët mund të diskutojnë se si këto pyetje mund t’i udhërrëfejnë përpjekjet e tyre dhe më pas kërkon përgjigje ndaj pyetjes së Motrës Bingham: “Cilët janë disa shembuj të dhënies së shërbesës?” Ju mund të shpenzoni kohë duke shqyrtuar disa nga shembujt që jep Motra Bingham për individët që japin shërbesë, dhe ftojini anëtarët që të japin shembuj nga vetja. Çfarë gjejmë te mesazhi i Motrës Bingham që na e shton kuptueshmërinë për arsyen përse dhe mënyrën se si të japim shërbesë?

Diter F. Uhtdorf, “*Shiheni Njeriun!*”, f. 107–110

Si do ta ndihmonim dikë që të kuptonte se flijimi shlyes dhe Ringjallja e Jezu Krishtit ishin ngjarjet më të rëndësishme në historinë e botës? Ftojini anëtarët ta përsiatin këtë pyetje tekta lexojnë pjesë nga mesazhi i Plakut Uhtdorf. Çfarë gjejnë që do të ndihmonte për të shpjeguar arsyen përse këto ngjarje janë kaq të rëndësishme për ta? Pas këtij diskutimi, anëtarët e klasës mund të flasin rreth asaj që do të thotë për ta që ta “sh[ohin] njeriun”. Si kemi mësuar që ta “sh[ohim] njeriun”?

Kuentin L. Kuk, “*Përgatituni që të Takoni Perëndinë*”, f. 114–117

Ju mund ta filloni diskutimin tuaj për mesazhin e Plakut Kuk duke e ftuar një anëtar të përmbledhë rivendosjen e çelësave të priftërisë në Tempullin e Kirtlandit. Sipas mesazhit të Plakut Kuk, çfarë përgjegjësish ka Kisha të cilat lidhen me këta çelës? Si shfaqen këto përgjegjësi në Kishë sot? Shkruajini në tabelë fjalët *drejtësi*, *unitet* e *barazi* dhe kërkojuni anëtarëve të japin ide që i fitojnë për secilin prej këtyre parimeve nga mesazhi i Plakut Kuk. Si na ndihmojnë këto parime që t’i përmbushim përgjegjësitë e shenjta të Kishës?



Mbledhjet e të

Dielës së Katërt

Në të dielën e katërt të çdo muaji, kuorumet e pleqve dhe Shoqatat e Ndhmës diskutojnë një temë të përzgjedhur nga Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve. Tema e të dielës së katërt do të përditësohet pas çdo konference të përgjithshme. Nga tani deri në konferencën e përgjithshme të ardhshme tema do të jetë “Dhënia e Shërbesës ndaj të Tjerëve”. Çdo muaj, udhëheqësit ose mësuesit mund të zgjedhin të udhëheqin diskutime mbi njërin prej parimeve vijuese që lidhen me dhënien e shërbesës.

Për burime shtesë që i mbështetin diskutimet rreth dhënies së shërbesës, shihni ministering.lds.org dhe artikujt “Parimet e Dhënies së Shërbesës” në numrat e ardhshëm të *Liahonës*.

Çfarë do të thotë të japësh shërbesë?

Çfarë do të thotë *dhënia e shërbesës* për anëtarët e lagjes ose degës suaj? Për ta zbuluar këtë gjë, ju mund të shkruani në tabelë *Dhënia e Shërbesës* dhe më pas ftojini anëtarët të shkruajnë fjalë përreth kësaj, të cilat i lidhin me dhënien e shërbesës. Anëtarët mund të gjejnë fjalë ose fraza për t’ia shtuar listës nga shkrime të shenjta si ato që vijojnë: Mateu 25:34–40; Lluka 10:25–37; 2 Nefi 25:26; Mosia 18:8–9; 3 Nefi 18:25; dhe Doktrina e Besëlidhje 81:5. Çfarë mësojmë nga këto vargje rreth

dhënies së shërbesës? Ju mund t’u kërkojuni anëtarëve të japin shembuj që i kanë parë për dhënien e shërbesës. Si mund të ndihmojë dhënia jonë e shërbesës për të plotësuar nevojat shpirtërore dhe materiale të njerëzve? Si mund t’i ndihmojë ajo njerëzit që të vijnë më pranë Krishtit?

Shpëtimtari është shembulli ynë i përkryer i dhënies së shërbesës.

Që të mësojnë se si të japin shërbesë në mënyrë të efektshme, anëtarët mund të tregojnë histori nga shkrimet e shenjta në të cilat Shpëtimtari u dha shërbesë të

tjerëve – disa shembuj mund të gjenden te Gjoni 4–6 dhe Marku 2:1–12. Anëtarët mund të tregojnë se çfarë u bën përshtypje rreth këtyre historive dhe çfarë parimesh mësojnë rreth dhënies së shërbesës. Për shembull, si e përshtati Shpëtimtari shërbimin e Tij ndaj të tjerëve? Si i plotësoi Ai nevojat shpirtërore të njerëzve si edhe nevojat materiale? Anëtarët e klasës mund të tregojnë raste kur i kanë parë njerëzit t'i përdorin këto parime në dhënien e shërbesës prej tyre.

Dhënia e shërbesës nxitet nga dashuria si e Krishtit.

Për ta shqyrtuar fuqinë e dhënies së shërbesës, të nxitur nga dashuria si e Krishtit, ju mund të shkruani fjalitë vijuese në tabelë dhe t'i ftoni anëtarët të sugjerojnë mënyra se si t'i plotësojnë hapësirat bosh: *Kur i dua me të vërtetë njerëzit të cilëve u shërbej, unë _____.* *Kur shërbej për arsye të tjera, unë _____.* Çfarë mund të bëjmë që të sigurohemi se dhënia e shërbesës sonë për të tjerët nxitet nga dashuria e ngjashme me të Krishtit? Si zhvillojmë dashuri si e Krishtit për ata të cilëve jemi caktuar t'u japim shërbesë? (Shih Moroni 7:45–48.) Ndoshta anëtarët mund të japin shembuj të dhënies së shërbesës që u frymëzua nga dashuria si e Krishtit.

Perëndia do që fëmijët e Tij të vëzhgohen dhe për ta të tregohet kujdes.

Presidenti Rasëll M. Nelson tha: “Një tipar dallues i Kishës së vërtetë dhe të gjallë të Zotit do të jetë gjithmonë një përpjekje e organizuar, e drejtuar për t'u dhënë shërbesë fëmijëve individualë të Perëndisë dhe familjeve të tyre” (“Dhënia e Shërbesës me Fuqinë dhe Autoritetin e Perëndisë”, *Liahona*, maj 2018, f. 69). Sipas mesimit që na jep Presidenti Nelson, cilat janë disa prej mënyrave të “organizuar[a], [të] drejtuar[a]” sipas të cilave Kisha mund të na ndihmojë që të kujdesemi më mirë për individët? Përse janë këto përpjekje “një tipar dallues i Kishës së vërtetë dhe të gjallë të Zotit”? (Shih Mosia 18:21–22 dhe Moroni 6:4–6 për disa ide.) Çfarë bekimesh kanë ardhur në jetën tuaj ose në jetën e të tjerëve ngaqë njerëzit dhanë shërbesë në thirrjet e tyre në Kishë ose në caktimet e tyre?

Vlera e shpirtrave është e madhe në sytë e Perëndisë.

Përvojat e bijve të Mosias tregojnë se mënyra se si i shohim njerëzit e ndikon

mënyrën se si u japim shërbesë atyre. Mund të shkruani në tabelë: *Si i shihnin neftitë lamanitët?* dhe *Si i shihnin bijtë e Mosias lamanitët?* Më pas ftojini anëtarët të shqyrtojnë Mosian 28:1–3 dhe Almën 26:23–26 për të gjetur fjalë dhe fraza që t'i shkruajnë nën secilën prej këtyre thëniesve. Çfarë na mëson ky krahasim se si ndikohet mënyra se si u japim shërbesë njerëzve nga mënyra se si i shohim ata? Si mund të mësojmë t'i shohim njerëzit më shumë siç i sheh ata Perëndia? (Shih DeB 18:10–16.)

Shërbetarët e vërtetë përqendrohen te nevojat e të tjerëve.

Për t'i ndihmuar anëtarët që ta kuptojnë më mirë vlerën e përqendrimit te nevojat e atyre të cilëve u japim shërbesë, ju mund ta krahasoni dhënien e shërbesës me dhënien dhe marrjen e dhuratave. A kemi marrë ndonjëherë një dhuratë domethënëse nga dikush që dukshëm e dinte se çfarë na nevojitej apo çfarë dëshironim? Ku ngjason dhënia e shërbesës me dhënien e një dhurate të menduar mirë? Merrni parasysh të diskutoni histori nga konferenca e përgjithshme më e fundit, të cilat tregojnë se si njerëzit dhanë shërbesë sipas nevojave të të tjerëve (shih, për shembull, Xhin B. Bingham, “Dhënia e Shërbesës Ashtu Siç e Jep Shpëtimtari”, *Liahona*, maj 2018). Anëtarët mund të tregojnë edhe histori të tjera që e paraqitin këtë parim.

Si mund të mësojmë se cilat janë nevojat e të tjerëve? Ftojini secilin anëtar të bëjë një listë të disa prej njerëzve të cilëve u japin shërbesë. Pranë çdo emri ata mund të shkruajnë një përgjigje për pyetjen: “Çfarë i nevojitet këtij njeriu që të vijë më pranë Krishtit?” Si të gjejë zbatim, nxitini anëtarët të përfshijnë ordinancat që mund të ketë nevojë t'i marrë çdo njeri. Ftojini anëtarët të vazhdojnë të mendojnë për këtë pyetje dhe të kërkojnë frymëzim për t'i ndihmuar që të plotësojnë nevojat e të tjerëve.

Zoti do që ne ta pranojmë dhënien e shërbesës nga të tjerët.

Plaku Robert D. Hejls tha: “Plani i ungjillit kërkon dhënie dhe marrje. . . Individët në vështirësi shpesh thonë: ‘Do ta bëj vetë’, . . . ‘Mund të kujdesem për veten time’. Është thënë që askush nuk është aq i pasur sa të mos ketë nevojë për ndihmën e dikujt tjetër, askush nuk është aq i varfër sa të mos jetë i dobishëm në njëfarë mënyre për

bashkënjერიun e tij. Prirja për të kërkuar ndihmë nga të tjerët me vetëbesim dhe për ta dhënë atë me mirësi, duhet të jetë pjesë e vetë natyrës sonë” (“We Can't Do It Alone”, *Ensign*, nëntor 1975, f. 91, 93). Përse jemi nganjëherë ngurrues që të pranojmë ndihmë nga të tjerët? Në çmënyrë gatishmëria jonë për të pranuar ndihmë i bekon njerëzit që na shërbejnë? Jepuni anëtarëve disa çaste që të përsiatin mënyra se si mund të jenë më të çiltër ndaj pranimit të dhënies së shërbesës nga të tjerët. Çfarë sugjeron 1 Korintasve 12:13–21 rreth arsyes përse kemi nevojë për njëri-tjetrin?

Ka shumë mënyra se si mund t'u japim shërbesë të tjerëve.

Për t'i ndihmuar anëtarët që të marrin në shqyrtim mënyrat e shumta se si mund t'i japim shërbesë njëri-tjetrit, ju mund t'i ftoni të rishikojnë mesazhin e Plakut Xhefri R. Holland “Jini me Ta e Forcojini Ata” (*Liahona*, maj 2018, f. 101–103; shih edhe “Parime të Dhënies së Shërbesës” në botimet e ardhshme të *Liahonës*). Anëtarët mund të ndahen në grupe të vogla dhe secili grup mund të mendojë për disa skenarë në të cilët një njeri mund të ketë nevojë për ndihmë. Më pas mund të shkëmbejnë mendime për mënyra të ndryshme sipas të cilave njerëzit mund të japin shërbesë ndaj nevojave shpirtërore dhe materiale të individëve në skenarët. Kërkojuni grupeve t'i tregojnë idetë e tyre dhe të përsiatin nëse ndonjë prej ideve të diskutuara mund t'i bekojë njerëzit të cilëve ata u japin shërbesë. ■





Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve

Ullur, nga e majta: Presidenti M. Rasëll Ballard, Plaku Xhefiri R. Holland, Plaku Ditter F. Uhtdorf, Plaku Dejvid A. Bednar, Plaku Kuentin L. Kuk. Në këmbë, nga e majta: Plaku D. Tod Kristoferson, Plaku Nil L. Andersen, Plaku Ronald A. Rasband, Plaku Geri E. Stivenson, Plaku Dejill G. Renland, Plaku Gerit W. Gong, Plaku Ulises Soaresh.



“Ju bekoj t’i dalloni ato gjëra të cilat mund t’i vini mënjanë, që të mund të harxhoni më shumë kohë në tempull”, tha Presidenti Rasëll M. Nelson gjatë sesionit përmbyllës të Konferencës së Përgjithshme Vjetore të 188-të të Kishës. “Ju bekoj me harmoni dhe dashuri më të madhe në shtëpitë tuaja dhe dëshirë më të thellë për t’u kujdesur për marrëdhëniet tuaja të përgjithshme familjare. Ju bekoj me besim më të madh te Zoti Jezu Krisht dhe aftësi më të madhe për ta ndjekur Atë si dishepujt e vërtetë të Tij.

Ju bekoj ta ngrini zërin tuaj në dëshmi, sikurse e bëj unë tani, që ne jemi përfshirë në veprën e Perëndisë së Plotfuqishëm! Jezusi është Krishti. Kjo është Kisha e Tij, të cilën Ai e drejton nëpërmjet shërbëtorëve të Tij të vajosur.”

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME

